LF-NA-27898-EN-N

European Commission

JRC TECHNICAL REPORTS

Analiza e politikave për zhvillimin rural dhe bujqësor të shteteve të Ballkanit Perëndimor

Autorët (në renditje alfabetike):
Sabahudin Bajramović, Natalija Bogdanov, Jakub Butković, Dragi Dimitrievski, Emil Erjavec, Grigor Gjeci, Ekrem Gjokaj, Bekim Hoxha, Ivana Janeska Stomenkovska, Darko Konjević, Ana Kotevska, Aleksandra Martinović, Iliriana Miftari, Marina Nacka, Dragana Ognjenović, Miroslav Rednak, Emelj Tuna, Tina Volk, Edvin Zhllima

Editorët: Tina Volk, Emil Erjavec, Pavel Ciaian Sergio Gomez y Paloma

2016

South Eastern Europe
SWG RRD
Regional Rural Development Standing Working Group

EUR 27898 EN

JRC Mission

As the science and knowledge service of the European Commission, the Joint Research Centre's mission is to support EU policies with independent evidence throughout the whole policy cycle.

EU Science Hub
ec.europa.eu/jrc

@EU_ScienceHub
EU Science Hub - Joint Research Centre
Joint Research Centre
EU Science Hub

doi:10.2791/744295
ISBN 978-92-79-58014-7

Publications Office

Ky publikim është një Raport Teknik nga Qendra e Përbashkët e Kërkimit, një shërbimi shkencor të brendshëm të Komisionit Evropian. Ky entitet ka si qëllim të ofrojë mbështetje shkencore të bazuara në dëshmi apo fakte për procesin e krijimit të politikave evropiane. Prodhimi shkencor i shprehur nuk nënkupton një pozicion ndaj politikave nga Komisioni Evropian. As Komisioni Evropian e as ndonjë person që vepron në emër të Komisionit është përgjegjës për përdorimin e mundshëm të këtij botimi.

Informacione kontakti

Pavel Ciaian
Adresa: Edificio Expo. c/ Inca Garcilaso, 3. E-41092 Seville (Spain)
E-mail: pavel.ciaian@ec.europa.eu
Tel.: +34 95 448 8429
Fax: +34 95 448 8300

QPK Qendra Shkencore

https://ec.europa.eu/jrc

JRC101320

EUR 27898 EN

PDF ISBN 978-92-79-58014-7 ISSN 1831-9424 doi:10.2791/744295

Luksemburg: Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2016

© Bashkimi Evropian, 2016

Riprodhimi është i autorizuar me kusht që burimi të bëhet i njohur.

Si të citohet: Bajramović, N., Bogdanov, N., Butković, J., Dimitrievski, D., Erjavec, E., Gjeci G., Gjokaj, E.,Hoxha, B., Stomenkovska, I.J., Konjević, D., Kotevska, A.,Martinović, A., Miftari, I., Nacka, M., Ognjenović, D., Rednak, M., Tuna, E., Volk, T., Zhllima E., (autorët); Volk, T., E. Erjavec, P. Ciaian and S. Gomez y Paloma (editorët) (2016). Analiza e politikave për zhvillim rural dhe bujqësor të shteteve të Ballkanit Perëndimor. EUR 27898 EN, Qendra e Përbashkët Kërkimore, Komisioni Evropian, doi:10.2791/744295.

Të gjitha imazhet © Bashkimi Evropian 2016, përveç: imazhit në fund të kopertinës nga ana e majtë: *peizazhi rural malor*; imazhit në fund të kopertinës nga ana e djathtë: *bariu, dhe logoja e SWG-së* © SWG

Parathënie

Procesi i integrimit në BE është një proces shumë kompleks që përfshin hartimin dhe zbatimin e reformave në një gamë të gjerë fushash.

Edhe pse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) janë në faza të ndryshme të zhvillimit, ato përballen me sfida të ngjashme në reformat dhe harmonizimin e politikave, sistemeve të informacionit dhe zhvillimin ekonomik, së bashku me mos-zhvillimin e përgjithshëm dhe kapacitetet e kufizuara institucionale, të cilat vazhdojnë të pengojnë proceset e reformave të Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kontekst, adaptimi i instrumenteve të reja politike dhe përafrimi i tyre me *aktin komunitar t*ë BE-së në bujqësi dhe zhvillim rural kërkon zhvillim të qasjeve për analizë të të dhënave bujqësore për të hedhur dritë mbi atë se çfarë ndikimi mund të kenë politikat e miratuara në sektorin bujqësor. Kjo do të lejoje kuptimin më të mirë të efektivitetit dhe efikasitetit të politikave të miratuara, dhe kështu mund të siguroje mbështetje të bazuar në shkencë për politikëbërjen. Njohuri më gjithëpërfshirëse të efekteve të masave individuale të politikave mbi zhvillimin e sektorit të bujqësisë do të lejonin që, si skemat kombëtare mbështetëse, ashtu edhe Instrumenti për Asistencë Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural (IPARD) të kenë një shënjestër më të mirë.

Përveç kërkesës së politikave për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, bashkëpunimi i zgjeruar rajonal është më i rëndësishëm për marrëdhëniet e ardhshme me BE-në. Ky është një mjet thelbësor i forcimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural që si sjell si rrjedhojepermiresimin e rritjes ekonomike të rajonit.

Objektivat kryesore të raportit janë monitorimi dhe vlerësimi instrumentet aktuale të politikave bujqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe krahasimi me Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) të BE-së.

Raporti trajton tre aspekte kryesore në lidhje me qëllimet dhe objektivat e tij:

- Jep informacione mbi zhvillimet e politikave kombëtare të bujqësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe i krahason ato me politikat e BE-së (Politikën e Përbashkët Bujqësore)

- Siguron një analizë krahasuese ndër-shtetërore të instrumenteve kombëtare të politikave bujqësore, dhe efektet e tyre në sektorët e ushqimit/ të bujqësisë.

- Analizon gjendjen e harmonizimit të politikave bujqësore të vendeve të Ballkanit Perëndimor me PPB.

Raporti është rezultat i punës së vazhdueshme në rajon, i kryer në bashkëpunim të ngushtë midis politikeberesve dhe institucioneve kërkimore në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Raporti jep informacion gjithëpërfshirës dhe analizë në lidhje me zhvillimin e politikave bujqësore në vendet e BP për të mbështetur bërjen e politikave, si dhe për të ofruar bazë solide për bashkëpunim në të ardhmen dhe dialog të vazhdueshëm dinamik ndërmjet politikëbërësve dhe komunitetit kërkimor.

Giampiero Genovese

Kryetari i Njësisë për Ekonomi Bujqësore, Qendra e Përbashkët Kërkimore, Komisioni Evropian

Boban Ilić

Sekretari i Përgjithshëm i Grupit të Përhershëm Punues për Zhvillim Rural Rajonal (SWG) në Evropën Juglindore

Mirënjohjet

Ky raport është rezultat i projektit "Analiza e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural në vendet e Ballkanit Perëndimor", të financuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Qendrës së Përbashkët të Kërkimit të Komisionit Evropian.

Dëshirojmë të falenderojmë të gjitha organizatat dhe individët pjesëmarrës për punën profesionale dhe me entuziazëm të bërë gjatë zbatimit të projektit.

Në veçanti, dëshirojmë të falenderojmë Z. Boban Ilic, Sekretarin e Përgjithshëm të SWG-së, dhe ekipin e zyrës qendrore / sekretariatit të SWG-së, për bashkëpunimin e ngushtë dhe ndihmën e tyre në realizimin e projektit.

Jemi falenderues dhe mirënjohës ndaj Z. Marius Lazdinis nga Drejtoria e Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (Drejtoria A.5) për mbështetjen e tij në zbatim të projektit dhe komentet e tij të vlefshme mbi rezultatet e projektit.

Falenderime të veçanta shkojnë për ekipin akademik ndërkombëtar, të përbërë nga hulumtuesit Emil Erjavec, Tina Volk dhe Miroslav Rednak, të cilët ishin përgjegjës për koordinimin e projektit.

Gjithashtu jemi mirënjohës për punën e ekspertëve akademikë kombëtarë dhe koordinatorëve kombëtarë të projektit, veçanërisht për Edvin Zhllima, Grigor Gjeci, Sabahudin Bajramović, Dushan Neskovic, Dragi Dimitrievski, Gjorgji Bozinov, Aleksandra Martinovic, Darko Konjevic, Natalija Bogdanov, Aleksandar Bogunovic, Bekim Hoxha dhe Iliriana Miftari.

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për menaxheren rajonale të projektit, Irena Dzimrevska. Është gjithashtu për tu vlerësuar shumë asistenca teknike nga Oliver Pop Arsov.

Përmbajtja

Parathënie **2**

Mirënjohjet **4**

Lista e figurave **7**

Lista e tabelave **9**

Lista e shkurtesave **11**

1. Gjendja aktuale dhe tendencat e politikave bujqësore në vendet që synojnë anëtarësimin në BE nga Ballkani Perëndimor **13**

1.1 Hyrje 13

1.2 Shënimet mbi metodologjinë 15

1.3 Situatat dhe tendencat në bujqësinë e BP-së 15

1.4 Kuadri i politikave bujqësore 21

1.5 Transfertat buxhetore për bujqësi 26

1.6 Struktura e fermave si çështje e politikave 34

1.7 Procesi i integrimit në BE për bujqësi 37

1.8 Konkluzionet dhe rekomandimet mbi politikat 39

2. Shqipëria: Përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore **44**

2.1 Zhvillimi ekonomik 44

2.2 Zhvillimi bujqësor 45

2.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 48

2.4 Çështjet e fermave 54

2.5 Procesi i integrimit në BE 55

2.6 Fuqitë dhe dobësitë e bujqësisë Shqiptare 56

2.7 Rekomandimet 60

3. Bosnja dhe Hercegovina: Përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore **62**

3.1 Zhvillimi ekonomik 62

3.2 Zhvillimi bujqësor 63

3.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 68

3.4 Çështjet e fermave 75

3.5 Procesi i integrimit në BE 76

3.6 Fuqitë dhe dobësitë e bujqësisë 77

4. Kosova*: përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore **81**

4.1 Zhvillimi ekonomik 81

4.2 Zhvillimi bujqësor 82

4.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 85

4.4 Çështjet e fermave 90

4.5 Procesi i integrimit në BE 90

4.6 Forcat dhe dobësitë e bujqësisë 92
5. IRJ Maqedonia: përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore 93
5.1 Zhvillimi ekonomik 93
5.2 Zhvillimi bujqësor 94
5.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 98
5.4 Rekomandimet e politikave 103
6. Mali i Zi: përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore 105
6.1 Zhvillimi ekonomik 105
6.2 Zhvillimi bujqësor 105
6.3 Zhvillimi i politikave bujqësore 108
6.4 Çështjet e fermave 112
6.5 Procesi i integrimit në BE 112
6.6 Fuqitë dhe dobësitë e bujqësisë 114
7. Serbia: përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore.....116
7.1 Hyrje 116
7.2 Zhvillimi ekonomik 116
7.3 Zhvillimi bujqësor 117
7.4 Zhvillimi i politikave bujqësore 124
7.5 Çështjet e fermave 131
7.6 Procesi i integrimit në BE 133
7.7 Përfundimet dhe rekomandimet 134
Referencat 139

Lista e figurave

Figura 1.1. Ndryshimet e vëllimit të prodhimit të mallrave bujqësore në shtetet e BP-së, 2005–2014 (2010 = 100) 17

Figura 1.2. Përbërja rajonale e eksporteve dhe importeve të produkteve agroushqimore në shtetet e BP-së (%) 20

Figura 1.3. Shpenzimet totale buxhetore për sektorin agro-ushqimor dhe zonat rurale në shtetet e BP-së (EUR/ha SBSH), 2012–2014 26

Figura 1.4. Shpenzimet totale buxhetore për sektorin e agroushqimor dhe zonat rurale sipas shtyllave të MPB-së në shtetet e BP-së, 2012–2014 (2012 = 100) 27

Figura 1.5. Mbështetja direkte e prodhimit në shtetet e BP-së (EUR/ha SBSH), 2012–2014 28

Figura 1.6. Zhvillimi i shpenzimeve dhe përbërja e masave të mbështetjes direkte prodhuese në shtetet e BP-së, 2012–2014 (2012 = 100) 29

Figura 1.7. Masat për zhvillimin strukturor dhe rural në shtetet e BP-së (EUR/ha SBSH), 2012–2014 32

Figura 1.8. Ecuria i shpenzimeve dhe përbërja e masave të zhvillimit strukturor dhe rural në shtetet e BP-së, 2012–2014 (2012 = 100) 33

Figura 1.9. Masat e përgjithshme të mbështetjes në shtetet e BP-së (EUR/ha SBSH), 2012–2014 34

Figura 2.1. Shqipëria: treguesit kryesor makroekonomik (% e rritjes nga viti kaluar; % e papunësisë), 2005–2014 44

Figura 2.2. Shqipëria: toka bujqësore sipas kategorive kryesore (000 ha), 2005–2014 46

Figura 2.3. Shqipëria: tregtia agroushqimore (milion EUR), 2005–2014 48

Figura 2.4. Shqipëria: mbështetja buxhetore për bujqësinë (milion EUR), 2005–2014 51

Figura 2.5. Shqipëria: Përbërja e masave direkte të mbështetjes (milion EUR), 2005–2014 51

Figura 2.6. Shqipëria: Përbërja e pagesave direkte për prodhuesit (milion EUR), 2005–2014 52

Figura 2.7. Shqipëria: Përbërja e masave t Përbërja zhvillimit strukturor dhe rural (milion EUR), 2005–2014 53

Figura 2.8. Shqipëria: Përbërja e masave të përgjithshme lidhur me bujqësinë (milion EUR), 2005–2014 53

Figura 3.1. Bosnja dhe Hercegovina: treguesit kryesor makroekonomik (% rritjes nga viti kaluar; % e papunësisë), 2005–2014 63

Figura 3.2. Bosnja dhe Hercegovina: tregtia agroushqimore (milion EUR), 2005–2014 65

Figura 3.3. Bosnja dhe Hercegovina: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë (milion EUR), 2005–2014 72

Figura 4.1. Kosova*: treguesit kryesorë makroekonomik (% rritje nga viti kaluar; % e papunësisë), 2005–2014 81

Figura 4.2. Kosova*: tregtia e produkteve agroushqimore (milion EUR), 2005–2014 83

Figura 4.3. Kosova*: Shpenzimet buxhetore për bujqësinë dhe zonat rurale (milion EUR), 2008–2014 86

Figura 4.4. Kosova*: Përbërja e masave të lidhura me aftësinë konkurruese (milion EUR), 2008–2014 89

Figura 4.5. Kosova*: Përbërja e mbështetjes së shërbimeve të përgjithshme në bujqësi (milion EUR), 2008–2014 89

Figura 5.1. IRJ Maqedonia: treguesit kryesor makroekonomikë (% rritje nga viti kaluar; % e papunësisë), 2005–2014 .. 93

Figura 5.2. IRJ Maqedonia: rritja reale e çmimit të prodhimit bujqësor, 2005–2014 (2010 = 100) 94

Figura 5.3. IRJ Maqedonia: tregtia agro-ushqimore (milion EUR), 2005–2014 95

Figura 5.4. IRJ e Maqedonisë: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë (milion EUR), 2008–2014 99

Figura 6.1. Mali i Zi: tregtia e produkteve agroushqimore (milion EUR), 2005–2014 107

Figura 6.2. Mali i Zi: përbërja e mbështetjes buxhetore për bujqësinë, 2011–2014 110

Figura 6.3. Mali i Zi: përbërja e pagesave direkte për prodhuesit,2011–2014 111

Figura 6.4. Mali i Zi: përbërja e masave për zhvillimin strukturore dhe rurale, 2011–2014 111

Figura 6.5. Mali i Zi: përbërja e masave mbështetëse të shërbimeve të përgjithshme, 2011–2014 112

Figura 7.1. Serbia: treguesit e prodhimit bujqësor, 2005–2014 (2010 = 100) 118

Figura 7.2. Serbia: treguesit real të çmimeve të prodhimit bujqësor, 2005–2014 (2010 = 100) 119

Figura 7.3. Serbia: tregtia e produkteve agroushqimore (milion EUR), 2005–2014.....119
Figura 7.4. Serbia: eksportet dhe importet e produkteve agroushqimore sipas tregjeve kryesore (mln EUR), 2005–2014120
Figura 7.5. Serbia: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë (milion EUR), 2005–2014.....126
Figura 7.6. Serbia: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për masat direkte mbështetëse të prodhuesve (milion EUR), 2005–2014 127
Figura 7.7. Serbia: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për pagesa direkte për prodhuesit (milion EUR), 2005–2014 127
Figura 7.8. Serbia: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për subvencionimin e inputeve variabël (milion EUR), 2005–2014 128
Figura 7.9. Serbia: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për zhvillimin rural (milion EUR), 2005–2014.....128

Lista e tabelave

Tabela 1.1. Të dhënat kryesore makroekonomike për shtetet e BP-së, 2014 15
Tabela 1.2. Të dhënat kyçë në shtetet e BP-së, 2014 16
Tabela 1.3. Përqindja e prodhimeve agroushqimore në tregtinë e jashtme të mallrave të shteteve të BP-së, 2014 18
Tabela 1.4. Raporti eksport-import i produkteve agroushqimore në shtetet e BP-së (%), 2010–2014 18
Tabela 1.5. Tregtia e produkteve agroushqimore në shtetet e BP-së (miliona EUR), 2012–2014 19
Tabela 1.6. Përbërja e eksporteve agro-ushqimore sipas grupeve më të rëndësishme tarifore në shtetet e BP-së (%) 19
Tabela 1.7. Numri i mallrave të subvencionuara nën skemën e pagesave direkte në shtetet e BP-së, 2005–2014 30
Tabela 1.8. Ndryshimet në vlera të pagesave direkte për mallra, në shtetet e zgjedhura të BP-së, 2014 (2013 = 100) 31
Tabela 1.9. Struktura e fermave në shtetet e BP-së 35
Tabela 2.1. Shqipëria: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014 44
Tabela 2.2. Shqipëria: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014 45
Tabela 2.3. Shqipëria: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2013 46
Tabela 2.4. Shqipëria: Zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore mes viteve 2005 dhe 2014 47
Tabela 2.5. Shqipëria: masat dhe instrumentet kryesore të politikave bujqësore, 2005 dhe 2014 49
Tabela 2.6. Shqipëria: të dhënat kryesore mbi strukturën e fermave, 2012 54
Tabela 2.7: Shqipëria: Fuqitë dhe dobësitë e bujqësisë dhe zonave rurale dhe politikat e lidhura me to 57
Tabela 3.1. Bosnja dhe Hercegovina: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014 62
Tabela 3.2. Bosnja dhe Hercegovina: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014 63
Tabela 3.3. Bosnja dhe Hercegovina: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2014 64
Tabela 3.4. Bosnja dhe Hercegovina: zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore mes viteve 2005 dhe 2014 64
Tabela 3.5. Bosnja dhe Hercegovina: masat dhe instrumentet kryesore të politikave bujqësore, 2005 dhe 2014 70
Tabela 3.6. Bosnja dhe Hercegovina: fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (SWOT) analiza e sektorit bujqësor ... 78
Tabela 4.1. Kosova*: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014 81
Tabela 4.2. Kosova*: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014 82
Tabela 4.3. Kosova*: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2013 83
Tabela 4.4. Kosova*: zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore në periudhën 2007 dhe 2014 84
Tabela 4.5. Masat e zgjedhura të zbatohen në Kosovë* gjatë 2014–2020 86
Tabela 4.6. Kosova*: masat dhe instrumentet kryesore të politikave bujqësore, 2008 dhe 2014 87
Tabela 4.7. Kosova*: Fuqitë dhe dobësitë e sektorit bujqësor dhe të zonave rurale 92
Tabela 5.1. IRJ Maqedonia: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014 93
Tabela 5.2. IRJ Maqedonia: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014 94
Tabela 5.3. IRJ Maqedonia: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2014 96
Tabela 5.4. IRJ e Maqedonisë: treguesit kryesor të strukturës së fermave, 2013 96
Tabela 5.5. IRJ e Maqedonisë: zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore 97
Tabela 5.6. IRJ e Maqedonisë: masat dhe instrumentet kryesore të politikave bujqësore, 2008 dhe 2014 100
Tabela 6.1. Mali i Zi: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014 105
Tabela 6.2. Mali i Zi: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014 106
Tabela 6.3. Mali i Zi: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2014 106
Tabela 6.4. Mali i Zi: zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore mes viteve 2007 dhe 2014 108

Tabela 6.5. Mali i Zi: Përbërja buxhetore për bujqësi sipas grupeve të masave (EUR 000), 2008–2015 110
Tabela 6.6. Mali i Zi: treguesit kryesor të strukturës së fermave, 2010 112
Tabela 6.7. Mali i Zi: Analiza SWOT e sektorit bujqësor 115
Tabela 7.1. Serbia: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014 116
Tabela 7.2. Serbia: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014 117
Tabela 7.3. Serbia: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2014 117
Tabela 7.4. Serbia: zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore mes viteve 2005 dhe 2014 121
Tabela 7.5. Serbia: masat dhe instrumentat kryesorë të politikave bujqësore; 2005 dhe 2014 129
Tabela 7.6. Serbia: treguesit kryesor të strukturës së fermave, 2012 132

Lista e shkurtesave

:	Nuk disponohet
SB	Sipërfaqe Bujqësore
AGMEMOD	Modelimi Bujqësor i Shteteve Anëtare (MBSHA)
SDIB	Sistemi i Dijes dhe Inovacionit Bujqësor
AL	Shqipëria
MPB	Masat e politikave bujqësore
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
PZHBR	Programi për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
SZHBR	Strategjia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
QTTB	Qendra e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore
NJVP	Njësia vjetore e punës
BA	Bosnja dhe Hercegovina
QB	Qarku Bërçko
PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore
SPMNPB	Sistemi i Përbashkët i Modelimit të Ndikimit të Politikave Bujqësore
CEFTA	Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
FEBZHR	Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural
FEGB	Fondi Evropian për Garanci Bujqësore
AETL	Shoqata Evropiane për Tregti të Lirë
BEI	Banka Evropiane për Investime
BE	Bashkimi Evropian
RRDHKF	Rrjeti i të Dhënave të Kontabilitetit të Fermave
FAO	Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara (FAO)
FBH	Federata e Bosnje-Hercegovinës
IHD	Investimet e huaja direkte
MTL	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë
PBB	Prodhimi Bujqësor Bruto
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PATG	Projekti i Analizës së Tregtisë Globale
VSHB	Vlera e shtuar bruto
VNL	Vlera e natyrës (kuptimit) së lartë
SIAK	Sistemi i Integruar i Administratës dhe Kontrollit
MIF-PPB	Modeli Individual i Fermës për Analizë të Politikës së Përbashkët Bujqësore
INSTAT	Instituti i Statistikave i Shqipërisë
IPA	Instrumenti për Asistencë Para-anëtarësimit
IPARD	Instrumenti për Asistencë Para-anëtarësimit për Zhvillim Rural

SNBZHR	Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
QPK (JRC)	Qendra e Përbashkët Kërkimore e Drejtorisë së Përgjithshme
GLV	Grupi lokal i veprimit
LBZHR	Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
LSBZHR	Ligji për Subvencione për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
LEADER	Liaison Entre Actions de Développement de l'Économie Rurale (lidhjet mes ekonomisë rurale dhe veprimeve zhvillimore)
ZMPF	Zonë më pak e favorizuar
SIPT	Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës
NJSB	Njësia standarte e bagëtisë
AZHZM	Agjenci për Zhvillim të Zonës Malore
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MBPEU	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë Ujore
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujit
ME	Mali i Zi
MIDAS	Zhvillimi Institucional dhe Fuqizimi Bujqësor i Malit të Zi
MK	Ish-republika Jugosllave e Maqedonisë
MONSTAT	Zyra Statistike e Malit të Zi
SKZHBR	Strategjia Kombëtare për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
PFB (PPS)	Pariteti i fuqisë blerëse
RS	Serbia
RSr	Republika Serbe e Bosnjës
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit
SARED	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik Bujqësor dhe Rural
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
PS	Prodhimi standart
SORS	Zyra e Statistikave e Republikës së Serbisë
SWG	Grupi i Përhershëm Punues për Zhvillim Rural Rajonal
SWOT	Fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet
SBSH	Sipërfaqe bujqësore e shfrytëzuar
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
BP	Ballkani Perëndimor
WTO	Organizata Botërore e Tregtisë
XK	Kosova, nën Rregulloren 1244/99o të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, në referenca përdoret si Kosovë*

1. Gjendja aktuale dhe tendencat e politikave bujqësore në vendet që synojnë anëtarësimin në BE nga Ballkani Perëndimor

Emil Erjavec[1], Tina Volk[2], Miroslav Rednak[2]

[1]Fakulteti Bio-teknik, Universiteti i Lubjanës

[2]Instituti Bujqësor i Sllovenisë

1.1 Hyrje

Bujqësia është sektor ekonomikisht dhe politikisht i rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor,[1] i karakterizuar nga deficiti strukturor, burime dhe potenciale të prodhimit jo te shfrytëzuara plotesisht, zinxhir agro-ushqimor të pazhvilluar, margjinalizim të zonave rurale dhe, me përjashtim të Serbisë, deficit tregtar neto. Këto janë disa nga gjetjet e një studimi të gjerë nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO) (Volk et al. 2014; këtu referohet si studimi FAO) që tenton të përcaktoje sfidat dhe dobësitë e përbashkëta të politikave bujqësore në rajon, dhe të nxjerre në pah hapat e ardhshme që duhet të ndërmerren për të mbështetur përafrimin e tyre me Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE-së (PPB), si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE.

Studimi i FAO-s gjithashtu theksoi se, si në nivelin e mbështetjes ashtu dhe në përbërjen e instrumenteve bujqësore, politikat bujqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) nuk janë në nivel të njëjtë me PPB. Megjithatë, ato janë në nivel të krahasueshëm me ato të shteteve anëtare të reja të BE-së, kur ato ishin në fazën ekuivalente të procesit të integrimit në BE. Ka pasur një rritje të dukshme në nivelin e mbështetjes para ndodhjes së krizës ekonomike, por masat e politikave bujqësore janë subjekt i ndryshimeve të shpeshta, duke rezultuar në një kornizë të paqëndrueshme të politikave të nevojshme për të mbështetur zhvillimin afatgjatë të sektorit. Forma mbizotëruese e mbështetjes në vendet e Ballkanit Perëndimor është e shoqëruar me pagesa direkte, ndërkohë që politika e zhvillimit rural është mjaft e parëndësishme (me përjashtim të mbështetjes së investimeve në bujqësi). Ekziston gjithashtu një mungesë e dukshme e mbështetjes më të synuar për mjedisin, zonat margjinale rurale, transferim të njohurive dhe menaxhim të risqeve.

Politikëbërja bujqësore moderne është e bazuar në konceptin e ciklit të politikave, e cila mbështetet në qasjen e bazuar në dëshmi e fakte - monitorim dhe vlerësim të ndikimit - për të identifikuar prioritetet dhe kufizimet e politikave të propozuara dhe të miratuara. Ekziston një qasje e vendosur mbi programimin strategjik në rajon, por pa një cikël të qëndrueshëm të politikave të bazuara në dëshmi sistemi ekzistues i monitorimit dhe i vlerësimit të ndikimit është relativisht i dobët,. Monitorimi, sistemimi dhe zbatimi i qëndrueshëm i një matësi sasior të krahasueshëm ndërkombëtarisht të masave të politikave bujqësore mund të jape një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e praktikave të politikëbërjes, dhe ndihmon procesin e integrimit në BE.

---

[1] Shprehja 'Ballkani Perëndimor' përdoret për të përmbledhur shtetet e rajonit në nivelet e ndryshme të integrimit në BE: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova* (në përputhje me UNSCR 1244 dhe Opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës), Maqedonia, Mali i Zi, dhe Serbia.

Duke u bazuar në këto rezultate, objektivat kryesore të këtij raporti janë monitorimi dhe vlerësimi i politikave aktuale bujqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe vlerësimi i harmonizimit të tyre me PPB. Ky raport, ashtu si studimi i FAO-s, ndërtohet mbi punën e mëparshme të zhvilluar në kuadër të programit kërkimor të 7-të të Bashkimit Evropian, "Agro-politika", i cili u përpoq të zhvilloje nje mjet të ri analitik për të mbështetur grupet e interesit në rajon dhe komunitetin ndërkombëtar në monitorimin dhe vlerësimin e politikave bujqësore në vendet e BP-së (Volk, 2010).

Ky punim gjithashtu gjeti një vend të veçantë në kuadër të aktiviteteve të Grupit të Përhershëm Punues për Zhvillim Rajonal Rural (SWG), i cili bëri të mundur monitorimin e mëtejshëm të politikave bujqësore në vendet e BP përmes zbatimit të projektit "Analiza e politikave të zhvillimit rural dhe të bujqësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor", të financuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Qendrës së Përbashkët Kërkimore (JRC) të Komisionit Evropian. Qëllimet kryesore të këtij projekti ishin që të ofronte mbështetje analitike për vendimmarrësit në rajon duke i përditësuar statistikat bujqësore, si dhe për të dhënë monitorim cilësor dhe sasior të politikave bujqësore.

Së pari, ky raport ofron një analizë krahasuese ndër-shtetërore të politikave bujqësore kombëtare dhe të efekteve të tyre në sektorin e ushqimit/bujqësisë në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëri (AL), Bosnje dhe Hercegovinë (BA), Kosovë* (XK), ish-Republikën Jugosllave (IRJ) të Maqedonisë (MK), Mal të Zi (ME) dhe Serbi (RS) (kapitulli aktual). Së dyti, ky raport gjithashtu ofron analizë specifike të instrumentave të politikave bujqësore për secilin nga gjashtë vendet e prezantuara (Informacione mbi politikat bujqësore të shteteve, në Kapitujt 2 deri 7). Analizat janë të bazuara në metodologjinë e masave të politikave bujqësore (MPB), të zhvilluar posaçërisht për këtë qëllim, e cila siguron një bazë të dhënash të përbashkët dhe të qëndrueshme rajonale mbi politikat bujqësore (Rednak et al. 2013). Më tej, për të analizuar strukturën dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor, janë mbledhur dhe harmonizuar statistika bujqësore rajonale për t'i bërë ato të qëndrueshme dhe të krahasueshme në të gjitha vendet e studiuara. Është e rëndësishme të theksohet se ky raport është një raport vazhdues i studimit të FAO-s. Për këtë arsye, ai fillimisht fokusohet në zhvillimet e politikave bujqësore në periudhën 2013-2015, pas përfundimit të studimit të FAO-s. Në këtë mënyrë, raporti sjell vazhdimësi në monitorimin e politikave bujqësore, si dhe ndihmesë për diskutimin e vazhdueshëm lidhur me çështjet kyçe të zhvillimit në bujqësi dhe në politika bujqësore, me një fokus të veçantë në procesin e integrimit në BE.

Me këtë kontribut synojmë të vendosim gjetjet në nivel kombëtar brenda kontekstit rajonal dhe te përpiqemi të sqarojmë dhe të zgjerojmë aspektet e reja të çështjeve të politikave bujqësore që fillimisht janë trajtuar në studimin e FAO-s. Objektivi kryesor është të krahasohet gjendja dhe ndryshimet e fundit në bujqësi dhe politika bujqësore në bazë të rezultateve të fituara nga aplikimi i metodes analitike MPB[2].

Ky kapitull fillon me një përshkrim të shkurtër të metodologjisë dhe pastaj e vijon me analizën e zhvillimit të sektorit bujqësor në vendet e Ballkanit Perëndimor. Kapitulli gjithashtu diskuton zhvillimin e strukturës bujqësore, me fokus të veçantë në konsolidimin e tokës dhe zhvillimin e fermave të vogla, që rrjedh nga konstatimi se disa nga politikat bujqësore në rajon vendosin theks shumë të vogël në reformat e tokës dhe çështjet e trajtimit të pabarabartë te të gjitha llojeve të fermave brenda sistemeve të mbështetjes së drejtpërdrejtë, që shkon kundër disa parimeve themelore të politikave moderne bujqësore dhe veçanërisht PPB-së. Në seksionin vijues, kapitulli ofron analizë krahasuese ndërshtetërore të instrumenteve kombëtare të politikave bujqësore në vendet e BP-së. Më pas kapitulli vazhdon me diskutimin e çështjeve kryesore të harmonizimit dhe rregullimit të PPB-së në kontekst të procesit të vazhdueshëm të

[2] Në këtë raport po përqendrohemi në krijimin e pikave të referimit për statistika dhe transferime buxhetore në kontekst rajonal. Për më shumë detaje mbi krahasimin e politikave bujqësore të shteteve të BP-së brenda PPB-se së BE-së, shikoni studimin e FAO-s (Volk et al. 2014).

integrimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ai përfundon me disa përfundime të përgjithshme dhe rekomandime të politikave për politikëbërësit.

1.2 Shënimet mbi metodologjinë

Analizat e kryera në këtë raport mbështeten në dy bazat e të dhënave të përgjithshme dhe të qëndrueshme rajonale, të zhvilluara për të studiuar zhvillimin e sektorit bujqësor dhe të politikave bujqësore në shtetet e BP-së. Baza e parë e të dhënave përmban statistika bujqësore, kurse e dyta ofron të dhëna të përgjithshme mbi MPB në shtetet e BP-së.

Prezantimi i tendencave aktuale në zhvillimin e sektorit të bujqësisë në AL, BA, XK, MK, ME dhe RS është i bazuar në të dhënat statistikore të mbledhura nga ekspertët kombëtarë. Burimet kryesore të të dhënave ishin zyrat kombëtare (ose nën-kombëtare) statistikore dhe institucione të tjera që merren me statistika bujqësore në këto shtete. Në këtë kuadër, janë mbledhur një grup i statistikave kryesore të përgjithshme, bujqësore dhe tregtare, qe mbulojne periudhën 2005-2014. Përveç kësaj, janë përdorur edhe të dhënat nga Baza e të dhënavebaza e të dhënave të Eurostat. Edhe pse shumica e vendeve te BP-se kanë bërë progres në harmonizimin e statistikave të tyre bujqësore me metodologjinë e BE-së, grupet e të dhënave të mbledhura janë kryesisht jo të plota dhe ende nuk janë tërësisht të krahasueshme midis vendeve dhe me BE-në. Për këtë arsye, ishte e nevojshme të harmonizohen të dhënat statistikore të mbledhura nga burime të ndryshme. Në këtë raport janë prezantuar dhe përshkruar një grup i zgjedhur i treguesve bujqësor kyç, me qëllim paraqitjen e profilit kryesor dhe tendencave të bujqësisë në BP.

Për analizën sasiore të politikave bujqësore është përdorur baza e të dhënave të Baza e të dhënaveMPB. Kjo bazë të dhënash Baza e të dhënaveështë hartuar nga ekspertët kombëtare për gjashtë vendet e BP-se. Në këtë bazë të dhënash, të gjitha informacionet në dispozicion në lidhje me politikat bujqësore mblidhen në nivel të masave të hollësishme, në bazë vjetore. Kështu, janë mbledhur si karakteristikat e çdo mase të politikave, ashtu edhe transferimet e zbatuara buxhetore (monetare). Analiza e mbështetjes së bujqësisë në këtë raport fokusohet në vitet 2012-2014, edhe pse Baza e të dhënavebaza e të dhënave të MPB janë hartuar për një periudhë më të gjatë.

Masat e mbeshtetjes në bazë e të dhënave të e MPB janë të sistemuara dhe klasifikuara sipas një formati të përbashkët, e cila mundëson analiza cilësore dhe sasiore ndër-shtetërore të politikave të zbatuara bujqësore. Sipas klasifikimit MPB, masat specifike të politikave bujqësore janë grupuar në tri shtylla kryesore: (i) masat e drejtpërdrejta të mbështetjes së tregut dhe prodhuesit; (ii) masat strukturore dhe të zhvillimit rural; dhe (iii) masat e përgjithshme të lidhura me bujqësinë. Klasifikimi MPB përdor konceptin e BE-së për klasifikimin e politikave, të kombinuar me metodologjinë e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) (OECD 2008). Klasifikimi MPB është ndërtuar mbi një parim hierarkik, ku niveli i parë përcakton shtyllën e politikave bujqësore, niveli i dytë përcakton kategorinë e politikave, dhe çdo nivel i mëtejshëm ndahet në grupe të nën-kategorive, sipas metodologjisë së OECD (Rednak et al. 2013).

1.3 Situatat dhe tendencat në bujqësinë e BP-së

1.3.1 Bujqësia është sektor i rëndësishëm ekonomik në shtetet e BP-së

Tabela 1.1. Të dhënat kryesore makroekonomike për shtetet e BP-së, 2014

	AL	BA	XK	MK	ME	RS	EU-28
Sipërfaqja totale (000 km^2)	28.7	51.2	10.9	25.7	13.8	88.5[a]	4,467.8
(% e BE-së - 28)	(0.6)	(1.1)	(0.2)	(0.6)	(0.3)	(2.0)	(100.0)
Popullata me 1 Janar (000 banorë) (% të	2,910	3,836	1,805	2,069	622	7,132	506,881
BE-së - 28)	(0.6)	(0.8)	(0.4)	(0.4)	(0.1)	(1.4)	(100.0)

Dendësia e popullsisë (banorë/km^2)	101	75	165	80	45	92[b]	113
PBB (EUR miliardë)[c]	10.1	13.8	5.5	8.5	3.4	33.1	13,924.6
(% e BE-së - 28)	(0.1)	(0.1)	(0.0)	(0.1)	(0.0)	(0.2)	(100.0)
PBB për frymë (EUR)[c]	3,468	3,605	2,935[d]	3,930[d]	5,356[d]	4,635	27,325
(% e BE-së - 28 në PFB)	(29)	(28)	(:)	(36)	(39)	(35)	(100)
VSHB bujqësi, pyje, peshkim (% e totalit të VSHB-së)[c]	23.1	7.6	13.8	10.2	9.8[d]	9.7	1.6

Burimi: Baza e Të dhënave Statistikore Bujqësore, Eurostat.
a Duke përfshirë Kosovën*.
b Pa Kosovën*.
c Të dhëna paraprake.
d 2013.
:, nuk ka të dhëna; PBB, prodhimi brendshem bruto; VSHB, vlera e shtuarbruto; PFB, pariteti i fuqisë blerëse.

Në të gjitha shtetet e studiuara, bujqësia është sektor i rëndësishëm për ekonominë kombëtare. Në vitin 2014, pjesa e vlerës së shtuar bruto totale (VSHB) të krijuar nga sektori i bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit është llogaritur për rreth 23% në Shqipëri, dhe mes 8% dhe 14% në shtetet tjera të BP-së. Në shumicën e shteteve të BP-së (përveç Shqipërisë), rëndësia relative ekonomike e bujqësisë në ekonominë kombëtare ka një prirje rënëse (Tabela 1.1).

Përqindja e lartë e bujqësisë në VSHB në shtetet e BP-së është e lidhur ngushtë me nivelin relativisht të ulët të përgjithshëm të zhvillimit ekonomik. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë – i matur me paritetin e fuqisë blerëse (PFB) – është nën 40% të mesatares së BE-28 në të gjitha shtetet e BP-së (Tabela 1.2), dhe nuk janë vërejtur ndryshime të konsiderueshme në vitet e fundit (d.m.th. nga viti 2009–2010).

Tabela 1.2. Të dhënat kyçë në shtetet e BP-së, 2014

	AL	BA	XK	MK	ME	RS	EU-28
SB (000 ha)	1,201[a]	2,163[a]	288[b,c]	1,263[a]	230[d]	3,507[d,f]	175,815[d,e]
(% të BE-28)	(0.7)	(1.2)	(0.2)	(0.7)	(0.1)	(2.0)	(100.0)
% SB në sipërfaqen totale	42	42	26	49	17	45	39
% tokës së punueshme në SB	:	47	59	33	3	74	59
% prodhimit bimor në prodhimin e të mirave bujqësore [c]	49[f]	63[e]	59	76	:	67	56
Rendimenti mesatar i grurit (t/ha)[c]	4.1	3.9	3.8	3.2	3.4	4.3	5.8
Rendimenti mesatar i qumështit (t/lopë mjelëse)	2.7	2.8	:	3.1	2.9	3.4	6.4[c]

Burimi: Baza e Të dhënave Statistikore Bujqësore, Eurostat.
a Toka e përgjithshme bujqësore (të dhëna administrative).
b Zona bujqësore e shfrytëzuar (anketa e ekonomive familjare bujqësore).
c 2013.
d Zona bujqësore e shfrytëzuar.
e 2010.
f 2012.
:, nuk ka të dhëna, SB, sipërfaqe bujqësore.

Të dhënat mbi përdorimin e tokës bujqësore ende nuk janë të krahasueshme ndërmjet të gjitha vendeve te BP-se dhe me BE-në. Në AL, BA dhe MK këto të dhëna i referohen totalit të tokës bujqësore (kryesisht bazuar në burime administrative), në XK të tokës bujqësore që aktualisht përdoret nga ekonomitë familjare bujqësore (bazuar në anketat vjetore me familjet bujqësore), dhe në RS dhe ME për sipërfaqen bujqësore të

shfrytëzuar (SBSH), siç përkufizohet nga Eurostat (vrojtime me zgjedhje të bazuara në Regjistrimin Bujqësor).

Në vitin 2015, Serbia ka rishikuar të dhënat e përdorimit të tokës nga viti 2005 e në vijim, kurse Mali i Zi për periudhën 2007-2013. Sipas këtyre të dhënave, SBSH total në Serbi ka një prirje të lehtë negative (norma mesatare vjetore e rritjes në mes të 2005-2014 ishte -0.3%), ndërsa në Mal të Zi mund të vërehet një prirje e lehtë në rritje (0.5% norma mesatare e rritjes vjetore në 2007-2014). Në të dy vendet, shifrat e rishikuara janë dukshëm më të ulëta se ato që i referohen totalit të tokës bujqësore (të dhëna të vjetra në dispozicion deri në vitin 2013, dhe të bazuara në burimet administrative që nuk janë përditësuar rregullisht).

Sipas të dhënave të raportuara në Tabelën 1.2, RS ka sipërfaqen më të madhe bujqësore (3.5 milion ha), e ndjekur nga BA, MK dhe AL (secila më shumë se 1 milion ha). Dy shtetet e mbetura (ME dhe XK) kanë sipërfaqe relativisht të vogla bujqësore: më pak se 0.3 milion ha secila. Sipërfaqja totale e kombinuar bujqësore e shteteve të BP-së është ekuivalente me rreth 5% të sipërfaqes totale bujqësore të BE-28-ës.

1.3.2 Prodhimi i luhatshëm bujqësor

Në shumicën e vendeve te BP-se prodhimi bimordominon prodhimin bujqësor. Kontributi i prodhimit bimor në prodhimin e përgjithshëm bruto bujqësor është më i lartë në IRJ të Maqedonisë (rreth 76%) dhe më i ulët në Shqipëri (49%). Për Malin e Zi nuk ka të dhëna të besueshme në dispozicion për prodhimin (Tabela 1.2).

Të dhënat afatgjata ne seri kohore për zhvillimin e përgjithshëm te prodhimit bujqësor janë në dispozicion vetëm për IRJ te Maqedonisë, Serbinë dhe Kosovën* (Figura 1.1). Këta tre shtete karakterizohen nga ndryshime të mëdha në vëllimin e prodhimit bujqësor me kalimine kohës, kryesisht për shkak të ndryshimit në prodhimin bimor, që ndikohet kryesisht nga kushtet e motit.

Figura 1.1. Ndryshimet e vëllimit të prodhimit të mallrave bujqësore në shtetet e BP-së, 2005–2014 (2010 = 100)



Burimi: Baza e Të dhënave Statistikore Bujqësore, Eurostat.

Në IRJ të Maqedonisë dhe Kosovë*, prodhimi bujqësor në tërësi tregon një tendencë në rritje që prej vitit 2006 dhe 2005, respektivisht, ndërsa në Serbi nuk është vërejtur një trend i qartë gjatë kësaj periudhe. Trendi pozitiv në IRJ të Maqedonisë dhe Kosovë* është nxitur kryesisht nga rritja e prodhimit të bimëve. Në Serbi, prodhimi i bimëve dhe prodhimi i përgjithshëm bujqësor ndjekin tipare të ngjashme të luhatshmerisë së lartë dhe stanjacionit. Prodhimi blegtoral në përgjithësi ka një pirje në rënie në të tre shtetet, me disa shenja të rimëkëmbjes të vërejtura vetëm pas vitit 2012 (Figura 1.1).

Vlerësimi i zhvillimit të prodhimit për shtetet tjera të BP-së nuk është i drejtpërdrejtë, pasi të dhënat agregate të prodhimit bujqësor nuk janë të disponueshme. Duke marrë parasysh këtë mungesë të dhënash, duket se në Shqipëri prodhimi bujqësor në përgjithësi paraqet një lakore rritëse (si për sektorin e prodhimit bimor ashtu edhe për ate blegtoral). Në Mal të Zi është e dukshme një pirje e qartë rritëse në prodhimin bujqësor (në veçanti në prodhimin e patates dhe frutave), ndërsa prodhimi blegtoral kryesisht tregon tendencë në rënie apo stanjacion, me përjashtim të disa sektorëve (p.sh. për derra, pula). Në Bosnje dhe Hercegovinë, zhvillimet negative mbizotërojnë si në prodhimin bimor dhe në atë blegtoral, me vetëm disa përjashtime ku është vënë re rritje (p.sh. fruta, verë, shpendë).

1.3.3 Tregtia në rritje e sektorit agroushqimor

Në të gjitha gjashtë shtetet e BP-së, sektori agroushqimor është një kontribues i rëndësishëm për totalin e tregtisë së jashtme të vendit, si për eksportet ashtu edhe për importet. Pjesa e produkteve agroushqimore në totalin e eksporteve varion nga 6% në Shqipëri, deri në 24% në Mal të Zi. E njëjta shifër për importet është midis 8% në Serbi dhe 24% në Kosovë*. Rëndësia e tregtisë bujqësore në tregtinë e përgjithshme ka pirje të jetë shumë më e lartë në vendet e BP-se se sa në vendet e BE-28 (Tabela 1.3).

Tabela 1.3. Përqindja e prodhimeve agroushqimore në tregtinë e jashtme të mallrave të shteteve të BP-së, 2014

	AL	BA	XK	MK	ME	RS	EU-28
Eksporti i produkteve agroushqimore, (% e eksportit total)	6.4	7.6	12.1	12.9	24.4	20.6	6.9
Importi i produkteve agroushqimore, (% e importit total)	17.0	16.8	24.3	11.7	27.2	7.8	6.0

Burimi: Baza e të dhënave Statistikore Bujqësore.
Shënim: Të dhëna paraprake.

Tregtia agroushqimore është vazhdimisht në rritje me kalimin e kohës. Eksportet në përgjithësi janë në rritje me një normë më të lartë se importet, duke rezultuar në përmirësim të raportit eksport-import në shumicën e vendeve të BP-së. Kjo përqindje ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga vendi në vend, ku më e ulët është në Kosovë* (rreth 6% në vitin 2014), e ndjekur nga Shqipëria (18%), Mali i Zi (19%) dhe Bosnja dhe Hercegovina (24%). Në IRJ të Maqedonisë, përqindja është më e lartë (75%), por tregon një pirje në rënie. Midis vendeve te BP-se, vetëm Serbia është një eksportues neto i produkteve agroushqimore (d.m.th. raporti eksport-import është më i lartë se 100%), me normën afër 190% në vitin 2014.

Tabela 1.4. Raporti eksport-import i produkteve agroushqimore në shtetet e BP-së (%), 2010–2014

	2010	2011	2012	2013	2014[a]
Shqipëria	10.2	12.0	13.4	15.7	17.9
Bosnja dhe Hercegovina	22.9	22.6	22.3	25.1	24.2
Kosova*	5.1	4.7	3.6	6.0	6.4

IRJ e Maqedonisë	79.3	75.0	69.9	76.4	74.6
Mali i Zi	11.4	11.9	12.8	12.4	19.0
Serbia	186.6	191.9	183.3	173.8	189.0

Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore.
a Të dhëna paraprake.

Tabela 1.5. Tregtia e produkteve agroushqimore në shtetet e BP-së (miliona EUR), 2012–2014

	Eksporti				Importi				Bilanci			
				% rritje				% rritje				% rritje
	2012	2013	2014[a]	2012–2014	2012	2013	2014[a]	2012–2014	2012	2013	2014[a]	2012–2014
AL	83	101	129	55.5	618	646	721	16.6	–536	–545	–592	10.6
BA	317	351	338	6.6	1,426	1,394	1,396	–2.2	–1,109	–1,043	–1,057	-4.7
XK	21	35	39	91.1	573	584	616	7.6	–552	–549	–577	4.5
MK	470	496	480	2.0	673	649	643	–4.4	–203	–153	–163	-19.3
ME	57	56	92	61.7	443	454	482	8.8	–387	–397	–391	1.0
RS	2,084	2,078	2,295	10.1	1,137	1,196	1,214	6.8	947	882	1,081	14.1

Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore.
a Të dhëna paraprake.

Në vitet e fundit, rritja më e lartë në eksportet agroushqimore ka ndodhur në Kosovë*, Mal të Zi dhe Shqipëri; në vendet tjera të BP-së rritja ka qenë më e moderuar (Tabela 1.5). Eksportet nga shumica e vendeve te BP-se janë materiale kryesisht të papërpunuara dhe produkte me vlerë të ulët të shtuar. Importet janë rritur me ritme më të ulëta se eksportet në të gjitha vendet e BP-se. Në vitin 2014, krahasuar me vitin 2012, në BA dhe MK, importi ka rënë, duke rezultuar në përmirësim të bilancit tregtar bujqësor (d.m.th. deficit të ulët). Bilanci tregtar është përmirësuar edhe në Serbi. Në Mal të Zi deficiti tregtar ka mbetur pothuajse i pandryshuar, ndërsa Shqipëria dhe Kosova* regjistruan deficite më të larta agroushqimore se në vitin 2012 (Tabela 1.5).

Produktet kryesore të eksportuara (sipas grupeve tarifore) në vitin 2014 ishin farërat vajore, misht i përpunuar dhe perimet në Shqipëri; yndyrnat shtazore dhe vajrat, produkte të qumështit, vezët, mjalti, dhe fruta dhe arrore te ngrënshme në Bosnje dhe Hercegovinë; pijet, produktet e industrisë së blojës dhe perimet në Kosovë*; duhani, perimet dhe pijet në IRJ të Maqedonisë; mishi, pijet dhe duhani në Mal të Zi; dhe drithërat, frutat dhe pijet në Serbi. Përbërja e eksporteve agroushqimore, sipas grupeve kryesore tarifore të eksportit, nuk ka ndryshuar shumë në shumicën e vendeve të BP-se midis viteve 2012 dhe 2014. Ndryshimet më të dukshme në përbërjen e eksporteve u vunë re në Bosnje dhe Hercegovinë, ku sheqeri dhe produktet e ëmbëlsirave nuk pjesë e grupeve kryesore të eksportit në vitin 2014, ndërsa në vitin 2012 ato përfaqësonin një pjesë të madhe të totalit të eksporteve agroushqimore (18%). Gjithashtu, në Mal të Zi, duhani ka zëvendësuar drithërat si grupi i tretë më i eksportuar i produkteve. Në shtete të tjera, në vitin 2014, krhahasuar me vitin 2012, tre grupet më të mëdha tarifore të eksportit kanë mbetur të pandryshuara (Tabela 1.6).

Tabela 1.6. Përbërja e eksporteve agro-ushqimore sipas grupeve më të rëndësishme tarifore në shtetet e BP-së (%)

	AL		BA		XK		MK		ME		RS	
	2012	2014[a]	2012	2014[a]	2012	2014[a]	2012	2014[a]	2012	2014[a]	2012	2014[a]
02 Mish	4.3	0.4	3.0	3.0	0.0	0.3	3.6	2.9	7.7	45.4	0.9	2.9

04	Prodhime qumështi, vezë, Mjaltë	4.9	0.2	15.1	10.7	0.6	0.5	1.5	1.5	0.3	0.4	3.1	3.1
07	Perime të ngrënshme	9.3	13.6	4.1	4.3	8.8	12.5	10.9	14.4	5.8	4.7	2.4	3.0
08	Fruta të ngrënshme, arra	6.2	11.3	6.2	9.6	5.4	6.6	10.8	9.9	7.1	4.5	13.9	18.2
10	Drithëra	0.0	0.0	0.7	5.5	0.3	1.1	1.2	0.6	0.0	0.0	24.9	20.0
11	Prodhime të industrisë së blojës	0.1	0.0	1.0	1.2	26.3	16.6	0.1	0.2	3.1	2.4	2.8	2.4
12	Farëra vajore	25.0	22.0	0.9	1.4	2.7	3.4	0.9	0.9	0.4	0.4	2.6	2.7
15	Yndynra dhe vajra	2.6	0.5	12.2	14.1	0.3	0.0	2.6	2.0	6.4	3.3	7.7	5.3
16	Nënprodukte mishi	22.8	19.6	7.3	7.3	0.0	0.8	4.1	3.5	5.4	3.4	1.6	2.0
17	Sheqerna dhe ëmbëlsira	0.4	0.2	18.5	5.4	0.5	0.4	1.6	1.6	0.0	0.0	6.8	5.0
19	Prodhime drithërash	4.2	5.3	8.6	8.9	2.0	3.8	8.5	11.0	7.2	2.0	4.1	4.3
20	Prodhime perimesh, frutash, arrash	3.7	3.8	2.3	2.7	8.6	4.4	7.3	8.7	0.3	0.1	3.9	3.4
22	Lëngje, pije alkoolike, uthull	3.1	2.8	5.6	6.5	34.4	31.8	15.2	12.3	41.0	20.7	8.0	7.3
24	Duhan	0.0	4.3	1.6	2.5	0.2	0.0	24.4	22.8	4.0	6.4	2.7	5.8

Burimi: Baza e të Dhënave Statistike Bujqësore.
a Të dhëna paraprake.
Tre grupet më të mëdha tarifore eksportuese për secilin shtet janë theksuar me të gjelbër.

Figura 1.2. Përbërja rajonale e eksporteve dhe importeve të produkteve agroushqimore në shtetet e BP-së (%)



IMPORTET



Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore.
2014: Të dhëna paraprake.
CEFTA, shtetet e Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë.

Në vitin 2014, BE-ja ishte destinacioni më i rëndësishëm eksportues për Shqipërinë, Serbinë dhe IRJ të Maqedonisë, ndërsa në shtetet tjera të BP-së, përqindja më e lartë e eksporteve shkonte në vendet tjera të BP-së (Figura 1.2). Nga viti 2010, pjesa e eksporteve e që dërgohen për BE në përgjithësi është rritur, në veçanti pasi Kroacia ju bashkua BE-së në vitin 2013. Përjashtime bëjnë Shqipëria dhe Mali i Zi, ku mund të vihet re një rënie e eksporteve në BE, të shoqëruar nga një përqindje të rritur të eksporteve të drejtuara për shtete të tjera (jashtë BE-së dhe rajonit të BP-së). Gjithësesi, edhe pjesa e vendeve të treta në eksportet e produkteve agroushqimore gjithashtu është rritur në shtete të tjera të BP-së, në veçanti në dy vitet e fundit që u paraqitën në Figuren 1.2.

Për sa i përket importeve, BE-ja është partneri më i rëndësishëm tregtar për mallrat agroushqimore për të gjitha shtetet e BP-së dhe rëndësia e saj është rritur që nga viti 2010. Përjashtime bëjnë Mali i Zi, ku importet që vijnë nga shtetet e BP-së përfaqësojnë pjesën më të madhe në importin total të produkteve agroushqimore, dhe Shqipëria, ku pjesa e importeve nga BE-ja ka prirje rënëse (Figura 1.2).

1.4 Kuadri i politikave bujqësore

1.4.1 Kuadri i politikave 2007–2013

Studimi i sipërpërmendur i FAO ofron një përshkrim të plotë të kuadrit të politikave bujqësore në shtetet e BP-së për periudhën 2007-2013. Planifikimi i politikave bujqësore për këtë periudhë u bazua në një sërë dokumentesh strategjike që përcaktuan qëllimet afatgjata për bujqësisë dhe zhvillimin rural në të ardhmen ne shtetet e Ballkanit

Perëndimor. Vetë dokumentet në përgjithësi ishin të përbërë nga analiza të gjera të situatës së sektorit kombëtar bujqësor dhe përcaktimit të qëllimeve të politikave, në disa raste të ndjekura nga përkufizime të mekanizmave kryesore të politikave dhe një skicë të buxheteve vjetore (shumëvjeçare). Ashtu sic evidentoi studimi i FAO, qëllimet e politikave të përcaktuara në dokumentet strategjike varionin ndjeshëm mes vendeve, por në përgjithësi theksi kryesor ishte në sigurinë e ushqimit, përmirësimin e të ardhurave bujqësore dhe aspekte të ndryshme të konkurrencës. Megjithatë, prioritetet dhe qëllimet për bujqësinë dhe për zhvillimin rural janë adresuar në dokumente strategjike të veçanta në shumicën e vendeve, pa marrë parasysh të bëhen lidhje midis tyre.

Për zbatimin e politikave bujqësore, shtetet e BP-së përdorin programet dhe rregullat kombëtare që marrin parasysh planifikimin vjetor ose shumë-vjecar të përkufizuar qartë dhe zbatimin e masave të miratuara. Megjithatë, planifikimi vjetor mbizotëron dhe formon shtyllën kurrizore të zbatimit të politikave bujqësore në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Lidhja e tyre me dokumente strategjike dhe programe kombëtare është relativisht e dobët, duke lënë hapësirë të gjerë për vendime pragmatike *ad hoc* dhe ndonjëherë politikisht të motivuara.

Në periudhën e trajtuar nga studimi i FAO-s, vetëm disa nga shtetet e BP-se kanë pasur një sistem të krahasueshëm ndërkombëtarisht për monitorimin vjetor të zbatimit të politikave (p.sh. "raporte të gjelbra" të rregullta). Për më tepër, vlerësimi i ndikimit dhe vlerësimet e politikave janë përdorur rrallë për vendimmarrje praktike; kjo mungesë potencialisht ka kontribuar në paqëndrueshmërinë e politikave bujqësore në shtetet e BP-së.

Nga ana tjetër, ka pasur disa ndryshime në zbatimin e politikave lidhur me krijimin e institucioneve përgjegjëse për disbursimin e masave mbështetëse. Disa nga vendet kanë krijuar agjenci për pagesa dhe kanë filluar të miratojnë elemente të ngjashme me tipin PPB të BE-së për organizimin institucional. Në përgjithësi, kuadri i politikave bujqësore në shtetet e BP-se për periudhën 2007-2013 përmbante disa elemente të një koncepti modern të ciklit të politikave, sidomos në pikëpamje të programeve dhe ndarjeve buxhetore, por ishte i mangët në fusha të tjera, në veçanti lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të politikave.

1.4.2 Zhvillimet e politikave në vitet e fundit

Shtetet e BP-se kanë adaptuar kuadrin e programimit të tipit të PPB-së për politika bujqësore në vitet e fundit. Si rezultat, pritej që në periudhën e mbuluar nga ky raport (2013-2015) shumica e vendeve në rajon do të përgatisnin dokumente të reja programore për të mundësuar qasjen e planifikimit shumëvjeçar të aplikuar në kuadrin e programimit PPB. Në mënyrë të ngjashme, kriza ekonomike rajonale dhe pjesërisht procesi i vazhdueshëm i integrimit evropian, përpos çështjeve apo prioriteteve të tjera, është pritur të nxisin ndryshime në programet dhe instrumentet e politikave që janë miratuar,.

Pjesa tjetër e këtij nënseksioni merr në shqyrtim dokumentet e programimit të shteteve të BP-se që janë miratuar në vitet e fundit, me qëllim të identifikimit të risive kyçe të tyre në aspektin e qëllimeve, prioriteteve dhe mekanizmave të politikave, si dhe për të përcaktuar nëse ka patur ndryshime të evidentuara të bëra mbi instrumentet e politikave dhe strategjive të zbatimit të tyre.

Shqipëria

Në fund të vitit 2014, Shqipëria krijoi një kuadër të ri strategjik për zhvillimin e ardhshëm të bujqësisë dhe zonave rurale (Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (SNBZHR, 2014-2020). Dokumenti i jep prioritet politikave që nxisin zhvillimin dhe rritjen e prodhimit bujqësor dhe synon përmirësimin e konkurrencës, harmonizimin e politikave dhe rregullimeve institucionale me *aktin komunitar* të BE-së, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përfshirjen sociale të popullsisë rurale. Kuadri strategjik gjithashtu përshkruan në më shumë detaje ndërhyrjen publike

në tre fusha kryesore të politikave: (i) zhvillimi rural (me Instrumentin për Asistencën e Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural (IPARD)), (ii) mbështetje për fermerët dhe infrastrukturën rurale, dhe (iii) zhvillimi institucional dhe përshtatja rregullative me standartet e BE-së. Kuadri strategjik nuk përcakton masa të veçanta të politikave; ai vetëm vendos mekanizmat e miratimit të tyre përmes planeve kombëtare vjetore të veprimit. Krahasuar me gjetjet e studimit të FAO-s, reformat e politikave bujqësore brenda kuadrit strategjik janë më të theksuara në fushën e zhvillimit rural, kurse tregu dhe mbështetja direkte janë ndryshuar në masë më të vogël. Sipas përshkrimit të shkurtër të detajuar të vendit përkatës nga Zhllima dhe Gjeci (Kapitulli 2 më poshtë), nuk ka patur ndryshime të rëndësishme në shuma dhe struktura të ndarjeve buxhetore për bujqësi gjatë periudhës së studimit (2013-2014). Ndoshta më të dukshme janë përpjekjet për të futur pagesa për numër krerësh dhe pagesat për siperfaqe dhe për të ulur disi fondet për zhvillimin rural.

Bosnja dhe Hercegovina

Federata e Bosnje dhe Hercegovinës (FBH) dhe Republika Serbe e Bosnjës (RSr) miratuan dy dokumente të reja të zhvillimit strategjik në vitin 2015 që përcaktojnë një perspektivë afatmesme për politikat e tyre bujqësore[3]. Krahasuar me periudhën e mëparshme, strategjitë janë të strukturuara mirë dhe vendosin korniza më të mirëpërcaktuara të politikave, duke mundësuar vlerësime të politikave të bazuara në dëshmi apo fakte, vendosjen e objektivave të reja të politikave, zgjedhjen e instrumentave, si dhe përmirësimin e zbatimit, ndarje financiare dhe monitorim të përmirësuar. Objektivat e politikave u zgjeruan në fusha të reja në përputhje me PPB. Krahas mbështetjes për prodhim, të ardhura dhe konkurrencë, mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike tani janë ndër prioritetet kryesore të strategjisë afatgjatë për bujqësinë. Objektivat e politikës reflektojë në mënyrë të qartë synimin për të përshtatur politikat me PPB-në. Ky qëllim është gjithashtu, edhe pse më pak i dukshëm nga ndryshimet e paraqitura në instrumentet specifik të politikave. Masat "e kundërta me PPB" po humbin përkrahje në drejtim të shtrirjes dhe gamës, ndërkohë që po theksohen gjithnjë e më shumë pagesat për numër të krerëve dhe për siperfaqe, si dhe për aspekte të ndryshme të zhvillimit rural. Në aspektin e organizimit institucional dhe kuadrit programor, strategjitë e reja po sjellin përmirësime të mëdha dhe po përpiqen të forcojnë përshtatjen e tyre me kërkesat e PPB të BE-së.

Megjithatë, është shumë herët që elementet e reja të strategjisë të reflektohen plotësisht në zbatimin aktual të politikës bujqësore. Në përshkrimin e shkurtër të vëndit përkatës në Kapitullin 3, Bajramoviç et al. raportojnë se disa ndryshime të vendosura në politikat bujqësore janë duke shkuar në drejtim të ri (p.sh. bashkimi i pagesave për sipërfaqe dhe rritja e granteve për investime në FBH). Megjithatë, janë vërejtur edhe mospërputhje me strategjinë e re, sidomos lidhur me llojin e instrumenteve të politikave të zbatuar (p.sh. pagesa direkte të lidhura me rritjen e prodhimit). Është e rëndësishme të theksohet se politikat bujqësore janë nën presion të jashtëzakonshëm në Bosnje dhe Hercegovinë si pasojë e krizës aktuale ekonomike dhe sasisë së reduktuar të fondeve bujqësore që lidhen me të.

*Kosova**

Pas konsultimit të gjerë me grupet e interesit, Kosova* ka miratuar një dokument të ri strategjik për zhvillimin bujqësor dhe rural (Programi për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (PZHBR) 2014-2020) në vitin 2013. Dokumenti ka një strukturë moderne dhe është i afërt në kontekst me prioritetet e zhvillimit rural të BE-së. Disa nga përparësitë e tij kryesore përfshijnë nxitjen e transferimit të njohurive dhe inovacionit, shtimin e konkurrencës, zinxhirët agroushqimore dhe menaxhimin e riskut, promovimin e

[3] Nuk ka dokumente të reja strategjike që lidhen veçanërisht me bujqësinë në Qarkun Bërçko.

efikasitetit të burimeve, prodhimin e qëndrueshëm bujqësor, menaxhimin e tokës pyjore, adresimin e ndryshimeve klimatike, si dhe përfshirjen sociale dhe eliminimin e varfërisë rurale. Prioritetet dhe qëllimet e përcaktuara duhet të arrihen përmes zbatimit të masave në kuadër të skemave të mbështetjes kombëtare, Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) II dhe mbështetjes së donatorëve ndërkombëtarë. Zbatimi aktual i dokumentit të ri strategjik është i bazuar në buxhetin vjetor, të ndarë për bujqësinë dhe zhvillim rural (Kapitulli 4).

IRJ Maqedonia

Në fund të vitit 2014, një strategji e re e zhvillimit shtatë vjeçar (Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (SKZHBR) 2014-2020) u miratua në IRJ të Maqedonisë. Ajo ka filluar një periudhë të re të programimit për politikën bujqësore. U krijua një spektër i gjerë i prioriteteve të reja, i lidhur me ristrukturimin dhe modernizimin e sektorit agroushqimor, sigurinë e ushqimit dhe mbrojtjen nga rreziqet e lidhura me të, zhvillimin rural, zhvillimin e qëndrueshëm dhe forcimin e kapitalit njerëzor. Masat e propozuara të politikave ngjajnë në strukturë me ato të zbatuara në kuadër të PPB-së, ku pagesat direkte dhe zhvillimi rural janë ato kryesore. Megjithatë, pagesat e drejtpërdrejta të propozuara mbeten mjaft të ndryshme për sa i përket llojit të pagesës dhe sektorëve të pranueshëm përfitues, ku ato mbizotëruese janë pagesat bazuar në prodhim, dhe pagesat për numër krerësh dhe për sipërfaqe. Mbështetja kushtëzohet me respektimin e kërkesave të ndër-pajtueshmërisë në përpjekje për të harmonizuar sistemin mbështetës me logjikën e PPB. Qeveria e IRJ të Maqedonisë ka miratuar edhe programin e dytë IPARD për 2014-2020. Dimitrievski et al. Theksojnë, në përshkrimin e shkurtër për vëndin e tyre në Kapitullin 5, se ka patur një rritje të konsiderueshme në fondet e ndara për pagesat e drejtpërdrejta të prodhimit (kryesisht për duhanin), si dhe për pagesa për sipërfaqe dhe numër krerësh për kafshë në IRJ të Maqedonisë. Ajo që është e rëndësishme rreth politikës së zhvillimit rural është se ka një rritje të dukshme në mbështetjen për infrastrukturën rurale.

Mali i Zi

Mali i Zi së fundmi përfundoi periudhën e programimit 2007-2013, dhe është përgatitur një strategji e re për periudhën e programimit 2015-2020. Miratimi i dokumentit të ri strategjik është kusht për hapjen zyrtare të negociatave për anëtarësim në BE për kapitullin e bujqësisë. Duke patur parasysh këtë, strategjia përmban një plan veprimi për harmonizimin gradual të politikës bujqësore me *aktin komunitar të* BE-së. Në rastin e pagesave direkte, theksi vendoset në futjen e skemave të ngjashme me ato të PPB-së. Martinoviç dhe Konjeviç, në përshkrimin e shkurtër për vendin e tyre në Kapitullin 6, vënë theksin e fuqishëm të politikës së re bujqësore mbi çështjet e zhvillimit rural. Disa ndryshime në rregullore dhe forcimi i organizimit institucional janë theksuar gjithashtu si ndryshime të rëndësishme në politikën bujqësore. Në përgjithësi, strategjia e re pritet të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme qëllimin dhe strukturën e mbështetjes bujqësore në krahasim me përkrahjen e dhënë në kuadër të periudhës së programimit 2007-2013.

Serbia

Në vitin 2014, Serbia rinovoi në mënyrë të konsiderueshme kuadrin e vet strategjik për bujqësinë për periudhën e re programore me Strategjinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (SZHBR) për 2014-2024. Një fokus i veçantë i strategjisë së re është përshtatja e politikës bujqësore me kërkesat e procesit të integrimit Evropian. Strategjia ka një strukturë moderne (analizën e situatës, qëllimet, prioritetet, mekanizmin politik, kuadrin buxhetor dhe monitorimin), një fokus të fortë zhvillimor dhe rrjet të gjerë të objektivave, duke filluar nga mbështetja e prodhimit, të ardhurave, konkurrencës dhe mbrojtja e qëndrueshme e mjedisit në zonat rurale, dhe përmirësimin e kapaciteteve institucionale. Strategjia gjithashtu parashikon një reformë të plotë të instrumenteve të politikave dhe përshtatjen graduale të tyre me PPB. Më konkretisht, pagesat direkte janë parashikuar të zhvendosen në drejtim të pagesave shoqëruese për sipërfaqe (dhe më pak drejt

pagesave për numër krerësh), ndërsa politika e zhvillimit rural po rigjen ecurinë përmes futjes së mbështetjes për zona më pak të favorizuara, pagesave agro-mjedisore dhe mbështetjes së fuqishme të zhvillimit të produkteve agroushqimore. Puna është në vijim për të përgatitur dhe zbatuar programin kombëtar për bujqësi dhe zhvillim rural, që do të krijojë instrumentet specifike të politikave. Komisioni Evropian ka miratuar programin e asistencës së para-anëtarësimit IPARD në janar 2015.

Në përgjithësi, strategjia e re sjell reforma të dukshme në politikat bujqësore të Serbisë në krahasim me periudhën e mëparshme programore, gjatë së cilës pagesat e përbashkëta (p.sh. pagesat direkte në bazë të prodhimit) dominonin mbështetjen, ndërsa mbështetja e zhvillimit rural ishte jo e konsiderueshme (shih Kapitullin 7). Megjithatë, mbetet të shihet deri në çfarë mase strategjia e re do të zbatohet dhe do të vihet në praktikë.

Pasqyra rajonale

Zhvillimi më i dukshëm në fushën e politikës bujqësore në Ballkanin Perëndimor në vitet e fundit është përdorimi i një procesi intensiv politik për të përgatitur dhe miratuar një strategji afatmesme për bujqësinë dhe zhvillim rural. Të gjitha shtetet[4] e studiuara kanë përgatitur, dhe shumica gjithashtu, i kanë miratuar dhe janë në proces të zbatimit të kornizave të reja strategjike. Pjesa më e madhe e këtyre dokumenteve shfaqin përparim të dukshëm në përmbajtje dhe strukturë. Qëllimet e politikave bujqësore janë të ngjashme mes shteteve, dhe synojnë të forcojnë të tre dimensionet e bujqësisë së qëndrueshme (ekonomike, mjedisore dhe sociale), me një orientim të fortë drejt mbështetjes së rritjes të prodhimit dhe të të ardhurave të fermerëve. Siç u përcaktua në kornizat e reja strategjike, qëllimet e përgjithshme të politikave bujqësore në rajon janë kryesisht në përputhje me *aktin komunitar të* BE-së për bujqësinë.

Harmonizimi i instrumenteve të veçanta të politikave me modelin PPB është disi më pak i theksuar. Të gjitha vendet e studiuara tregojnë ambicie drejt harmonizimit, por ka dallime të dukshme në shkallën e përshtatjes aktuale. Serbia dhe Mali i Zi kanë arritur më shumë në këtë drejtim, pasi në fakt kanë vënë përpara plane për futjen graduale të elementeve të PPB-së. Kjo pritet në një shkallë të caktuar, pasi të dy vendet kanë filluar procesin e negociatave të pranimit në BE, kanë përfunduar pasqyrimin e gjendjes aktuale të situatës ligjore dhe institucionale me Komisionin Evropian, si dhe kanë treguar shenja të qarta të ndryshimeve të nevojshme për t'u miratuar që të hapen negociatat mbi kapitullin e bujqësisë[5], duke përfshirë dhe plane të qarta për të reformuar politikat e tyre bujqësore.

Shtetet tjera të BP-se janë ende në proces të futjes së ndryshimeve të kërkuara nga *akti komunitar* i kërkuar i BE-së për bujqësinë. Përparimi është i dukshëm, por ende nuk është krijuar një plan i qartë i harmonizimit me modelin PPB. Kjo mund të shpjegohet me faktin që këto vende nuk janë akoma në faza të avancuar në procesin e pranimit të tyre në BE. Ndoshta pyetja më themelore është nëse instrumentet e propozuara të politikave dhe ndarjet buxhetore janë vërtetë të favorshme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Të dhëna jozyrtare sugjerojnë se instrumentet e propozuara të politikave janë ende kryesisht rezultat i zgjedhjeve politike dhe të motivuara nga interesi, në vend se të projektoheshin në bazë të kritereve objektive.

---

[4] Në Bosnje dhe Hercegovinë, kuadri strategjik u përgatit nga dy entitete kyçe; por, diskutimi mbi përgatitjen e një dokumenti të përbashkët kombëtar është duke u zhvilluar.

[5] Në zhargonin e BE-së për negociatat e para-anëtarësimit, ato llogariten si "standarte", ose detyra që duhet të arrihen para se të bëhet "hapja" formale e negociatave për kapitullin e bujqësisë. Të dy shtetet janë në proces të përgatitjes dhe zbatimit të aktiviteteve që pritet të bëjnë të mundur negocimin e mëtejshëm.

Në përgjithësi, zbatimi aktual i politikave bujqësore në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor është ende larg nga ato të përshkruara në strategjitë e reja. Për shkak të krizës ekonomike dhe interesat ekonomikë e politikë të natyrës rishpërndarëse të mbështetjes së bujqësisë, parametrat rregullatorë dhe institucionalë vazhdojnë të jenë të varura në nivele të konsiderueshme nga modelet politikave bujqësore të së shkuarës . Një varësi nga e kaluara veçanërisht e fortë është vërejtur në preferencat politike për mbështetjen në lidhje me prodhimin se sa për zhvillim rural. Zbatimi efektiv i strategjive tashmë të miratuara dhe forcimi i vlerësimit të bazuar në dëshmi e fakte si dhe monitorimi i politikave janë mbase sfidat më të rëndësishme me të cilat përballen shtetet e BP-se në përputhjen e politikave të tyre bujqësore me kërkesat e BE-së.

1.5 Transfertat buxhetore për bujqësi

Siç u përmend më parë, analiza në këtë pjesë mbulon rezultatet e qasjes MPB për vitet 2013–2014[6]. Qëllimi kryesor është të vlerësohen ndryshimet relevante në transfertat për bujqësi krahasuar me gjetjet e studimit të FAO, që mbulonte periudhën para vitit 2013.

1.5.1 Shpenzimet totale buxhetore për bujqësi

Niveli relativ i mbështetjes buxhetore për bujqësi

Përfundimet kryesore të studimit të FAO:

> *Në BP, me përjashtim të IRJ të Maqedonisë, niveli relativ i mbështetjes totale buxhetore për bujqësinë është i ulët, në krahasim me BE-27.*

Figura 1.3. Shpenzimet totale buxhetore për sektorin agro-ushqimor dhe zonat rurale në shtetet e BP-së (EUR/ha SBSH), 2012–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB.

Konkluzioni nga studimi i FAO-s ende qëndron. Në vitin 2014, mbështetja buxhetore për hektar të SBSH arriti në rreth 23 euro në Shqipëri, 40 euro në Bosnje dhe Hercegovinë, 72 EUR në Kosovë* (të dhënat për vitin 2013), 79 euro në Maline Zi, 92 euro në Serbi dhe 187 euro në IRJ të Maqedonisë. Në vitin 2014, niveli i mbështetjes së përgjithshme ka qenë dukshëm më i lartë se në vitin 2012 në IRJ të Maqedonisë (pas një rënieje në vitin 2013), paksa më i lartë në Serbi, pak më i lartë në Shqipëri dhe pak më i ulët në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Mal të Zi. Shifra ekuivalente për BE-27 ishte rreth 480 euro në vitin 2012, shumë më e lartë se në shtetet e BP-së (Figura 1.3).

[6] Për Kosovë*, të dhënat MPB për vitin 2014 nuk janë të plota dhe nuk janë paraqitur në nivel total.

Përbërja e mbështetjes buxhetore në bujqësi

Konkluzioni kryesor në studimin FAO:

> *Përbërja e mbështetjes së përgjithshme për bujqësi ndryshon konsiderueshëm mes shteteve. Në përgjithësi, mund të vërehet se sa më i madh buxheti total, aq më e madhe edhe pjesa e fondeve për tregun dhe masat direkte mbështetëse për prodhim (masat e shtyllës së parë). Masat strukturore dhe të zhvillimit rural (shtylla e dytë) dhe masat e përgjithshme mbështetëse të bujqësisë (shtylla e tretë) në përgjithësi renditen më ulët se mbështetja e prodhimit, me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës*, por shumat aktuale në këto dy shtete janë të ulëta.*

Nuk mund të vërehen ndryshime të rëndësishme në përbërje të mbështetjes totale buxhetore gjatë periudhës studiuese që janë relative me periudhën e mbuluar nga studimi i FAO-s. Ka ndryshime në madhësi të mbështetjes totale, por jo në përbërje.

Figura 1.4. Shpenzimet totale buxhetore për sektorin e agroushqimor dhe zonat rurale sipas shtyllave të MPB-së në shtetet e BP-së, 2012–2014 (2012 = 100)



Burimi: Baza e të dhënave MPB.

Pjesa e fondeve për masa mbështetëse për treg dhe prodhim direkt (masat e shtyllës së parë) janë të larta në Serbi (afër 90%), Bosnje dhe Hercegovinë (rreth 80%) dhe IRJ të Maqedonisë (më shumë se 75% dhe në rritje). Pjesë më të ulëta të fondeve që i përkasin shtyllës së parë vërehen në Kosovë* (rreth 50% në 2013), Mal të Zi (rreth 35%) dhe në veçanti në Shqipëri (rreth 10%). Në këto tre shtete, pjesa e masave strukturore dhe për zhvillim rural (shtylla e dytë) dhe masat e përgjithshme të mbështetjes së bujqësisë (shtylla e tretë) janë shumë më te larta, por vlerat aktuale (të matura me EUR/ha SBSH) janë relativisht të ulëta (veçanërisht në Shqipëri) (Figura 1.4).

1.5.2 Masat mbështetëse direkte të prodhimit

Në kuadër të shtyllës së parë të politikës bujqësore, përqindja më e lartë e fondeve deri tani i takon masave mbështetëse direkte të prodhimit. Në vitin 2014, disa masa mbështetëse të tregut (p.sh. ndërhyrja me blerje të mallrave bujqësore) ekzistonte vetëm në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Mal të Zi. Për shkak se masat mbështetëse të tregut janë jo shumë domethënëse, analiza e detajuar është e fokusuar vetëm në pjesën e shtyllës së parë, që lidhet me masat direkte mbështetëse të prodhimit.

Konkluzioni kryesor në studimin e FAO:

> *Shumica e shteteve në rajon paraqesin një trend në rritje të fondeve për masa direkte mbështetëse në vitet e fundit (me disa luhatje, në veçanti në Serbi dhe IRJ të Maqedonisë).*

Në 2012-2014, trendi rritës i transfertave për mbështetje direkte të prodhimit vazhdoi në të gjitha shtetet e BP-se, përveç Malit të Zi. Në vitin 2014, masat direkte mbështetëse për prodhim për hektar të SBSH ndryshonin nga më pak se 3 euro në Shqipëri në 145 euro në IRJ të Maqedonisë. Shuma të ngjashme për hektar janë regjistruar në Kosovë* (45 euro), Bosnje dhe Hercegovinë (31 euro) dhe Mal të Zi (25 EUR). Në Serbi, masat e mbështetjes direkte të prodhimit ishin rreth 80 euro për hektar të SBSH. Krahasuar me shifrat e vitit 2012, në vitin 2014 mbështetja direkte për prodhim u rrit ndjeshëm në Kosovë*, IRJ të Maqedonisë dhe Serbi, dhe ishte pak më e lartë në Shqipëri dhe Bosnje e Hercegovinë, ndërsa u zvogëlua paksa në Mal të Zi (Figura 1.5).

Figura 1.5. Mbështetja direkte e prodhimit në shtetet e BP-së (EUR/ha SBSH), 2012–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB.

Përbërja e masave direkte mbështetëse të prodhimit

Konkluzioni kryesor në studimin e FAO-s:

> *Krahasuar me BE-në, i gjithë BP ka strukturë shumë të ndryshme të pagesave direkte. Pagesa direkte për prodhim (shtesë mbi çmimet), që nuk përdoret më në vendet e BE-së, është shumë e zakonshme në Bosnje dhe Hercegovinë dhe IRJ të Maqedonisë. Në Mal të Zi dhe Kosovë*, dhe në vitin e fundit edhe në Serbi, shumica e pagesave kishin një formë të pagesës për siperfaqe dhe për krerë, të lidhur me mallra të veçanta, formë kjo e cila është zbatuar në BE në shkallë më të gjerë vetëm para reformës PPB në vitin 2003. Në përgjithësi, mund të thuhet se politika bujqësore e zbatuar në vëndet e Ballkanit Perëndimor nuk është në përputhje me politikën aktuale bujqësore në BE.*

Nga viti 2012 vërehen disa ndryshime në përbërjen e mbështetjes direkte për prodhim, por nuk ka shenja të procesit të përshtatjes së tyre me instrumente të politikave të ngjashme me PPB-në.

Me përjashtim të Bosnje-Hercegovinës, pagesat për krerë bagëtie dhe sipërfaqe janë format më të rëndësishme të mbështetjes direkte të prodhimit në shtetet e BP-se. Në Kosovë*, pothuajse e gjithë mbështetja direkte e prodhimit është e këtij lloji.

Pagesat direkte për prodhim (shtesë mbi çmimin) janë ende të pranishme në shumicën e shteteve të BP-se. Në veçanti, Bosnje dhe Hercegovina dhe IRJ Maqedonia kanë subvencione më të mëdha të bazuara në prodhim. Në këto dy shtete, dhe në Serbi, kjo ndihmë u rrit si përqindje ndaj mbështetjes direkte totale të prodhimit gjatë kohës së marrë në studim (Figura 1.6).

Figura 1.6. Zhvillimi i shpenzimeve dhe përbërja e masave të mbështetjes direkte prodhuese në shtetet e BP-së, 2012–2014 (2012 = 100)



Burimi: Baza e të dhënave MPB.

Luhatshmëria e politikave të mbështetjes direkte

Konkluzioni kryesor në studimin e FAO:

> *Një nga karakteristikat kryesore të politikave të mbështetjes direkte te të gjithë BP-së është luhatshmëria e tyre.*

Ka dallime të mëdha mes shteteve të BP-se në numrin e mallrave (dhe grupeve të mallrave) që përfitojnë nga skemat e mbështetjeve direkte. Ky numër është veçanërisht i lartë në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në IRJ të Maqedonisë (përshembull 21 në vitin 2014). Në pjesën tjetër të shteteve të mbuluara, ky numër ka ndryshuar midis pesë dhe nëntë mallrave në vitin 2014. Kategoritë e mallrave (apo grupet e mallrave) që marrin mbështetje janë në përditësim të vazhdueshëm, me disa artikuj të rinj që i shtohen listës dhe të tjerë që hiqen nga kjo listë. Siç është paraqitur në Tabelën 1.7, ndryshimet janë

vënë re në grupin e mallrave të subvencionuara në të gjitha vendet e studiuara dhe pothuajse gjatë çdo viti të periudhës së mbuluar.

Tabela 1.7. Numri i mallrave të subvencionuara nën skemën e pagesave direkte në shtetet e BP-së, 2005–2014

	2005	2006			2007			2008			2009			2010			2011			2012			2013			2014		
		A	N	O	A	N	O	A	N	O	A	N	O	A	N	O	A	N	O	A	N	O	A	N	O	A	N	O
AL	1	1	0	0	1	0	0	5	+4	0	7	+2	0	5	+1	–3	6	+1	0	6	+2	–2	7	+1	0	5	+2	–4
BA	23	23	+2	–2	23	0	0	23	+1	–1	21	+2	–4	21	0	0	22	+1	0	21	0	–1	21	+1	–1	21	+1	–1
XK											3			3	+1	–1	4	+1	0	6	+3	–1	9	+3	0	11	+2	0
MK								19			21	+3	–1	24	+3	0	19	0	–5	21	+2	0	21	+1	–1	21	+1	–1
ME																				6			8	+2	0	9	+1	0
RS	8	6	+1	–3	3	+2	–5	3	0	0	3	0	0	1	0	–2	1	0	0	4	+3	0	6	+2	0	7	+1	0

Burimi: Baza e të dhënave MPB.
A, numri i mallrave të mbështetura gjatë një viti (matjet aktuale); N, ndryshimet në numër: të paguara në vitin aktual, por jo në vitin paraprak (masë e re); O, ndryshim në numër: paguar në vitin paraprak, por jo në vitin aktual (masë e përjashtuar).

Më tej, madhësia e subvencionimit të mallrave për lloje të veçanta të mallrave ndryshon dukshëm me kalimin e kohës ne shtetet e BP-se. Tabela 1.8 paraqet ndryshimet në mbështetje mes viteve 2013 dhe 2014 sipas mallrave (ose grupit të mallrave). Mbështetja për disa mallra në Bosnje dhe Hercegovinë dhe IRJ të Maqedonisë ka rënë me më shumë se 50% (p.sh. për dele dhe dhi, elb, drithëra, perime dhe produkte të hortikulturës), ndërsa për disa të tjerë është rritur me më shumë se 100% (p.sh. për vezë, pagesave në bazë të siperfaqeve për drithëra, farëra vajore dhe kultura të proteinike) në vitin 2014 në krahasim me vitin 2013. Në Serbi u regjistrua një rritje e konsiderueshme në pagesa për dele, dhi e derra.

Ka disa arsye për ndryshime të tilla të konsiderueshme të mbështetjeve të mallrave me kalimin e kohës, duke filluar nga gabimet e mundshme në regjistrimin e të dhënave, përmes vonesave të pagesave nga viti në vit, e deri të ndryshimet e shpeshta të bëra në skemat e pagesave. Megjithatë, këto ndryshime krijojnë një ambient të pasigurt të politikave për fermerët dhe i kufizojnë ata në planifikimin e tyre afatgjatë të vendimeve për investime dhe për prodhim. Paqëndrueshmëria e sistemit të mbështetjes direkte duket se po vazhdon, duke mbetur një dobësi kryesore e politikave bujqësore në Ballkanin Perëndimor.

Tabela 1.8. Ndryshimet në vlera të pagesave direkte për mallra, në shtetet e zgjedhura të BP-së, 2014 (2013 = 100)

	AL	BA	XK	MK	ME	RS
Qumësht	130.1	110.5	123.6	98.7	107.1	110.0
Dele dhe dhi	132.4	18.7	100.1	110.6	76.1	407.9
Gjedhë	O	56.9		101.4	93.0	133.4
Derra		78.5	N	114.0		211.2
Shpendë		110.7		198.5		N
Prodhime tjera shtazore: të tjera	104.4	93.9	155.3	119.6		
Vezë		253.5	95.4	228.1		
Kuaj		N				
Kafshë tjera				81.5		
E gjithe blegtoria						0.7
Grurë		86.0	96.2			
Misër		83.7	134.5			
Elb		40.3				
Drithëra				45.4		
Rrepë vajore		125.4				
Soja		O				
Farëra vajore		218.0	108.2			
Duhan		64.8		396541	100.0	
Bimë tjera industriale: tjera		26.4			100.0	
Patate		73.9			100.0	
Bimë foragjere		94.4		N		
Farëra		83.9		283.5		
Prodhime tjera të kulturave: tjera				162.6		
Drithëra, farëra vajore, bimë proteinash				210.8	100.0	
Të gjitha kulturat bujqësore				155.6		100.1
Perime të freskëta	O	133.3	N	94.4		
Perime të tjera të freskëta					100.0	
Perime dhe prodhime të hortikulturës				32.0		
Mollë tavoline				0.0		
Fruta të freskëta	O	144.0		136.3		
Fruta dhe perime	N					
Rrush			203.7	78.5		
Ullinj	N				N	
Vaj ulliri	O					
Bimë për fidanishte		145.7	78.7	62.9		

Burimi: Baza e të dhënave MPB.
N, subvencionet u paguan në vitin 2014, por jo në vitin 2013 (masë e re); O, subvencionet u paguan në vitin 2013, por jo në vitin 2014 (masë e përjashtuar).

1.5.3 Masat e zhvillimit struktural dhe rural

Konkluzioni kryesor në studimin e FAO:

> *Si rregull i përgjithshëm, buxhetet bujqësore nuk janë të orientuar drejt zhvillimit. Kjo deklaratë bazohet në sasi të ulëta absolute të fondeve për masa zhvillimore, strukturore dhe rurale. Është e rëndësishme të theksohet që shumica e shteteve nuk kanë përjetuar rritje të dukshme të fondeve për masat e zhvillimit strukturor dhe rural në vitet e fundit. Vetëm Kosova* dhe (deri në 2009) Mali i Zi janë karakterizuar nga prirja pak a shumë konstante në rritje. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, dhe IRJ e Maqedonisë tregojnë luhatje gjatë viteve, ndërsa Serbia ka përjetuar rënie.*

Konkluzioni i studimit te FAO-s në masë të madhe është i përshtatshëm edhe për periudhën e studimit të raportit aktual. Vlera e përgjithshme e mbështetjes për zhvillimin strukturor dhe rural u zvogëlua në vitin 2014 krahasuar me vitinn 2012, në të gjitha shtetet e BP-së, me përjashtim të Malit të Zi. Rënia më e lartë u vu re në Bosnje dhe Hercegovinë. Vlera e mbështetjes për zhvillimin strukturor dhe rural është relativisht e ulët, që tregon se orientimi zhvillimor i politikave bujqësore është një prioritet i ulët në shtetet e BP-se. Në vitin 2014 vlera e tyre për hektar ishte 4 euro në Serbi, 5 euro në Bosnje dhe Hercegovinë, 11 euro në Shqipëri, 23 euro në IRJ te Maqedonisë dhe 28 euro në Mal të Zi. Vlera e mbështetjes ishte 28 euro në Kosovë *, sipas të dhënave të vitit 2013 (Figura 1.7).

Figura 1.7. Masat për zhvillimin strukturor dhe rural në shtetet e BP-së (EUR/ha SBSH), 2012–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB.

Përbërja e masave për zhvillimin strukturor dhe rural

Konkluzioni kryesor në studimin FAO:

> *Pjesa më e madhe e fondeve nga kjo shtyllë e politikave i takon grupit të masave të destinuara për përmirësimin e aftësisë konkurruese të bujqësisë, ndërsa dy aspekte të tjera të politikave të zhvillimit rural (p.sh. mjedisi dhe ekonomia rurale dhe popullsia) kanë marrë vëmendje më të pakët.*
>
> *Fondet e destinuara për përmirësimin e mjedisit dhe fshatrave janë të papërfillshme në shumicën e vendeve të BP-së. Pyetja më sfiduese nga pikëpamja e zhvillimit të balancuar territorial të BP është mungesa e masave për të mbështetur zonat më pak të favorizuara (ZMPF- LFA). ZMPF-të janë shumë të përfaqësuara në të gjithë BP-në dhe gjithashtu përballen me probleme serioze demografike dhe sociale (braktisja, varfëria rurale).*

Në shumicën e shteteve të BP-së nuk janë vërejtur ndryshime të rëndësishme në periudhën e studimit në përbërjen e shpenzimeve për masat e zhvillimit strukturor dhe

rural. Kështu, konkluzionet e studimit të FAO-s janë ende të vlefshme. I vetmi përjashtim është IRJ e Maqedonisë, ku përbërja e shpenzimeve për masat e zhvillimit strukturor dhe rural u ndryshuan dukshëm në 2014 në favor të mbështetjes së ekonomisë rurale dhe popullsisë. Ky ndryshim është kryesisht rezultat i një reduktimi të ndjeshëm në mbështetjen e investimeve (një rënie prej gati 50% ose 6 milionë euro) dhe zhvendosjen e saj në mbështetjen e ekonomisë rurale dhe popullatës përmes programit "Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale", që mori më shumë se 7 milion euro fonde shtesë në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013 (Figura 1.8).

Pagesat për mbështetje të mjedisit janë të parëndësishme në shtetet e BP-se. Në Shqipëri dhe Kosovë* ato mungojnë plotësisht. Në shtetet tjera të BP-së, niveli tashmë i ulët i fondeve ka rënë në vitet e fundit (me përjashtim të Serbisë) (Figura 1.8).

Pavarësisht nga një nivel më i ulët i fondeve në dispozicion për zhvillimin strukturor dhe rural, në disa shtete të BP-së u vendosën masa të reja mbështetëse. Në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në IRJ te Maqedonisë, u prezantua një masë mbështetëse për ZMPF. Në Serbi u prezantua një program i ri për mbështetjen e varieteteve të kulturave dhe rracave të kafshëve të rrezikuara. Megjithatë, në përgjithësi, politikat e zhvillimit strukturor dhe rural në shtetet e BP-së ruajnë strukturën e tyre të më të vonët; asnjë ndryshim i rëndësishëm në përbërjen e tyre nuk është vënë re në periudhën e mbuluar nga ky raport.

Figura 1.8. Ecuria i shpenzimeve dhe përbërja e masave të zhvillimit strukturor dhe rural në shtetet e BP-së, 2012–2014 (2012 = 100)



Burimi: Baza e të dhënave MPB.

1.5.4 Masat e përgjithshme të mbështetjes

Konkluzioni kryesor në studimin e FAO:

> *Masat e përfshira nga kjo kategori e politikave, ... janë zakonisht në hije të kategorive tjera të politikave bujqësore.*
>
> *Në shumicën e vendeve të BP-së, siguria e ushqimit dhe kontrolli i cilësisë merr pjesën më të madhe të fondeve për këtë kategori të politikave. Këto përqindje janë veçanërisht të larta në Kosovë*, IRJ te Maqedonisë dhe Shqipëri. Në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, përveç sigurisë së ushqimit dhe kontrollit të cilësisë, është relativisht e lartë edhe përqindja e buxhetit për shërbime kërkimore, zhvillime, këshillime dhe shërbime profesionale. Megjithatë, duke marrë parasysh buxhetin modest total për masat e përgjithshme, të gjitha këto shërbime mbështeten me fonde të modeste.*

Nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në madhësi dhe përbërje të mbështetjes së përgjithshme që kanë ndodhur në periudhën studimore, krahasuar me periudhën e mbuluar nga studimi i FAO-s. Një ndryshim më i dukshëm ndodhi në Shqipëri dhe IRJ të Maqedonisë, ku mbështetja e përgjithshme shfaqi një rritje relativisht të fortë në 2014 në krahasim me 2012. Në shtetet tjera të BP-së, mbështetja e përgjithshme mbeti pothuajse e pandryshuar apo u ul pak gjatë periudhës së njëjtë. Vlera për hektar e mbështetjes së përgjithshme është relativisht modeste; në 2014 ishte 25 euro në Mal të Zi, 14 euro në IRJ të Maqedonisë, 9 euro në Shqipëri, 8 euro në Kosovë* (2013), 7 euro në Serbi dhe 2 euro në Bosnje dhe Hercegovinë (Figura 1.9).

Figura 1.9. Masat e përgjithshme të mbështetjes në shtetet e BP-së (EUR/ha SBSH), 2012–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB.

1.6 Struktura e fermave si çështje e politikave

Studimi i FAO-s theksoi problemin e "fragmentimit të tokës dhe strukturave bimodale të fermave" në mesin e sfidave të tjera kryesore për zhvillimin e shteteve të BP-se. Saktësisht, studimi FAO përshkroi këto sfida në lidhje me strukturat e fermave në shtetet e BP-së:

> *Historia e zhvillimit, trashëgimisë dhe reformave të tokës në periudhën socialiste dhe të tranzicionit ka çuar në kushte shumë të pafavorshme të shfaqura në madhësi të mpakur të fermave dhe fragmentim të tokës. Mbizotërojnë ferma të vogla, në disa zona edhe në formë të fermave për mbijetesë ku mungojnë burimet për prodhim ekonomikisht të qëndrueshëm. … Në zonat fushore që janë disi më të favorshme, nga ana tjetër, ekziston një pabarazi në rritje mes fermave të vogla familjare, që janë të dobëta në madhësi dhe efikasitet, dhe fermave të mëdha ish-socialiste të ruajtura, tashmë të privatizuara dhe të transformuara në kompani të*

mëdha. Edhe pse numri i këtyre kompanive është i kufizuar, ato kanë tendencë për të zgjeruar më tej madhësinë e tokës dhe për të dominuar prodhimin bujqësor në rajonet ku janë të pranishme, duke kërcënuar stabilitetin dhe ekuilibrin social.

Studimi i FAO-s gjithashtu vuri në dukje disa mangësi të kuadrit aktual të politikave lidhur me çështjen e reformës së tokës dhe qasjen e saj ndaj fermave të vogla. Ai gjithashtu identifikoi një sërë rekomandimesh thelbësore politike për politikat e ardhshme të zhvillimit bujqësor dhe rural në shtetet e BP-se, siç janë "konsolidimi i tokës, rritje e qëndrueshme e madhësisë së fermave, përmirësimi i cilësisë së tokës, menaxhim më i mirë i ujit dhe akses më i mirë në toka bujqësore".

Të dhënat e fundit rreth strukturës së fermave të BE-së tregojnë se madhësia mesatare e ulët e fermave mbetet një nga karakteristikat kryesore të bujqësisë së BP (Tabela 1.9). Edhe pse sektori i bujqësisë është jashtëzakonisht i shumëllojshëm, pjesa më e madhe e fermave janë ferma të vogla familjare dhe janë në natyrë të veprimit për mbijetesë apo gjysmë-mbijetesë (Volk et al. 2014). Përqindja e fermave më të vogla se 2 ha është veçanërisht e lartë në Kosovë*, IRJ të Maqedonisë dhe Mal të Zi (mbi 70%), dhe ndoshta edhe në Shqipëri (Qineti et al. 2015). Në Serbi, përqindja është më e vogël dhe afër mesatares së BE-28 (rreth 50%), por kryesisht në sajë të një strukture më të favorshme të fermave në provincën e Vojvodinës (Bogdanov dhe Rodic 2014).

Tabela 1.9. Struktura e fermave në shtetet e BP-së

	AL (2012)	BA (2010)	XK (2014)	MK (2013)	ME (2010)	RS (2012)	EU-28 (2010)
Numri i fermave (000) (% të	324.0		129.2	170.9	48.9		12,248
BE-28)	(2.6)	:	(1.1)	(1.4)	(0.4)	631.6 (5.2)	(100.0)
SBSH (000 ha)			257.6	315.9	221.3	3,437.4	175,815
(% të BE-28)	:	:	(0.1)	(0.2)	(0.1)	(2.0)	(100.0)
SBSH për fermë (ha)	2.8[1]	2.0[a]	2.0	1.8	4.5	5.4	14.4
% e fermave me SBSH < 2 ha	:	:	80[a]	78	73	48	49

Burimi: Baza e të dhënave Bujqësore, Eurostat.
a Të dhëna nga studimi i FAO-s (Volk et al. 2014).
:, nuk ka të dhëna në dispozicion.

Strategjitë afatmesme për politikat e ardhshme bujqësore, siç u përcaktua në dokumentat e reja strategjike (Kapitujt 2 deri 7), kanë njohur problemet e strukturës së fragmentuar të tokës, mbizotërimit të fermave të vogla dhe ndryshimeve të ngadalta strukturore. Gjithësesi, sfidat e politikave që lidhen me madhësinë e fermave dhe strukturat e fermave nuk janë të drejtpërdrejta. Nga njëra anë, fermat e vogla janë të rëndësishme për kohezionin territorial dhe social të zonave rurale. Në anën tjetër, ka një perceptim të përgjithshëm në rajon që fermat e vogla kanë tendenca të zvogëlojnë efikasitetin e përgjithshëm të prodhimit bujqësor[7]. Dimitrievski et al. raportojnë se (shih Kapitullin 5) nevoja për konsolidimin e tokës, si një instrument i politikave bujqësore, është njohur nga vendimmarrësit në IRJ te Maqedonisë me miratim të Strategjisë Kombëtare për Konsolidim të Tokës Bujqësore për 2012-2020.

Përderisa strategjitë afatmesme mund të (ri)njohin veten me problemin e strukturës së fermave, politikat aktuale bujqësore të shteteve të BP-së nuk kanë masa efektive për të

[7] Lidhja mes strukturës së madhësisë së fermës dhe produktivitetit nuk është e qartë. Në praktikë, fermat e vogla individuale mund të jenë ekonomikisht të suksesshme, por, lidhur me strukturën socio-ekonomike të këtyre fermave (në aspektin e arsimimit dhe strukturës së moshës), pohimet se fermat më të mëdha kanë prirje të jenë më të suksesshme ekonomikisht duket të jenë të vlefshme.

trajtuar këtë sfidë. Bogdanov ka theksuar për Serbinë (Kapitulli 7) se politika bujqësore nuk ka mjete adekuate për t'u marrë me ndryshimet strukturore të fermave:

> *Procesi i ristrukturimit të fermave në Serbi u zhvillua në mënyrë spontane dhe të ngadaltë, me mesazh të paqartë të dhënë nga qeveria për fermerët dhe investitorët në drejtimin e dëshiruar të zhvillimit të tyre nga pikëpamja e mirëqenies. ... Masat e mbështetjes për përshpejtimin e ndryshimeve strukturore u zgjodhën dobët dhe nuk u zbatuan rregullisht (stimuj të barabartë për fermerët "pasiv" me qëllim aktivizimin e tregut të qiradhënies së tokës, subvencionimit të normave të interesit për kredi afatgjata, etj.).*

E njëjta gjë është e vërtetë për të gjithë rajonin e BP-së.

Funksionimi i dobët i tregut të shitjes së tokës dhe tregjeve të qiradhëdhënies janë edhe një pengesë që kufizon ndryshimet strukturore te fermave ne shtete e BP-se. Pasoja direkte e tregjeve të pazhvilluara të tokës është mundësia e reduktuar për fermerët të përdorin tokën si kolateral për të marrë kredi, që përndryshe do të mund të ndikonte në zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Shpeshherë, elementet themelore të institucioneve të tokës, si zbatimi i të drejtës pronësore dhe regjistrimi i tokës, janë të pazhvilluar në shtetet e BP-së.

Siç argumentohet nga Bajramoviç et al. për Bosnje dhe Hercegovinën (Kapitulli 3), "legjislacioni i dobët rregullues dhe zbatues për të drejtat pronësore, si dhe pavendosmëria në zgjedhjen e sistemit të regjistrimit të tokës, ngadalësojnë modernizimin, dixhitalizimin dhe restaurimin e kadastrës dhe regjistrimin e tokës, që është kërkesë bazë që tregjet e tokës të zhvillohen". Rregullimi institucional i konsolidimit të tokës është vështirë të zbatohet nga pikëpamja politiko-ekonomike, në veçanti pasi kërkon shumë përpjekje administrative dhe financiare, kështu që kjo gjë është vështirë e zbatueshme gjatë krizës financiare.

Një kufizim tjetër për zhvillimin e fermave të vogla është trajtimi i tyre i pabarabartë në aksesin ndaj pagesave direkte. Rregullat që përcaktojnë dhënien e pagesave direkte zakonisht janë të njëanshme drejt fermave të mëdha, ndërsa fermat e vogla janë të kufizuara për të patur akses ndaj tyre. Shpesh, vetëm fermat që shesin prodhimin përmes kanaleve zyrtare të tregut janë të pranueshme për pagesa direkte; kjo direkt i përjashton fermat e vogla të përfitojnë prej tyre. Politika të tilla diskriminuese kontribuojnë dukshëm në performancën e dobët ekonomike të fermave të vogla. Kjo praktikë është në kundërshtim me filozofinë PPB, që trajton të gjitha fermat si të barabarta, ndërkohë që njeh edhe problemin e zhvillimit të fermave të vogla duke futur skema të synuara për fermat e vogla (p.sh. skema e fermave të vogla, kalim fondesh nga shtylla te tjera si rasti i modulimit ne skemat e kaluara te PPB).

Promovimi i fermave të vogla apo i ndryshimit strukturor të fermave mund të trajtohet përmes masave mbështetëse që synojnë zinxhirët agroushqimore dhe organizatat e prodhuesve. Ka relativisht pak masa mbështetëse të këtij lloji në dispozicion në rajon. Disa shembuj të miratuar në mënyrë sporadike në rajon (p.sh. programi në Mal të Zi i Bankës Botërore-Zhvillimi Institucional i Malit të Zi dhe Forcimi i Bujqësisë) tregon se një mbështetje e tillë krijon përfitime potenciale për fermat e vogla (informacione personale nga terreni).

Në përgjithësi, disa nga rekomandimet kryesore të politikave të lidhura me mbështetjen e fermave të vogla dhe ndryshimet strukturore të fermave përfshijnë miratimin e legjislacionit të tokës, konsolidimin e tokës, regjistrimin e tokës, ndarjen në mënyrë më të drejtë të mbështetjes së bujqësisë, masa më mirë të synuara të zhvillimit rural dhe krijimin e sistemeve të bazës së të dhënaveve që të përdoren për monitorimin e politikave (p.sh. baza e të dhënave të tokës, të dhënat e tregut të tokës).

1.7 Procesi i integrimit në BE për bujqësi

Përvojat e fundit të proceseve integruese evropiane tregojnë se bujqësia është një nga sektorët më të vështirë, duke mbuluar disa nga çështjet më komplekse që duhet të negociohen dhe të bien dakord gjatë procesit të anëtarësimit. Në përgjithësi, procesi i anëtarësimit mund të ndahet në katër aktivitete kryesore të ndërvarura: (i) harmonizimi ligjor; (ii) përmirësimi i zbatimit dhe kapaciteteve institucionale; (iii) reforma politike dhe përshtatja ekonomike; dhe (iv) negociatat e anëtarësimit (Erjavec, 2007). Negocimi i anëtarësimit ishte themelor dhe formoi shtyllën kurrizore të bashkëveprimit politik mes BE-së dhe përfaqësuesve politik të BP-së, që përfaqëson mjetin e transmetimit të informacioneve midis dy palëve.

Shtetet e BP-së të marra në studim janë në faza të ndryshme të procesit të anëtarësimit[8]. Dy nga shtetet kandidate po presin për hapjen zyrtare të negociatave mbi kapitullin e bujqësisë (RS dhe ME), dy po presin për fillim të procesit të negociatave (AL dhe MK), dhe dy janë kandidat potencial (BA dhe XK*). Në fushën e politikave bujqësore[9], çështjet kyç të procesit të anëtarësimit përfshijnë:

- zbatimi i IPARD;
- harmonizimi i kuadrit ligjor për zbatimin e politikave bujqësore;
- ngritja e kapaciteteve institucionale (kapaciteti për programim, agjensi të pagesave, Sistemi i Integruar Administrativ dhe i Kontrollit (SIAK), zbatimi i rregulloreve horizontale, etj.);
- zbatimi i reformave të politikave për të përshtatur instrumentat e politikave si ato të PPB-së në politika bujqësore (pagesa direkte, zhvillimi rural dhe organizimi i tregut të përbashkët).

Shtetet e BP zbatojnë këto elemente të procesit të integrimit me intensitet të ndryshëm. Në vazhdim, diskutohet në detaje progresi i arritur në këto katër sfera nga shtetet e BP.

1.7.1 IPARD: financim i kufizuar

Programi IPARD është aktualisht mbështetja kryesore e para-anëtarësimit e BE-së në fushën e bujqësisë. Qëllimet e tij kryesor janë ofrimi i ndihmës për zbatimin e *aktit komunitar* në lidhje me modelin PPB dhe dhënia e kontributit në përshtatjen e qëndrueshme të sektorit të bujqësisë dhe të zonave rurale në vendet kandidate[10]. Prandaj, programi IPARD është një mundësi për shtetet e BP-së për të marrë mbështetje financiare që të përshtasin dhe të reformojnë politikat e tyre bujqësore, si dhe të sigurojnë mbështetje për sektorin e bujqësisë dhe për zhvillim rural. Megjithatë, IRJ e Maqedonisë është vendi i vetëm nga shtetet e BP-së me një përvojë më të gjerë (d.m.th për periudhën financiare 2007-2013) në zbatimin e programit IPARD.

Përvoja nga IRJ e Maqedonisë tregon se programi IPARD ishte vetëm pjesërisht i suksesshëm në të qënurit një instrument efektiv për mbështetjen në periudhën e para-anëtarësimit në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Kohëzgjatja e të gjitha procedurave për ngritje dhe akreditimin e kuadrit të nevojshëm institucional, nivel i ulët i thithjes së fondeve (për shkak të kufizimeve programore, administrative dhe financiare[11]), si dhe mungesa e efikasitetit në administratat publike të shteteve të BP-së

---

8 Për më shumë detaje, shikoni http://ec.europa.eu/enlargement/countries/check-current-status/index_en.htm.

9 Kapitulli 11 i procesit të negocimit

10 Për më shumë informacione, shikoni http://ec.europa.eu/agriculture/enlargement/assistance/ipard/index_en.htm

11 Në Maqedoni, vetëm 7% e fondeve totale në dispozicion nga IPARD ishin shfrytëzuar gjatë periudhës së programit 2007–2014 (shikoni Kapitullin 5).

ishin disa nga kufizimet kryesore që nuk lejuan përdorimin e plotë të programit ne shtetet e BP-së.

Problemi themelor qëndron në shtetet e BP-se, pasi zbatimi i programit IPARD duket të jetë një sfidë serioze për institucionet e tyre lokale dhe administratën publike. Zakonisht, shtetet e BP-se kanë vështirësi në organizimin e burimeve njerëzore, institucionale dhe financiare për të zbatuar plotësisht programin IPARD. I gjithë procesi shpesh pengohet nga cilësia e ulët dhe puna e dobët e vendimmarrësve, administratorëve shtetërorë dhe politikëbërësve që, ndër të tjera, reflektohet në kohën e gjatë të nevojshme për miratimin e kuadrit institucional dhe nivelet e ulëta të thithjes së fondeve të programit. Për të adresuar pengesat e zbatimit të IPARD, është e dëshirueshme që të organizohet një workshop apo grup pune me një prezantim të shkurtër, që të shqyrtohen të gjitha mangësitë dhe të identifikohen zgjidhje të mundshme për përmirësimin e funksionimit të programit IPARD në shtetet e BP-së.

1.7.2 Ndonjëherë motivimi i ulët për harmonizim ligjor

Harmonizimi i kuadrit ligjor për zbatimin e PPB përfshin përshtatjen e katër grupeve ligjore të rregulloreve të BE-së (baza ligjore për mbështetje direkte, organizimin e përbashkët të tregut, zhvillimin rural dhe financimin e PPB[12]). Shumica e detyrave të rëndësishme (kryesisht vendosja e kuadrit të kërkuar institucional) janë një çështje e zbatimit kompetent të politikave pas anëtarësimit, ndërsa vetëm një pjesë kërkon harmonizim aktual përpara anëtarësimit. Këto të fundit përfshijnë adoptimin e standarteve të ndryshëm të cilësisë, të tilla si rregullat që rregullojnë vreshtarinë, prodhimin e verës dhe prodhimin organik, si dhe standartet e kërkuara veterinare dhe fitosanitare në fushën e sigurisë së ushqimit, që janë gjithashtu të rëndësishme në kontekstin e pagesave direkte, pasi janë komponent të kërkesave të ndër-pajtueshmërisë.

Ky raport nuk vlerëson në mënyrë të detajuar progresin në fushën e harmonizimit ligjor. Megjithatë, bazuar në njohuritë e ekspertëve nga rajoni, mund të konkludohet se shumë fusha të politikave bujqësore janë tashmë (ose të paktën pjesërisht) të harmonizuara dhe/ose përshtatja e tyre përfundimtare është e planifikuar. Megjithatë, një mangësi e madhe e legjislacionit të miratuar është se zbatimi aktual në praktikë mbetet prapa. Niveli i harmonizimit dhe zbatimit është shumë i varur nga presionet që vijnë nga procesi i negociatave, në përgjigje të sinjaleve të strategjisë së zgjerimit të ndjekur nga institucionet e BE-së. Çdo pengesë në procesin e anëtarësimit merr "shpërblimin" e vet duke dobësuar motivimin e shteteve te BP-së, si dhe duke ushtruar presion mbi këto vende për të arritur harmonizim më të plotë. Serbia dhe Mali i Zi janë në një fazë të procesit në të cilën sinjalet pozitive politike nga BE-ja dhe koordinimi i përmirësuar i brendshëm i proceseve politike mund të përshpejtojnë harmonizimin, duke e çuar atë në fazën përfundimtare.

1.7.3 Kufizimet serioze të ndërtimit të institucioneve

Detyra më e vështirë e procesit të pranimit është arritja e ndryshimeve të nevojshme institucionale të afta për zbatimin e instrumentave të politikave të ngjashme me PPB-në. Modernizimi dhe forcimi i ministrive shtetërore, dhe krijimi i agjencive të pagesave dhe të gjitha bazave të të dhënave të nevojshme, të administratës dhe sistemeve të kontrollit janë shpenzime të konsiderueshme për çdo vend që synon anëtarësimin në BE. Kjo është edhe më e theksuar për shtetet e BP-së për shkak të administratës së tyre të dobët shtetërore, kufizimeve financiare dhe shpesh të kuptuarit të pamjaftueshëm (apo

12 http://ec.europa.eu/agriculture/direct-support/index_en.htm; http://ec.europa.eu/agriculture/markets/index_en.htm;http://ec.europa.eu/agriculture/rural-development-2014-2020/legislation/index_en.htm; http://ec.europa.eu/agriculture/cap-funding/index_en.htm.

mungesës totale të të kuptuarit) politik të procesit dhe të kërkesave të tij. Ndërtimi i institucioneve është administrativisht, financiarisht dhe profesionalisht sfidues dhe kërkon përpjekje dhe vullnet politik të jashtëzakonshëm nga shtetet e BP-se.

Në fushën e zhvillimit rural, IPARD zbut disi barrën duke luajtur rol të rëndësishëm në lehtësimin e transferimit të modeleve institucionale dhe përvojave nga shtetet anëtare të BE-së. Krijimi i parametrave institucionale për zbatimin e pagesave direkte është proces më sfidues, që kërkon investime dhe ndryshime të mëdha në mënyrën e funksionimit, që mund të ndërtohen në mënyrë të besueshme gjatë periudhës së para-anëtarësimit vetëm nëse ato përdoren edhe për zbatim të masave kombëtare. Një element kyç i këtij procesi është krijimi i Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës (SIPT), pasi ai është i domosdoshëm për të mundësuar miratimin dhe zbatimin e pagesave për siperfaqe të ngjashme me PPB-në dhe masa tjera të ngjashme. Ky ndërtim i institucioneve është i pamundur pa ndihmën e jashtme, dhe rezultatet e projekteve të kaluara tregojnë që edhe projektet e mëdha të ndihmës së huaj nuk çojnë detyrimisht në ndërtim të suksesshëm të institucioneve. Një sfidë e mëtejshme e ndërtimit të institucioneve para anëtarësimit në shtetet e BP-se janë kufizimet në burimet njerëzore dhe mungesa e aftësive organizative në administratën publike.

1.7.4 Vullneti politik për reformimin e politikave

Kërkesa kryesore e para-anëtarësimit në fushën e rregullimit dhe reformës së politikave kombëtare bujqësore është krijimi i një kuadri institucional të aftë për zbatimin e modelit PPB në tërësinë e tij pas anëtarësimit në BE. Duhet pranuar se pa lëvizjen graduale të instrumenteve kombëtare në drejtim të PPB-së, nuk është e mundur të ndërtohen institucione dhe të harmonizohet legjislacioni në fushën e politikës bujqësore,. Përfitimet e lëvizjes graduale drejt instrumenteve të politikave të ngjashme me PPB-në gjatë periudhës së para-anëtarësimit si për administratën publike ashtu dhe për grupet e interesit reflektohen në adoptimin e insitutcioneve dhe sistemit tëpagesave sipas PPB të dhe marrjes së njohurive lidhur me to.

Procesi i mëparshëm i anëtarësimit në BE ka hasur në vështirësi në zbatimin e PPB-së. Nisur nga ky fakt BE-ja vendosi një kërkesë për vendet kandidate që të hartojnë strategji të qartë dhe një plan veprimi për të reformuar masat e politikave bujqësore gjatë procesit të para-anëtarësimit, që të jenë të përgatitur në momentin e anëtarësimit. Ky hap kërkon vullnet të konsiderueshëm politik, duke pasur parasysh kufizimet financiare, të burimeve njerëzore dhe të kontekstit të ekonomisë politike me të cilat përballen shtetet e BP-së. Në të njëjtën kohë, kuptimi i gjerë i PPB, si dhe pasja e një administrate efektive publike, është e nevojshme për të adoptuar modelin e përshtatshëm të masave të politikave bujqësore që është edhe politikisht dhe ekonomikisht i qëndrueshëm dhe në përputhje me objektivat e përcaktuara. Plane të tilla janë vetëm fillimi për t'u adaptuar nga vendet e BP-së; Mali i Zi dhe Serbia (shih Kapitujt 6 dhe 7), kanë arritur më larg në këtë drejtim.

Në përgjithësi, analiza jonë sugjeron se dokumentet e miratuara strategjike (ose që janë në përgatitje) që përcaktojnë qëllime afatgjata për bujqësinë në të ardhmen në shtetet e BP-së janë në drejtimin e duhur përsa i përket parashikimit të reformave të politikave në përputhje me kërkesat për anëtarësim. Sfida kryesore është nëse këto dokumente do të vihen në zbatim, dhe në çfarë mase hartuesit e politikave do të ndjekin objektivat, prioritetet dhe instrumentet e zgjedhura. Përvoja e kaluar ka treguar se nuk ndodhte gjithmonë kështu; shpesh, objektivat e caktuara nuk janë ndjekur për zbatim. Nëse objektivat e përcaktuara në dokumente strategjike do të vihen në zbatim, kjo do të ofronte një sinjal të angazhimit të vërtetë politik dhe shtetet e BP-se me siguri do të plotësojnë kërkesat e pranimit.

1.8 Konkluzionet dhe rekomandimet mbi politikat

Analizat nxjerrin në pah disa përfundime dhe rekomandime të përgjithshme relevante për ekspertët kombëtarë që merren me politika bujqësore, si dhe për institucionet ndërkombëtare, sidomos për Komisionin Evropian. Rekomandimet bazë për

modernizimine politikave bujqësore në shtetet e BP-së tashmë u theksuan në studimin e FAO-s dhe vazhdojnë të jenë të vlefshme në këtë raport. Qëllimi kryesor i këtij seksioni është të sqarojë zhvillimet aktuale përkatëse në rajon dhe t'i tregojë ato në kontekst të situatës dhe të ndryshimeve në politikat bujqësore rajonale pas vitit 2013.

1.8.1 Disa ndryshime pozitive dhe nevoja e zhvillimit bujqësor

Faktorët kryesorë të jashtëm që ndikuan në situatën rajonale në bujqësi gjatë viteve 2013-2015 ishin përmbytjet katastrofike të vitit 2014 në disa rajone të BP-së, embargoja ruse e ushqimit, pranimi i Kroacisë në Bashkimin Evropian në vitin 2013 dhe ndryshimet pasuese në regjimet e tregtisë së jashtme në rajon. Zhvillimet e përgjithshme ekonomike kishin prirje të kontribuojnë negativisht në zhvillimin e sektorit bujqësor për shkak të krizës ekonomike të zgjatur, pasi rajoni nuk arriti plotësisht të përmbysë performancën negative ekonomike, edhe pse u vërejtën disa shenja pozitive. Secili nga këta faktorë kishin ndikime të ndryshme në shtete të ndryshme të BP-së. Bosnja dhe Hercegovina duket të jetë shteti më i prekur, pasi u përball me pasoja të konsiderueshme në prodhimin bujqësor nga përmbytjet në vitin 2014 dhe gjithashtu u ndikua negativisht nga mbyllja e disa kanaleve tregtare me Kroacinë.

Edhe pse nuk u vu re ndonjë ndryshim i madh në prodhim apo në strukturën e fermave gjatë periudhës së studimit, ne mund të vëmë re një përmirësim në bilancin e tregtisë së jashtme të rajonit të BP, që kryesisht është udhëhequr nga performanca më e fortë e eksporteve. U vërejtën edhe gjurmët e para të rritjes së prodhimit agroushqimor të shkaktuar nga investimet e kaluara në zinxhirët agroushqimore, që stimuluan zhvillimin e sektorit bujqësor dhe eksportet. Është vështirë të matet se sa e qëndrueshme është kjo prirje, duke pasur parasysh që sektori agroushqimor i rajonit të BP është duke dalë nga periudha e stagniaconit. Duhet të bëhen investime të konsiderueshme shtesë dhe veprime të koordinuara të politikave që rritja e sektorit agroushqimor të jetë ekonomikisht e qëndrueshme. Megjithatë, është e vështirë që kjo të arrihet për shkak se ekonomia e rajonit vazhdon të jetë në një gjendje stanjacioni.

Në këtë raport kemi mbuluar edhe çështje që lidhen me ndryshime strukturore të fermave, konsolidimin e tokës dhe funksionimin e tregjeve të tokës. Tregjet e tokës të zhvilluara dobët në rajon çojnë në disa efekte negative në zhvillimin e strukturës së fermave në veçanti, dhe zhvillimimin rural në përgjithësi. Ka një proces të vazhdueshëm të përqendrimit të pronësisë së tokës në duart e një numri të vogël individësh, ndërsa ndryshimet strukturore të fermave janë të ngadalta. Kjo kërkon më shumë veprime të politikave në forcimine tregjeve të tokës dhe përshtatjen strukturore. Krijimi i një politike moderne të meaxhimit të tokës është një parakusht i rëndësishëm në këtë drejtim, dhe kërkon një nivel të lartë të dijes, vullnetit politik dhe të një administrate shtetërore kompetente. Një kërkesë kryesore në këtë drejtim është miratimi i politikës së drejtë publike, veçanërisht kur caktohen pagesat direkte, që shmang çrregullimin e konkurrencës dhe trajtimin e pabarabartë të llojeve të ndryshme të fermave.

1.8.2 Mungesa e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë në politika

Në periudhën e mbuluar nga ky studim nuk janë vërejtur ndryshime të theksuara në strukturën dhe vëllimin e ndarjes buxhetore për politikat bujqësore në rajon. Trendi i kaluar i rritjes së fondeve për politika bujqësore kryesisht ka përfunduar, si rezultat i krizës ekonomike. Në zgjedhjen e tyre të masave të mbështetjes, shtetet e BP-së po ndjekin kursin e vendosur në vitet e mëparshme, dhe ka edhe përpjekje për futje të masave të reja, duke shkuar drejt mbështetjes së shoqëruar të prodhimit. Por, masat e politikave bujqësore janë subjekt i ndryshimeve të shpeshta, që rezultojnë me një kuadër jo shumë të qëndrueshëm të politikave. Paqëndrueshmëria e kuadrit së politikave gjeneron pasiguri për prodhuesit dhe kufizon aftësinë e tyre për të marrë vendime afatgjata të prodhimit. Mungesa e politikave të synuara zhvillimore mbetet një tjetër dobësi e politikave bujqësore në rajon, pasi pragmatizmi dominues politik po dështon t'iu përgjigjet sfidave zhvillimore me të cilat përballet sektori i bujqësisë.

Dokumentet e miratuara të politikave strategjike që përcaktojnë objektivat afatgjata për bujqësi në të ardhmen tregojnë se politikëbërësit janë të vetëdijshëm për sfidat kryesore me të cilat përballet sektori i bujqësisë dhe zonat rurale. Megjithatë, dobësia kryesore e politikave është zgjedhja dhe miratimi i masave të duhura për trajtim të nevojave dhe sfidave të identifikuara. Roli rishpërndarës i shtetit është shumë më i theksuar se roli i tij zhvillimor, kur është fjala për miratimin dhe zbatimin specifik të masave të politikave. Përveç kësaj, rajoni ka probleme në krijimin e një sistemi efikas analitik dhe programues që mund të ofrojë mbështetje për hartimine politikave.

Në përgjithësi, dokumentet e reja strategjike janë hap i rëndësishëm drejt stabilitetit dhe qëndrueshmërisë më të lartë të kuadrit të politikave bujqësore ne shtetet e BP-së. Por, zbatimi i veçantë i tyre në praktikë është në pyetje për veprimet e ardhshme politike dhe mbetet të shihet në çfarë mase zbatimi do të ndjekë drejtimin e përshkruar të planifikuar, apo nëse do të ketë një kthesë të vërtetë në cilësinë e politikave bujqësore në rajon.

1.8.3 Vendimet e nevojshme politike për të fuqizuar procesin e integrimit Evropian të shteteve të BP-së

Ne provuam të vlerësojmë gjendjen dhe prirjet në procesin e integrimit evropian për bujqësinë ne shtetet e BP-së. Ne theksuam disa fusha që kufizojnë fuqinë e shteteve të BP-së në procesin e integrimit evropian, siç janë miratimi i ngadaltë i mbështetjes së para-anëtarësimit IPARD për shkak të kufizimeve të ndryshme politike dhe administrative, stanjacioni në harmonizimin e kuadrit ligjor dhe ndërtimin institucional dhe mungesën e planeve të qarta të veprimit për reformimin e politikave bujqësore që do të siguronte mundësinë për akomodimin e instrumenteve politike si PPB-ja. Një faktor i rëndësishëm që mund të fuqizojë procesin e anëtarësimit të shteteve të BP-së do të ishte dhënia e një sinjal të qartë lidhur me mundësitë aktuale për anëtarësim në BE të shteteve të BP-së. Kjo mund të japë një stimul të fortë për përpjekjet e disa vendeve të rajonit, veçanërisht për ato në fazë më të avancuar të proçesit të anëtarësimit.

Ndryshimi i shpeshtë i ministrave të bujqësisë në rajon është gjithashtu një mangësi e rëndësishme që kufizon integrimin afatgjatë evropian, pasi kjo pengon akumulimin e njohurive dhe aftësive në këtë sektor sfidues, por politikisht të rëndësishëm. Koordinimi i fortë politik dhe qeverisja e çështjeve Evropiane ne shtetet e BP-së, përfshirë burimet njerëzore, përmirësimin financiar dhe institucional, janë domosdoshmëri për përmirësimin e mëtejshëm në përparimin drejt anëtarësimit. Administrata shtetërore ka nevojë urgjente për udhëheqje dhe iniciativë më të mirë nga zyrtarët e qeverisë për të adresuar mangësitë e administratës në aftësitë organizative dhe në qeverisje.

Çështjet kyçe të mbetura në proceset e integrimit Evropian kanë të bejnë me fushën e reformave të politikave bujqësore. Ndërtimi i institucioneve, harmonizimi i legjislacionit dhe IPARD paraqesin një sfidë të madhe për shtetet e BP-së. Lidhur me reformën e politikave, do të përsërisim disa sugjerime të bëra nga studimi i FAO-s që ende vazhdojnë të jenë të vlefshme:

- Një plan i qartë i veprimit për reformë të politikave bujqësore duhet të bëhet në shtetet e BP-së, gjë e cila do të krijojë një strategji për përshtatjen dhe harmonizimin gradual të politikave të brendshme bujqësore me kërkesat e PPB-së.

- Fillimisht, nga PPB duhet të merren elemente që kanë kuptim nga perspektiva e mbështetjes së bujqësisë, dhe që kanë orientim afatgjatë, të tilla si forcimi i zhvillimit rural.

- Paralelisht me ngritjen e kapaciteteve institucionale (d.m.th SIAK dhe SIPT), duhet të futen pagesat direkte që janë në përputhje me PPB.

- Masat e politikave ekzistuese aktuale, që janë të papajtueshme me PPB, duhet të hiqen gradualisht; dhe duhet të përgatitet një plan strategjik për shkrirjen e tyre, pa sjellë tronditje të mëdha për aktorët dhe administratën. Duhet të ruhen

vetëm ato masa që mund të transformohen në instrumente si ato të PPB-së, dhe që pritet të gjenerojnë përfitime afatgjata ekonomike dhe mjedisore.

1.8.4 Fuqizimi i analizës së politikave dhe qasja për politika të bazuara në fakte apo dëshmi

Ky raport ka vënë në dukje disa nga të metat e statistikave bujqësore dhe përdorimin e tyre për të mbështetur politikëbërjen në rajon. Pavarësisht dallimeve mes shteteve individuale të BP-së, pritej që statistikat do të përshtateshin më tej me standartet evropiane, duke futur tregues shtesë, disponueshmëri dhe përdorim më të madh të rezultateve të studimit dhe një rritje të mëtejshme të përgjithshme në cilësinë e të dhënave. Këto pritshmëri janë plotësuar vetëm pjesërisht. Përvoja tregon se përmirësimi i statistikave varet në një masë të madhe nga kërkesat dhe nevojat e përdoruesit, në veçanti atyre të ministrive dhe subjekteve akademike, që janë përdoruesit e tyre kryesor. Njohuria e shkëlqyer dhe interpretimi solid i treguesve bazë statistikorë janë hapat e parë dhe themelor për aplikimin e statistikave në dispozicion të monitorimit dhe analizës së politikave bujqësore. Këtu nevojitet më shumë progres dhe angazhim, me përfshirjen e qarqeve akademike.

Nuk ka pasur progres thelbësor në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të fuqishëm të mbështetjes analitike për politikat bujqësore në rajon. Përsëri, ekziston nivel i ulët i ndërgjegjësimit të problemit, që qëndron jo vetëm në kërkesën e dobët dhe të ndryshueshme për analiya, por edhe në furnizimin mjaft të kufizuar me dëshmi dhe fakte. Ka nevoja për vendime afatgjata, monitorim të përhershëm, vlerësim të ndikimit, dhe investime në burime njerëzore, krahasueshmëri ndërkombëtare dhe bashkëpunim. Nevojiten përpjekje serioze në të dy anët e kërkesës dhe ofertës. Çdo vend mund të ketë sistemin e vet të mbështetjes analitike; ajo që është e rëndësishme është që ai të jetë vazhdimisht funksional dhe që të krijohet bashkëpunimi midis ministrive të linjës dhe akademikëve. Këto vendime duhet të bëhen në të gjitha shtetet e BP-së dhe në të njëjtën kohë njësitë analitike në ministri duhet të forcohen. Ministritë gjithashtu duhet të rrisin ndërgjegjësimin për dobinë e politikëbërjes të bazuar në fakte apo dëshmi. Këto ndryshime në vendime nga ana e kërkesës duhet të fillojnë në nivelin më të lartë ministror dhe të ndiqen nga stafi i administratës për të ruajtur dhe zhvilluar sistemin e mbështetjes analitike.

Përkundër vështirësive të vërejtura në përdorimin e informacionit bazë statistikor për politikëbërje, mbështetja analitike e bazuar në shkencë kërkon disponueshmëri të aftësive relativisht komplekse dhe burime njerëzore të kualifikuara që të jenë në gjendje të ofrojnë vlerësime të rëndësishme të ndikimit të politikës bujqësore – përfshirë vlerësimet në fushën e procesit të integrimit evropian. Prandaj është e nevojshme të zhvillohen mjete dhe qasje të modeleve dhe të mbështetet pjesëmarrja në konsorciume ndërkombëtare të mjeteve të ndryshme analitike (p.sh. Modelimi Bujqësor i Shteteve Anëtare (AGMEMOD), Sistemi i Përbashkët i Modelimit të Ndikimit të Politikave Bujqësore (SPMNPB), Projekti i Analizës Tregtare Globale (PATG), Modeli i Fermave Individuale për Analizë të Përbashkët të Politikave Bujqësore (MIF-PPB)) për të ndihmuar në transferimin e dijes dhe përvojës së nevojshme në komunitetin lokal kërkimor. Shqyrtimi i mundësive të futjes së qasjeve të ndryshme të modelimit në shtetet e BP-së mund të jetë një hap i rëndësishëm në këtë drejtim, dhe meriton vëmendje të veçantë. Kërkuesit e rinj shkencorë në veçanti mund të kontribuojnë për këtë, në bashkëpunim me kërkuesit më me përvojë.

1.8.5 Komentet përfundimtare dhe detyrat përtë ardhmen

Zonat bujqësore dhe rurale të shteteve të BP-së janë në një pikë kthese të rëndësishme. Nga njëra anë, ka shenja të rritjes dhe progresit në tendencat e zhvillimit në bujqësi dhe zona rurale; në anën tjetër, ka edhe tregues të një ngecjeje të vazhdueshme në disa fusha kyçe të zhvillimit rural. Sektori i bujqësisë dhe zonat rurale janë në nevojë për investime dhe instrumente të politikave me synime dhe objektiva më të mira. Zgjedhja e instrumenteve nuk është një detyrë e thjeshtë, duke pasur parasysh kufizimet financiare,

dhe kërkon njohuri dhe të kuptuarit të mirëfilltë të problemeve të bujqësisë dhe të zonave rurale. Politika bujqësore Evropiane ofron një model për të përcaktuar instrumente më efektive të politikave ne shtetet e BP-së, por kopjimi automatik i modeleve pa i përshtatur ato me kontekstin politik, ekonomik dhe agronomik rajonal, mund të mos jetë i suksesshëm nëse konsideratat lokale nuk merren parasysh.

Angazhimet politike në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE duhet të përkthehen në reforma të politikave bujqësore me vendime të lidhura me çështjet kyçe të zhvillimit bujqësor dhe ndërtim adekuat të institucioneve. Krijimi i mbështetjes analitike në ministritë e linjës dhe institucionet akademike dhe kërkimore është i nevojshëm për të forcuar më tej mbështetjen e politikave të bazuara në fakte apo dëshmi që mund të kontribuojnë në përmirësimin e procesit të vendimmarrjes.

Si përfundim, më poshtë prezantojmë një sërë çështjesh të politikave bujqësore që meritojnë vëmendje dhe mund të mbështesin përpjekjet e përgjithshme për të përmirësuar efikasitetin e politikave bujqësore dhe stimuluar rritjen në sektorin bujqësor dhe zonat rurale:

- Miratimi dhe zbatimi i reformave të tokës dhe të qiramarrjes;

- Adresimi i pengesave me të cilat përballen fermat e vogla, dhe i ndarjes së pabarabartë të mbështetjes nga politikat;

- Fuqizimi i mbështetjes për stimulim të zhvillimit të zinxhirëve modern të furnizimit agro-ushqimor;

- miratimi i një sistemi mbështetës për ZMPF-të në përputhje me PPB;

- fuqizimi i mbështetjes për krijimin e organizatave prodhuese;

- futja në përdorim e instrumentave për menaxhimin e rrezikut;

- forcimi i zhvillimit të ardhshëm të sistemit të dijes dhe inovacionit në bujqësi (SDIB);

- zbatimi i proceseve vendimmarrëse demokratike dhe transparente për politikat bujqësore;

- modernizimi i sistemit të financimit rural.

2. Shqipëria: Përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore

Edvin Zhllima[1], Grigor Gjeçi[2]

[1] Universiteti Bujqësor i Tiranës, Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural

[2] Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë (MBZhRAU)

2.1 Zhvillimi ekonomik

Shqipëria përjetoi një periudhë të rritjes së ngadalësuar ekonomike, e cila filloi në vitin 2009 dhe arriti nivelin më të ulët të saj në periudhën 2012-2013. Gjatë vitit 2014, Shqipëria dukej se po rimëkëmbej nga ngadalësimi i ashpër i rritjes ekonomike, e cila u nxit nga kriza financiare e vitit 2008 (ku rritja e PBB-së u rrit nga 1.4% në vitin 2013 në 2.1% në 2014) (Figura 2.1). Mirëpo, duke qenë se popullsia ishte në rënie krahas ngritjes së PBB-së, edhe pse me një normë më të ngadalshme se në të kaluarën, PBB për frymë është rritur nga viti 2005) (Tabela 2.1). Rritja është shtyrë kryesisht nga rimëkëmbja e kërkesës në sektorin privat.

Tabela 2.1. Shqipëria: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014

	2005	2014
PBB (milionë EUR)	6 561	10 092
Popullsia (milionë)	3,0	2,9
Sipërfaqja (km^2)	28 748	28 748
Dendësia e popullsisë (banorë/km^2)	105	101
PBB/frymë, PPP* (EUR)	5 201	7 301
Tregtia e jashtme si % e PBB-së	36,0	61,5

Burimi: Baza e Të dhënave statistikore për bujqësi - Shqipëri, 2015.
*PPP, paritet i fuqisë blerëse.

Figura 2.1. Shqipëria: treguesit kryesor makroekonomik (% e rritjes nga viti kaluar; % e papunësisë), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave statistikore për Bujqësi - Shqipëri, 2015.

Në vitet e fundit, inflacioni nuk ka tejkaluar 3.6% (niveli i synuar i inflacionit); ka filluar rënien në vitin 2012 dhe vazhdoi me këtë prirje deri në vitin 2014, kur ra në 1.6%. Gjatë të njëjtës periudhë, është rritur shkalla e papunësisë, duke arritur në 17.3% në vitin 2014, niveli më i lartë në 20 vitet e kaluara. Rritja e papunësisë shkaktoi tkurrjen e të ardhurave familjare dhe rritjen e varfërisë. Pas rënies së shpejtë gjatë dekadës së dytë të tranzicionit, normat e varfërisë u rikthyen në nivele te larta sërish në periudhën 2008-2012, duke u rritur nga 10.2% deri 13.6% në zonat urbane dhe nga 14.7% në 15.3% në zonat rurale.

Gjatë periudhës 2009-2013, flukset e investimeve të huaja direkte (IHD) u ngadalësuan nga 1.7% në vit dhe remitancat ranë nga 10.8% të PBB-së në vitin 2009 në 6.6% në vitin 2014. Borxhi i jashtëm u rrit nga viti 2009, edhe pse mbetet në nivelin e menaxhueshëm 36.7% të PBB-së në vitin 2014. Borxhi publik gjithashtu u rrit nga 55% të PBB-së në 71% të PBB-së gjatë së njëjtës periudhë. Deficiti tregtar arriti majën në vitin 2014, me 5.6% të PBB-së. Borxhi i lartë publik dhe deficiti i madh fiskal janë krijuar nga niveli i lartë i shpenzimeve qeveritare, arkëtimi i ulët i të ardhurave tatimore dhe evazioni i përhapur fiskal, që rrjedhin nga një shkallë e lartë e ekonomisë informale.

2.2 Zhvillimi bujqësor

Bujqësia mbetet një prej sektorëve më të rëndësishëm të ekonomisë së Shqipërisë. Në vitin 2014, bujqësia vazhdoi të kontribuojë afërsisht në një të pestën e vlerës së shtuar bruto (GVA) të vendit dhe rreth gjysma e të punësuarve ishin të punësuar në bujqësi (Tabela 2.3), përqindja më e madhe kjo[13] në krahasim me të gjitha vendet tjera të rajonit (shih Kapitullin 1).

Norma e rritjes reale vjetore të GVA-së së sektorit bujqësor ishte e ndjeshme që nga viti 2005, duke regjistruar rritje për çdo vit, përfshirë këtu rritjen prej 8.0% në vitin 2013 dhe 6.0% në vitin 2014. Mirëpo, produktiviteti i fuqisë punëtorë në bujqësi i matur me GVA për punëtor është vetëm sa gjysma e produktivitetit të përgjithshëm në ekonomi (respektivisht, rreth 4,500 EUR për punëtor dhe 8,700 EUR për punëtor). Në vitin 2014, rritja e vëllimit të prodhimit u rimëkëmb pas rënies së shpejtë në vitin 2013 (që erdhi kryesisht si pasojë e përmbytjeve të shumta), ndërsa çmimet mbetën në vend për shkak të presioneve për ulje të çmimeve në ekonomi.

Kontributi i këtij sektori në bilancin e tregtisë ndërkombëtare është në rënie të lehtë për nga pjesëmarrja e tij në totalin e eksporteve dhe importeve. Mirëpo, raporti i eksportit ndaj importit agroushqimor brenda sektorit është përmirësuar (Tabela 2.3).

Tabela 2.2. Shqipëria: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014

Treguesit	2005	2014
% e GVA-së (vlerës së shtuar bruto)	20,6	20,1
% e punësimit	58,2	49,0
Eksportet e produkteve agroushqimore (% e eksportit total)	7,9	6,4
Importet e produkteve agroushqimore (% e importit total)	20,3	18,7

Burimi: Baza e të dhënave statistikore për bujqësi - Shqipëri, 2015.

Janë rreth 352,000 ndërmarrje bujqësore në Shqipëri, të cilat punojnë në rreth 1.2 milionë ha tokë bujqësore. Përkundër rritjes së vogël të madhësisë së fermës në vitet e fundit, sipërfaqja bujqësore për një fermë ende mbetet e vogël, me vetëm 2.8 ha.

[13] Të dy këto shifra duhet të trajtohen me kujdes; duke pasur parasysh nivelin e lartë të informalitetit e cila karakterizon sektorin bujqësor, dhe mangësitë në sistemin informativ të bujqësisë, GVA dhe normat e punësimit nuk mund të jenë shumë të sakta.

Sipërfaqet bujqësore në Shqipëri përfshijnë edhe kullota dhe livadhe që janë në dispozicion dhe por që nuk shfrytëyohen tërësisht, gjë që tregon se sipërfaqja mesatare e fermës, e matur në sipërfaqen e shfrytëzuar bujqësore (SBSH), do të ishte më e vogël. Kullotat dhe livadhet kryesisht mbeten në menaxhim shtetëror dhe vetëm një pjesë u jepen me qira blegtorëve.

Strukturat bujqësore janë përkeqësuar paksa duke qenë se edhe pjesëmarrja e tokës së punueshme ka rënë. Nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2,875,000 ha, rreth 1,201,000 ha është tokë bujqësore (Tabela 2.3). Mirëpo, statistikat e tokës bujqësore kanë ndryshuar shumë pak me kalimin e viteve (Figura 2.2), pjesërisht për shkak të mungesës së regjistrimit të bujqësisë dhe mungesës së informacioneve të përditësuara nga Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme.

Përkundër mungesës së statistikave mbi strukturat bujqësore, rendimenti i disa sektorëve është përmirësuar (Tabela 2.3). Ministria për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Administrimin e Ujrave (MBZhRAU 2013) raporton rritje të rendimenteve të drithërave, perimeve dhe bulmeteve.

Tabela 2.3. Shqipëria: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2013

Treguesit	2005	2013
SB (000 ha)	1 120	1 201
% e tokës pjellore në SB	36	34
% e kulturave bujqësore në prodhimin total bujqësor	40,7	:
Rendimentet mesatare të grurit (t/ha)	3,2	4,1
Rendimentet mesatare të qumështit (t/lopë mjelëse)	2,163	2,722
Faktori i të ardhurave vjetore për një njësi pune (EUR)	:	:
Raporti Export/Import për produktet agroushqimore (%)	11,2	17,9

Burimi: Baza e të dhënave statistikore për bujqësinë - Shqipëri, 2015.
:, nuk ka; SB, sipërfaqe bujqësore.

Figura 2.2. Shqipëria: toka bujqësore sipas kategorive kryesore (000 ha), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave statistikore për bujqësinë - Shqipëri, 2015.

Në vitin 2014, importet e produkteve agroushqimore përbënin rreth 18.7% të importeve totale të mallrave, ndërsa kontributi i produkteve agroushqimore në totalin e eksporteve ishte 6.4%. Gjatë periudhës 2005-2014, eksportet agroushqimore të Shqipërisë u rritën dukshëm - mesatarisht me 14% në vit - duke arritur 128.9 milionë EUR në vitin 2014. Nga ana tjetër, importet janë rritur me mesatarisht 8% në vit. Raporti eksport - import është përmirësuar nga 11.2% në 2005 në 17.9% në 2014, duke qenë se eksportet janë rritur më shumë se importet gjatë kësaj periudhe.

Tabela 2.4. Shqipëria: Zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore mes viteve 2005 dhe 2014

Kategoria	Tradicionalisht, vendi është	Nga viti 2005, prodhimi është	Ndryshimet domethënëse
Drithërat	Importues neto	Rritur	Eksportet janë simbolike në raport me importet. Rritje e dukshme e prodhimit prej rreth 25% u vu re në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007 dhe që atëherë prodhimi është në rritje të lehtë
Sheqeri	Importues neto	Nuk ka trend domethënës	Eksportet janë rritur dukshëm, por mbesin simbolike në krahasim me importet. Importet, në anën tjetër, janë zvogëluar që nga viti 2005, edhe pse nuk ka trend të qartë në vitet e ndërmjetme
Farëra vaore, vajrat dhe yndyrat	Eksportues neto	Nuk ka trend domethënës	Shqipëria është eksportues neto. Bimë mjekësore dhe aromatike, sidomos sherbela, përbëjnë pjesën më të madhe të këtij grupi. Shifrat e prodhimit nuk janë të raportuara, pasi ky sektor është shumë informal. Sherebela në vitet e fundit ka përjetuar ulje drastike të çmimit për shkak të devijimit të tregut dhe tepricës së ofertës
Fruta dhe perime	Importuesi neto	Rritur	Eksportet paraqesin një trend domethënës pozitiv, sidomos në vitin 2010. Në këtë vit, eksportet janë pak më shumë se dyfishi krahasuar me periudhën paraprake. Importet kanë filluar rënien në vitin 2011. Prodhimi është në rritje të vazhdueshme. Në disa produkte, vendi arrin vetë-mjaftueshmëri.
Vera	Importuesi neto	Zvogëluar	Importet janë rritur vazhdimisht gjatë periudhës së vrojtuar, ndërsa eksportet mbesin simbolike krahasuar me prodhimin apo importet
Patatet	Importuesi neto	Rritur	Përkundër sasisë simbolike krahasuar me importet ose prodhimin, eksporti pothuajse është dyfishuar në sasi në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012.
Duhani	Importuesi neto	Rritur	Përkundër rritjes në vitet e fundit, eksportet mbesin më të ulëta se importet. Gjatë periudhës së vrojtuar, prodhimi është rritur me një dinamikë të ngadaltë. Qeveria shpërfill këtë produkt për nga mbështetja financiare dhe jo-financiare
Mish gjedhi dhe viçi	Importuesi neto	Nuk ka trend domethënës	Shqipëria nuk eksporton mish gjedhi dhe viçi, përveç një sasie të vogël në vitin 2005 (vetëm 16 t). Prodhimi është në rritje të lehtë, ndërsa importet në rënie konstante përveç vitit 2013.
Mish derri	Importuesi neto	Nuk ka trend domethënës	Ashtu si të gjitha llojet e mishit, Shqipëria nuk eksporton mish derri. Importet kanë shënuar rënie të lehtë, duke filluar nga viti 2008
Mish delje dhe dhie	E vetë-mjaftueshme	Është rritur	Importet janë në rritje të lehtë në vitet e fundit, por kanë qenë gjithnjë më të ulëta se prodhimi, duke marrë pjesë me vetëm 1% të ofertëse totale. Kjo është arsye se pse e konsiderojmë Shqipërinë si të vetë-mjaftueshme në raport me këto lloje të mishit.
Mish pule	Importuesi neto	Është rritur	Prodhimi pothuajse është dyfishuar gjatë periudhës 2005-2009 dhe pastaj mbeti në vënd deri në vitin 2014. Importet kanë përjetuar një rënie drastike në vitin 2006 dhe iu kthyen niveleve paraprake në vitet pasuese. Eksportet pothuajse nuk ekzistojnë.
Qumështi dhe prodhimet e bulmetit	E vetë-mjaftueshme	Është rritur	Importet janë përgjysmuar gjatë viteve 2005-2007 dhe kanë filluar rënien në vitet pasuese, duke arritur nivelet më të larta në vitin 2013. Pas disa viteve, Shqipëria ka filluar eksportimin e produkteve të bulmetit në sasi modeste, të cilat luhaten nga 200 deri 600 tonë. Kriteret e sigurisë pengojnë vendin që të realizojë qasjen e mundshme tregjeve të jashtme përveç atij të Kosovës*

Figura 2.3. Shqipëria: tregtia agroushqimore (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e Të dhënave statistikore për bujqësi - Shqipëri, 2015.

Kategoritë kryesore të agro-ushqimeve të eksportuara janë "Farërat dhe frutat vajore" si dhe "mishi i përpunuar". Pranues kryesor të eksporteve të produkteve agroushqimore janë anëtarë të BE-së, kryesisht Italia, Greqia dhe Gjermania. Përkundër rritjes së përgjithshme dhe diversifikimit të eksporteve të produkteve agroushqimore, vazhdon deficiti tregtar krahasuar me vitin 2005 (Figura 2.3).

2.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

2.3.1 Kuadri dhe zbatimi i politikave bujqësore

MBZhRAU ushtron funksionet e saj në bazë të tre dokumenteve kryesore të politikave: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020, Programi Afatmesëm Buxhetor, si dhe strategjitë sektoriale, ndërsektoriale dhe të ndërthurura, të cilat përcaktojnë pikësynimet afatmesme dhe afatgjata të politikave, masat kryesore, mjetet e monitorimit dhe koston e zbatimit të politikave. Politikat afatmesme të MBZhRAU-së janë përcaktuar në programin vjetor ndërsa aktivitetet relevante në planin vjetor të veprimit. Që nga viti 2005, ministria aplikon një Sistem të Integruar të Planifikimit, i cili përfaqëson një tërësi të parimeve operative për t'u siguruar që planifikimi dhe monitorimi i politikave qeveritare realizohet në një mënyrë efikase dhe të harmonizuar.

Zbatimi i Strategjisë së Ndërthurur Ndërsektoriale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 (SNBZHR) koordinohet nga MBZhRAU, në bashkëpunim me ministritë e tjera, në veçanti me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Ndërmarrjes. Kuadri kryesor ligjor është Ligji për bujqësinë dhe zhvillimin rural i miratuar në vitin 2007, i cili rregullon programimin e masave të politikave të ndërlidhura me bujqësinë dhe zhvillimin rural, mundëson shërbime publike këshilluese për bujqësinë, kërkimin dhe trajnimin, si dhe mundëson themelimin e një databaze të informacioneve. Ligji gjithashtu përcakton bazën ligjore për skemat kombëtare të mbështetjes, të cilat përcaktohen çdo vit me Planin kombëtar të veprimit, dhe përcakton gjithashtu institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikës bujqësore me themelimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor Rural (AZhBR).

SNBZHR 2014-2020 u miratua në vitin 2014. SNBZHR 2014-2020 integron zhvillimin bujqësor dhe rural në një strategji të vetme. SNBZHR përcaktoi "një sektor agroushqimor efikas, inovativ dhe të qëndrueshëm, të aftë për tu bërë ballë presioneve të konkurrencës dhe të përmbushë kushtet e tregut të BE-së përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve dhe zona rurale të qëndrueshme që ofrojnë aktivitete ekonomike dhe mundësi

punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi të jetës për banorët rural" (MBZhRAU, 2014). Në këtë mënyrë, kuadri strategjik që udhëheq zbatimin e zhvillimit bujqësor dhe rural gjithashtu është i ndërlidhur me statusin e Shqipërisë në kontekstin e integrimit në BE.

Më konkretisht, SNBZHR parashikon ndërhyrje në tre fusha të politikave: (i) politika e zhvillimit rural; (ii) skemat kombëtare të mbështetjes për fermerë, zhvillimin e infrastrukturës rurale dhe ofrimin e mundësive të barabarta; dhe (iii) zhvillimin institucional, zbatimin e kërkesave institucionale të BE-së.

SNBZHR 2014-2020 ka katër prioritete: (i) rritjen e qëndrueshmërisë së fermave dhe aftësisë konkurruese të bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit, krahas harmonizimit të vazhdueshëm me standartet e BE-së; (ii) restaurimin, ruajtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve të varura prej bujqësisë dhe pyjeve; (iii) zhvillimin e balancuar territorial dhe ekonomik të zonave rurale për të promovuar përfshirjen sociale; dhe (iv) transferimin e dijes dhe inovacioni në bujqësi, pylltari dhe zona rurale.

Tabela 2.5. Shqipëria: masat dhe instrumentet kryesore të politikave bujqësore, 2005 dhe 2014

	Zbatuar	Nga viti 2005, mbështetja është	Ndryshimet domethënëse
Masat për mbështetje të tregut	Nuk janë domethënëse	Nuk ka trend domethënës	Nuk ka mbështetje domethënëse të tregut
Subvencione të inputeve variabile	Po, herë pas here	Zvogëluar	Është zvogëluar dhe ka pushuar së ekzistuari pas vitit 2007
Pagesat direkte bazuar në prodhim	Po, rregullisht	Nuk ka trend domethënës	Është rritur nga 2009 deri 2012, por në vitin 2012 ka qënë jodomethënëse. Janë vërejtur luhatje përgjatë viteve. Mbështetja është rritur sërish në vitin 2013 dhe më pas ka rënë në vitin 2014. Pjesa më e madhe e subvencioneve është e lidhur me pagesat për litër qumësht të prodhuar dhe vajit ulliri organik të prodhuar. Në vitin 2014, skema e vajit të ullirit ka pushuar së ekzistuari, dhe është paraqitur një skemë tjetër për fruta dhe perime të dorëzuar në pikat e grumbullimit dhe përpunimit.
Pagesat direkte bazuar në sipërfaqe/kafshë	Po, rregullisht	Është rritur	Është rritur dukshëm. Pagesat për numër krerësh, siç janë për kafshë të regjistruara apo të racës së pastër, me fokus në kafshë të imta, janë kontribues kryesor të rritjes
Pagesat direkte të ndara nga prodhimi	Nuk janë zbatuar	Nuk ka trend domethënës	Nuk ka pagesa direkte të ndara nga prodhimi apo skema të ngjashme
Mbështetje për investime në fermë	Po, rregullisht	Është zvogëluar	Në pesë vitet e para vërtetohet një trend rritës, duke arritur kulmin në vitin 2010. Nga viti 2010, vërehet një trend rënës, për shkak të reduktimit të mbështetjes për plantacione (kryesisht ullinj dhe fruta të tjera) dhe riorientim drejt sistemeve të ujitjes me pika dhe sistemeve të reja të ngrohjes për serra.
Mbështetje për industrinë ushqimore	Po, herë pas here	Nuk ka trend domethënës	Janë vërejtur luhatje përgjatë viteve. Nga viti 2008, skema ka ndryshuar çdo dy vjet. Zhvillimi më i fundit i skemës është pagesa prej 50% e vlerës së investimeve për infrastrukturën e magazinimit dhe përpunimit
Pagesat e lidhura me mjedisin	Nuk janë zbatuar	Nuk ka trend domethënës	Gjatë këtyre viteve nuk janë zbatuar masa mjedisore
Mbështetje për zonat rurale	Nuk janë zbatuar	Nuk ka trend domethënës	Gjatë këtyre viteve nuk është regjistruar mbështetje për ekonominë dhe popullsinë rurale

Masa të përgjithshme të mbështetjes	Po, rregullisht	Është rritur	Masat kryesore fokusohen në sigurinë e ushqimit. Buxheti u rrit në vitin 2014 bazuar në masa të tjera të mbështetjes së përgjithshme që ofrohet nga projektet e ndihmës teknike

Një skemë kombëtare për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural zbatohet çdo vit me dekretin e Këshillit të Ministrave. Zbatimi i Planit kombëtar të veprimit është përgjegjësia e AZhBR-së dhe Drejtorisë së Zhvillimit Rural brenda MBZhRAU-së nën mbikëqyrjen e Komitetit Ndërministror për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Skema Kombëtare e mbështetjes gjatë vitit 2013 u implementua nëpërmjet 23 masave. Njëzet prej tyre janë skema të përfitimeve direkte nga Fondi i Programit për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural. Tre skemat tjera inkurajojnë huadhënien për sektorin agro-përpunues, investimet në makineri bujqësore dhe promovojnë bashkëpunimin për themelimin e kooperativave bujqësore. Prioritet iu jepet zonave malore duke aplikuar disa kritere të ndryshme (p.sh. sipërfaqe më të vogla, numri i lopëve, deleve, dhive, etj.). Në vitin 2014, janë aplikuar 21 masave, prej të cilave 19 ishin masa të përfitimeve direkte, një mase inkurajoi huadhënien për sektorin agro-përpunues dhe investimet në makineri bujqësore dhe një mase ishte e lidhur me investimet, që mbështeste 50% të kostos së investimeve.

Nga viti 2011, Shqipëria ka hartuar Programin IPARD (2011-2013) dhe ka themeluar një strukturë operative të IPARD-it. Agjencia e Pagesave e IPARD, në kuadër të strukturës së AZhBR-së është duke fituar akreditimin për t'u bërë organ përgjegjës për zbatimin e Programit IPARD. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përfunduar përgatitjen e akreditimit për tërë Sistemin e Menaxhimit dhe Kontrollit të IPARD, përfshirë aktivitetet e Oficerit Kombëtar Autorizues, Fondit Kombëtar, organeve teknike dhe Autoritetin Auditues.

Gjatë vitit 2015, është vënë në zbatim një skemë grantesh si skemë plotësuese e IPARD-it. Skema e granteve e Programit për Zhvillim bujqësor dhe Rural e Ekonomik parimisht mbështet vetëm investimet nën pragun e IPARD-it, fermerët e vegjël dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në zonat malore të pazhvilluara.

Projekti "Zhvillimi i qëndrueshëm i Sektorit të Ullishtarisë të Shqipërisë" financohet në shumën prej 3 milionë EUR në kuadër të një marrëveshjeje bilaterale ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë. Në vitin 2016, pritet të vihen në zbatim masa të mbështetjes për sektorin e ullishtarisë, me synim ruajtjen e diversitetit dhe promovimine qëndrueshmërisë mjedisore.

2.3.2 Mbështetja buxhetore për bujqësinë

Gjatë periudhës 2013-2014, mbështetja buxhetore për bujqësinë në vend përjetoi ndryshime të vogla. Në vitin 2013, mbështetja e përgjithshme buxhetore u zvogëlua, dhe në vitin 2014 është rritur në vlerë pothuajse të njëjtë si në vitin 2012 (Figura 2.4). Në vitin 2014, mbështetja e përgjithshme buxhetore ishte në vlerën 22.9 milionë EUR ose 19.2 EUR për hektar të tokës së shfrytëzuar bujqësore (SBSH). Përkundër prirjes rritëse por shumë të luhatshëm në periudhën 2006-2011, gjatë tre viteve pasuese, mbështetja e përgjithshme buxhetore u stabilizua në vlera të ngjashme me ato të regjistruara në vitin 2005.

Figura 2.4. Shqipëria: mbështetja buxhetore për bujqësinë (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave, MPB – Shqipëri.

Masat strukturore dhe të zhvillimit rural (shtylla e dytë) dhe masat e përgjithshme të mbështetjes bujqësore (shtylla e tretë) ishin shumë më të larta sesa mbështetja direkte e prodhuesve. Shtylla e tretë është rritur në përqindje gjatë vitit 2014, kryesisht për shkak të disbursimeve nga projektet e donatorëve. Fuqia e ulët e lobimit në sektorin e bujqësisë, prania e lartë e projekteve të ndihmës së huaj dhe vlerat e ulëta të përgjithshme buxhetore e bëjnë mbështetjen direkte të prodhuesve në Shqipëri më pak të dukshme sesa në vendet tjera.

Masat e mbështetjes direkte të prodhuesve në vend vazhdojnë të jenë shumë modeste (më pak se 2.4 EUR për ha). Për më tepër, kjo masë mbështetjeje për nga pjesëmarrja në mbështetjen e përgjithshme buxhetore është e dobët, edhe pse u rimëkëmb në 9.8%. Në Shqipëri, shumica e fondit të ndarë për mbështetje direkte të prodhuesve i jepet sektorit të blegtorisë.

Vendi përfaqëson një rast interesant në Ballkanin Perëndimor, pasi që subvencionet për inputet variabile janë shumë modeste (Figura 2.5). Lobimi i dobët nga agro-përpunuesit dhe furnizuesit e inputeve mund të jenë faktorët kryesorë të këtij trendi. Kjo veçori e ndihmon vendin që të orientohet drejt skemave të ngjashme me BE-në.

Figura 2.5. Shqipëria: Përbërja e masave direkte të mbështetjes (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave, MPB – Shqipëri.

Përbërja e masave të mbështetjes direkte në përgjithësi nuk ka ndryshuar shumë përgjatë periudhës në fjalë. Nuk ekzistojnë pagesa të palidhura me prodhimin (decoupled), edhe pse këto përbëjnë një masë shumë të rëndësishme të PPB-se.

Figura 2.6. Shqipëria: Përbërja e pagesave direkte për prodhuesit (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave, MPB – Shqipëri.

Pjesa më e madhe e pagesave janë bërë për sipërfaqe/nr. krerësh, dhe janë të lidhura me produkte të caktuara, një formë kjo e cila është gjithmonë e më pak e përdorur në shtetet anëtare (Figura 2.6). Skema është rritur dukshëm ndër vite. Pagesat për numër krerësh, siç janë për kafshë të regjistruar apo të racës së pastër, kryesisht të përqendruar në kafshë të imta, janë kontribues kryesor të rritjes së saj.

Shqipëria gjithashtu kryen pagesa direkte bazuar në prodhim (shtese mbi çmim), me ndryshime madhore nga viti në viti në sektorët e mbështetur siç janë ato për qumësht, vaj ulliri organik, fruta dhe perime të dorëzuara në pikat e grumbullimit apo përpunimit.

Në kuadër të masave për zhvillimin rural, nuk ka fonde që shënjestrojnë mbështetjen për ekonominë dhe popullsinë rurale. Fondet që kanë për synim përmirësimin e mjedisit dhe natyrës janë gjithashtu të pakta. Njohja e gjendjes mjedisore në zonat rurale përmes politikave është ende shumë e ulët. Menaxhimi i mbeturinave është shumë i dobët dhe nxjerrja e burimeve natyrore mbetet e pakontrolluar (EC 2014).

Mbështetjet për rritjen e aftësisë konkurruese janë modeste (Figura 2.7). Përkundër luhatjeve të përgjithshme, në vitet e fundit shihet një rënie relative. Nga viti 2010, vërehet një prirje rënëse, shkaktuar nga rënia e mbështetjes për plantacione (kryesisht ullinj dhe fruta të tjera) dhe riorientim drejt sistemeve të ujitjes me pika dhe sistemeve të reja të ngrohjes për serra.

Figura 2.7. Shqipëria: Përbërja e masave t Përbërja zhvillimit strukturor dhe rural (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave, MPB – Shqipëri.

Të dhënat mbi masat e përgjithshme të mbështetjes përbëhen nga mbështetja e përgjithshme për kërkim dhe zhvillim bujqësor, shërbime këshillimore dhe të zgjerimit për bujqësinë, financimi publik i masave në fushën e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit (masat veterinere dhe fitosanitare) si dhe masat tjera të karakterit të përgjithshëm. Buxhetimi për këto masa është rritur (Figura 2.8).

Për masat e përgjithshme të mbështetjes, rritja e fondeve nxitet nga mbështetja që ofrohet për sigurinë ushqimore, gjithashtu e financuar nga projektet e ndihmës së huaj prej BE-së. Fondet buxhetore për krijimin dhe transferimin e njohurive tek prodhuesit bujqësor janë pak a shumë konstante, duke nxjerrë në pah njohuritë e pamjaftueshme lidhur me rëndësinë e dijes për zhvillimin e bujqësisë.

Figura 2.8. Shqipëria: Përbërja e masave të përgjithshme lidhur me bujqësinë (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave, MPB – Shqipëri.

2.4 Çështjet e fermave

2.4.1 Struktura e fermave

Numri i madh i fermave për mbijetesë dhe gjysmë-mbijetesë është një karakteristikë e Shqipërisë. Mirëpo, të dhënat mbi strukturat e fermave janë të pjesëshme dhe nuk janë të përditësuara në dy vitet e fundit. Statistikat administrative të MBZhRAU-së aktualisht deklarojnë se numri i fermave është rreth 350,000 dhe Instituti i Statistikave i Shqipërisë (INSTAT) gjithashtu publikon po të njëjtin numër, e cila bazohet jo në konsensus por në një vlerësim të ekspertëve të cilët përdorën të dhënat paraprake mbi strukturën administrative dhe të fermës nga MBZhRAU (Tabela 2.6).

Gjatë viteve 2013-2014, është përkeqësuar disponueshmëria dhe besueshmëria e të dhënave. Faktorët institucionalë janë përcaktues kryesorë të kësaj situate. Në vitin 2012, pas regjistrimit të Ekonomive Bujqësore, me vendim të Këshillit të Ministrave mbledhja dhe përpunimi i statistikave bujqësore iu delegua INSTAT-it nga nga MBZhRAU. Prandaj, në ministri pushoi së ekzistuari organi përgjegjës për vrojtimine fermave dhe mbledhjen e të dhënave administrative.

Tabela 2.6. Shqipëria: të dhënat kryesore mbi strukturën e fermave, 2012

Sipërfaqja (ha)	Numri i fermave	Përqindja
0.1.-0,5	70 195	20,00
0.6.-1,0	89 661	25,55
1.1.-2,0	142 084	40,49
2.1 e më shumë	48 976	13,96
Gjithsej	**350 916**	**100,00**

Burimi: Të dhënat administrative të MBZhRAU.

Sipas Regjistrimit të Njësive Ekonomike Bujqësore të vitit 2012, 98.2% e 303,802 njësive ekonomike bujqësore në Shqipëri janë kryesisht ferma familjare. Mirëpo, rezultatet e regjistrimit nuk janë bërë publike nga INSTAT-i dhe si rrjedhojë nuk shfrytëzohen për qëllime statistikore nga MBZhRAU. Gjatë viteve 2013 dhe 2014, INSTAT-it i vihen në dispozicion vetëm disa të dhëna kyçe të performancës nga drejtoritë regjionale të MBZhRAU-së. Në fillim të vitit 2015, me një vendim tjetër qeveritar, shërbimi i mbledhjes së të dhënave primare i është bartur sërish MBZhRAU-së, por INSTAT-i vazhdon të ketë përgjegjësi për çështjet metodologjike.

Ndryshimet e vazhdueshme institucionale penguan përpjekjet e ndihmës së huaj për të përmirësuar statistikat bujqësore dhe për t'i harmonizuar këto me kërkesat e BE-së. Të dhënat nga regjistrimi duhet të krijojnë bazën për krijimin e regjistrit të fermave - proces ky i cili kërkon financim të mëtejshëm. Statistikat mbi strukturat e fermave nuk përditësohen. Llogaritë ekonomike për bujqësinë nuk janë të disponueshme dhe nuk janë ndërmarrë hapa madhorë për të krijuar një rrjet të të dhënave mbi kontabilitetin e fermave. Shqetësime të tilla janë shprehur edhe në Raportin e Progresit të BE-së të vitit 2014. Departamenti statistikor në Ministri kërkon ristrukturim organizativ dhe më shumë personel për të përmirësuar kapacitetet për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Ky ristrukturim dhe alokim i burimeve njerëzore për sistemin e mbështetjes analitike nevojitet për të mundësuar programim të politikave bazuar në fakte apo dëshmi si dhe për vendimmarrje.

2.4.2 Politikat e lidhura me çështjet e fermave

Skemat kombëtare të mbështetjes janë formuluar gjithashtu për të trajtuar kufizimet me të cilat ballafaqohen fermerët e vegjël. Kufijtë minimal të mbështetjes në disa masa, në

veçanti pagesat për sipërfaqe apo për kafshë, janë mjaft të volitshme për strukturën aktuale të fermave. Sipërfaqja mesatare e një parcele në Shqipëri është 0.25 ha. Mbështetje ofrohet për plantacionet e frutave, bimë mjekësore dhe aromatike me së paku 0.2 ha. Mbështetja e kafshëve është më e kufizuar por prapë kufiri minimal i pranueshëm është ruajtur në nivele relativisht të ulëta, siç është përshëmbull 10 krerë gjedh dhe 50 krerë kafshë të imta. Vëmendje i kushtohet modernizimit të pemëve të ullinjve dhe investimeve në ujitjen me pika për këto pemë, për plantacionet e vreshtave dhe të limonit, me kufi më të ulët se 0.5 ha. Gjatë viti 2013, fermerët e vegjël janë mbështetur nëpërmjet investimeve në koshere bletësh dhe në vjeljen e arrave dhe shegëve. Për më tepër, gjatë vitit 2013, skema kombëtare e mbështetjes ofroi mbështetje për grupet e fermerëve të regjistruar si Shoqata për Bashkëpunim Bujqësor, duke iu ofruar mundësinë e bashkëfinancimit të pjesshëm të investimeve. Në vitin 2014, mbështetja për grupet e fermerëve dhe për vjeljen e arrave dhe shegëve është ndërprerë.

Nuk ka vlerësime për të matur lehtësinë e aksesit të fermave të vogla në skemën kombëtare të mbështetjes. Është e njohur se aksesi në skemat e IPARD është mjaft e vështirë për fermat e vogla. Një pjesë shumë e vogël e aplikantëve potencialë bëhen përfitues. Nuk ka shifra lidhur me dimensionet e fermave të përfituesve; prandaj, është e pamundur të vlerësohet se në ç'masë kjo skemë është e orientuar drejt fermerëve të vegjël. Pagesat për mbjelljen e pemëve të ullinjve, mbrojtjen e ullinjve nga miza e ullirit, kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike, si dhe pagesat për fermat të cilat kultivojnë më shumë se 100 krerë dhi/dele të regjistruara ishin masat me numër më të madh të përfituesve, gjë që dëshmon se këto skema janë më të lehta për t'u aplikuar në raport me të tjerat. Për të ardhmen e afërt, janë duke u studiuar edhe një fond i garancave dhe një skemë e sigurimeve për fermerët.

Gjermania dhe Danimarka kanë bashkëpunuar gjithashtu për të krijuar një program të mbështetjes bujqësore, Mbështetja për Bujqësinë dhe Zhvillimin Ekonomik e Rural (SARED). Programi ofron mbështetje për zinxhirët e vlerave të zgjedhura: (i) të bimëve mjekësore dhe aromatike, (ii) frutat dhe arroret, (iii) të të imtave dhe (iv) të turizmit rural. Mbështetja përfshin një kombinim të investimeve kapitale, lehtësimin dhe asistencë teknike për të ndërtuar kapacitetin e fermerëve dhe agrobiznesit në zonat jo të favorshme malore. Fokusi nga SARED është të mbështesë përpjekjet e Qeverisë së Shqipërisë për të zgjeruar ndihmën e saj për fermerët e varfër dhe agrobizneset në zonat malore. Objektivi i përgjithshëm i SARED-it është që të rrisë qëndrueshmërinë e ekonomisë rurale në zonat jo të favorshme malore. Buxheti i përgjithshëm është 13.2 milion euro për një periudhë katërvjeçare zbatimi. Zbatimi ka filluar në qershor të vitit 2014, me përjashtim të mbështetjes për turizmin. SARED është lehtë i aksesueshëm nga fermerët e vegjël, në sajë të kritereve relativisht miqësore të pranimit. Për shembull, investimet dhe ndihmat mbështetëse jepen për fermerët apo grupet e fermerëve me një minimum prej 30 krerë kafshë të imta ose 0.1 ha të tokës së kultivuar me fruta. Gjithashtu ka kërkesat administrative të kufizuara për ata që aplikojnë për këtë mbështetje.

2.5 Procesi i integrimit në BE

Rruga e Shqipërisë për arritjen e bujqësisë së qëndrueshme dhe zhvillimit rural është e lidhur me çështjet kyçe, të cilat ende nuk janë arritur. Ajo dështoi me kërkesat e përgjithshme institucionale për anëtarësim në BE, pavarësisht progresit të dëshmuar në vitet e fundit. Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat në BE në qershor të vitit 2014 dhe aktualisht është duke rritur përpjekjet e saj për tu harmonizuar me BE-në. MBZHRAU ka themeluar Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZhBR), e cila do të shërbejë si agjensi e pagesave për skemën SNBZHR dhe vendosjen e autoritetit menaxhues përgjegjës për përcaktimin e masave IPARD. Mbështetja e pritur nga BE-ja e kombinuar me kontributin kombëtar nën programin IPARD është një vlerë prej 92 milionë euro përgjatë periudhës kohore 2016-2020. Draft programi i konsoliduar IPARD-2 i është dorëzuar Komisionit Evropian për konsultime të brendshme.

Masat e IPARD-it janë të orientuara drejt modernizimit të fermave, sidomos përmes miratimit të standarteve të BE-së për përpunim dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe produkteve të peshkimit. Masa të tjera janë të nevojshme për rritjen e aftësisë konkurruese të bujqësisë. Sfidat strukturore të sektorit në lidhje me cilësinë e produktit dhe produktivitetit, nxitja e eksportit dhe aksesi në financë si dhe të drejtat e tokës dhe konsolidimit të tyre nuk janë të përfshira në SNBZHR. Këto sfida janë pasqyruar në strategjitë dhe planet e veprimit të ministrive të tjera dhe janë të administruara nga një strukturë e fragmentuar administrative dhe institucionale.

Reformat e menaxhimit të tokës duhet të vazhdojnë me një ritëm më të shpejtë. Një strategji për konsolidimin e tokës është duke u miratuar në bazë të një bashkëpunimi të mëparshëm me programin UN-FAO. Hapa të mëtejshëm janë të nevojshme për institucionalizimin e këtyre ndërhyrjeve. Për më tepër, shqetësimet në lidhje me të drejtat e tokës duhet të adresohen veçanërisht në verilindje të vendit, ku ringjallja e të drejtave zakonore solli mospërmbushjen e procedurave e për pajisjen me tituj pronësie të atyre që kanë përfituar tokë sipas reformës së vitit 1991 (sipas Ligjit 7501). Investimet në këto zona do të mund të pengohet nga e sigurisë së fermerëve që kanë tituj të pronësisë së tokës dhe dokumentacionit pamjaftueshëm të pronësisë të tokës për fermerët e tjerë.

Përpjekjet janë të nevojshme për të mbështetur zhvillimin e balancuar territorial, veçanërisht masat për të mbështetur LFA. Edhe pse Shqipëria ka një përqindje të lartë të LFA, Agjencia per Zhvillimin e Zonave Malore (AZhZM), përgjegjëse për administrimin e mbështetjes për LFA, ka përjetuar në vitet e fundit një ulje të fondeve në dispozicion dhe përgjegjësive .

Zhvillimi rajonal nuk po ecën ashtu siç pritet. Varfëria rurale është në rritje, pabarazitë rurale-urbane janë zgjeruar dhe një trend i migrimit rural ka vazhduar në dhjetë vitet e fundit. Regjistrimi i Popullsisë në vitin 2012 ka identifikuar për herë të parë në historinë e vendit se më shumë njerëz jetojnë në zonat urbane në Shqipëri se sa në ato rurale. Varfëria rurale në vitin 2012 është duke ndjekur një trend rritës që nga viti 2008, shumë të ndryshëm nga trendi rënës përjetuar prej vitit 2002. Politika rajonale po përballet me sfida të reja. Shqipëria është duke kaluar një reformë të rëndësishme të zhvillimit rajonal, që e shndërroi vendin nga një strukturë shumë të fragmentuar të përbërë nga 374 njësive të qeverisjes vendore në rreth 61 njësi të qeverisjes vendore. Ky ristrukturim territorial premton reformë financiare dhe fiskale që do të shtyjë për decentralizimin e disa funksioneve administrative dhe financiare. Një ndryshim i përgjithshëm ligjor dhe institucional do të duhet të ndërmerret përpara se të mund të hartohet sërish një politikë e qartë bujqësore dhe e zhvillimit rural me qasje rajonale .

2.6 Fuqitë dhe dobësitë e bujqësisë Shqiptare

2.6.1 Fuqitë dhe dobësitë e përgjithshme

Tabela 2.7 shpjegon fuqitë dhe dobësitë kryesore në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri, si dhe lidhur me politikat për zhvillim rural dhe të bujqësisë.

Pikat kryesore pasqyrojnë disa boshllëqe të mëdha të zbuluara, dhe relative me gjendjen e tanishme në BE. Përshkrimi është i bazuar në një grup faktorësh në aspektin e disponueshmërisë së burimeve, mjedisit aktual të biznesit, fuqitë ekzistuese, mundësitë për diversifikim dhe politikat përkatëse për sektorin (Tabela 2.7).

Tabela 2.7: Shqipëria: Fuqitë dhe dobësitë e bujqësisë dhe zonave rurale dhe politikat e lidhura me to

	Fuqitë	Dobësitë
Burimet	- Fermat me drejtim nga tregu po rriten shpejtë dhe rrisin prodhimin - Puna familjare në dispozicion - rreth 45% e fuqisë punëtore punon në bujqësi - Kosto e ulët e punës dhe aftësi të bollshme të përgjithshme bujqësore - Burime të papërdorura dhe të pastra natyrore, që janë potencial për diversifikim	- Fragmentimi shumë i lartë i tokës - Shfrytëzimi i dobët i burimeve natyrore - Strukturat e paluajtëshme të fermave dhe makineritë e nevojshm mungojnë apo është në gjendje të dobët - Makineritë dhe pajisjet mbeten të prapambetura në aspektin e e inovacioneve teknike - Mungesa e kapitalit të kualifikuar njerëzor nga ana teknike - Mungesa e kapitalit personal dhe sigurisë së kredive - Mbishfrytëzimi i burimeve natyrore në disa zona - Infrastruktura e pazhvilluar logjistike (transporti, tregu, uji, energjia) në zonat rurale
Rrethi biznesor	- Aksesi ekzistues në treg për konsumatorët lokalë apo rajonalë, që kanë preferenca për produkte tradicionale dhe të përpunuara në nivel lokal - Rritja e fuqisë blerëse të konsumatorëve - Përvojë e mirë në tejkalimin e deficiteve në infrastrukturë	- Fuqia e ulët blerëse e konsumatorëve - Industria e përpunimit e pazhvilluar - Sektori i NVM-ve shumë informal - Mbështetje e dobët për zbatimin e standarteve të higjenës - Konkurrenca e lartë nga sektori informal - Partneriteti i dobët dhe mungesa e bashkëpunimit - Zinxhirët e ushqimit janë pak të integruar - Vështirësia e aksesit në treg nga zonat e thella rurale - Mungesa e zbatimit te të drejtave pronësore për shkak të dokumentacionit të pakët dhe zhvillimit informal
Kompetencat	- Përvoja në veprimin në ambient të vështirë - Përvoja në përpunimin e produkteve tradicionale - Sipërmarrje e fortë familjare, bërje biznesi me iniciativë personale - Rrjeti i tregut me shumicë po përmirësohet - Përpunimi i qumështit pjesë e shumicës se fermave të vogla - Motivim i fortë për përmirësim te cilësisë se jetës dhe te të ardhurave	- Njohuri të ulëta dhe ybatimi i dobët i standarteve të teknologjivë dhe higjenës - Sektori informal ofron pak përvojë në aftësitë profesionale të menaxhimit - Mungesa e njohurive profesionale të marketingut - Investimet ende të kufizuara, për shkak të strukturës së fragmentuar të prodhimit primar dhe mungesës së një tregu real të tokës - Objektet dhe shërbimet për nevoja pas korrjes ende shumë të papërshtatshme, por po kryhen investimet e para - Kuadri i pamjaftueshëm ligjor për sigurinë e ushqimeve dhe zbatim i pamjaftueshëm i dispozitave ekzistuese ligjore - Pengesë për hyrje në treg relativisht të hapur: ka pak hapësirë për operatorët e vegjël dhe nuk ka burime të mjaftueshme për të ndërtuar tregje të mëdha; prodhuesit e mëdhenj të huaj janë shumë konkurrues në disa zona për të lënë hapësirë për ndërmarrjet lokale që të rriten - Tregu i tokës nuk funksionon, për shkak te të drejtave pronësore ende të pasigurta

Fuqitë	Dobësitë

Diverzifikimi

- Aftësitë specifike dhe aftësitë njohurive dhe menaxhimit: Sukses veçanërisht në sektorin jo-bujqësor që hyn në biznesin rural, kryesisht turizmin rural, me përvojë paraprake në këtë biznes të veçantë
- Diversifikimi i produkteve i suksesshëm, kur i përgjigjet kërkesës aktuale të tregut (d.m.th një nevojë e veçantë nga blerësi tashmë i identifikuar)
- Orientimi në preferencat e tregut të brendshëm për produkte tradicionale dhe të "bëra në ferma
- Rrjeti i komunikimit i përmirësuar në zonat rurale

- Nuk ka investime në mbrojtje të mjedisit, edhe për shkak se kuadri ligjor është i paplotë dhe nuk zbatohet
- Investimet e udhëhequra nga biznesi shpesh janë të planifikuara keq
- Për produktet e vecanta (niche), nevoja për të trajtuar tregjet ndërkombëtare, pasi tregjet vendase janë mjaft të vogla
- Potencial i rëndësishëm për turizëm rural dhe të fermave, por tregu (si kërkesa ashtu dhe oferta) është mjaft i parakohshëm
- Shumica e ekonomive familjare rurale tashmë merren me bujqësi me kohë të pjesshme: nevojitet specializimi
- Specializimi/integrimi kundër diversifikimit të EF rurale zgjedhje e ndërlikuar: politikat adekuate duhet të zhvillohen paralelisht; për momentin, Shqipëria ka akses në IPARD vetëm për konkurrencë (p.sh. specializim)
- Pak ide, për shkak të njohurive të pakta; fermerët janë mjaft konservatorë
- Kuptimi i kufizuar i koncepteve të prodhimit tradicional dhe tipik mes gjithë aktorëve (vendimmarrësve, prodhuesve, konsumatorëve)
- Perceptimi i konsumatorëve që cilësia (e identifikuar me produkte tradicionale) është alternativë për sigurinë e ushqimit (identifikuar me produktet ushqimore "industriale")
- Braktisja i zonave të thella dhe plakje të popullsisë në disa zona me potencial më të lartë për agro-biznes jo-ushqimor

Politikat bujqësore dhe rurale	- Integrimi në BE objektivi kyç dhe afrimi me PPB të BE-së shihet si mundësi e madhe për modernizim të politikës bujqësore - Dokumente strategjike afatmesme të miratuara, ku janë përcaktuar prioritetet për bujqësi dhe zhvillim rural - Harmonizimi i legjislacionit dhe procedurave përparon, pasi AZHBR është e gatshme dhe ka gjasa të akreditohet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016 - Trendi i rritjes së financimit dhe mbështetjes direkte për prodhues ende nuk mbulon pjesën e lartë të mbështetjes së përgjithshme - Pragjet minimale të ulëta dhe kriteret nuk përjashtojnë fermerët e vegjël nga mbështetja - Qasja gjithëpërfshirëse për pagesa direkte, në veçanti për mbështetjen e dhënë për ullinj, bagëti te imta dhe bimë mjekësore dhe aromatike; e fundit ka edhe një efekt të madh në mjedis - Fokusimi në përmirësimin e aftësisë konkurruese të sektorit agro-ushqimor, duke siguruar mbështetje për investime në fermë dhe infrastrukturë të ujitjes, që mund të qasen nga fermerët e vegjël	- Qëllimet e shtetit të vendosura në SNBZHR ende nuk janë vendosur në masat mbështetëse - Niveli i fondeve buxhetore për mbështetjen e zhvillimit strukturor dhe rural në përgjithësi është i ulët - Qëllimet e reja lidhur me kohezionin social për popullsinë rurale, diversitetin dhe mirëmbajtjen e mjedisit nuk janë mirë të zhvilluara - Nuk ka subvencione për inputet por Shqipëria ende ofron mbështetje në bazë të sasisë së prodhimeve të shitura, dhe për pagesa për numër krerësh dhe për siperfaqe; edhe pse të motivuara nga nevoja e shtetit për të zgjeruar prodhimin, për të kompensuar shpenzimet e rritura dhe ofrimin e një nxitjeje për formalizim, këto masa nuk janë në përputhje me PPB - Mbështetja për ZMPF nuk është prioritet në axhendën e politikave mbështetëse; zvogëlimi i AZHZM vendos në rrezik rolin e masave agromjedisore dhe mbështetjen për ZMPF-të; SARED po zëvendëson disa elemente por aksesi territorial është ende e kufizuar - Mes masave për politika zhvillimore rurale, mbështetja investuese për ferma bujqësore dominon, por është e kufizuar në disponibilitetin dhe shtrirjen për të gjithë prodhuesit dhe sektorët; numri mjaft i ulët i përfituesve për disa skema - Mekanizmat e pazhvilluar mirë të menaxhimit të riskut të prodhimit dhe të ardhurave, dhe të sigurimit të prodhimit - Projektet e infrastrukturës dhe ato të lidhura me përmirësimet e përgjithshme të shërbimeve, të formuluara përmes Fondit Rajonal Zhvillimor, kanë mungesë fokusin dhe lidhjen direkte me agjencitë e zhvillimit bujqësor dhe rural; reformat rajonale po hapin diskutimet për vizione më të gjëra për bujqësinë tek njësitë lokale të qeverisjes - Ndryshimet afatshkurtra në strukturën e masave mbështetëse kombëtare (u futën nëntë masa të reja në dy vitet e fundit); promovimi i organizimit të prodhuesve në grupe prodhuesish apo kooperativa u ndal gjatë 2014; diversifikimi i lartë i mbështetjes financiare mund të jetë i lidhur me numrin e madh të sfidave në sektor - Shumica e nën-sektorëve në Shqipëri janë të bazuar në struktura bujqësore shumë të fragmentuara; mbështetjes direkte në të ardhura për fermerët e vegjël i mungon harmonizimi me masat tjera nga ministritë dhe programet tjera që promovojnë aktivitete jo-bujqësore; standartet e marketingut dhe masat e politikave të cilësisë ende nuk janë në përputhje me kërkesat e BE-së

2.6.2 Shqetësimet institucionale lidhur me mbështetjen financiare

Mbështetja e investimeve është penguar nga zhvillimi i dobët i institucioneve financiare rurale dhe sistemi i mbingarkuar i shërbimeve këshillimore. Për fermerët në zonat malore mbështetja e dhënë është e kufizuar, pasi në këto zona reforma e tokës është kryer në bazë të praktikave zakonore, dhe titujt e tokës nuk janë miratuar formalisht.

Administrimi dhe kontrolli i pagesave direkte është një nga kërkesat kryesore. Shqipëria nuk ka regjistër të fermave dhe gjithashtu nuk disponohet një SIPT. Nidhma e huaj e ofruar nga Kooperimi Italian është duke bashkëpunuar në përpjekjete të mëtejshme për të përmirësuar sistemin SIPT. Sistemet e identifikimit të kafshëve janë duke funksionuar, edhe pse disa nevoja specifike i bëjnë masat mbështetëse të tregut dhe çmimit shumë të kufizuara në terren.

Pagesat e shoqëruara për krerë blegtorie dhe për sipërfaqe, si ato të modelit PPB, ende nuk janë të mundshme, duke marrë parasysh mungesën e sistemin SIAK dhe mjeteve tjera administrative si bazë për zbatimin e pagesave të tilla.

Sistemi i monitorimit të skemës kombëtare mbështetëse duhet të hartohet në mënyrë të përfundojë ciklin e politikave bujqësore në mënyrë efektive. Hartimi i politikave të bazuara në dëshmi apo fakte dëmtohet nga statusit i papërcaktuar i departamentit statistikor lidhur me statistikat bujqësore, dhe fillimi i ngadalshëm i projektit FAO për themelimin e Njësisë së Analizës Ekonomike ne MBZhRAU.

Financimi i shërbimeve të përgjithshme për bujqësi (shërbimeve veterinare dhe fito-sanitare, dhe mbështetja e pjesshme për kërkime, ekstension, shërbime të ekspertëve dhe institucioneve bujqësore) përfaqëson pjesën më të vogël të buxhetit total bujqësor.

2.7 Rekomandimet

Analiza në këtë kapitull tregoi disa mangësi të ndryshme strukturore dhe politike aktuale në Shqipëri. Hapja graduale e ekonomisë Shqiptare ndaj BE-së dhe pjesës tjetër të Ballkanit Perëndimor do të jetë një sfidë sa i përket konkurrencës. Për të orientuar politikën bujqësore që të trajtojë këto sfida siç duhet, qeveria Shqiptare duhet të adresojë çështjet në vazhdim:

- Skema kombëtare e mbështetjes duhet ti bëjë masat te jenë më shumë në përputhje me IPARD dhe të ngjashme me portofolin e skemave me ato te PPB-se. Duhet të shmangen masat afatshkurtra mbështetëse. Qëndrueshmëria nga një vit në tjetrin do të inkurajojë aplikimet dhe do të rrisë përvojën e fermerëve me procedurat. Masat e reja duhet të promovojnë zhvillimin rural dhe kohezionin social, të shtojnë përfitimet mjedisore dhe të zbatojnë një kriter që u jep aktorëve prodhues një nxitje për të aplikuar kritere të sigurisë dhe cilësisë. Masat institucionale duhet të aktivizohen me shpejtësi. Kapacitetet administrative dhe instrumentet për qeverisjen e pagesave për numër krerësh dhe për sipërfaqe (SIAK, SIPT, regjistrat, etj.) duhet të zhvillohen në përputhje me rrethanat. Mbështetja e politikave të bazuara në fakte e dëshmi duhet të vendoset për të ndihmuar politikëbërjen.
- Reforma e tokës duhet të miratohet që të ndryshojë zhvillimet negative strukturore që ndodhin në bujqësi, të shkaktuara nga përcaktimi dhe mbrojtja e dobët e të drejtave të pronësisë së tokës, dhe tregu jofunksional i tokës.
- Kërkimet në bujqësi duhet të riorientohen drejt një axhende për zgjidhjen e problemeve konkrete në bujqësi. Mbështetje e mëtejshme financiare është e nevojshme në këtë drejtim. Edhe pse përqindja e shpenzimeve për kërkim dedikuar për bujqësinë në Shqipëri nuk është e njohur, fondi vjetor për Qendra të Transferimit të Teknologjisë Bujqësore (QTTB) nuk ka tejkaluar 2.3 milionë euro (përfshirë pagat, shpenzimet operative dhe investimet) në vitet e fundit. Për më tepër, përqindja e financimit të shërbimeve të zgjeruara në shpenzimet e përgjithshme të MBZHRAU është pakësuar përgjatë viteve, e shoqëruar me reduktim të burimeve njerëzore. Puna e QTTB ka nevojë për rishikim, dhe financimi kërkon një qasje novatore për të rritur bashkëpunimin mes institucioneve publike dhe private, shërbimeve dhe organizatave të përfshira në kërkimin shkencor bujqësor dhe transferimin e teknologjive.
- Shërbimi i këshillimeve ka nevojë për një rol të ri në strategjinë dhe sfidat e ardhshme të zhvillimit rural në Shqipëri. Ndryshimet e politikave të nënkuptuara nga SNBZHR 2014-2020 kërkojnë paraqitje të ndryshimeve në fusha të ndryshme të tilla si prioritetet e politikave, kuadrit institucional, aftësitë teknike dhe alokime të tjera (njerëzore dhe financiare) të burimeve për shërbimin këshillimor. Në mungesë të qasjes gjithëpërfshirëse lidhur me rolin dhe objektivat e shërbimeve këshillimore bujqësore, ekziston rreziku që të dështojë balancimi me saktësi nga shërbimet këshillimore mes qëllimeve të ndryshme të politikave (p.sh. mirëmbajtja ose rritja e produktivitetit, së bashku me shërbimet e ekosistemit) dhe horizonteve kohore (objektivat afatshkurtra lidhur me të ardhurat dhe objektivat afatgjata lidhur me qëndrueshmërinë) . Partneritetet publik-privat janë të nevojshme në disa fusha të shërbimeve këshillimore për të përmirësuar efektivitetin e tyre.

- Qeveria duhet të trajtojë çështjet kritike për përmirësimin e infrastrukturës në zona të largëta rurale. Duhet të miratohen programe të pranueshme në bazë të SNBZHR, siç janë investimet në rrugët e komunitetit, akses në rrugë me rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik lokal, akses në fermë dhe toka pyjore, furnizim me energji, menaxhim të mbeturinave dhe të ujit, dhe akses lokal në teknologji informative dhe komunikim. Kërkohet bashkëpunimi i mëtejshëm me Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, dhe Ministrinë e Brendshme për të koordinuar dhe siguruar mbështetje për investime për zhvillimin e rrugëve rurale.
- Nevojiten ndërhyrje të mëtejshme për të imponuar sigurinë e ushqimit duke forcuar zbatimin e ligjit dhe duke rritur ndërgjegjësimin e konsumatorit. MBZHRAU duhet të trajtojë zbatimin e ligjit përmes bashkëpunimit dhe komunikimit midis autoriteteve kompetente në sistemin e sigurisë së ushqimit në nivel qendror, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe zyrave përgjegjëse për zbatimin e ligjit në terren. Duhet të merren hapa në mënyrë që e gjithë mbështetja e dhënë të jetë në përputhje me standartet relevante kombëtare minimale në fuqi në fushën e mbrojtjes së mjedisit, shëndetit publik, shëndetit të kafshëve dhe bimëve, mirëqenien e kafshëve dhe sigurisë në punë. Shqipëria duhet të vlerësojë me kujdes se cilat "nivele standarte minimale" janë më të mira për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe të lidhë sistemin e saj mbështetës në bazë të këtyre kërkesave. Për shembull, për prodhuesit e vegjël bujqësorë (p.sh. shitje të drejtpërdrejta), mund të zbatohen kushte të ndryshme minimale të higjenës së ushqimit dhe të sigurisë së ushqimit, në përputhje me kërkesat e BE-së.

Përpjekjet e politikave duhet gjithashtu të trajtojnë këto çështje duke krijuar një mjedis të përgjithshëm të favorshëm ekonomik, duke forcuar institucionet e tregut, duke mundësuar akses më të mirë në fonde publike dhe private, duke zhvilluar zinxhirët e integruar të vlerave, duke rritur investimet e mëdha nëpërmjet partneritetit publik dhe privat, duke u fokusuar në ruajtjen e natyrës dhe masat për mbrojtjen e mjedisit, si dhe duke mbështetur një jetesë të qëndrueshme rurale e duke ruajtur fokus të veçantë për gratë dhe të rinjtë.

3. Bosnja dhe Hercegovina: Përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore

Sabahudin Bajramović[1], Dragana Ognjenović[1], Jakub Butković[2]

[1] Fakulteti i Bujqësisë dhe Shkencave Ushqimore, Universiteti i Sarajevës

[2] Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike, Zyra për Harmonizimin dhe Koordinimin e Sistemit të Pagesave në Bujqësi dhe Zhvillimin Ushqimor dhe Rural e Bosnje dhe Hercegovinës

3.1 Zhvillimi ekonomik

Sistemi kompleks politik dhe ekonomik dhe struktura e shtetit, e krijuar nga Marrëveshja e Përgjithshme e Paqes e vitit 1995, kufizon në mënyrë të konsiderueshme zhvillimin ekonomik dhe transformimin e Bosnje dhe Hercegovinës në shtet modern dhe funksional Evropian (Sadiković 2015, Pejanović 2013, Terry 2013). Treguesit makroekonomikë tregojnë se kriza socio-politike dhe ekonomike është thelluar në periudhën e fundit, krahasuar me vitin 2008, jo vetëm për shkak të ndikimit të zhvillimeve negative rajonale dhe globale, por edhe për shkak të mungesës së vullnetit politik për të vazhduar me reformat e nevojshme strukturore. Në vitin 2014, si në vitet e mëparshme, Bosnja dhe Hercegovina vazhduan të tregojnë progresin më të ulët mes shteteve në rajon në proceset integruese Evropiane, sidomos lidhur me miratimin e legjislacionit. Mungesa e një mekanizmi efikas koordinimi për çështje të integrimit në BE vazhdon të ketë ndikim negativ në raportet mes BA dhe BE-së, përfshirë përcaktimin e mbështetjes financiare nga ana e BE-së.

Tabela 3.1. Bosnja dhe Hercegovina: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014

	2005	2014
PBB (milionë EUR)	8,655	13,827
Popullsia (milionë)	3.8	3.8
Sipërfaqja e tokës (km^2)	51,197	51,197
Dendësia e popullsisë (banorë/km^2)	75.1	74.7
PBB/për frymë, PFB (EUR)	2,252	3,606
Tregtia e jashtme si % e PBB-së	88.4	92.0

Burimi: Baza e Të dhënave Statistikore Bujqësore – Bosnja dhe Hercegovina, 2015.
PFB, pariteti i fuqisë blerëse.

Pavarësisht mungesës së progresit në procesin e pranimit në BE dhe stanjacionit makroekonomik në vitet e fundit, BA ka bërë përparim të rëndësishëm në krahasim me vitin 2005. PBB u rrit me rreth 60% midis viteve 2005 dhe 2014 (Tabela 3.1). Rritje e ndjeshme u regjistrua edhe në PBB për fryme, duke arritur vlerën prej 3606 euro në vitin 2014, por kjo është ende shumë më e ulët me nivelin të BE-së dhe më e ulët se shumica e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor.

Rimëkëmbja dhe forcimi i ekonomisë në vendet e BE-së u shoqërua me intensifikimin e IHD-ve. Pavarësisht situatës së vështirë ekonomike dhe pasigurisë politike në BA, të shkaktuar nga zgjedhjet dhe krijimi i një qeverie të re në vitin 2014, ka pasur një rritje të konsiderueshme në IHD, duke arritur në 422 milionë euro (shumica në sektorin e minierave dhe të energjisë).

Kriza ekonomike globale ka pasur një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të BA nga viti 2009 e në vazhdim. Vetëm në vitin 2013 rritja reale e PBB-së arriti vlerë pozitive, duke arritur në 1.6%. Rritja e ngadaltë në BE, ulja e çmimeve të mallrave në botë, deflacioni, përmbytjet dhe situata e pafavorshme hidrologjike në hidrocentrale ishin ndër faktorët më të rëndësishëm që kanë ndikuar negativisht në rritjen ekonomike në Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 2014. Pavarësisht të gjitha këtyre efekteve, BA arriti një rritje shumë modeste, megjithatë pozitive të PBB-së në vitin 2014, duke arritur në 0.6%.

Figura 3.1. Bosnja dhe Hercegovina: treguesit kryesor makroekonomik (% rritjes nga viti kaluar; % e papunësisë), 2005–2014



Burimi: Baza e Të dhënave Statistikore Bujqësore – Bosnja dhe Hercegovina, 2015.

BA karakterizohet nga stabiliteti i monedhës kombëtare (marka e konvertueshme). Në 2013 dhe 2014 është regjistruar deflacion (respektivisht, -0.1% dhe -0.9%), i nxitur kryesisht nga faktorë të jashtëm siç janë çmimet ndërkombëtare në rënie të naftës dhe ushqimit. Shkalla e lartë e papunësisë, më e larta në mesin e shteteve të BP, është ende problemi më i madh ekonomik në Bosnje dhe Hercegovinë (Drejtoria për Planifikim Ekonomik 2015). Shkalla e papunësisë u reduktua vetëm pak gjatë dekadës së fundit (nga 31.1% në 2005 në 27.5% në vitin 2014).

3.2 Zhvillimi bujqësor

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm në ekonominë e BA-së. Ajo përbën pjesë të madhe të VSHB-së totale, të punësimit dhe tregtisë (Tabela 3.2). Edhe pse aktiviteti ekonomik u ul gjatë periudhës së studimit, 2005-2014, si rezultat i faktorëve të shumtë socio-politik dhe ekonomik, kontributi i bujqësisë në krijimin e VSHB është ende relativisht e lartë (7.6%), edhe pse më e ulët se në vitin 2005 (10.6%). Sektori është veçanërisht i rëndësishëm për kontributin në punësim. Sektori i bujqësisë përfaqësonte 17.1% të punësimit total në vitin 2014, i ulur nga 20.6% në vitin 2005 (Tabela 3.2).

Tabela 3.2. Bosnja dhe Hercegovina: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014

	2005	2014
% e VSHB	10.6	7.6
% e punësimit	20.6	17.1

Eksportet e produkteve agroushqimore (% e eksporteve totale)	6.1	7.6
Importet e produkteve agroushqimore (% e importeve totale)	17.6	16.8

Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Bosnja dhe Hercegovina, 2015.

Zhvillimi i tregtisë agroushqimore tregon një model ndryshe zhvillimor. Përqindja e këtij sektori në eksportet totale u rrit nga 6.1% në 2005 në 7.6% në vitin 2014, kurse përqindja në importe totale zbriti nga 17.6% në 16.8% për të njëjtën periudhë (Tabela 3.2).

Bosnja dhe Hercegovina karakterizohet nga kushte relativisht të favorshme klimatike për prodhimin bujqësor, ndërkohë që sipërfaqja e tokës është relativisht e ulët në raport me popullsinë, në 0.56 hektarë për krymë për sipërfaqen totale bujqësore dhe 0.26 hektarë për frymë për tokë të punueshme. Nga gjithsej 2.16 milionë hektarë tokë bujqësore, 46.7% është tokë e punuar në mënyrë intensive. Statistikat tregojnë se më shumë se gjysma e tokës së punueshme, që është e cilësisë më të lartë (50.2% në vitin 2014), nuk shfrytëzohet. Prodhimi i drithërave dominon prodhimin e përgjithshëm bujqësor, duke përfaqësuar 63.2% të prodhimit të përgjithshëm bujqësor në vitin 2010 (Tabela 3.3).

Tabela 3.3. Bosnja dhe Hercegovina: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2014

	2005	2014
SB (000ha)	2,164	2,163
% e tokës së punueshme në SB	47.5	46.7
% e kulturave në prodhimin total bujqësor	63.9	63.2[a]
Rendimenti mesatar i grurit (t/ha)	3.1	2.9
Rendimenti mesatar i qumështit (t/lopë mjelëse)	2,174	2,781
Faktori i të ardhurave për njësi vjetore të punës (EUR)	:	:
Raporti i eksportit-importit për produktet agroushqimore (%)	11.7	24.2

Burimi: Baza e Të dhënave Statistikore Bujqësore – Bosnja dhe Hercegovina, 2015.
a 2010 (të dhënat e fundit zyrtare).
:, nuk ka të dhëna në dispozicion; SB, sipërfaqe bujqësore.

Një nga problemet më të mëdha të prodhimit bujqësor në BA është produktiviteti i ulët, i shprehur në kuptimin e prodhimit të fituar për hektar (rendimenti). Prodhimi joefikas dhe i kufizuar, sipërfaqe e tokës e copëzuar, pajisje të dobëta bujqësore dhe njohuritë e pamjaftueshme teknike dhe teknologjike në mesin e fermerëve, janë disa nga faktorët që vendosin BA në fund të renditjes Evropiane kur bëhet fjalë për rendimente të arritura të produkteve bujqësore.

Nuk janë vërejtur ndryshime të rëndësishme në prodhimin dhe rendimentin për shumicën e kulturave dhe perimeve në BA në 10 vitet e fundit (p.sh. rendimentii grurit 3.1 t/ha në vitin 2005 kundrejt 2.9 t/ha në vitin 2014). Ndryshimet e rendimentit nga viti në vit janë rezultat i kushteve klimatike dhe të motit në një vit të caktuar, e jo rritja e produktivitetit. Përjashtimet përfshijnë kultura të zgjedhura, të tilla si grupi i frutave të manit, që kanë rritje të mëdha në rendimente dhe prodhim në vitet e fundit. Me përjashtim të shpendëve, dhe në një mase edhe qumështit, prodhimi blegtoral në BA ka qëndruar e pandryshuar në periudhën e fundit, dhe nuk tregon shenja të rëndësishme të rritjes. Prodhimi bujqësor është ndikuar më tej nga përmbytjet e rënda në maj të vitit 2014, që çoi në një rënie të ndjeshme të prodhimit për sektorët e bujqësisë dhe blegtorisë.

BA ka një bilanc të pafavorshëm tregtar të mallrave bujqësore dhe ushqimore. Eksportet totale nga sektori bujqësor në vitin 2014 ishin 338,4 milion euro, apo 7.6% të totalit të eksporteve të BA-së. Importet bujqësore ishin dukshëm më të larta, me rreh 1,395 miliard euro në vitin 2014, ose 16.8% e totalit të importeve të BA-së. Figura 3.2 tregon se eksportet nga sektori agroushqimor u rritën vazhdimisht gjatë gjithë periudhës në fjalë, dhe në vitin 2014 ato ishin 2.9 herë më të larta se në vitin 2005. Mbulimi i importeve nga eksportet e mallrave agroushqimore shënuan rritje të ndjeshme në periudhën e marrë në studim: ato u rritën nga 11.7% në vitin 2005 me më shumë se dy herë vitin 2014, kur arritën në 24.2%.

Mallrat kryesore agroushqimore të eksportuara përfshijnë produktet e bulmetit (grupi tarifor 04), nënprodukte të drithërave (19), frutat e freskëta dhe arroret (08) dhe nënprodukte të mishit (16)[14]. Mallrat më të rëndësishme agroushqimore të importuara përfshijnë pijet (grupi tarifor 22), drithërat (10), përgatitje të ndryshme ushqimore (21), sheqerna (17) dhe mbetje dhe mbeturina nga industritë ushqimore (23).

Figura 3.2. Bosnja dhe Hercegovina: tregtia agroushqimore (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Bosnja dhe Hercegovina, 2015.

Shumica e produkteve agroushqimore të importuara kanë origjinë nga BE (65.0% në vitin 2014), të ndjekura nga vendet e BP (29.6% në vitin 2014), dhe pjesa tjetër e botës përfaqëson vetëm 5.4%. Partnerët e jashtëm më të rëndësishëm të BA-së për ushqim në mesin e vendeve të BE-së janë Kroacia, Sllovenia, Hungaria, Gjermania, Italia dhe Austria. Nga Ballkani Perëndimor, Serbia dhe IRJ e Maqedonisë janë partnerët më të rëndësishëm tregtarë, dhe Turqia në mesin e vendeve të tjera evropiane. Në lidhje me eksportet agroushqimore, tregu më i rëndësishëm në vitin 2014 ishin vendet e BP (41.0%) – ndër të cilat Serbia dhe IRJ e Maqedonisë janë mbizotëruese - të ndjekura nga BE-ja (37.8%) dhe pjesa tjetër e botës (21.2%).

Tabela 3.4 paraqet karakteristikat kryesore të zhvillimit të tregjeve kryesore bujqësore në Bosnja dhe Hercegovinë në vitet 2005-2014.

Tabela 3.4. Bosnja dhe Hercegovina: zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore mes viteve 2005 dhe 2014

[14] Grupet tarifore 17(sheqerna etj.) dhe 15(vajra dhe yndyrna shtazore apo bimore) u injoruan, pasi këto prodhime rieksportohen, nuk prodhohen (panxhar sheqeri) ose prodhohen në sasi modeste (farëra vajore) në BA.

Kategoria	Në traditë, shteti është	Nga 2005, prodhimi ka	Ndryshimet e rëndësishme
Drithëra	Importues neto	Rënë	BA është një importues neto i theksuar i drithërave, sidomos të grurit. Prodhimi mesatar i grurit është 225.000t. Prodhimi vendas plotëson rreth 30% të nevojave të brendshme. Prodhimi total i drithërave ka ndjekur pirje rënieje në vitet e fundit dhe kjo është shumë e varur nga kushtet klimatike dhe atmosferike. Rënie e rëndësishme në prodhim u evidentua në vitet 2007 dhe 2012. Sa i përket vlerës së drithërave të importuara, është regjistruar rritje modeste e paqëndrueshme, ndërsa vëllimi i importit ka qenë në rënie modeste
Sheqer	Importues neto	Nuk ka prodhim të rëndësishëm	Nuk ka prodhim të panxharit të sheqerit në BA, kështu që shteti është importues neto i sheqerit. Importi mesatar shkon në EUR 85.6 milion dhe 198,000t. Vlera më e lartë e importeve u regjistrua në 2011 (EUR 133.8 milion) dhe është në rënie nga ajo kohë. Por, BA është eksportues i rëndësishëm i sheqerit (mesatarisht eksportohet EUR 27.7 milion). Kjo i referohet rieksportit, që dëshmohet nga të dhënat ku ndryshimet në importin e sheqerit ishin thuajse njëllojë të reflektuara në ndryshimet në eksportin e sheqerit gjatë periudhës 2005–2014.
Farëra vajore, vajra dhe yndyra	Importues neto	Nuk ka prodhim të rëndësishëm	BA realizon prodhim shumë modest të farërave vajore, mesatarisht 11,000t, kryesisht nga soja. Pavarësisht mbështetjes ekzistuese buxhetore, prodhimi i farërave vajore ka një pirje rënëse. Në vitin 2006, prodhimi ishte 16,700t, në 2011 - 8,300t, dhe në vitin 2012 vetëm 7,300t. Importet mesatare të vajrave dhe yndyrave në periudhën e vëzhguar ishin 65,500t. Importi ishte veçanërisht i lartë në periudhën 2012-2014 (në vitin 2014, 90,000t dhe 77 milion EUR). Me gjithë prodhimin e ulët të brendshëm, BA eksporton sasi të mëdha të vajrave dhe yndyrave (mesatarisht 28 milionë EUR). Në vitet e fundit, u regjistrua një rritje e ndjeshme e eksporteve, kështu që në 2014 arritën në 47.7 milionë euro. Ashtu si në rastin e sheqerit, eksporti i vajit dhe yndyrës është, në fakt, rieksport; gjatë gjithë periudhës 2005-2014, ndryshimet në importet e vajit dhe yndyrës janë reflektuar pothuajse në mënyrë të barabartë në ndryshimet në eksporte.
Fruta dhe perime	Importues neto	Nuk ka tendencë të rëndësishme	Gjatë periudhës së vëzhguar, prodhimi i frutave në BA pati rritje modeste, ndërsa prodhimi i perimeve nuk tregoi pirje të dukshme. Rendimentet në fruta dhe perime ndryshonin dukshëm, si pasqyrim i kushteve klimatike (prodhimi më i ulët në vitet 2012 dhe 2014, më i lartë në 2013). BA është ende një importues neto i frutave dhe perimeve, por shihen tendenca pozitive në prodhim të tyre. Ndryshe nga perimet, ku rritja thuajse identike u regjistrua për import dhe eksport, rënia në deficitin tregtar të frutave është evidente. Në rast se përjashtohen importi i bananes dhe agrumeve, të cilat BA nuk ka kushte për prodhim, dhe që mesatarisht përbëjnë 55% të totalit të importit të frutave, mund të thuhet se gjatë periudhës 2010-2014 (me përjashtim të 2012), BA ishte një eksportues neto i frutave.
Verë	Importues neto	Nuk ka tendencë të rëndësishme	Megjithëse nuk ka statistika zyrtare të prodhimit të verës në BA, ekspertët vlerësojnë që kjo ndodh në afër 3,200ha të vreshtave, me prodhim mesatar total prej 22 milionë kg të rrushit dhe 15 milion litra të verës. Nuk ka trend në prodhim të verës, pasi që ndryshon me rendimente të paqëndrueshme që varen shumë nga kushtet klimaterike. Ky ishte rasti ne vitin 2011, kur u shënua një rënie e madhe në prodhim. Varietetet autoktone Zilavka (60 %), Blatina (25 %) dhe Vranac (15 %) dominojnë strukturën e prodhimit të verës. BA është importues neto i verës, zakonisht nga shtetet në rajon (Kroacia, IJR Maqedonia, Serbia dhe Sllovenia).BA importon, mesatarisht 14 milionë EUR (8.85 milionë litra) të verës, derisa eksportet janë shumë më të ulëta, rreth 2.8 milionë EUR. Deficiti tregtar mesatar i BA-së për verë është 11 milionë EUR.

Patate	I vetë-mjaftueshëm	Rënë	Patatet janë një nga pak mallrat që BA ka prodhim të mjaftueshëm. Por, prodhimi total i patates ka rënie, nga 458,600t në vitin 2005 ka rënë me 35%, në vetëm 300,000t në vitin 2014. Prodhimi është shumë i varur nga kushtet klimatike, pasi prodhimi përdor nivel të ulët të masave agroteknike, pa sistem të ujitjes dhe përdor varietete tradicionale. Importet janë zakonisht të materialit për mbjellje, dhe tregojnë një tendencë në rritje (niveli më i lartë i importit ishte në vitin 2013, 7.5 milionë EUR, 23,500t).

Kategoria	**Në traditë, shteti është**	**Nga 2005, prodhimi ka**	**Ndryshimet e rëndësishme**
Duhan	Importues neto	Rënë	BA është importues neto i duhanit. Mesatarisht BA importon 2,200t në vit, që arrin në 6.1 milion euro. Prodhimi i përgjithshëm ka patur trend të vazhdueshëm rënës, kështu që ai është ulur 2.6 herë nga 4,400t në vitin 2005, në vetëm 1,700t, që ishte prodhimi mesatar për 2010-2014. Përveç kësaj, është regjistruar një rënie e konsiderueshme në import të duhanit, dhe në 2012 dhe 2013 BA kishte teprica të tregtisë së jashtme për duhan. Trendi i përgjithshëm i nevojës së tkurrur për duhan shpjegohet nga kërkesa e ulët e tregut për shkak të rritjes së vazhdueshme të çmimeve, si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të harmonizuar politikën e BA-së të taksës së akcizës për duhan me politikën e BE-së për akciza. Nga ana tjetër, nuk mund të injorohet rritja e konsumit të duhanit të papërpunuar, të blerë kryesisht në tregun e zi pa regjistrim statistikor.
Mish lope dhe viçi	Importues neto	Rënë	BA është importues neto i theksuar i mishit të viçit dhe lopës, pavarësisht kushteve të favorshme natyrore për rritjen e gjedh. Prodhimi është në rënie; dhe u përgjysmua nga 23,600t në vitin 2005, në 11,400t në vitin 2014. Mishi shitet kryesisht i freskët në tregun e brendshëm, që lë përpunuesit e mishit pothuajse tërësisht të varur nga importi. Importi i mishit të lopës dhe viçit u rrit shumë, nga 10,200t në vitin 2006, në 32,500t në vitin 2014. Prodhimi vendor ende nuk mund të konkurrojë me çmimet e mishit të importuar, që zakonisht janë 2.5-3.0 EUR/kg.
Mish derri	Importues neto	Është rritur	Prodhimi i derrave në BA kishte trend të theksuar në rritje deri në vitin 2011, dhe nga ajo kohë është në rënie të konsiderueshme. Nga ana tjetër, importi i derrit është në rritje konstante. Importi më i madh u shënua në vitin 2014 (12,600t apo 29.5 milionë EUR). Rritja e importit lidhet me zhvillimin e përpunimit të mishit, përkundër tendencës së rritjes në çmime.
Mish dele dhe dhie	Importues neto	Nuk ka tendencë të rëndësishme	Përkundër kushteve natyrore mjaft të favorshme për prodhim të mishit të deleve dhe dhive, ky prodhim është ende i pamjaftueshëm, dhe BA është importues neto i madh. Prodhimi vendor nuk ka trend të saktë, me një nivel prodhimi të regjistruar prej 1,800t (në thertore). BA importon mesatarisht 1,100t, me trend të theksuar në rritje.
Mish shpendi	Importues neto	Është rritur	Prodhimi i mishit të shpendëve u rrit vazhdimisht deri në vitin 2012, por në vitet 2013 dhe 2014 u regjistruan ulje të vogla. Kjo është një nga kategoritë e pakta të prodhimi të mishit kafshëve ku BA pothuajse ka arritur vetë-mjaftueshmërinë. Rritja e shpejtë shpjegohet me rënie të fuqisë blerëse të konsumatorëve dhe animin e tyre ndaj mishit më të lirë. Kjo mund të shpjegohet edhe me zhvillimin e industrisë së përpunimit të mishit dhe shtrirjes së saj në tregjet ndërkombëtare, fillimisht në tregun rajonal, përfshirë Kroacinë. Importet janë ende dukshëm më të larta se eksportet, dhe tregojnë luhatje të shënuara nga viti në vit. Importet mesatare vjetore arrijnë në 13.3 milionë euro, dhe eksportet në 4.8 milionë euro. Eksportet, ndryshe nga importet, kanë treguar rritje të vazhdueshme deri në vitin 2012, dhe një rënie e lehtë u regjistrua në vitet 2013 dhe 2014. Në mënyrë të ngjashme si me qumështin dhe produktet e tij, kjo ishte për shkak të eksportit të ulët në Kroaci, pas anëtarësimit të saj në BE.

Qumësht dhe prodhime bulmeti	I vetë-mjaftueshëm	Nuk ka tendencë të rëndësishme	BA pothuajse arriti vetë-mjaftueshmërinë për qumësht të freskët dhe prodhime të tij, por është ende importues neto i theksuar për gjalpë, djathë dhe djathëra të përpunuara. Prodhimi total i qumështit kishte trend të theksuar në rritje deri më 2008, kur arriti prodhimin më të lartë (759 milionë kg), dhe pastaj ndodhi një rënie e theksuar në prodhim deri në vitin 2012, kur u shënua prodhimi minimal (672 milionë kg). Kjo rënie është rezultat i trendit në rënie të numrit të lopëve mjelëse, përkundër rritjes së rendimentit mesatar qumësht/lopë. Eksporti i BA-së i qumështit dhe prodhimeve të tij ishte në rritje deri në 2012 (47.8 milionë EUR në 2012), dhe pastaj pësoi rënie pasi humbi tregun e Kroacisë për shkak të hyrjes së saj në BE. Importet e prodhimeve të qumështit kishin trend të ngjashëm në rritje deri më 2012, kur u shënua importi maksimal (87 milionë EUR). Ka një dallim interesant dhe të rëndësishëm mes sasisë dhe vlerës tregtare të këtyre prodhimeve. Gjatë periudhës së marrë në studim, importi i këtyre prodhimeve ishte më i lartë në vlerë sesa eksporti, por sa i përket vëllimit, ky dallim pothuajse u zhduk në vitin 2009, dhe nga viti 2012 eksportet tejkalojnë importet. Kjo tregon që industria e prodhimit të qumështit dhe nënprodukteve të tij në BA karakterizohet nga struktura e pafavorshme e përpunimit të qumështit me përqindje të ulët të prodhimeve që kanë qëndrueshmëri të gjatë (djathë, gjalpë, pluhur qumështi) apo vlerë të shtuar.

3.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

Politika bujqësore bëhet në disa nivele të administratës qeveritare në BA për shkak të sistemit kompleks politik të zbatuar në vend. Çdo entitet i veçantë rajonal i BA-së ka juridiksion mbi politikat bujqësore në territorin e tij. Pra, ka dy ministri të veçanta të bujqësisë, menaxhim të ujit dhe pyjeve në Federatën e Bosnje dhe Hercegovinës (FBH) dhe Republikën Serbe të Bosnjës (RSr) dhe, së bashku me Divizionin për Bujqësi në kuadër të Qeverisë së Qarkut Bërçko, janë institucionet më të rëndësishme me detyrë për miratim dhe zbatim të politikave bujqësore në BA. Për FBH, administrimi i politikave bujqësore ndahet më tej në nivel kantonal (në 10 ministri kantonale), si rezultat i së cilës masat e politikave mund të ndryshojnë mes kantoneve. Në të dy njësitë rajonale në BA (d.m.th në FBH dhe RSr) mbështetja bujqësore është e ndarë edhe në nivel komunal, por transfertat në këto nivele janë zakonisht të ulëta krahasuar me nivelin e përgjithshëm të mbështetjes kombëtare (Bajramoviç et al. 2014).

Niveli më i lartë, ai shtetëror, i qeverisë së Bosnje dhe Hercegovinës ka autoritet të kufizuar në fushën e politikave bujqësore. Shteti ka juridiksion vetëm mbi politikat e tregtisë së jashtme (përfshirë edhe tregtinë bujqësore). Niveli shtetëror i qeverisë nuk ka juridiksion mbi fusha tjera të politikës bujqësore (p.sh. pagesat direkte apo zhvillimi rural). Prandaj, nuk ka dokumente strategjike dhe programore që lidhen drejtpërdrejt me programimin/hartimin e politikave bujqësore në nivel shtetëror.

Në **FBH**, dokumenti kryesor strategjik i përdorur për krijim të politikave bujqësore në periudhën e analizuar ishte strategjia afatmesme për zhvillim të sektorit bujqësor në FBH (2006-2010). Orientimi kryesor strategjik në këtë dokument ishte zhvillimi dhe transformimi strukturor i bujqësisë. Në mes të vitit 2015, parlamenti i FBH miratoi strategjinë e zhvillimit afatmesëm për sektorin e bujqësisë në FBH për periudhën 2015-2019, që krijoi një qasje të re për politikat zhvillimore bujqësore dhe rurale të FBH-së. Objektivat strategjike të strategjisë janë: (1) zhvillimi i sektorëve të bujqësisë dhe i sektorëve të lidhur me të, së bashku me rritjen e nivelit teknik dhe teknologjik, përdorimin më efikas të burimeve në dispozicion dhe orientimin drejt përmbushjes së kërkesave të tregut modern; (2) sigurimi i kushteve për një gjenerim më të mirë të të ardhurave të qëndrueshme për sektorin e bujqësisë, dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për popullsinë rurale; (3) menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe përshtatja e bujqësisë me ndryshimet klimatike; (4) Përshtatja e kuadrit institucional dhe ligjor dhe i politikave bujqësore me PPB, duke marrë parasysh nivelin e zhvillimit të sektorit në

FBH. Fondet e nevojshme për zbatimin e strategjisë janë vlerësuar rreth 373,8 milionë euro, që ndikon në orientimin e zhvillimit të sektorit. Fondet janë planifikuar të mblidhen nga buxhetet federale dhe kantonale, fondet IPARD, dhe nga kreditë nga Banka Botërore (BB) dhe Banka Evropiane e Investimeve (BEI).

Globalizimi dhe liberalizimi i tregtisë bujqësore, ndryshimet klimatike dhe proceset integruese, veçanërisht ato në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) dhe BE, janë identifikuar si sfida të mëdha të jashtme me të cilat përballet sektori. Sfidat e brendshme, të identifikuara në këtë dokument, janë nën-shfrytëzimi i burimeve në dispozicion (i tokës dhe kapitalit), shkalla e vogël e prodhimit, produktiviteti i dobët dhe transferimi i teknologjisë, qasje e pamjaftueshme në treg për produktet bujqësore dhe ushqimore, konkurrenca e ulët e sektorit, çështjet e mjedisit, zhvillimi rural, dhe korniza jo e plotë institucionale dhe rregullatore.

Politika e ardhme bujqësore në FBH do të vazhdon të bazohet në tri shtylla të mbështetura në masat e politikës së tregut të çmimeve, pagesat direkte (Shtylla I), masat strukturore dhe të zhvillimit rural (Shtylla II) dhe masat që lidhen me shërbimet e përgjithshme për bujqësi (Shtylla III). Përkufizimi dhe përpunimi i masave/shtyllave është bërë mbi parimin e planifikimit buxhetor shumëvjeçar, që u fut në praktikat e FBH për herë të parë. Harmonizimi i politikave bujqësore me PPB është një nga drejtimet kryesore të strategjisë së re.

Në periudhën 2015–2020 u hartua gjithashtu programi i zhvillimit rural të FBH për . Ky dokument është në proces të miratimit dhe duhet që së shpejti të bëhet zyrtar për këtë pjesë të politikave bujqësore të FBH-së. Synimet janë të ndara në grupe sipas masave, dhe në përmbajtje janë shumë afër me boshtin e zhvillimit rural të BE-së 2007–2013. Buxheti për zbatim të programit vlerësohet në 150 milionë EUR për periudhën shtatë vjeçare për të cilën u përgatit programi. Buxhetet e FBH dhe të kantoneve, fondet IPARD dhe kreditë nga BP dhe BEI u planifikuan si burime të fondeve për zbatim të programit.

Dokumentet kryesore strategjike të përdorura për krijimin e politikave bujqësore gjatë 2005–2014 në **RSr** ishin "Strategjia për Zhvillim të Bujqësisë në Republika Serbe të Bosnjës deri më 2015" dhe "Plani Strategjik për Zhvillim Rural në Republikën Serbe të Bosnjës për periudhën 2009–2015". Këto dokumente vendosin synimet strategjike që duhet të çojnë drejt prodhimit të rritur me përdorim më të mirë të burimeve, prodhimtari të rritur dhe ristrukturimin e bujqësisë. Në vitin 2014 u miratua dokumenti i ri strategjik: "Plani Strategjik për Zhvillim të Bujqësisë dhe Zonave Rurale në Republikën Serbe të Bosnjës 2015–2020". Ai ka synime të ngjashme me ato të periudhës paraprake, ku rëndësi më e madhe u dha për zhvillimin rural. Ky dokument strategjik, si ai në FBH, thekson nevojën për konvergjencë dhe harmonizim gradual të politikave bujqësore me PPB, futje graduale të masave që zbatohen në shtetet e BE-së, pa masa të reja divergjente. Strategjia parasheh edhe përmirësimin e sistemit të legjislacionit, dhe të institucioneve të duhura që të kryejnë me sukses procesin e integrimeve Evropiane në sektorin e bujqësisë. Definicioni dhe përshkrimi i masave u bë përmes parimeve të planifikimit buxhetor shumë-vjeçar (si në FBH), duke ndjekur parimet e stabilitetit, konsistencës, transparencës dhe mundësie të gjurmimit. Buxheti i vlerësuar i duhur për zbatim të strategjisë shkon në 920 milionë euro për tërë periudhën 2015–2020, dhe 153 milionë euro në vit, që tregon orientimin zhvillimor të politikave bujqësore të RS.

Dokumentet e reja strategjike për sektorin bujqësor në të dy entitetet e BA-së, me synime dhe masa të përcaktuara dhe me mekanizma të veprimit, bënë një hap të rëndësishëm para, dhe ato thuajse mund të shpjegohen si ndryshim strategjik. Dokumentet u kryen me një qasje bashkëkohore, me peshim të tërësishëm te të gjitha elementeve të ciklit të politikave: planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin. Janë veçanërisht inkurajuese në këtë kuadër qasja e theksuar e konvergjencës dhe harmonizimit të politikave bujqësore të secilit entitet me PPB, dhe përkushtimi i qartë për reformë të politikës, për krijim dhe fuqizim të kornizës legjislative dhe institucionale për të modernizuar administrimin e bujqësisë,.

Në **Qarkun Bërçko** (QB) nuk kishte dokument strategjik që në mënyrë ekskluzive synon zhvillimin bujqësor dhe rural[15] gjatë periudhës së analizuar, por çështjet e lidhura me sektorin u trajtuan në dokumentin kryesor strategjik (Strategjia Zhvillimore e QB).

Transfertat buxhetore, masat e politikave bujqësore, politika e zhvillimit rural dhe kriteret për mbështetjen e prodhuesve janë nën kompetencën e mirëfilltë të ministrive të bujqësive të entitetit/kantonit, p.sh. Divizioni për Bujqësi në kuadër të Qeverisë së Qarkut Bërçko. Në fakt, mund të thuhet se politika bujqësore e BA-së nuk ekziston, por vetëm grumbullimi i politikave në nivele të entitetit dhe kantonit, pa ndonjë koordinim deri tani (Erjavec et al. 2010, Bajramovic et al. 2014). Prandaj, ky raport përqendrohet në analizën e politikave bujqësore të çdo niveli administrativ.

Tabela 3.5. Bosnja dhe Hercegovina: masat dhe instrumentet kryesore të politikave bujqësore, 2005 dhe 2014

		Zbatuar	Nga 2005, mbështetja është	Ndryshimet e rëndësishme
Masat e mbështetjes së tregut	FBH	Po, rregullisht	Është rritur	Edhe pse u ndanë fonde të caktuara për masa që mund të klasifikohen si masa te mbështetjes së tregut, në FBH nuk është themeluar një mekanizëm aktiv dhe real i politikave të çmimeve konkurruese . Ndërhyrja në blerje u realizua në vitet 2008 dhe 2011. Mbështetja e vazhdueshme për përpunuesit në 2005-2014 u zbatua në nivel kantoni. Mbështetja e eksportit u prezantua në vitin 2012. Nga viti 2011, sistemi i zbatimit është rishikuar.
	RSr	Po, rregullisht	Rënë	Pak rëndësi iu dha këtyre masave, dhe pak fonde buxhetore u ndanë për to. Masat ishin vazhdimisht të pranishme deri në vitin 2011. Nuk pati ndarje në vitet 2011 dhe 2012, u ri-futën në vitin 2013. Masat kryesore janë ndërhyrja në treg, nevojat emergjente (e paqartë se çka referojnë) dhe shpërblimi ndërhyrjes. Kryesisht sektorët e njëjtë janë mbuluar gjatë gjithë periudhës së vëzhgimit.
	QB	Nuk është zbatuar		
Subvencionet variabile të hyrjeve	FBH	Po, rregullisht	Është rritur	Masa u zbatua në nivel kantoni. Përfshin subvencione për inseminim artificial (në vazhdimësi), mbarështim të kafshëve (vetëm në 2008), karburant (2011 –2014) dhe interes për kredi afatshkurtër (2014)
	RSr	Po, rregullisht	Është rritur	Masat kryesore janë subvencione për karburante dhe plehra minerale (futur në 2008). Blerja e farërave dhe materialeve për mbjellje u subvencionua vetëm në vitet 2005 dhe 2007.
	QB	Nuk është zbatuar		

[15] Në fakt, dokumenti i emëruar "Strategjia për Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural në Qarkun Bërçko për Periudhën 2008–2013" ishte krijuar; por, ai kur nuk u fut në procedurën e rregullt për miratim.

Pagesat direkte në bazë të prodhimit	FBH	Po, rregullisht	Është rritur	Masa kryesore e mbështetjes, me pjesën më të madhe të pagesës për prime të qumështit. Primet për disa prodhime janë rritur, por qumështi mbeti prodhimi më i mbështetur (0.07–0.15 EUR për litër). Nga 2011, sistemi i zbatimit është rishikuar. Nga 2011, gati të gjitha prodhimet e kulturave janë ndihmuar për sipërfaqe (ha) në vend të prodhimit.
	RSr	Po, rregullisht	Është rritur	Masa kryesore e mbështetjes së bujqësisë. Primet në cmim për qumësht dominuan gjatë gjithë periudhës së vështruar. Nga 2010, primi në cmim për qumësht u lidh me klasën/kualitetin e qumështit. Norma për gjetje të sasisë për njësi prodhuese për shumicën e prodhimeve është e ndryshueshme.
	QB	Po, kohe pas kohe		Në vitet 2005 dhe 2006 kjo ishte ndihma e vetme për prodhuesit. Vitet 2007 dhe 2008 ishin tranzicion, me futje graduale të pagesave në bazë të sipërfaqes / nr. krerësh, që në 2009 u bë forma e vetme e ndihmës direkte. Prodhimet kryesore të mbështetura ishin qumështi dhe drithërat.
Pagesat direkte të bazuara në sipërfaqe/nr. krerësh	FBH	Po, rregullisht	Është rritur	Një nga masat më të rëndësishme në FBH. Nga 2011, shumica e primeve për kultura u zëvendësuan me pagesa për hektarë. Pastaj u ndryshua edhe sistemi i zbatimit, që futi rregulla për mundësinë për mbështetje.Obligimi i shitjes së prodhimeve si parakusht për marrje të ndihmës u fut në FBH për shumicën e prodhimit, nga viti 2011.
	RSr	Po, rregullisht	Ka rënë	Masa e dytë me e rëndësishme. Nga viti 2009, nuk ka ndihmë fikse për njësi, por ndihma llogaritet në bazë të aplikacionit për mbështetje dhe të shumës së fondeve të miratuara për prodhimin në fjalë.
	QB	Po, rregullisht	Është rritur	Mbështetja më e rëndësishme për prodhim, dhe e vetmja direkte nga viti 2009. Si numri i mbuluar i produkteve, ashtu dhe sistemi i zbatimit (kriteret) mbetën thuajse të pandryshuar.

		Zbatuar	**Nga 2005, mbështetja**	**Ndryshimet e rëndësishme**
Mbështetja e investimit në fermë	FBH	Po, rregullisht	Është rritur	Masa në fuqi nga 2005. Masat kryesore janë investimet për modernizim të pasurive bujqësore. Fondet e ndara dallonin nga viti në vit, dhe ishin të rëndësishme gjatë 2006–2009. Gjatë 2011–2014 nuk kishte financim nga buxheti federal, dhe fondet nga kantonet ishin modeste. Nga 2011, sistemi i zbatimit u rishikua.
	RSr	Po, rregullisht	Ka rënë	Masa në fuqi nga 2005. Masat kryesore janë investimet për modernizim të pasurive bujqësore. Fondet dallonin nga viti në vit.
	QB	Po, rregullisht	Është rritur	Masa në fuqi nga 2005. Thuajse e vetmja masë e shtyllës së dytë të politikave bujqësore. Masat kryesore janë investimet për modernizim të pasurive bujqësore. Fondet ndryshojnë nga viti në vit.
Mbështetja e industrisë ushqimore	FBH	Po, rregullisht	Ka rënë	Masat në fuqi nga viti 2005. Masat kryesore janë certifikimi (masë e vazhdueshme nga viti 2009), ndërtimi dhe pajisja e industrisë ushqimore (masë e rëndësishme deri në vitin 2009, kur u anulua; kjo masë u fut sërish në përdorim në vitin 2014)
	RSr	Po, rregullisht	Është rritur	Ndarje modeste për këtë masë. Kjo masë ishte në fuqi gjatë gjithë periudhës së vëzhgimit. Masat kryesore janë certifikimi dhe pajisja
	QB	Po, kohe pas kohe	Nuk ka tendencë të rëndësishme	Mbështetja u zbatua gjatë një viti (2007), dhe ishte e lidhur me investimet në industrinë përpunuese

Pagesat e lidhura me mjedisin	FBH	Po, kohe pas kohe	Nuk ka tendencë të rëndësishme	Masa u zbatua ne vitet 2007 dhe 2008 (kur buxhetet ishin më të qëndrueshëm) dhe i referohet pagesave për fermer në ZMPF. Nga viti 2009 nuk është zbatuar më
	RSr	Nuk është zbatuar		
	QB	Nuk është zbatuar		
Mbështetja e zonave rurale	FBH	Po, kohe pas kohe	Nuk ka tendencë të rëndësishme	Masat kryesore ishin diversifikimi i ekonomisë rurale, mbështetja për infrastrukturën rurale, rindërtimi i fshatrave, dhe ruajtja e racave dhe specieve autoktone. Këto masa ishin në fuqi gjatë periudhës 2007–2011, dhe nga atëherë më nuk zbatohen. Sistemi i zbatimit nuk u ndryshua për kohën sa këto masa ishin në fuqi
	RSr	Po, kohe pas kohe	Nuk ka tendencë të rëndësishme	Ky grup i masave është në fuqi, me variacione të zbatimit të disa masave të veçanta. Nuk ka vazhdimësi në asnjë masë, por secila u zbatua në disa vite (diversifikimi u zbatua në vitet 2009–2012; mbështetja për infrastrukturën rurale në 2006–2010, nuk u zbatua në 2011, u fut sërish në vitet 2012–2013, dhe nuk u zbatua në vitin 2014)
	QB	Nuk është zbatuar		
Masat e përgjithsh me mbështetëse	FBH	Po, rregullisht	Ka rënë	Ndarje shumë modeste, veçanërisht në periudhën 2011–2014. Masa lidhet me shërbimet e kontrollit, hulumtimit, zhvillimit dhe inspektimit të bimëve. Kontrolli veterinar ishte pjesë e shtyllës së tretë (mbështetje në nivel kantoni) deri në 2010, kur u anulua. Situata është e ngjashme me asistencën teknike, që ishte në fuqi deri në vitin 2008. Nga viti 2011, sistemi i zbatimit u rishikua
	RSr	Po, rregullisht	Është rritur	Masat kryesore janë kontrolli i shëndetit të shtazëve, mbrojtja e bimëve dhe kontrolli i ushqimit. Masat kishin qëllim të mbështesin hulumtimin dhe zhvillimin, infrastrukturën; edhe trajnimi dhe puna profesionale janë pjesë e masës. Masa këshillimore u mbështet vetëm ne vitin 2009
	QB	Po, kohe pas kohe	Nuk ka tendencë të rëndësishme	Ky grup i masave u zbatua vetëm në vitin 2007, kur u ndanë mjete për mbështetje të punës këshilluese

Figura 3.3. Bosnja dhe Hercegovina: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave MBP – Bosnja dhe Hercegovina, 2015.

Ndarja buxhetore totale në FBH ishte vazhdimisht në rritje deri në vitin 2008; prej atëherë u ul deri në vitin 2013, dhe në vitin 2013 dhe 2014 ka mbetur e qëndrueshme më një mesatare prej 37 milionë eurosh. Masat e Shtyllës I dominojnë në strukturë, në veçanti pagesat direkte, ndërsa masat e përgjithshme për bujqësi ishin shumë modeste në periudhën 2011-2014, që shkonin në vit në më pak se 3 milionë euro (në vitin 2014 vetëm 0.26 milionë euro, ose 0.7% të buxhetit total për bujqësi.

Me përjashtim të vitit 2012, pagesat direkte shënonin rritje të vazhdueshme nga 2005 deri në vitin 2013, dhe ndarja e përgjithshme për këtë qëllim u rrit nga 8.21 milion euro në vitin 2005 në 31.53 milion euro në vitin 2013. Pagesat e bazuara në prodhim mbizotëronin në vitin 2008, dhe ishin kryesisht të lidhura me qumështin, duhanin dhe kulturat hamullore. Nga viti 2009 deri në 2013, struktura e pagesave direkte ndryshoi, kështu që pagesat e bazuara në sipërfaqe/nr. krerësh (nga viti 2011, pothuajse i gjithë prodhimi i bimëve) dominuan. Në vitin 2014, ndodhi një rritje tepër e lartë në prime për litër të qumështit nga 0.09 euro në 0.15 euro, kështu që pagesat në bazë të prodhimit përsëri u bënë mbizotëruese, dhe përbënin 55% të pagesave direkte.

Ndryshe nga RS, nuk ka mbështetje të rëndësishme për hyrje të ndryshueshme në FBH. Kjo kryesisht vjen nga niveli i kantonit dhe vetëm në vitet 2013 dhe 2014 tejkaloi 1 milionë euro, duke përfaqësuar 3-5% të totalit të pagesave direkte.

Mbështetja për masat e zhvillimit strukturor dhe rural në FBH p luhatjet më të theksuara nga viti në vit. Ajo ishte kryesisht e lidhur me rritjen e fuqisë konkurruese të sektorit bujqësor dhe të investimeve në fermë. Kjo qasje padyshim tregon se buxhetet bujqësore nuk kanë komponent të zhvillimit (kjo është e vetmja shtyllë e politikës që përmban një aspekt zhvillimor) dhe ndarjet për zhvillim rural varen kryesisht nga qeveritë aktuale dhe të kuptuarit e tyre të kësaj pjese të politikave. Administrata e fundit natyrisht që nuk e ka kuptuar atë, kështu që ndarjet për këtë shtyllë janë prerë në vitet e fundit të periudhës së analizuar; kështu ato përbënin vetëm 2.3% të totalit të mbështetjes buxhetore në vitin 2013 dhe 15.4% në vitin 2014.

Buxheti total për bujqësi në RSr u rrit vazhdimisht deri në 2009 (41.22 milionë euro). Që nga viti 2009 ai ka qenë në rënie, kështu që në vitet 2013 dhe 2014 ai ishte nën 30 milion euro. Masat mbështetëse të tregut dhe pagesat direkte janë pjesa më e madhe e mbështetjes për prodhuesit bujqësor në RSr, duke përbërë mesatarisht dy të tretat të buxhetit të përgjithshëm të Shtyllës I..

Pagesat direkte, përfshirë mbështetjen për hyrje të ndryshueshme, treguan rritje të vazhdueshme deri në vitin 2009, kur arritën në 28.35 milion euro, dhe më pas, pas një rënie të mprehtë në një ndarje modeste prej 11.9 milion euro në vitin 2010, ky lloj i mbështetjes u stabilizua mes 21 dhe 22 milionë euro gjatë 2011-2014. Në strukturën e pagesave direkte, pagesat në bazë të prodhimit përbëjnë pjesën më të madhe, që në 2012-2014 ishte mesatarisht 70% ose rreth 15 milionë euro. Shumica e këtyre pagesave janë për sektorin e qumështit. Ndryshe nga FBH, pjesa e madhe e mbështetjes direkte për prodhuesit në RSr lidhet me subvencionet për prokurimin e hyrjeve variabile, ku dominojnë pagesat për naftë, plehra dhe fara. Në disa vite, si në vitin 2011, ai përbënte 60% të totalit të mbështetjes direkte. Në vitin 2012-2014 përbënte 13-20%.

Si situata në FBH, masat strukturore dhe masat e zhvillimit rural në RSr ndryshonin shumë nga viti në vit, dhe ishin kryesisht për përmirësimin e konkurrencës së bujqësisë dhe për mbështetje të fshatrave. Gjatë 2005-2014, ndarjet për këtë shtyllë u rritën vazhdimisht deri në vitin 2010 (me përjashtim të vitit 2009), kur u arritën shuma më e lartë (20.34 milionë euro) dhe pjesa e buxhetit të përgjithshëm bujqësor (50.6%). Ai më pas ka rënë në vitet 2013 dhe 2014, kur arriti vetëm 15% të buxhetit të përgjithshëm bujqësor. Si në FBH, është e qartë se edhe buxheti i bujqësisë në RSr nuk ka komponent të zhvillimit, duke pasur parasysh ndryshueshmërinë e theksuar si në kushte absolute ashtu dhe ato relative të ndarjeve për zhvillim rural.

Masat e përgjithshme për sektorin kishin mbështetje më të madhe në RSr sesa në FBH, kështu që gjatë 2012-2014 ato përbënin 7-9% të buxhetit të përgjithshëm bujqësor. Së fundi, rregullat për klasifikimin e pronave në ato tregtare dhe jo-tregtare u futën në vitin 2013. Sipas këtyre rregullave, ato sipërmarrje bujqësore që zgjedhin të klasifikohen si të orientuara nga tregu janë të detyruara të paguajnë daljen në pension dhe sigurimin shëndetësor.

Alokimet konkrete buxhetore për sektorin e bujqësisë në Qarkun Bërçko filluan në vitin 2005 dhe prej atëherë deri në fund të vitit 2013 ato ishin në rangun e 2.3 deri në 3.5 milionë euro. Mesatarisht, 90% e totalit të fondeve janë ndarë për zbatimin e masave të Shtyllës I, dhe pjesa tjetër për masat e zhvillimit rural, ndërsa mbështetja për Shtyllën III nuk ekzistonte, me përjashtim të shumave simbolike në vitet 2007 dhe 2008.

Pagesat direkte ishin dominuese, dhe nga viti 2009 ato ishin vetëm të bazuara në sipërfaqe (prodhim të kulturave) dhe për krerë gjedh (prodhimi shtazor). Buxheti bujqësor u ul në mënyrë drastike në vitin 2014 në vetëm 1.8 milionë euro.

3.4 Çështjet e fermave

Ende nuk ka pasqyre të plotë të strukturës së fermave në BA[16], sepse regjistrimi i fundit bujqësor u zhvillua në vitin 1960. Bazuar në të dhënat e kufizuara të sipërmarrjeve bujqësore dhe strukturën e tyre, të marra nga regjistrimi pilot i bujqësisë në vitin 2010[17], sipërfaqja mesatare e tokës së përdorur është 1.97ha për fermë, me mesatarisht katër ngastra për fermë në fermat familjare, që është shumë më pak se në BE-27 (14.3ha) (Eurostat 2015).

Pa marre parasysh mungesën e statistikave mbi numrin, madhësinë dhe strukturën e fermave në BA, janë të theksuara probleme të tilla si madhësia e fermës, dhe struktura duale e fermave. Bujqësia e BA-së është ende e dominuar nga fermat e vogla, të ndara në parcela të vogla toke. Përveç kësaj, fushat e minuara, një problem i pasluftës, ndërlikojnë më tej situatën dhe çojnë në braktisjen e pjesshme ose të plotë të prodhimit dhe banimit në disa zona të vendit. Sipas hulumtimit në kuadër të raportit të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP 2013) mbi zhvillimin njerëzor në BA për vitin 2013, gjysma e të gjitha ekonomive familjare rurale janë pak ose aspak të angazhuara në bujqësi, 36% të ekonomive familjare rurale kanë "ferma të vogla" që plotësojnë një pjesë të konsiderueshme të nevojave të tyre për ushqim, dhe më pak se 1% të ekonomive familjare mund të klasifikohen si "ferma komerciale" dhe të jenë të afta për përfitim nga masat e IPARD për përmirësim të prodhimit bujqësor dhe aktivitete të marketingut. Madhësia dhe struktura e pafavorshme e fermave është përnjëmend një nga sfidat me të cilat përballen ministritë e bujqësisë në të dy entitetet, dhe imponohet si një prej çështjeve më të rëndësishme strategjike që duhet të trajtohet në të ardhmen.

Erjavec et al. (2014) identifikoi një sërë objektivash të rëndësishme për politikën e ardhshme bujqësore dhe të zhvillimit rural në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë reformat e menaxhimit të tokës. Një mënyrë për të zgjidhur problemet është duke zhvilluar tregun e tokës. Problemet që lidhen me mosfunksionimin apo funksionimit të dobët të tregut të tokës ngadalësojnë ristrukturimin e sektorit në BA e. Legjislacioni i dobët në lidhje me rregullimin dhe zbatimin e të drejtave pronësore, dhe pasiguria në zgjedhjen e sistemit të regjistrimit të tokës, do ngadalësojë modernizimin, dixhitalizimin dhe restaurimin e kadastrës dhe regjistrin e tokës, e cila është një kërkesë themelore për të zhvilluar tregjet e tokës. Përveç kësaj, gjendja e tregut të tokës ul vlerën e tij, dhe mundësinë e përdorimit si kolateral për garantimin e kredive. Edhe pse ka një ligj për tokën bujqësore, nuk ka baza të të dhënave zyrtare të mirëmbajtura. Njësitë administrative nuk shkëmbejnë të dhëna për shndërrimin e përdorimit të tokës bujqësore. Procedurat jokorrekte dhe të pakontrolluara administrative për ndryshimin e përdorimit të tokës bujqësore na çojnë në humbje të konsiderueshme dhe të përhershme të këto burimeve të pakta, dhe zakonisht cënojnë tokën e cilësisë më të mirë.

Problemet e lartpërmendura kufizojnë fuqishëm rritjen, ristrukturimin dhe modernizimin e sektorit. Për këtë arsye, është e nevojshme për të krijuar dhe për të forcuar kuadrin rregullator dhe institucional, për të nisur një iniciativë të përbashkët të të gjitha institucioneve përgjegjëse për të kontribuar për një përdorim më racional të tokës, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së tokës, dhe zhvillimit të tokës (përmirësimet agronomike dhe hidrologjike, konsolidimi i tokës). Për këtë arsye, politikat bujqësore duhet të mbështesin krijimin e sistemeve për menaxhimin e tokës, dhe në veçanti,

---

16 U bë e ditur se rezultatet e regjistrimit të parë të popullsisë pas luftës në BH do të publikoheshin në qershor të vitit 2015, përfshirë dhe një vlerësim paraprak të numrit të fermave. Për fat të keq, për disa arsye (politike) publikimi i rezultateve u shty deri në një njoftim të mëtejshëm, që bëri të pamundur të ofrohen të dhënat e para zyrtare mbi numrin dhe madhësinë e fermave në BH në këtë raport.

17 regjistrimi pilot i Bujqësisë u krye nga tri agjensitë statistikore në BH (agjencia kombëtare dhe dy agjencitë e entiteteve) në Tetor 2010, brenda IPA 2007.

krijimin e mekanizmave për lehtësimin (bazat të dixhitalizuara e të dhënave të tokës, SIPT, të dhëna sistematike mbi furnizimin e tokës dhe kërkesës, një organ koordinues për tokën bujqësore (të gjitha nivelet administrative), modernizimi i regjistrave kadastra e tokës etj), si dhe përcaktimin e politikës afatgjatë së tokës.

3.5 Procesi i integrimit në BE

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) ndërmjet Bosnje-Hercegovinës dhe Bashkimit Evropian hyri në fuqi më 1 qershor 2015 duke krijuar kështu kushtet për diskutim në lidhje me dorëzimin e aplikimit të BA-së për anëtarësim në BE dhe marrjen e statusit të vendit kandidat. Pasi është krijuar administrata e re (në fillim të vitit 2015), autoritetet BA kanë shprehur qartë dëshirën për të zhbllokuar procesin e ngecur të integrimit në BE, për të marrë hapa seriozë përpara dhe për të punuar në reformat, veçanërisht në reformat e rëndësishme ekonomike dhe reformat e sistemit të sigurimeve shoqërore, si dhe në ato që lidhen me sundimin e ligjit.

Zbatimi formal dhe thelbësor e procesit të pranimit dhe përshtatjen e politikave bujqësore të PPB në BA janë ende në faza të pakënaqshme. Politika bujqësore në të dy njësitë e BA në menyrë konsiderueshme ndryshojn nga PPB, si në varg dhe strukturën e masave, në mënyrë që politika e zbatuar është larguar nga modeli i BE-së. Në të dyja entitetet BA, pagesat direkte për prodhim përbëjnë një pjesë të madhe të pagesave të drejtpërdrejta, ndërsa ata mezi ekzistojnë në vendet e BE. Transfertat modeste për masat e zhvillimit rural pothuajse tërësisht i përkasin Shtyllës 1 dhe investimet në ferma bujqësore, ndërsa Shtylla 2 dhe masa të ruajtjes së mjedisit, si pjesë e detyrueshme e PPB, praktikisht nuk ekzistojnë në BA.

Një problem i veçantë për politikën e zhvillimit rural në BA është dështimi për të krijuar institucionet e nevojshme për strukturat e IPARD në nivel shtetëror që do të mundësonte barazimin e fondeve IPARD. Një qasje e re për integrimin në BE mund ta zgjidhë këtë problem dhe do të lejojë që vendi dhe entitetet e tij të gëzojnë qasjen ndaj burimeve të rëndësishme për të përshtatur dhe për të përmirësuar sektorin e bujqësisë, por gjithashtu do të krijojë mundësi për të vendosur elemente thelbësore të kornizës administrative PPB.

Përveç dallimeve të përcaktuara në fushën dhe strukturën e masave, ka ende shumë boshllëqe të tjera midis politikave bujqësore të BA (dmth i entitetevetë tij) dhe PPB. Çështjet që lidhen me agro-mjedisin janë trajtuar në mënyrë të pamjaftueshme dhe janë pjesërisht të mbështetura. Përveç kësaj, mungojnë dokumentet e shumta legjislative, ndërsa ato që ekzistojnë duhet të harmonizohen me standartet dhe rregulloret e BE-së. Karakteristikat më të rëndësishme të zonave rurale të vendit, të tilla si statusi i dobët social e fermave të vogla bujqësore dhe varfërisë së shprehur, janë duke u zgjidhur në mënyrë joadekuate dhe ngadalë. Edhe pse ka shumë ZMPF në vend, këto zona kanë qenë dhe ende janë të lënë pas dore si subjekte për mbështetje nga politikëbërësit bujqësore në të dy njësitë në BA. Shërbimet e përgjithshme në bujqësi janë të mbështetura dobët dhe me një pjesë shumë të vogël të buxhetit (sidomos në FBH). Kjo është veçanërisht shqetësuese, sepse ka një mungesë të dukshme të inovacionit në sektorin bujqësor në të dy entitetet në BA. Për më tepër, transferimet të njohurive, shërbimet këshillimore dhe zgjerimi e shërbimeve janë në nivel jo të kënaqshëm apo aspak të kënaqshëm.

Në përgjithësi, procesi i integrimit në BE në bujqësi kupton harmonizimin e legjislacionit, ndërtimin dhe forcimin të institucioneve, dhe reformën e politikave bujqësore si një e tërë. Prandaj, korniza institucionale dhe ligjore duhet të ristrukturohet rrënjësisht, të jetë bazë për krijimin e një administrate moderne, fleksibël dhe të orientuara ga sektori bujqësor,në të gjitha nivelet. Prioritet duhet t'i jepet krijimit të një plani të saktë operativ për adaptimin e *aktit komunitar* të BE-së dhe për miratimin e ligjeve dhe hartimit të një plani për krijimin e institucioneve të munguara dhe mekanizmav të nevojshëm për menaxhimin efikas të sektorit që mund të mbështesin zhvillimin e tij të mëtejshëm. Kjo do të ndihmojë në kapërcimin e vonesave në proceset e ristrukturimit dhe integrimit në BE.

Forcimi i administratës dhe politikës bujqësore është e rëndësishme, por jo element i vetëm i përgatitjes me sukses për anëtarësim në BE. Suksesi i këtij procesi varet, para së gjithash, nga ristrukturimin dhe modernizimin e bujqësisë dhe agrobiznesit. Vetëm një zinxhir konkurrues prodhimi të ushqimit mund të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe për qasjen me sukses në të. Kjo është detyrë dhe përgjegjësi jo domosdoshmërisht e secilit entitet, por e të gjithë sektorit. Gjithashtu institucionet ekonomike dhe akademike janë përgjegjës në këtë proces.

Janë miratuar dokumentet e reja strategjike për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në të dy njësitë, si dhe për zhvillimin rural në RS. Të dy dokumentet theksojnë një angazhim të qartë për integrimin evropian dhe kanë përcaktuar masat për rregullim gradual dhe rracional ndaj PPB. Duke gjykuar nga vlerësimet pozitive nga ana e hulumtuesve dhe teknicienëve, si dhe nga ana e delegacionit të BE në BA, zbatoimi tërësor i masave të propozuara është e vetmja detyrë me të cilet përballet sektori.

3.6 Fuqitë dhe dobësitë e bujqësisë

Bosnja dhe Hercegovina është e karakterizuar nga diversiteti i zonave agro-klimatike, të cilat lejojnë prodhimin e larmishëm të kulturave. Burimet e pashfrytëzuara natyrore janë në dispozicion për zhvillimin e bujqësisë. Kjo është tokë kryesisht e punueshme intensivisht, e cila është përdorur vetëm pjesërisht (50%), dhe zonat e kullotave që janë të favorshme për zhvillimin e prodhimit të kafshëve.

Cilësia dhe disponueshmëria e kapitalit njerëzor është një çelës për përmirësimin e çdo sektori ekonomik. Edhe pse papunësia është një problem i madh në BA, disponueshmëria e fuqisë punëtore në bujqësi është e kufizuar nga rritja e ulët e popullsisë, e theksuar me migrimin fshat-qytet dhe infrastrukturës së pazhvilluar të transportit. Këto probleme në disa zona, parandalojnë përdorimin e burimeve dhe kontribuojnë në problemet kronike të bujqësisë: produktiviteti i ulët dhe ristrukturimi i ngadaltë i sektorit (Nikoliç et al, 2014.). Cilësia e burimeve njerëzore përcaktohet nga mosha dhe struktura arsimore e popullsisë, e cila është shumë e pafavorshme në zonat rurale. Përsa i përket kapitalit fizik, objektet ekzistuese në të dy sektorët të prodhimit të blegtorisë dhe bujqësisë janë të vjetër, teknologjikisht të vjetëruar, me energjinë joefikase dhe jo të përshtatur me kërkesat për zbutjen e ndikimit negativ në mjedis. Një tjetër problem madhor për pothuajse të gjithë sektorin e bujqësisë në BA është produktiviteti i ulët, si për njësi të prodhimit dhe për fermë. Produktiviteti i ulët është shkaku kryesor i konkurrencës së ulët, veçanërisht në tregun e brendshëm. Sigurisht, produktiviteti i ulët i bujqësisë është pasojë e mungesës së specializimit të qartë, kryesisht në prodhimin e kulturave, por edhe dobësitë në pajisje teknike të fermave dhe varësia e lartë ndaj kushtevetë motit. Progresi në produktivitetin e ndonjë produkti (qumësht, fruta) është i dukshëm, por ky proces është ende shumë i ngadalshëm.

Struktura e industrisë ushqimore është shumë e pafavorshme, ku ndërmarrjet mikro dhe dërmarrjet e vogla mbizotërojnë sektorin. Kjo industri punon me një nivel shumë të ulët të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe është më shumë orientuar drejt prodhimit sesa drejt tregut. BA vazhdon të jetë importuese e mallrave agroushqimore me një deficit tregtar shumë të dukshëm, i cili është edhe një tjetër tregues i së zhvillimit të cunguar të bujqësisë dhe zinxhirit të vlerës së prodhimit të ushqimit. Integrimi i dobët horizontal dhe vertikal është gjithashtu një nga karakteristikat e rëndësishme të sektorit. Niveli i ulët i orientimit nga tregu, mungesa e aftësisë për të ofruar cilësi, sasi dhe siguruar qëndrueshmërinë dhe zinxhiri i vlerave i pazhvilluar rrezikojnë qasjen në tregje dhe kontribuojnë në konkurrueshmërinë e ulët të sektorit. Zhvillimi i sektorit është i kufizuar edhe nga logjistika pazhvilluara dhe aktivitete të tjera ekonomike.

Rrjeti i institucioneve publike, private dhe organizatave, bazuar në arsimimin gjatë gjithë jetës si dhe institucioneve kërkimore, të cilat do të mundësojnë transferimin efikas të njohurive, teknologjisë dhe informacionit dhe të formojnë bazën për risi dhe

modernizimin, nuk është krijuar ende. Për më tepër, nuk ka plane për forcimin dhe zhvillimin e shërbimeve ekzistuese këshilluese apo bashkëpunimit dhe koordinimit midis elemetëve të këtyre shërbimeve.

Tabela 3.6. Bosnja dhe Hercegovina: fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet (SWOT) analiza e sektorit bujqësor

S – Përparësitë	**W – Dobësi**
- Kushtet agro-klimatike lejojnë prodhimin e bimëve të ndryshme - Toka djerrë e punueshme dhe tokat e papërdorura natyrore lejojnë zhvillimin e bimëve dhe blegtorisë - Pyje me bollëk dhe zonate papunuara të pasura me pyje, bimë të egra, bimë medicinale dhe aromatike - Fuqia punëtore ne dispozicion - Burimet e ujit në dispozicion për ujitje - Ruajtja e rracave autoktone blegtorale dhe varieteteve të frutave dhe rrushit - Traditë në prodhimin dhe përpunimin në fermë (reçel, lëngje, raki, djath) - Disa fusha kanë treguar konkurrencë (vera, fruta te buta, peshkimi, prodhimi në serra) - Rritje e ndërgjegjësimit në lidhje me standartet e prodhimit dhe nevoja për futjen e tyre në praktikë - Rritje e ndërgjegjësimit për nevojën për modernizimin e institucioneve - Rritja e motivimit për bashkëpunim dhe koordinim - Ekzistenca i kompanive të suksesshme, të orientuara nga eksporti - Ekzistenca i një kompanie të certifikimit e njohur ndërkombëtarisht - Dokumente bashkëkohore të zhvillimit strategjik të miratuar në të dy njësitë në BA	- Fragmentimi i theksuar si dhe përqindja e madhe e fermave të vogla - Produktiviteti i ulët i punës në gjithë sektorin primar - Kapacitetet e dobëta teknike dhe teknologjike për një numër të madh të fermave - Paqëndrueshmeria dhe luhatjet e larta të çmimeve - Mungesa e përdorimit të makinerive bujqësore - Niveli i ulët i njohurive të teknologjisë, të marketingut dhe të menaxhimit të fermerëve - Përdorimi i farërave jo të certifikuara në prodhimin e kulturave - Përqindja e ulët e totalit të tokës së punueshme dhe ujitur - Prodhimi jo i specializuar, prodhimi dual - Mungesa e bashkëpunimit horizontal dhe vertikal - Mosha e jo e favorshme, struktura jo e favorshme arsimore dhe sociale e popullsisë rurale - Braktisja i zonave rurale dhe *brain drain* - Varësia e lartë ndaj inputevetë importuara dhe mallrave të ndërmjetëm - Një bilanc i varfër tregtar në shumicën e mallrave bujqësore dhe ushqimore - Statistikat e pamjaftueshme bujqësore dhe sisteme analitike dhe IT të pazhvilluara. - Extension dhe shërbime këshilluese joefikase (veçanërisht në FBH) - Shërbime publike të padisponueshme - Shpërndarja e pabarabartë territoriale e kapaciteteve përpunuese - Industria e ushqimit teknologjikisht e vjetëruar, joefikase dhe jo konkurruese - Niveli i ulët i përshtatjes me kërkesat e tregut - Kapacitete pak të përdorura në industrinë ushqimore - Kuadri ligjor institucionalqë nuk është në përputhje me praktikat dhe standartet e BE-së
O – Mundësitë	**T – Kërcënimet**

- Fondet në dispozicion para pranimit në BE për sektorin agroushqimor dhe zhvillimin rural
- Përcaktimi i bujqësisë si prioritet i zhvillimit në vend
- Rritja e kërkesës globale për ushqim
- Nevojat në rritje të industrisë ushqimore për lëndë të parë
- Aksesi në tregjet rajonale nëpërmjet marrëveshjes së tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
- Trendi rritës i produkteve me një shenjë të cilësisë dhe origjinës, dhe trendi rritës i kërkesës për to
- Forcimi i sektorëve ekonomikë komplementare (turizëm dhe hoteleri)
- Proceset e integrimit në BE shtyjnë përpara axhendën politike bujqësore
- Ndryshimi i klimës globale
- Menaxhimi i dobët i burimeve ujore duke çuar ndoshta në përmbytje apo thatësira
- Mungesa e sinkronizimit në zhvillimin e sektorëve të tjerë me zhvillimin e bujqësisë, të cilat mund të ndikojnë në shpopullimin e mëtejshëm dhe mungesën e përdorimit te burimeve natyrore
- Paqëndrueshmëria politike dhe mjedisi i varfër i biznesit si faktore të rrezikshëm për investimet e huaja
- Korrupsioni
- Ekonomia informale
- Fondet e reduktuara të donatorëve
- Politikat e zhvillimit jo të harmonizuara mjaftueshëm me *aktin komunitar* të BE-së
- Prapambetja në proçesin e integrimit në BE
- Mungesa e linjave të kreditit për bujqësinë
- Kontrolli i papërshtatshëm i kufijve që lejon hyrjen e mallrave me origjinë dhe cilësi të dyshimtë
- Gjendja e keqe ekonomike dhe reduktimi i fuqisë blerëse
- Infrastruktura e pazhvilluar e komunikimit, veçanërisht në zonat rurale
- Paaftësia e autoriteteve lokale për të marrë përgjegjësinë
- Imazhi i dobët i BA për shkak të luftës së fundit, jostabiliteti politik dhe moszhvillimi ekonomik.

Cilat janë hapat e nevojshëm për ndryshime? E para është që të ketë një vizion të qartë të zhvillimit të sektorit bujqësor, si dhe një angazhim të fortë për proceset integruese evropiane dhe të përshtatura me PPB. Pas kësaj, është e nevojshme të ndiqen objektivat e vendosura tashmë të politikës bujqësore në të dy njësitë kryesore, të cilat përmblidhen si më poshtë:

- Zhvillimi i bujqësisë dhe sektorëve të lidhura me përdorimin më efikas të burimeve në dispozicion, e cila kërkon një rritje të mëtejshme të nivelit teknologjik të prodhimit;
- Rritjen dhe stabilizimin e të ardhurave në bujqësi dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në zonat rurale;
- Integrimi më i fortë horizontal dhe vertikal;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe përshtatja e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike;
- Reduktimi i varfërisë rurale dhe problemet e fermerëve të vegjël;
- Harmonizimi i kuadrit institucional dhe ligjor dhe politikave bujqësore me PPB, duke respektuar nivelin e zhvillimit të sektorit bujqësor në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Është e sigurtë se përmirësimi i kuadrit institucional dhe legjislativ dhe forcimi i administratës në nivel të entitetit dhe administratës shtetërore do të jenë çështjet kyçe për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në periudhën e ardhshme. Krijimi i kuadrit të përshtatshëm administrativ dhe i sistemeve të nevojshme për zbatimin e PPB janë ndër kërkesat kryesore që një vend kandidat duhet të përmbushë përpara se të bashkohet me BE-në. Ndër të metat e tjera në infrastrukturën administrative dhe institucionale në BA, entitetet dhe Rrethin e Bërçko, një problem i veçantë është zhvillimi i dobët apo edhe mungesa e SIAK, e cila me avancimin e integrimit në BE, do të bëhet një kërkesë për zbatimin e plotë dhe zbatimin e pagesave direkte për bujqësinë. Është e nevojshme gjithashtu krijimi i një databaze, SIPT, si një sistem identifikimi që do të jetë në gjendje të sigurojë përputhjen me standartet e sigurisë së produktit dhe cilësisë, marketingut, madhësiës dhe paketimit, rregullat e etiketimit, analizat dhe kontrollet, monitorimi, etj.

Sugjerimet më të rëndësishme për politikëbërësit bujqësore në BA mund të përmblidhen si më poshtë (Erjavec et al 2014.): Nuk ka alternativa të qarta për një orientim përfundimtar të zhvillimit. Në këtë këndvështrim, integrimi evropian dhe miratimi i objektivave dhe instrumentet në përputhje me PPB mund të shërbejë si një motiv i mirë dhe katalizator për ndryshim. PPB është një objektiv i kërkuar dhe në lëvizje, por ka potencial për të prezantuar një qëndrim aktiv dhe pozitiv ndaj bujqësisë dhe funksionon qoftësi një model zhvillimi qoftë si një pikë referimi.

Ndryshimet në politikën bujqësore të shpallura në dy njësitë e BA, që mund të quhen një ndryshim i politikave bujqësore, janë inkurajuese. Ka ngjashmëri të shumta mes strategjive të reja të zhvillimit të sektorit të njësive në objektivat, mekanizmat e veprimit dhe masat e propozuara, të cilat mund të shihen si hapat e parë të nevojshëm drejt krijimit të kushteve të barabarta të biznesit për të gjithë fermerët në BA. Mbetet për t'u parë se sa realisht dokumentet strategjike mund të vihet në praktikë, deri në çfarë mase buxhetet e planifikuara janë reale dhe nëse janë apo jo administratat vendore këmbëngulëse për zbatimin e tyre të plotë.

4. Kosova*: përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore

Iliriana Miftari[1], Bekim Hoxha[2], Ekrem Gjokaj[2]

[1] Departamenti i Ekonomisë Bujqësore, Fakulteti i Bujqësisë dhe veterinarisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

[2] Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dheZhvillimit rural

4.1 Zhvillimi ekonomik

Kosova* është shtet me të ardhura të mesme të ulëta që ka përjetuar rritje solide ekonomike që prej vitit 1999. Është një nga katër shtetet e vetme në Evropë që ka regjistruar norma pozitive të rritjes për çdo vit që nga fillimi i krizës financiare globale në vitin 2008, me përjashtim të vitit 2014.

Deficitet tregtare janë të larta, dhe aktivitetet ekonomike janë kryesisht të fokusuara në sektorin e shërbimeve, në veçanti në tregti me pakicë dhe shumicë. Mbështetja prej dërgesave të emigrantëve dhe kapitali i huaj direkte/e tërthortë nga ndihma ka rënë, por mbetet akoma e rëndësishme.

Tabela 4.1. Kosova*: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014

	2005	2014
PPB (milion EUR)	3,003	5,485
Popullsia (milion)	2.070	1.805
Sipërfaqja (km^2)	10,908	10,908
Dendësia e popullsisë (banor/km^2)	190	166
PBB për frymë, PFB (EUR)	:	:
Tregtia e jashtme si % e PBB	40.4	52.2

Burimi: Baza e Të dhënave Statistikore Bujqësore – Kosovë*, 2015.
:, nuk është në dispozicion; PFB, pariteti i fuqisë blerëse.

Figura 4.1. Kosova*: treguesit kryesorë makroekonomik (% rritje nga viti kaluar; % e papunësisë), 2005–2014



Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Kosovë*, 2015.

Gjatë viteve të fundit ekonomia u rrit mesatarisht me rreth 3%. Rritja mbështetet kryesisht në kërkesën e brendshme, me rritje të fortë të konsumit dhe investimeve publike, përfshirë këtu ndërtimet. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve është rritur, por ende mbulon vetëm rreth një të tretën e totalit të importeve. Baza e prodhimit mbetet jashtëzakonisht e ngushtë. Bujqësia, kryesisht gjysmë-subsistencë, kontribuon rreth 14% të vlerës së shtuar në ekonomi. Prodhimi është i kufizuar, dhe i përqendruar në nxjerrjen e lëndëve të para, që gjithashtu mbizotëron në eksportin e mallrave.

Pavarësisht kësaj, gjendja ekonomike është sfiduese, dhe ekonomia ofron pak mundësi punësimi, veçanërisht për gratë në zonat rurale dhe të rinjtë. Ndërkohë që gati dy të tretat e popullsisë së vendit janë të moshës së punës (15-64 vjeç), ky grup pritet të rritet me shpejtësi gjatë 10 viteve të ardhshme, pasi Kosova* ka popullsinë më të re në Evropë. Megjithatë, mungesa e perspektivës për punë ushtron presion mbi kohezionin social dhe nxit emigrimin.

Pagat e sektorit publik janë burimi më i rëndësishëm i të ardhurave në Kosovë*, të ndjekura nga pagat nga sektori privat dhe remitancat. Përqindja e larte e remitancave ka një ndikim të lartë në tregun e punës, pasi ka prirje për rritje të pagës minimale, dhe zvogëlon nxitjen për të punuar. Dallimet në paga vërehen për grupmoshat aktive për punë, ku gratë zakonisht paguhen më pak se burrat. Qartazi, nuk krijohen vende punë të mjaftueshme për reduktimin e presionit të papunësisë në tregun e punës. Përveç kësaj, ekonomia kryesisht bazohet në sektorët që mbështeten në punë më aftësi të ulëta.

4.2 Zhvillimi bujqësor

Kontributi mesatar i bujqësisë, pyjeve, gjuetisë dhe i sektorit të peshkimit në VSHB në 2006-2014 ishte 15.4%. Duke marrë në konsiderate kontributin e sektorit të bujqësisë në VSHB dhe normën e vlerësuar të punësimit në bujqësi, të jepet përshtypja e një sektori me normë të mirë të efikasitetit. Megjithatë, kjo shifër (2.6%) mbulon vetëm punësimin formal në sektorin e bujqësisë. Sektori i bujqësisë ka mundësi të mëdha për të ofruar mundësi punësimi dhe gjeneron të ardhura për njerëzit që jetojnë në zonat rurale. Norma vjetore e rritjes së VSHB te sektorit të bujqësisë tregon një trend pozitiv nga viti 2005 deri në vitin 2014.

Tabela 4.2. Kosova*: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014

	2005	2014
% e VSHB	13.6	13.8
% e punësimit	:	2.6
Eksportet e produkteve të sektorit agroushqimor (% e eksporteve totale)	13.9	12.1
Importet e produkteve të sektorit agroushqimor (% e importeve totale)	24.8	24.3

Burimi: Baza e Të dhënave Statistikore Bujqësore – Kosovë*, 2015.
:, nuk është në dispozicion.

Sipërfaqja e tokës në dispozicion të bujqësisë është relativisht e vogël. Sipas Anketës së Njësive Ekonomike Bujqësore 2013, 49% e familjeve zotërojnë më pak se 1ha tokë. Numri i fermave të vogla është rritur me 3.6% nga viti 2007, ndërsa sipërfaqja që ata kanë kultivuar u rrit me 11.7%. Gjatë të njëjtës periudhë, numri i fermave të mëdha dhe të specializuara u rrit me 255 njësi dhe sipërfaqja që ata kultivojnë u rrit me 4,168ha.

Kosova* nuk është qendër e rëndësishme bujqësore dhe prodhuese. Përpunimi dhe tregtia janë të fokusuara kryesisht në konsumin lokal dhe për vetëmbajtje. Zinxhirët e saj të vlerave janë të kufizuara, dhe ofrimi i shërbimeve është i penguar nga burimet e kufizuara.

Kulturat më të rëndësishme për prodhim bujqësor në Kosovë* janë drithërat, kryesisht gruri dhe misri. Edhe pse statistikat tregojnë një prirje në rritje në sipërfaqen e mbjellë

me grurë, dhe rritje të lehta për kulturat tjera, të tilla si misri, frutat dhe perimet, rendimentet mesatare për hektar janë shumë më të ulëta se ato të vendeve të BE-së. Rendimentet janë të ulëta kryesisht për shkak të mungesës së njohurive për teknikat moderne të prodhimit dhe trajtimin e sëmundjeve, pasi këshillimet dhe trajnimet nuk janë mirë të shënjestruara, si dhe për shkak të qasjes të ulët në inpute me cilësi të mirë.

Tabela 4.3. Kosova*: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2013

	2005	2013
SB (000 ha)	265	297
% e tokës së punueshme ne SB	52.3	57.6
% e kulturave në prodhimin total bujqësor	50.9	59.0
Rendimenti mesatar i grurit (t/ha)	3.9	3.8
Rendimenti mesatar i qumështit (t/lopë mjelëse)	:	:
Faktori i të ardhurave për njësi vjetore pune (EUR)	:	:
Raporti i eksportit-importit për produktet agroushqimore (%)	2.7	6.4

Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Kosovë*, 2015.
:, nuk është në dispozicion; SB, sipërfaqe bujqësore.

Në përgjithësi, çmimet e prodhimit bujqësor treguan rritje të konsiderueshme në 2013-2014. Çmimet për thekër, elb, patate, speca, dardha, rrush tavoline dhe arra treguan rritjet më të larta të çmimeve në vitet 2013 dhe 2014. Çmimet për produktet blegtorale u rritën konsiderueshëm më shpejt se ato të produkteve bujqësore. Midis inputeve bujqësore, rritjet më të larta të çmimeve u regjistruan për plehrat, për përbërësit e tjerë ushqyes të tokës dhe për ushqimin e blegtorisë.

Për vite me radhë Kosova* u përball me bilanc negativ tregtar, që është i dominuar nga importet dhe niveli dukshëm më i ulët i eksporteve, duke rezultuar me deficit të lartë tregtar për vendin. Përqindja e eksporteve agroushqimore në eksportin total të mallrave është rritur pak në dy vitet e fundit të studiuara (2013-2014). Edhe pjesa e importeve agroushqimore në importin total të mallrave u rrit në 24%, që është shumë më e lartë se raporti i eksporteve të produkteve agroushqimore.

Figura 4.2. Kosova*: tregtia e produkteve agroushqimore (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e Të dhënave Statistikore Bujqësore – Kosovë*, 2015.

Sic përmendet më lartë, tregtia e lirë ka rritur bilancin negativ tregtar për eksportin dhe importin total të mallrave, si dhe në veçanti për produktet agroushqimore.

Mallrat më të rëndësishme agroushqimore të eksportuara janë frutat dhe arrat, perimet e përpunuara, perimet e freskëta, produktet e industrisë së blojës, pijet, alkooli dhe uthulla.

Vlera e importit të produkteve agroushqimore në vitin 2014 ishte 616 milion euro, që është 6% më e lartë se vlera e importit të kryer në vitin 2013. Vlera e eksportit të produkteve agroushqimore në vitin 2014 u rrit me 13% nga viti i kaluar (në 39.4 milion euro). Më shumë se 70% e vlerës së importit për produktet agroushqimore vjen nga produktet e qumështit, drithërat, mishi dhe pijet.

Tabela 4.4. Kosova*: zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore në periudhën 2007 dhe 2014

	Tradicionalisht, shteti është	Nga viti 2007, prodhimi	Ndryshimet e rëndësishme
Drithëra	Importues neto	Nuk ka trend të rëndësishëm	Rritje e ulët në sipërfaqe të mbjellë dhe eksport në vitin 2014. Rënie e konsiderueshme e sasisë së importuar dhe çmimit të tregut
Sheqer		Nuk ka prodhim të rëndësishëm	
Fara vajore, vajra dhe yndyra		Nuk ka prodhim të rëndësishëm	
Fruta dhe perime		U rrit	Eksporti u rrit në mënyrë të konsiderueshme, por importi mbetet i lartë dhe është ende në rritje në 2013-2014. Rritje e lehtë në prodhim të frutave në krahasim me prodhimin e perimeve. Rritje e konsiderueshme e çmimeve, sidomos për frutat
Verë		Nuk ka prodhim të rëndësishëm	
Patate		U ul	Rënie e konsiderueshme në sipërfaqe të kultivuar dhe prodhim, e ndjekur nga rritja e konsiderueshme e çmimeve, sidomos në 2013.
Duhan	Importues neto	Nuk ka trend të rëndësishëm	Importi në rritje nga viti 2007. Kosova* nuk eksporton duhan
Mish viçi dhe lope	Importues neto	Nuk ka trend të rëndësishëm	Rritje konstante në sasi dhe çmime të importeve të mishit, kurse eksportet janë pothuajse zero
Mish derri		Nuk ka trend të rëndësishëm	Si për shumicën e prodhimeve bujqësore, çmimet për mishin e derrit u rritën vazhdimisht gjatë periudhës 2007–2014
Mish dele dhe dhie		U rrit	Rritje e konsiderueshme e çmimit të të leshtave. Rritje e lehtë në madhësi të tufave të të të imtave.
Mish shpendësh		Nuk ka trend të rëndësishëm	Rritje të konsiderueshme në çmime për mish shpendësh, në veçanti në vitet 2013 dhe 2014
Qumësht dhe bulmetet		Nuk ka trend të rëndësishëm	Nuk ka ndryshime të konsiderueshme në çmimet e qumështit dhe nënprodukteve të qumështit

4.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

4.3.1 Korniza e politikave bujqësore

Programi i Kosovës* për Zhvillimin Rural dhe Bujqësinë (PZHBR) është kuadri i plotë dhe gjithëpërfshirës zbatues që udhëzon zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe të zhvillimit rural në Kosovë* në drejtim të modernizimit dhe përafrimit me standartet e BE-së. Pjesë e madhe e PZHBR është Programi Granteve për Zhvillim Rural, që bashkëfinancon investimet e ndryshme të sektorit privat përmes ofrimit të granteve.

Politika e Kosovës* për zhvillimin rural 2014-2020 do të orientohet sipas drejtimeve të reja strategjike të politikës së BE-së për zhvillim rural, duke marrë parasysh përvojat e fituara gjatë zbatimit të PZHBR 2007-2013.

Objektivat e deklaruara në PZHBR 2014-2020 ishin të bazuara ngushtë në objektivat strategjike të politikave IPA II, por gjithashtu u fokusuan dhe pasqyruan objektivat strategjike të shtetit për zhvillim, dhe në nevojat specifike të sektorit agroushqimor, pyjor dhe të zonave rurale të Kosovës*. Programi i Kosovës* për Zhvillimin Rural 2014-2020 fokusohet në gjashtë prioritetet në vazhdim (MBPZHR 2013a):

1. Nxitja e transfertave të njohurive dhe inovacionit në bujqësi, pylltari dhe zonat rurale;
2. Rritja e konkurrencës në të gjitha llojet e bujqësisë dhe rritja e qëndrueshmërisë së fermave;
3. Promovimi i organizimit të zinxhirëve të ushqimit dhe i menaxhimit të rrezikut në bujqësi;
4. Restaurimi, ruajtja dhe përmirësimi i ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe pylltaria;
5. Promovimi i efikasitetit të burimeve dhe mbështetja e ndryshimit drejt ekonomisë me karbon të ulët dhe e ndjeshme ndaj klimës në sektorët e bujqësisë, ushqimit dhe ato pyjore;
6. Promovimi i përfshirjes sociale, reduktimit të varfërisë dhe zhvillimit ekonomik në zonat rurale.

Synimet e përgjithshme të PZHBR 2014–2020 u përcaktuan si në vazhdim:

– të zhvillojë sektorin agroushqimor të bazuar në inovacion dhe konkurrues, me prodhim dhe produktivitet në rritje, të aftë për prodhim të produkteve të cilësisë së lartë dhe për arritje të standarteve të tregut të BE-së, me kontribut në sigurimin në qasje dhe sigurinë e furnizimit me ushqime, duke ndjekur qëllimet ekonomike, sociale dhe mjedisore duke nxitur punësimin dhe duke zhvilluar kapitalin njerëzor dhe atë fizik;

– të mbrojë burimet natyrore dhe mjedisin në zonat rurale, duke trajtuar sfidat e ndryshimeve klimatike përmes arritjes së përdorimit të qëndrueshëm dhe efikas të tokës dhe menaxhimit të pyjeve, dhe me implementimin e metodave të prodhimit bujqësor që ruajnë mjedisin;

– të përmirësojë cilësinë e jetës dhe të diversifikojë mundësitë e punësimit në zonat rurale me nxitje të punësimit, përfshirje sociale dhe zhvillim të balancuar territorial të këtyre zonave.(2013a MBPZHR)

Objektivat strategjike të PZHBR 2014-2020 do të arrihen nëpërmjet implementimit të prioriteteve të zhvillimit rural dhe të masave sipas IPA II, dhe masave mbështetëse kombëtare që trajtojnë të ardhurat, përdorimin e tokës dhe infrastrukturën e ujitjes, të financuara nga buxhetit shtetëror dhe iniciativat e ndihmës së huaj. Tabela 4.5 paraqet masat e përzgjedhura që do të zbatohen në Kosovë*, të kategorizuara nën katër prioritetet e IPA II të BE-së për zhvillim rural.

Tabela 4.5. Masat e zgjedhura të zbatohen në Kosovë* gjatë 2014–2020

Prioritetet	Masat
Rritja e qëndrueshmërisë dhe aftësisë konkurruese të fermës	Investimet në pasuritë fizike të fermave bujqësore Investimet në pasuritë fizike të përpunimit, dhe marketingu i produkteve bujqësore dhe të peshkimit
Rikthimi, ruajtja dhe përmirësimi i ekosistemeve	Masat agro-mjedisore dhe bujqësia organike Ngritja dhe mbrojtja e pyjeve
Nxitja e përfshirjes sociale dhe ekonomike	Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve Përgatitja dhe zbatimi i strategjive lokale zhvillimore - Liaison Entre Actions de Développement de l'Économie Rurale (lidhjet mes ekonomisë rurale dhe veprimeve zhvillimore, LEADER)
Bartja e njohurive dhe inovacionit	Përmirësimi përmes trajnimeve, Shërbime këshilluese, Ndihma teknike

Burimi: MBPZHR (2013a).

4.3.2 Mbështetja buxhetore për bujqësinë

Nga viti 2008 deri në vitin 2014, buxheti i përgjithshëm i ndarë për bujqësinë dhe zhvillim rural është rritur. Investimet e fundit dhe rritja e vëmendjes së qeverisë në formë të granteve dhe subvencioneve kanë qenë shumë të pakta për të patur ndikim domethënës në drejtim të shtimit të përqindjes së bujqësisë në PBB të shtetit.

Figura 4.3. Kosova*: Shpenzimet buxhetore për bujqësinë dhe zonat rurale (milion EUR), 2008–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB – Kosova*, 2015.

Qëllimi i masave të përkrahjes direkte brenda PZHBR ishte rritja e prodhimit bujqësor dhe të ardhurave të fermerëve, dhe për të përmirësuar aftësinë konkurruese të sektorit të bujqësisë në krahasim me sektorët tjerë dhe importet. Shuma e buxhetit total të ndarë për pagesa direkte u rrit ndjeshëm në 2013-2014 dhe u futën disa pagesa të reja direkte.

Pagesat direkte filluan në vitin 2008 me mbështetje për karburant për korrje si subvencion hyrës. Mbështetje e tillë nuk u ofrua në 2013-2014. Nuk ka subvencione të tjera hyrëse, si për plehra kimike apo pesticide, që u zbatuan gjatë 2008-2014. Në vitet 2012-2104 pagesa u dha për zonat e mbjella me grurë, të certifikuara nga inspektorët e Ministrisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), dhe zona minimale e pranueshme ishte 10 ha/fermë.

Në mesin e pagesave direkte, masa e vetme mbështetëse ishte pagesa direkte e bazuar në sipërfaqe / numër krerësh. Pagesat direkte për farëra dhe shpendë u futën në periudhën 2013-2014. Fermerët që kanë aplikuar duhet të përmbushnin këto kritere: (i) duhet të kenë një minimum prej 0.50 ha tokë bujqësore (në pronësi ose me qera); (ii) sipërfaqja e tokës me qera duhet të jetë kontraktuar për të paktën dy vjet; (iii) fermeri duhet të prodhojë një minimum prej 5000 fidanë dhe një maksimum prej 100,000 fidanë të pemëve frutore të shartuara me rrënjë vegjetative. Pagesat për shpendë u transferuan për të gjithë fermerët që kishin të paktën 2,400 pula për vezë . Pagesat janë bërë për umër krerësh. Shuma e pagesës është kategorizuar në varësi të numrit të shpendëve (2,400-10,000, 0.50 EUR/krerë, 10,000-20,000, 0.40 EUR/krerë, më shumë se 20.000, 0.30 EUR/krerë).

Në vitin 2014 u prezantuan pagesa të tjera direkte, për perime në fusha të hapura, për cilësi të qumështit dhe prodhim të dosave. Në total, 23 perime të ndryshme janë subvencionuar, dhe kriteri minimal për të përfituar nga kjo pagesë ishte mbjellja e një sipërfaqe me perime 0,2 - 0,5 ha . Shumica e përfituesve për subvencione të tilla ishin fermerët që kultivonin speca, bostan dhe patate. Numri i aplikuesve në rritjen e dosave ishte relativisht i vogël. Kështu që u përkrahën të gjithë fermerët që kishin minimum dy dosa në prodhim aktiv. Thirrjet për të aplikuar për pagesa për cilësi të qumështit janë shpallur çdo tre muaj. Pagesat u bënë për tri klasa të ndryshme, me sasi të ndryshme për klasën ekstra, të parë dhe të dytë.

Tabela 4.6. Kosova*: masat dhe instrumentet kryesore të politikave bujqësore, 2008 dhe 2014

	Zbatimi	Nga 2008, mbështetja	Ndryshimet e rëndësishme
Masat e mbështetjes së tregut	Nuk u zbatua		
Subvencionet për inputet variabile	Po, rregullisht	U rrit	Buxheti i ndarë për masa të tilla u rrit ndjeshëm në 2012-2014. Mbështetja është dhënë kryesisht për karburant dhe fidanë. Mbështetja për karburant për korrje nuk u vazhdua në 2013-2014, ndërsa mbështetja për fidanë u zbatua vetëm në ato vite
Pagesat direkte në bazë të prodhimit	Nuk është e rëndësishme	Nuk ka trend të rëndësishëm	Zbatimi i pagesave direkte në bazë të prodhimit filloi kohët e fundit. "Cilësia e qumështit" është masa e parë, që u fut në vitin 2014. Janë tri kategori të cilësisë së qumështit që subvencionohen: klasa ekstra, klasa e parë dhe klasa dytë. Thirrjet për aplikime bëhen çdo tre muaj dhe edhe pagesa bëhet në çdo tre muaj
Pagesat direkte në bazë të sipërfaqes / nr. krerëve	Po, rregullisht	U rrit	Këto pagesa realizohen prej vitit 2009. Buxheti i ndarë për këtë skemë u rrit ndjeshëm në tre vitet e fundit të studiuara. Mbështetja u rrit kryesisht për lopë mjelëse, dele dhe dhi, grurë, dhe vreshta. Kosova* zbatoi pagesat direkte për krerë ne shpend dhe dosa, si dhe për sipërfaqet e mbjella me perime në fusha të hapura në vitin 2013, në një farë mase, dhe në 2014
Pagesat direkte të ndara nga prodhimi	Nuk u zbatua		

Mbështetja për investime në fermë	Po, rregullisht	U rrit	Mbështetja për investime në fermë u zbatua rregullisht, dhe buxheti i ndarë për mbështetje të tillë u rrit vazhdimisht. Qëllimi i përgjithshëm ishte të përmirësohej struktura e familjeve bujqësore duke rritur prodhimin dhe përmirësuar cilësinë. Në 2014 u futën nën-masa të reja për drithëra, sera, bletari dhe sektorin e mishit, përfshirë edhe zogjtë. Në vitin 2014, u dha edhe mbështetja për përmirësimin dhe konsolidimin e tokës
Mbështetja për industrinë ushqimore	Po, rregullisht	Nuk ka trend të rëndësishëm	Mbështetja u dha për ndërtimin e qendrave për grumbullim, paketim dhe ruajtje të produkteve bujqësore. Masat mbulojnë qumështin, mishin, drithërat, frutat dhe perimet, ujin e amballazhuar, verërat dhe birrën. Mbështetja ka për qëllim të përmirësojë përdorimin e produkteve bujqësore duke rritur vlerën e shtuar në prodhim , ngritjen e qendrave të grumbullimit, futjen e analizës së rriskut dhe pikave kritike të kontrollit për sigurinë e ushqimit, dhe orientimin e linjave të prodhimit dhe objekteve të lidhura me to, drejt kërkesave të BE-së
Pagesat e lidhura me mjedisin	Nuk u zbatua		
Mbështetja për zonat rurale	Nuk është e rëndësishme	Nuk ka trend të rëndësishëm	Zbatohet prej vitit 2010. U mbështetën projektet publike dhe private që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të jetës së popullsisë rurale. Buxheti i ndarë ishte shumë më i ulët në vitin 2014 sesa në vitin 2013.
Masat e mbështetjes së përgjithshme	Po, rregullisht	U rrit	Në periudhën 2013-2014U rrit ndjeshëm buxheti i ndarë për zhvillimin e trajnimit profesional që të plotësojë nevojat rurale dhe kërkimi . Kjo masë u zbatua përmes projekteve kapitale, dhe synon zhvillimin e zonave rurale duke përmirësuar shërbimet këshillimore

Më shumë se 95% e buxhetit total të shpenzuar në masat e zhvillimit rural u përqendrua në konkurrencë dhe 1-2 % në ekonominë rurale dhe popullsinë. Në vitet 2013-2014, nuk janë ndarë fonde për mjedisin dhe zonat rurale.

Nga buxheti i përgjithshëm i shpenzuar për konkurrencë, më shumë se 80% u fokusua në mbështetjen për ristrukturim të fermave (ristrukturimin e potencialit fizik në sektorin bujqësor-rural, konsolidimin e tokës, menaxhimin e burimeve ujore për bujqësinë, dhe mbështetje të tjera për fermat) dhe 10-20% në mbështetje të pyjeve (përmirësimi i menaxhimit të burimeve natyrore). Struktura e shpenzimeve buxhetore për rritjen e konkurreshmërisë nuk ka ndryshuar në vitet 2013-2014, krahasuar me dy vitet paraprake. Brenda mbështetjes së investimeve në fermë, në vitin 2014 u futën nën-masa të reja në mbështetje të investimeve në sera, bletari, drithëra dhe sektorin e mishit (shtimin e peshës së viçave dhe shpendëve). Shuma e paguar për këto nën-masa është relativisht e vogël në krahasim me shumat për nën-masa të tjera të zbatuara mes viteve 2008 dhe 2014.

Figura 4.4. Kosova*: Përbërja e masave të lidhura me aftësinë konkurruese (milion EUR), 2008–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB – Kosova*, 2015.

Nga viti 2009, MBPZHR filloi të mbështesë projekte publike dhe private që kishin ndikim në përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë rurale. Përfitues ishin grupet e veprimit lokal (GLV) të regjistruara në Kosovë* sipas parimeve të *Liaison Entre Actions de Développement de l'Économie Rural* (lidhja mes ekonomisë rurale dhe veprimeve zhvillimore, LEADER). Drejtuesit e GLV-ve ishin përgjegjës për aplikim dhe zbatimin e projekteve që përfshinin komunitetet rurale. Buxheti i ndarë për mbështetje të tilla u ul ndjeshëm në vitin 2014, në krahasim me një vit më parë. Në vitin 2013, u dha mbështetje 15 GLV-ve që zbatonin projekte të infrastrukturës bujqësore, siç janë përmirësimi i oborreve të shkollave, parqeve, varrezave, shtretërve të lumenjve, urave me interes të përbashkët dhe rrugëve rurale. Diversifikimi i fermave dhe aktivitetet alternative në zonat rurale dhe përmirësimi i infrastrukturës rurale dhe mirëmbajtja e trashëgimisë rurale u zbatuan fillimisht në vitin 2014, edhe pse buxheti i ndarë për një mbështetje të tillë ka qenë relativisht i vogël.

Figura 4.5. Kosova*: Përbërja e mbështetjes së shërbimeve të përgjithshme në bujqësi (milion EUR), 2008–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB – Kosova*, 2015.

Më shumë se 95% e buxhetit të shpenzuar për shërbime të përgjithshme u përdor për sigurinë e ushqimit, në veçanti për shërbime veterinare dhe fito-sanitare, dhe nje përqindje e vogël e fondeve u shpenzua për kërkim dhe zhvillim, shërbime këshilluese dhe të ekspertëve (Figura 4.5). Buxheti i shpenzuar në trajnim profesional nuk u rrit gjatë viteve 2013 dhe 2014. Sipas raportit afatmesëm të vlerësimit, masat e trajnimeve

profesionale kontribuan në rritjen e prodhimit bujqësor, përdorimin më efikas të hyrjeve të fermave dhe aktiviteteve më të specializuara të fermës (MBPZHR 2012).

4.4 Çështjet e fermave

Kosova* ka një strukturë të pafavorshme të fermave, me një SBSH mesatare për fermë prej 1.5ha, të fragmentuar në shtatë ngastra. Sipas të dhënave paraprake nga regjistrimi i bujqësisë së vitit 2014, SBSH mesatare për fermë është 2ha. Kosova* ka SBSH më të ulët për fermë bujqësore nga çdo vend i BE-së apo BP, përveç Maltës. Madhësia e fermave është sfidë serioze që duhet tejkaluar për rritje të produktivitetit.

Diversifikimi i kulturave është strategji e zakonshme e përdorur nga fermat familjare për të minimizuar rreziqet që mund të vijnë nga dështimi i kulturave dhe për të stabilizuar të ardhurat e familjes për të mbijetuar. Mbështetja e fermerëve dhe rritja e nxitjes së tyre për të marrë tokë publike me qira për përdorim bujqësor me kosto të përballueshme, do të ishte një mënyrë për të rritur produktivitetin dhe aftësinë konkurruese të fermerëve të vegjël. Rritja e prodhimit bujqësor është mjaft e vështirë, nëse nuk shoqërohet me rritje të kapaciteteve prodhuese përmes kultivimit të tokës dhe rritjes së madhësive të fermave. Përmirësimi i objekteve për magazinim do të rrisë të ardhurat neto të fermerëve të vegjël nga prodhimi, dhe do të përmirësojë aftësinë e tyre konkurruese. Mbështetja e dhënë për ndërtim të qendrave për grumbullim, paketim dhe ruajtje të prodhimeve bujqësore u ndal plotësisht në vitet 2013-2014.

Më parë Kosova* nuk ka patur masa të veçanta të politikave apo subvencione që synojnë grupe të fermave të vogla. Në vitet 2013-2014 u nda një buxhet i vogël për konsolidim të tokës, që është shumë e rëndësishme duke pasur parasysh situatën aktuale: fermat janë mesatarisht të vogla dhe të fragmentuara në shumë ngastra; tregu i tokës është i dobët, me transparencë të kufizuar mbi pronësi të tokës; dhe është e paqartë e drejta e përdorimit të sipërfaqeve të përbashkëtave të tokës. Mund të bëhen përpjekje për mbështetje të kësaj masë me qëllim arritjen e disa synimeve që janë përcaktuar në strategjinë e re të PZHBR 2014-2020. Kështu mund të rriten edhe investimet në sistemet e ujitjes dhe të mbjellave(prodhim të kulturave).

4.5 Procesi i integrimit në BE

Dokumenti i ri i programit për bujqësi dhe zhvillim rural në Kosovë* u miratua në bazë të konceptit të zhvillimit rural të BE-së. Masat e PZHBR 2007-2013 që japin mbështetje direkte për prodhuesit korrespondojnë në një deri diku me masat e Shtyllës I në kuadër të PPB, dhe masat mbështetëse të zhvillimit rural janë të ngjashme me PPB Shtyllën II. Dokumenti i programit me masat e planifikuara për mbështetje u realizua në bazë të ndarjes së buxhetit vjetor për sektorin e zhvillimit rural dhe të bujqësisë. Ndarja e buxhetit të përgjithshëm të MBPZHR për masa të ndryshme të PZHBR 2007-2013 ka ndjekur vetëm pjesërisht synimet e përgjithshme për bujqësinë dhe zhvillimin rural (MBPZHR 2012).

Për shkak të strukturës jo të favorshme të fermave dhe përdorimit joefikas të faktorëve të prodhimit, rendimentet e prodhimeve bujqësore në Kosovë* janë shumë më të ulëta se rendimentet mesatare të BE-së. Në përgjithësi, sektori i bujqësisë dhe i përpunimit të ushqimit janë duke u përballur me vështirësi në zhvillimin e zinxhirëve të shpërndarjes së ushqimeve, marketingut, dhe të cilësisë, standarteve veterinare dhe fitosanitare të krahasueshme me standartet e BE-së. Mesatarisht, çmimet e prodhimit bujqësor janë dukshëm më të larta në Kosovë* se në vendet e BE-së. Kjo tregon se prodhuesit e Kosovës* ende nuk janë shumë konkurrues në çmim. Në vitet e fundit u vu re një deficit tregtar agro-ushqimor në rritje. Strategjia e tregtisë bujqësore duhet të zhvillohet në bazë të analizës se tregut; kështu, prodhuesit dhe përpunuesit lokal mund të shfrytëzojnë më mirë mundësitë e tregut dhe të stabilizojnë punësimin dhe të ardhurat.

Në përgjithësi, zonat rurale në Kosovë* kanë nivel të ulët të zhvillimit ekonomik, që çon në normë të lartë të papunësisë. Reduktimi i varësisë së fuqisë rurale punëtore nga bujqësia dhe zhvillimi i aktiviteteve për të ardhura shtesë për jetesën rurale mbetet një nga detyrat më të vështira. Për të tkurrur fenomenin e emigrimit dhe varfërisë në zonat rurale, duhet të krijohen mundësi punësimi me mbështetje të diversifikimit të aktiviteteve bujqësore, siç janë përpunimi i produkteve ushqimore tradicionale lokale, dhe produkteve të vecanta (niche), si dhe duhet ofruar nxitje të iniciativave të bizneseve që ofrojnë shërbime rurale. Gjithashtu, duhet të organizohen edhe seminare të vogla ku të inkurajohet sipërmarrja e femrave. Zhvillimi ekonomik në zonat rurale duhet të nxitet përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës, siç janë energjia elektrike, rrugët, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbeturinave dhe interneti me shpejtësi të lartë.

Shpërndarja e buxhetit dhe niveli e mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga viti 2007 deri në vitin 2014 ishte relativisht i ulët në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe vendet e BE. Një rritje në konkurrencën e bujqësisë duhet të shoqërohet me një rritje në ndarjen e buxhetit për bujqësinë. Bujqësia konkurruese kërkon njohuri, informacion dhe menaxhimin të shërbimeve të përditësuara. Sigurimi i trajnimeve të mëtejshme, me tematika teknike dhe në lidhje me menaxhimin sipërmarrjeve bujqësore si dhe ofrimi i dhe informacionit për tregun bujqësor, në përputhje me nevojat specifike të vendit janë parakushte për rritjen e prodhimit bujqësor dhe rritjen e efikasitetit dhe aftësisë konkurruese të sektorit.

Promovimi i kërkimit bujqësor do të ndihmojë në zhvillimin e sistemeve të qëndrueshme të prodhimit, veçanërisht në pikëpamje të sfidave të reja të tilla si ndryshimi i klimës, biodiversitetit, rritja e çmimeve të ushqimit dhe bio-karburanteve. Edhe pse për disa vite nuk ka pasur unanimitet në kuadër të PPB për optimizimin e politikave dhe instrumenteve që synojnë pagesa agro-mjedisore, Kosova* duhet të fillojë me futjen e skemave të pagesave agro-mjedisore që ofrojnë mbështetje për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, në mënyrë të veçantë për përdorimin e qëndrueshëm të tokës dhe praktikimin e bujqësisë me vlerë të lartë natyrale (VLN). Një angazhim për të mbështetur VLN bujqësinë do të përmirësojë theksimin e eksternaliteteve pozitive dhe shërbimeve mjedisore që rrjedhin prej praktikave bujqësore.

Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet ZMPF. Pasi shumica e fermave (94 %) janë shumë të vogla - deri në 4 ha - duhet të gjenden mënyra për t'u marrë me zhvillimin e këtyre fermave. Për të forcuar prodhimin dhe tregtimin e fermerëve të vegjël në Kosovë*, duhet mbështetur krijimi i organizatave të prodhuesve të bazuar në idenë e BE-së e një organizate të vetme të tregut të përbashkët do të ishte masa më e rëndësishme për sektorin e frutave dhe perimeve. Duke marrë në konsideratë shumëllojshmërinë e prodhimit dhe luhatjen të çmimeve, Kosova* duhet të ndërrmarrë mekanizma për parandalimin dhe menaxhimin e rrezikut duke subvencionuar primet e sigurimit.

Kosova* duhet të rivlerësojë politikën e saj aktuale në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare, si një hap për përafrim me politikën e BE-së. Me Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit (MSA) Kosova* po hyn në një fazë të re të procesit të integrimit. Prandaj, duhen bërë më shumë përpjekje për të përmirësuar koordinimin ndër-ministror dhe brenda-ministror, si dhe forcimin e burimeve njerëzore në drejtim të kurseve dhe trajnimeve individuale afatgjatë mbi gjuhën dhe aftësive negociuese, si dhe tematika që mbulojnë cështjet e BE-së, duke përfshirë PPB,.

4.6 Forcat dhe dobësitë e bujqësisë

Tabela 4.7 tregon forcat dhe dobësitë të sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale në Kosovë*.

Tabela 4.7. Kosova*: Fuqitë dhe dobësitë e sektorit bujqësor dhe të zonave rurale

Fuqitë	Dobësitë
- Kushtet e mira klimatike dhe toka pjellore, sidomos për perime dhe frutat në rritje - Shtimi i prodhimi bujqësor për shkak të rritjes së interesit në prodhimin bujqësor dhe mbështetjen e dhënë për sektorin në aspektin e pagesave direkte dhe granteve - Zonat rurale kanë potencial të madh për krah pune dhe prodhimin intensiv bujqësor të perimeve në veçanti - Mbështetje dhënë për bujqësinë nga MBPZHR-ja dhe donatorë të tjerë ka kontribuar dukshëm në futjen e teknologjive të reja të prodhimit - Përmirësimi i cilësisë dhe produktivitetit në produktet blegtorale, drithëra dhe perime - Rritja e ndërgjegjësimit të konsumit dhe kërkesa për produktet bujqësore vendase - Rritja e njohjes së qeverisë për rëndësinë e sektorit të bujqësisë dhe performancën e saj - Burimet e pasura natyrore, kushtet e mira natyrore dhe peisazhe të ndryshme - Mjedis më pak stresues dhe jetesë m shpenzimet më të ulët në zonat rurale - Gatishmëri e lartë e popullates për të përmirësuar gjendjen rurale;	- GDP më të ulët për banor - Varfëria e vazhdueshme, veçanërisht në zonat rurale - Shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht në zonat rurale - Mungesa e konsiderueshme e infrastrukturës rurale, në mënyrë të veçantë të furnizimit me ujë, menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin e mbeturinave - Shërbime të dobëta publike në zonat rurale (kujdesi shëndetësor, transport dhe kopshte) - Çmimet e larta në tregun e tokës - Mungesa e bashkëpunimit mes fermerëve, institucioneve publike, sektorit privat dhe publik - Kufizimet financiare për ndërmarrjen e investimeve në fermë - Makineri dhe pajisje teknike të vjetruara - Fermerët konservativë dhe hezitues për të aplikuar teknologji të re - Niveli i ulët arsimor i fermerëve (shumica vetem me arsimin fillor) - Subvencionet shumë te ulëta në krahasim me vendet e tjera të rajonit - Mungesa e një sistemi të përshtatshëm të kreditimit rural që ofron kredi për fermerët në kushte të mira, me periudha më të gjata dhe normat e ulëta të interesit - Pasiguri në pronësinë e tokës, të drejtat e tokës të paqarta - Progres i pamjaftushëm përmes programit për konsolidimin e tokës - Fermat e vogla dhe toka të fragmentuara cojnë në produktivitet të ulët - Mungesa e hapësirave të ruajtjes - Kapaciteti i ulët të përpunimit - Nuk ka kontrata afatgjata midis fermerëve dhe përpunuesve;

5. IRJ Maqedonia: përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore

Dragi Dimitrievski, Ana Kotevska, Ivana Janeska Stamenkovska, Emelj Tuna, Marina Nacka

Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit, Universiteti i St. Cyril dhe Methodius i Shkupit

5.1 Zhvillimi ekonomik

IRJ e Maqedonisë është një vend pa dalje në det në Evropën juglindore me një sipërfaqe prej 25,713 km2 dhe një popullsi prej rreth 2 milionë banorë, duke rezultuar në një dendësi të popullsisë prej rreth 80 banorë për km2. Gjatë 10 viteve të fundit, performanca e përgjithshme ekonomike e IRJ të Maqedonisë tregon rritje; PBB ishte 8.5 miliardë euro në vitin 2014, që është 70% më i lartë se në vitin 2005. Paraqitur për banor në SFB, PBB u rrit me 38% nga viti 2005 deri në 2013 (Tabela 5.1).

Tabela 5.1. IRJ Maqedonia: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014

	2005	2014
Popullsia (milion)	2.04	2.07
Dendësia e popullsisë (banorë / km2)	79.2	80.5
PBB (milion Euro)	5,032	8,534
PBB/për frymë, SFB (EURO)	6,900	9,500[a]
Rritja reale e PBB-së (%)	4.7	3.8
Shkalla e papunësisë (%)	33.8[b]	28.0
Bilanci tregtar (milion Euro)	–961	–1,762
Tregtia e jashtme si % e PBB-së	84.5	107.9

Burimi: Baza e të dhënave e Statistikave Bujqësore - IRJ e Maqedonisë, 2015.
a 2013;
b 2008 (më e hershme në dispozicion sipas të njëjtës metodologji).

Figura 5.1. IRJ Maqedonia: treguesit kryesor makroekonomikë (% rritje nga viti kaluar; % e papunësisë), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave e Statistikave Bujqësore - IRJ e Maqedonisë, 2015.

Kriza ekonomike globale ka ndikuar edhe në ekonominë e IRJ të Maqedonisë. Edhe pse është zbatuar një grup i veçantë i masave fiskale dhe monetare për ruajtjen e stabilitetit makroekonomikë, kriza ekonomike ka rezultuar në një rënie të vogël në PBB (–0.4 % në 2009 dhe -0.5 % në 2012). Treguesit makroekonomikë tregojnë një rimëkëmbje të ekonomisë së IRJ të Maqedonisë në vitin 2013, me një rritje të PBB-së reale prej 2.7%, e pasuar nga 3.8% në vitin 2014. Figura 5.1 tregon normën e inflacionit në periudhën 2005-2014. Inflacioni arriti normat nga 0.8% në vitin 2009 në 8.3% në vitin 2008.

Shkalla e lartë e papunësisë pengon zhvillimin e ekonomisë së IRJ të Maqedonisë dhe konsiderohet si një nga faktorët vendimtarë për shkallën e lartë të varfërisë. Shkalla e papunësisë tregon një rënie të ngadaltë me kalimin e viteve, dhe në vitin 2014 ishte 28% (Tabela 5.1). Bilanci negativ tregtar po bëhet gjithnjë e më i dukshëm me kalimin e viteve. Në vitin 2014 ai arriti në një deficit prej 1.762 milionë Euro. Tregtia e jashtme si pjesë e PBB-së tregon një rritje, që do të thotë se vendi është bërë ekonomikisht shumë më i ndjeshëm ndaj tregtisë globale.

5.2 Zhvillimi bujqësor

Bujqësia ndikon ndjeshëm në ekonominë e IRJ të Maqedonisë, duke kontribuar me rreth 11% në total të VBSH-së dhe duke siguruar punësim për rreth 19% të popullsisë (Tabela 5.2). Prodhimi bujqësor bruto (PBBQ) arriti në 1.385 milionë Euro në vitin 2013, që tregon një rritje prej 22% që nga viti 2005.

Tabela 5.2. IRJ Maqedonia: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014

	2005	2014
% e VBSH-së	11.3	10.2
% e punësimit	19.5	18.5
Eksportet agro-ushqimore (% e eksporteve të përgjithshme)	16.7	12.9
Importet agro-ushqimore (% e importeve të përgjithshme)	13.1	11.7
Norma e eksportit ndaj importit agroushqimor (%)	80.7	74.6

Burimi: Baza e të Dhënave e Statistikave Bujqësore - IRJ e Maqedonisë, 2015.

Figura 5.2. IRJ Maqedonia: rritja reale e çmimit të prodhimit bujqësor, 2005–2014 (2010 = 100)



Burimi: Baza e të Dhënave e Statistikave Bujqësore - IRJ e Maqedonisë, 2015.

Indekset e çmimeve të prodhimit bujqësor tregojnë një rritje të vazhdueshme gjatë 10 viteve të fundit. Ndërmjet 2005 dhe 2010, çmimet blegtorale tregojnë luhatshmëri

shumë më të larta se çmimet e kulturave bujqësore; më vonë, çmimet stabilizohen dhe tregojnë një prirje të lehtë rritëse (Figura 5.2).

Për sa i përket tregtisë, IRJ e Maqedonisë është një importues neto i produkteve agroushqimore, me një bilanc tregtar negativ të vazhdueshëm gjatë viteve 2005-2014 (Figura 5.3). Vendi është një eksportues neto vetëm për disa mallra, si disa fruta dhe perime, verë, duhan dhe qingji. Tregtia e produkteve agroushqimore tregon një prirje rritëse me kalimin e viteve; në vitin 2014 volumi tregtar ishte dyfishi i asaj të vitit 2005. Liberalizimi, veçanërisht në sektorin agroushqimor, ka rezultuar në importe më të larta se eksportet, duke thelluar kështu bilancin negativ tregtar. Deficiti tregtar arriti nivelin më të lartë në vitin 2012, në rreth 202 milionë Euro, me një rënie në vitet në vazhdim dhe një deficit prej 163,4 milionë Euro në vitin 2014 (Figura 5.3).

Figura 5.3. IRJ Maqedonia: tregtia agro-ushqimore (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të Dhënave e Statistikave Bujqësore - IRJ e Maqedonisë, 2015.

Produktet agro-ushqimore kanë përbërë 12.9% të eksporteve të përgjithshme në vitin 2014, ndërsa ato ishin 11.7% të importeve të përgjithshme. Vlera e eksportit të produkteve agro-ushqimore ishte 479,6 milionë euro në vitin 2014, një rritje prej 75% nga viti 2005. Bazuar mbi vlerën e përgjithshme të eksportit, grupet më të rëndësishme tarifore në vitin 2013 dhe 2014 ishin duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit (25%), Pijet, alkoolet dhe uthulla (13%) dhe perime të freskëta, bimët, rrënjët dhe zhardhokët (13%). Duhani, vera dhe perimet janë produktet më të rëndësishme agro-ushqimore që eksportohen. Vlera e importit të produkteve agro-ushqimore ishte 643,0 milionë euro në vitin 2014, një rritje prej 89% krahasuar me vitin 2005. Grupi më i rëndësishëm tarifor i importit në vitin 2013 dhe 2014 ishte mishi dhe pjesë të brendshmeve të ngrënshme të mishit (16% e produkteve agro-ushqimore të importuara).

Sipërfaqja bujqësore, rreth 1,263 milion ha, mbulon pothuajse gjysmën e sipërfaqes së përgjithshme të tokës; 32.7% e tokës bujqësore është e punueshme dhe 64.2% është kullotë e përhershme. Edhe pse pjesa më e madhe është kullotë, prodhimi bimor ka karakterizuar bujqësinë e IRJ të Maqedonisë, duke kontribuar në 76% të prodhimit të përgjithshëm bujqësor (Tabela 5.3).

Prodhimi blegtoral mbetet përgjithësisht jo konkurrues, sepse nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për prodhimin e ushqimit të kafshëve dhe fermerët janë të varur në ushqimin e importuar (MBPEU 2015). Varietet e jo të favorshme dhe struktura e kultivimit rezulton në rendimentet e ulëta. Për shembull, mesatarja e rendimenteve të

grurit dhe qumështit në vitin 2014 ishte 3.75 t/ha dhe 3.14 t/krerë, respektivisht, dhe ishin përkatësisht 22% dhe 35% më e lartë se në vitin 2005.

Bujqësia e IRFJ të Maqedonisë karakterizohet me një strukturë e dyfishtë, e dominuar nga fermat e vogla me një nivel të lartë të fragmentimit të tokës. Madhësia mesatare e SBSh-së për fermë është shumë e ulët (1.9 ha), dhe pothuajse 60% e fermave operojnë me më pak se 1 ha tokë. Ferma mesatare ka 2.14 njësi standarte blegtorale (NJSB), dhe 24.6% të numrit të përgjithshëm të ekonomive familjare kanë më pak se një njësi standarte blegtorale. Prodhimi standart (PS) per fermë është 4.825 Euro, ndërsa gjysma e fermave kanë një PS më pak se 2,000 euro. Kjo është për shkak se fermat individuale bujqësore prodhojnë 86.9 % të PS të përgjithshëm.

Tabela 5.3. IRJ Maqedonia: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2014

	2005	2014
SB (000 ha)	1,199	1,263
% tokë e punueshme në SB	37.4	32.7
% kulturave bimore në prodhimin e përgjithshëm bujqësor	78.5	76.1[a]
Rendimenti mesatar i grurit (t/ha)	3.07	3.75
Rendimenti mesatar i qumështit (t /lopë mjelëse)	2.31	3.14

Burimi: Baza e të dhënave e Statistikave Bujqësore - IRJ e Maqedonisë, 2015.
a 2013.
SB, sipërfaqe bujqësore.

Kapacitetet e tokës dhe burimeve të tjera natyrore nuk janë shfrytëzuar plotësisht. Bujqësia e IRJ të Maqedonisë përballet me shumë dobësi të tjera që pengojnë zhvillimin e saj, të tilla si pajisje dhe teknologji të vjetruara, niveli i ulët i produktivitetit dhe mungesa produkteve bujqësore me vlerë të shtuar e. Përveç kësaj, ka një mungesë të punës sezonale, plakje dhe emigrimi i popullsisë rurale, si dhe niveli të ulët i arsimor dhe menaxhim të dobët të aftësive në përbërjen e popullatës rurale. Për më tepër, mungesa e kapitalit vetjak dhe e aksesit në burime financiare, niveli i dobët i integrimit të sektorit agroushqimor, si dhe niveli i ulët i integrimit të kapacitetit kërkimor në zhvillimin e bujqësisë kufizon zhvillimin e sektorit.

Tabela 5.4. IRJ e Maqedonisë: treguesit kryesor të strukturës së fermave, 2013

	2013
SBSH për fermë (ha)	1.85
Fermat me SBSH < 1 ha (% e totalit)	58.2
NJSB për fermë	2.14
Fermat me NJSB < 1 (% e totalit)	24.6
PS për fermë (EURO)	4,825
Fermat me PS < EUR) 2,000 (% e totalit)	58.2

Burimi: Baza e të dhënave e Statistikave Bujqësore - IRJ e Maqedonisë, 2015.

Tabela 5.5 paraqet zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore. Kapacitetet e prodhimit bimor janë përgjithësisht të qëndrueshme, me përjashtim të zonës së mbjellë me drithëra, e cila ka patur prirje rënëse.

Në terma të vëllimeve të prodhimit, një rritje e konsiderueshme paraqitet në prodhimin e perimeve, ndërsa prodhimi i rrushit tregon një rënie.

Prodhimi blegtoral tregon një rritje të prodhimit, veçanërisht vihet re një rritje në prodhimin e derrave. Edhe pse ka një rënie të konsiderueshme në madhësi të tufave me të leshta dhe shpendë, rezultatet e tyre të prodhimit janë rritur.

Për sa i përket tregtisë, importet janë rritur shumë më tepër se eksportet për pothuajse të gjitha grupet tarifore (veçanërisht për mish dhe pjesët e brendshme të ngrënshme të mishit, prodhimin e qumështit, vezët, mjalti natyral; yndyrna shtazore apo bimore dhe vajra; dhe nënprodukte të ndryshme të ngrënshme).

Vetëm disa grupe tarifore tregojnë rritje më të mëdha në eksporte se në importe.

Tabela 5.5. IRJ e Maqedonisë: zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore

	Tradicionalisht, vendi është	Që nga viti 2005, prodhimi	Ndryshimet në çmim, prodhim dhe tregti, viti 2014 në krahasim me vitin 2005
Drithëra	Importues neto	Nuk ka prirje të konsiderueshme	- Çmimi: është rritur, sidomos për misrin - Prodhimi: rënie e lehtë (edhe pse ka një rënie të sipërfaqeve me drithëra) - Tregtia: Rritja në importet dhe eksportet e drithërave, dhe më shumë në mënyrë të ndjeshme në eksportet e nënprodukteve nga drithërat
Sheqer	Importues neto	Ka rënë	- Prodhimi: pas vitit 2008, nuk ka patur prodhim të panxharit të sheqerit, për shkak të çmimeve të ulëta të prodhimit dhe rritjes së importeve të sheqerit të papërpunuar - Tregtia: importet janë rritur vazhdimisht me kalimin e viteve deri në vitin 2014, kur importet ranë me 13% nga viti 2013
Farëra vajore, vajra dhe yndyrna	Importues neto	Ka rënë	- Çmimi: është rritur - Prodhimi: ka rënë; prodhimi tashmë shumë i ulët i luledielli (për shkak të çmimit të ulët në tregun botëror dhe rritjes së importeve të vajit të papërpunuar të luledielli) - Tregtia: janë rritur në mënyrë të vazhdueshme importet (8.8 milionë euro në vitin 2005; 17.8 milion euro në vitin 2014) dhe eksportet (1,8 milion euro në vitin 2005; 4.2 milion euro në vitin 2014)
Fruta dhe perime	Eksportues neto	Është rritur	- Çmimi: është rritur, sidomos për disa fruta (kajsi, pjeshkë, rrush) - Prodhimi: është rritur; rritje e lehtë në prodhimin e frutave (14%) dhe më shumë në prodhimin e perimeve (40%) - Tregtia: rritja e importeve të perimeve, frutave dhe arroreve; rritje e vazhdueshme në eksportet e frutave, perimeve dhe nënprodukteve të tyre (rënie e lehtë në eksportin e frutave në vitin 2014, -11%)
Verë	Eksportues neto	Ka rënë	- Çmimi: është rritur çmimi i rrushit të verës - Prodhimi: ulje e lehtë në sipërfaqe, por më shumë rënie në prodhim (-26%); rritja e prodhimit të verës së ambalazhuar në shishe[a] - Tregtia: janë rritur eksportet[a]
Patate	I vetëmjaftueshëm	Nuk ka prirje të konsiderueshme	- Çmimi: është rritur - Prodhimi: i qëndrueshëm
Duhani	Eksportues neto	Nuk ka prirje të konsiderueshme	- Prodhimi: i qëndrueshëm - Tregtia: rritje e vazhdueshme në importe dhe eksporte deri në vitin 2013; rënie prej 20% dhe 10% (respektivisht) në vitin 2014, krahasuar me 2013

Mish lope dhe viçi	Importues neto	Është rritur	- Çmimi: është rritur - Prodhimi: është rritur; në aspektin e sasisë, është malli kryesor blegtoral - Tregtia: importi i mishit të freskët dhe të ftohtë dhe sasive më të ulëta për industrinë e përpunimit të mishit[a]
Mish derri	I vetëmjaftueshëm	Është rritur	- Çmimi: është rritur - Prodhimi: është rritur - Tregtia: importet e mishit të ftohtë dhe të ngrirë të derrit për industrinë e përpunimit të mishit[a]
Mish dele dhe dhie	Eksportues neto	Është rritur	- Çmimi: rritje të lehtë - Prodhimi: rritje të konsiderueshme në mishin e qingjit - Tregtia: eksportues neto i qingjit, rënie e lehtë e eksportit
Mish shpendësh	Importues neto	Është rritur	- Çmimi: ka rënë - Prodhimi: rritja e prodhimit, por ai mbulon vetëm 20% të kërkesës së brendshme[a] - Tregtia: është importuar si mish i ngrirë[a]
Qumështi dhe produktet e qumështit	Importues neto	Është rritur	- Çmimi: është rritur - Prodhimi: është rritur prodhimi i qumështit dhe produkteve të qumështit[a] - Tregtia: është rritur vazhdimisht importi i qumështit dhe produkteve të qumështit

Burimi: Baza e të Dhënave e Statistikave Bujqësore - IRJ e Maqedonisë, 2015; a, MBPEU (2014).

5.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

Zhvillimi i politikave bujqësore karakterizohet me përshtatjet ndaj PPB-ve të BE-së. Procesi i integrimit në BE ka sjellë ndryshime pozitive në legjislacion dhe kapacitetet institucionale. Objektivat PPB-së janë adaptuar dhe relfektuar në objektivat e politikave kombëtare bujqësore dhe strategjisë për bujqësinë dhe zhvillim rural. Përveç krijimit sistematik të politikës nëpërmjet një grupi ligjesh, strategjish, programesh dhe planesh afatgjata, ka një rritje të buxhetit për bujqësinë për të arritur objektivat e përcaktuara në to. Megjithatë, ekziston nevoja për përshtatje të caktuara të disa masave të politikave. Përshtatja e politikave kombëtare me politikat Evropiane do të vazhdojë deri në pajtueshmërinë e tyre të plotë dhe anëtarësim të plotë në BE. Dinamika dhe shtritja e këtij procesi të përshtatjes në masë të madhe varet nga progresi në procesin e anëtarësimit dhe fillimin e negociatave për anëtarësim (MBPEU 2014).

Në mesin e kapaciteteve institucionale, institucionet e sapoformuara, të tilla si Agjencia për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvilimit Rural dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, kanë sisteme të fuqishme organizative, përderisa të tjerat, të tilla si Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) dhe Agjencia Kombëtare e Ekstensionit, kanë përmirësuar kapacitetet e tyre përgjatë procesit të përshtatjes. Pavarësisht nga çdo gjë, sfida e tyre kryesore mbetet zbatimi i qëndrueshëm i legjislacionit dhe amendimeve të tij për shkak të ndryshimeve në PPB, dhe presionit të fortë nga aktorët vendorë.

Përshtatja e politikave bujqësore me modelin PPB ka filluar më intensivisht pasi IRJ e Maqedonisë mori statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, në vitin 2005. Ndryshimet e para më serioze sistematike dhe strukturore në këtë drejtim kanë ndodhur në vitin 2007 kur janë miratuar Ligji i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (LBZHR), Strategjia Kombëtare Bujqësore dhe e Zhvillimit Rural (SKBZHR 2007-2013) dhe Programi IPARD. Harmonizimi i politikave kombëtare bujqësore ka vazhduar, dhe LBZHR i tanishëm (nga viti 2010), i cili shërben si kornizë ligjore për politikën bujqësore të vendit, është akoma më shumë në përputhje me parimet e BE-së. SKBZHR më e fundit (2014–2020) përkufizon objektivat e reja specifike, duke u përpjekur të ndjekë nevojat e sektorit: (i) ristrukturimi dhe modernizimi i sektorit agroushqimor; (ii) rregullimi i tregut, organizimi i zinxjirit të ushqimit dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve bujqësore; (iii) përmirësimi i

kushteve të jetesës për aktivitetet ekonomike në zonat rurale; (iv) aksesi i vazhdueshëm në njohuri dhe investimi në kapitalin njerëzor për bujqësi; (v) krijimi i sistemit tërësisht funksional të sigurisë së ushqimit; dhe (vi) menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore si dhe zbutja e efekteve të ndryshimit klimatik (MBPEU 2014). Përveç kësaj, janë miratuar shumë dokumente zbatuese, të tilla si programet vjetore dhe shumëvjeçare për mbështetjen financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural nga buxheti kombëtar dhe nga fondet e IPARD-it (2007–2013).

Aspektet kryesore të përshtatjes së mëtjeshme me PPB janë identifikuar në SKBZHR 2014–2020: "ndarja" graduale e pagesave direkte; duke i rritur masat e zhvillimit rural; zgjerimi i masave agro-ekologjike dhe ndër-pajtueshmërisë; mbështetja e fermerëve të rinj; mbështetja e fermave të vogla familjare; themelimi i kooperativave; integrimi vertikal; prezantimi i bordeve drejtuese të tregut; standartet minimale të cilësisë; zbutja e ndikimit të ndryshimeve klimatike; menaxhimi i mbeturinave; dhe përmirësimi i efikasitetit të energjisë (MBPEU 2014).

5.3.1 Transfertat buxhetore për bujqësinë

Mbështetja buxhetore për bujqësinë nga buxheti kombëtar është rritur ndjeshëm (Figura 5.4); transfertat buxhetore në vitin 2014 (128.7 milion euro) janë më shumë se dyfishuar në krahasim me vitin 2008 (52.7 milion euro). Instrumentat kryesore të politikës bujqësore janë pagesat direkte. Masat e Zhvillimit Rural dhe mbështetja e përgjithshme për bujqësinë marrin nje pjesë relativisht të vogël të buxhetit bujqësor. Rregulloret, mbështetja për tregjet bujqësore dhe ndihma shtetërore janë vënë në zbatim vetëm për raste urgjente.

Pagesat direkte shpërndahen për njësi të produktit bujqësor dhe për sipërfaqe të tokës bujqësore apo për krerë të blegtorisë. Ato kushtëzohen me masat e ndër-pajtueshmërisë (të cilat gradualisht janë duke u zbatuar në pajtim me rregulloren e PPB) për të siguruar prodhimin e ushqimit të sigurtë dhe të shëndetshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Gjatë zbatimit, pagesat direkte kanë qenë forma kryesore e mbështetjes gjatë tërë periudhës. Në vitet e fundit, pagesat direkte janë zhvendosur nga pagesat për prodhim në pagesën për kapacitet prodhues. Sektorët kryesorë që janë mbështetur sipas prodhimit janë duhani dhe qumështi, ndërsa prodhimi i rrushit është mbështetur në bazë të sipërfaqes dhe prodhimtaria i të leshtave mbështetet për krerë (shih Tabelën 5.6). Duke marrë parasysh madhësinë e vogël të strukturës së fermës të IRJ të Maqedonisë, pagesa varion në varësi të madhësisë së fermës. Në anën tjetër, fermat shumë të vogla (më pak se 0.2 ha ose 0.3 ha, në varësi të sektorit përkatës) përjashtohen nga lista e përfituesve legjitim(të pranueshëm).

Figura 5.4. IRJ e Maqedonisë: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë (milion EUR), 2008–2014



Burimi: Baza e të dhënave e MPB-ve – IRJ e Maqedonisë, 2015.

Politika e zhvillimit rural ka katër fusha prioritare dhe katër instrumenta për t'i mbështetur ato: konkurrueshmëria bujqësore, mbrojtja agro-mjedisore, ekonomia rurale dhe zhvillimi lokal. Në mesin e tyre, rritja e konkurrueshmërisë, qoftë me investimet në ferma apo me mbështetjen për ristrukturimin e sektorit agro-ushqimor, ka tërhequr më së shumti interes nga fermerët. Gjatë vitit 2013 dhe 2014 ka pasur një rritje të ndjeshme në mbështetjen për zonat rurale dhe popullsinë banuese, në aspektin e mbështetjes së infrastrukturës bazë, shërbimeve dhe ripërtëritjen e fshatit. Mbështetja agro-mjedisore dhe mbështetja e ZMPF-ve mbesin me interes të vogël për prodhuesit bujqësor, që përbëjnë vetëm 5 % të buxhetit për zhvillim rural.

Buxheti për mbështetjen e përgjithshme në bujqësi ishte i qëndrueshëe përsa i përket vlerave absolute gjatë viteve të marra në studim, dhe nuk shoqëron trendin rritës që ka karakteriyuar buxhetin e përgjithshëm bujqësor. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shkon për veterinarinë dhe kontrollin e cilësisë së ushqimit, ndërsa transferimi i njohurive është shumë më pak i përfaqësuar. Në vitin 2014, ka pasur një rritje dramatike në mbështetjen për asistencë teknike për të promovuar programin.

Disa studime dhe raporte vënë në dukje rolin pozitiv të agjensisë kombëtare të ekstensionit në ofrimin e informacioneve rreth programeve mbështetëse dhe masave, si dhe në ndihmën për fermerët në procesin e aplikimit (Kotevska dhe Martinovska Stojceska 2015, Pringle et al. 2014). Duke pasur parasysh rolin në këtë proces, duhet të merret në konsideratë rritja e buxhetit të agjensisë kombëtare të ekstensionit. Këtu, duhet marrë parasysh se buxheti aktual i shpenzuar në agjencinë kombëtare të ekstensionit nuk është i mjaftueshëm për të kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në procesin e modernizimit të bujqësisë.

Tabela 5.6 jep një pasqyrë më të detajuar të ndryshimeve në vitin më të fundit (2014) nga viti i mëparshëm që zbërthen shpenzimet buxhetore në detaje (2008).

Tabela 5.6. IRJ e Maqedonisë: masat dhe instrumentet kryesore të politikave bujqësore, 2008 dhe 2014

	Zbatimi	Që nga viti 2008, mbështetja	Ndryshimet e konsiderueshme
Masat e mbështetjes së tregut	Nuk janë zbatuar		
Subvencionet për inputet variabël	Po, ndonjëherë	Ka rënë	Në vitin 2008, subvencionet e inputeve janë përdorur për të rimbursuar shpenzimet e karburantit në prodhimin bimor. Në vitin 2014, buxheti për subvencionet e inputeve ishte më pak se një e katërta e shpenzimeve në vitin 2008 dhe kishte si qëllim blerjen e kafshëve për mbarështim dhe shërbimet jashtë fermës
Pagesat direkte bazuar në produktin	Po, rregullisht	Është rritur	Shumica e kësaj forme të mbështetjes është dhënë për duhan: 79% në vitin 2014, që është dyfishi nga shuma në vitin 2008. Pjesa e dytë më e lartë shkon për qumësht: 16% në vitin 2014, që është një rënie e lehtë nga viti 2008. Pagesat direkte për rrush (23% në vitin 2008) janë zhvendosur në pagesat sipas sipërfaqes. Sektorët tjerë me mbështetje në rritje janë perime të freskëta dhe farërat
Pagesat direkte bazuar në sipërfaqe/nr. kreresh	Po, rregullisht	Është rritur	Krahasuar me vitin 2008, alkimi i mbështetjes në sektorin e vreshtarisë është rritur në mënyrë dramatike (në 12.9 milion euro). Sektori i të leshtave tregon katër herë më shumë mbështetje, duke arritur në 12.7 milion euro në vitin 2014. Sektori i gjedhit, i cili ka qenë shumë pak i mbështetur, përfiton subvencione prej 6.8 milion euro. Sektorët tjerë po ashtu tregojnë disa rritje në transfertat e buxhetit, por këto nuk janë shumë të konsiderueshme sepse nivelet e përgjitshme janë më të ulëta se sa për të tjerat
Pagesat direkte të ndara nga prodhimi	Nuk janë zbatuar		
Mbështetja e investimeve në fermë	Po, rregullisht	Nuk ka trend të ndjeshëm	Në vlerat absolute, mbështetja e investimit në ferma nuk tregon ndryshim të konsiderueshëm; ajo arrin në nivel të 3 milion eurove. Kjo është në rënie, si përqindje e mbështetjes së zhvillimit rural, nga rreth 80 % në vitin 2008 në rreth 50 % në vitin 2014
Mbështetja e industrisë së ushqimit	Po, rregullisht	Ka rënë	Mbështetja për industrinë e përpunimit të ushqimit ishte më e ulët në vitin 2014 (0.2 milion euro) se në vitin 2008 (0.7 milion euro)
Pagesat lidhur me mjedisin	Po, rregullisht	Ka rënë	Buxheti për pagesat lidhur me mjedisin janë ulur nga 3.6 milion euro në vitin 2008 në 0.8 milion euro në vitin 2014. Në vitin 2008, 90 % e atyre pagesave ishin për mbështetjen e ZMPF-ve, për derisa në vitin 2014 kjo mbështetje ishte vetëm rreth 40 %. Masat agro-mjedisore nuk tregojnë ndryshimet e konsiderueshme në vlerat absolute (rreth 0.5 milion euro)
Mbështetja e zonës rurale	Po, rregullisht	Është rritur	Mbështetja e zonave rurale nuk është zbatuar në vitin 2008. Në vitin 2014, ky zë i buxhetit sillej në vlerat 8.5 milion euro, i shpenzuar në infrastrukturën bazë, ripërtëritjen e fshatit, mirëmbajtjen e veçorive tradicionale, turizmit rural dhe energjisë së ripërtëritshme
Masat e mbështetjes së përgjithshme	Po, rregullisht	Nuk ka trend të ndjeshëm	Përqindja më e madhe e shpenzimeve për mbështetjen e përgjithshme lidhen me kontrollin e cilësisë veterinare dhe të ushqimit, duke rënë lehtas në vitin 2014 në krahasim me vitin 2008. Shpenzimi për këshillim ka patur ecuri të ngjashme, megjithëse ka rritje të përdorimit të fondeve për asistencë teknike

Burimi: Baza e të dhënave e MPB-ve – IRJ e Maqedonisë, 2015.

Shënim: Zbatimi i programit vjetor shtrihet në disa vite pasuese, prandaj transfertat e buxhetit janë paraqitur sipas shpenzimeve në vitin aktual.

5.3.2 Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimit për Zhvillim Rural

IPARD është një burim shtesë i fondeve për zhvillimin rural. Buxheti total në dispozicion nga IPARD-i për periudhën 2007–2014 ishte 64.3 milion euro (prej të cilave 48.2 milion euro ishin nga fondet Evropiane). Programi IPARD fokusohet në tre masa: (i) M101,

investimet për ristrukturimin dhe modernizimin e ekonomive bujqësore; (ii) M103, investimet për ristrukturimin dhe modernizimin e përpunimit dhe marketingut të bujqësisë dhe produkteve të peshkimit; dhe (iii) M302, diversifikimi dhe zhvillimi i aktiviteteve ekonomike rurale. Në zbatimin e IPARD I, për tu theksuar është niveli i ulët i absorbimit të fondeve (vetëm 7 %). Masa M101 është përdorur më së shumti, për masën M103 interesimi ka qënë në rënie dhe nuk kishte aspak interes për masën M302. Sektori i frutave ka qenë përfituesi kryesor, si për prodhimin primar ashtu edhe për atë sekondar.

Lidhur me nivelin e ulët të absorbimit të fondeve, vlerësimi i programit IPARD (Pringle et al. 2014) ka zbuluar disa nga çështjet që e pengojnë këtë proces. Procedura është vlerësuar si e karakterizuar nga kosto shumë të larta dhe si një procedurë që merr kohë për të përgatitur dokumentat e shumta të nevojshme (që vlerësohet të jetë 81.7 faqe mesatarisht), veçanërisht për të marrë certifikatat dhe tre ofertat nga furnizuesit. Aksesi në mjete financiare është një problem tjetër që ka nevojë për më shumë vëmendje. Edhe pse shumica e investimeve janë bashkëfinancuar me kreditë e bankës, vetëm dy banka ofrojnë kredi me afate më të favorshme dhe më pak se gjysma e aplikantëve janë të vetëdijshëm se cila bankë e ofron këtë. Përveç kësaj, vetëm një e katërta e aplikantëve kanë qenë të informuar rreth kërkesave të ndër-pajtueshmërisë, dhe kryesisht vetëm lidhur me konsideratat për sigurinë e ushqimit dhe mjedisin.

Nga perspektiva e sotme, IPARD I ishte proces i të mësuarit. Feedback-u i marrë nga thirrjet e shpallura ka rezultuar në disa modifikime të programit për të përshtatur dhe lehtësuar procedurën. Krahas problemeve, përfituesit vërejnë ndryshime pozitive në nivel ferme, në industrinë e përpunimit dhe në sërën e konsulentëve të përfshirë në këtë proces (Pringle et al. 2014). Shumë aplikantë (80–90 %) i konsiderojnë investimet e tyre si të suksesshme për sa i përket përmbushjes së objektivit të tyre fillestar. Progresi vërehet në ndërgjegjësimin e tyre për nevojën dhe objektivin që karakterizojnë të tilla masa mbështetëse.

Akreditimi i masave shtesë nga programi IPARD II dhe krijimi i kushteve institucionale për të mbështetur investimin, ka shpresë se, do të përmirësojë absorbimin (thithjen) e fondeve të IPARD-it në periudhën e ardhshme.

5.3.3 Politikat e lidhura me çështjet e fermave

Fragmentimi (copëzimi) i lartë i tokës bujqësore është dobësi strukturore e sektorit bujqësor të IRJ të Maqedonisë që ka efekt negativ në produktivitetin e tij, efikasitetin, kostot dhe në të ardhurat nga aktiviteti bujqësor, dhe kështu edhe në konkurrueshmërinë e tij. Nevoja për konsolidimin (bashkimin e ngastrave) e tokës bujqësore si një instrument, është njohur me miratimin e strategjisë kombëtare për bashkimin e ngatsrave të tokës bujqësore për periudhën 2012–2020. Në periudhën deri në vitin 2020, synohet që të krijohen kushtet për konsolidimin e tokës dhe të zbatohen proceset e konsolidimit me vështirësitë e ndryshme që hasen në zbatim.

Duke pasur parasysh natyrën komplekse të procesit, konsolidimi planifikohet të zbatohet në faza, duke rritur gradualisht vëllimin dhe kompleksitetin e instrumenteve të politikës së aplikuar. Pas sigurimit të kushteve ligjore dhe institucionale, faza e parë planifikohet të fokusohet në projektet e thjeshta të madhësisë së vogël deri te ato të mesme për shkëmbimin vullnetar të tokës, zbatimin pilot të instrumenteve më të ndërlikuara në shkallë të vogël, si dhe ngritjen e ndërgjegjësimit midis fermerëve. Zbatimi i projekteve më të ndërlikuara në sipërfaqet më të mëdha me investime më të larta infrastrukturore planifikohet për fazën e mëvonshme. Financimi i kësaj politike planifikohet që të mbulohet nga fondet kombëtare apo Evropiane për zhvillim rural dhe, në pjesën më të madhe, konsiderohet si ndihmë shtetërore për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Për të parandaluar fragmentimin e mëtejshëm të tokës bujqësore, vazhdon të jetë veprues ndalimi ligjor për ndarjen fizike të parcelave më të vogla se 2 ha.

Procesi i konsolidimit të tokës ka filluar me projektet pilote në dy zona të konsolidimit. Procesi është ende në fazën e aktiviteteve parapërgatitëse; kështu që, nuk ka rezultate që të mund të përdorne për vlerësimin e progresit apo ndikimit.

5.4 Rekomandimet e politikave

Rekomandimi i përgjithshëm për zhvillimin e politikës bujqësore lidhet me strukturën e saj. Deri më tani, në përbërjen e mbështetjes buxhetore për bujqësinë kanë mbizotëruar pagesat direkte. Është e domosdoshme që të rriten fondet për mbështetjen e zhvillimit rural dhe mbështetjen e përgjithshme në bujqësi, dhe mënyra më pak e dëmshme do të ishte duke e rritur pjesën e tyre ndaj totalit të buxhetit.

Pagesat direkte, në formën e tyre aktuale të ndarë, nuk adresojnë siç duhet dobësitë e sektorit bujqësor ose e përdorin potencialin e tyre në mënyrë racionale. Përveç kësaj, procesi i përshtatjes së politikës bujqësore kombëtare me modelin PPB kërkon transformimin e mbështetjes në formë të pashoqëruar me kriteret dimensionale të prodhimit (decoupled). Duke e zëvendësuar në mënyrë graduale formën aktuale të mbështetjes në formë të pashoqëruar me kriteret dimensionale të prodhimit kjo do të përgatisë fermerët dhe do të shmangë shqetësimet serioze për sektorin. Një fazë e rëndësishme, e cila do të ishte e vështirë për t'u zbatuar, është anulimi i mbështetjes së lidhur me kriteret prodhimit (coupled) për sektorët që nuk mbështeten në BE, të tillë si prodhimtaria e derrave, shpendëve dhe perimeve. Ky proces duhet të ndihmohet me informacione rreth formave tjera të mbështetjes në dispozicion për ato.

Rritja e përqindjes së mbështetjes të zhvillimit rural është hap i nevojshëm për të bërë sektorin më konkurrues në tregun e përgjithshëm bujqësor. Gjendja aktuale e sektorit dhe e zonave rurale ka nevojë për përmirësim më intensiv të ekonomive bujqësore dhe të infrastrukturës rurale. Mbështetja do të adresonte më mirë disa prej dobësive të bujqësisë së IRJ të Maqedonisë, të tilla si mospërputhjen ndërmjet kapaciteteve në dispozicion dhe atyre të shfrytëzuara të prodhimit, dhe pajisjeve, teknologjisë dhe njohurive praktike të vjetruara. Investimet në ferma duhet të plotësohen me masat të tjera të zhvillimit rual për zhvillimin infrastrukturor apo përmbushjen e standarteve të cilësisë që do të rrisnin në mënyrë plotësuese konkurrueshmërinë e tyre. Mbështetja për fermerët e rinj pritet të ndryshojë moshën dhe strukturën arsimore të fermerëve, dhe rrjedhimisht të edukojë sjelljen sipërmarrëse dhe të ndryshojë strukturën gjenetike dhe të llojllojshmërisë së strukturë së prodhimit dhe nivelin e aplikimit të teknologjive të reja.

Mbështetja e përgjithshme e bujqësisë fokusohet kryesisht në sigurinë dhe cilësinë e ushqimit. Ky sistem institucional i kontrollit është një aspekt i rëndësishëm i tregut Evropian. Megjithatë, arsimi dhe ekstensioni kanë një rol me rëndësi në shpërndarjen e informacionit dhe ndihmesën e fermerëve. Fermerët e njohin rolin e ekstensionistëve, prandaj ky mjet duhet të zhvillohet dhe të zgjerohet edhe më tutje, me mbështetjen e duhur institucionale dhe financiare. Forcimi i lidhjes ndërmjet ekstensionit dhe arsimit dhe institucioneve të kërkimit për çështjet të identifikuara në mënyrë specifike do të theksonte rolin e tyre.

Sidoqoftë, aspekte të tjera janë me rëndësi për zbatimin e suksesshëm të politikave. Madhësia e vogël e fermës dhe fragmentimi i lartë i tokës pengojnë potencialin për përdorimin e ekonomive të shkallës dhe si rrjedhojë përmirësimin e produktivitetit në sektor. Një nga zgjidhjet është zbatimi i plotë i strategjisë së konsolidimit të tokës, me vlerësimin e vazhdueshëm të ndikimit dhe përmirësimet në përpjekjet për të marrë rezultatet më të mira.

Shoqatat ekonomike të fermerëve janë me rëndësi për përmirësimin e pozitës së tregut të fermerëve të vegjël. Hulumtimi i fundit tregon se krijimi i rrjeteve të fermerëve rrit gatishmërinë e tyre për të aplikuar për mbështetje të zhvillimit rural (Kotevska et al., 2015). Përveç kësaj, forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve në zinxhirin e marketingut dhe integrimi më i madh vertikal në sektor do të përmirësojë funksionimin institucional të tregut dhe në mënyrë indirekte mbështesin po ashtu zhvillimin e sektorit primar.

Një pengesë e rëndësishme për çdo aktivitet të investimit dhe për thithjen më të lartë të fondeve kombëtare dhe të IPARD-it apo të zhvillimit rural është aksesi në financë. Prandaj, ky problem meriton vëmendje të veçantë në planifikim dhe programim. Qeveria ka mundur të sigurojë përmirësimin e aksesit në burime të shumëllojshme të financave (bankë apo produkte joformale kreditore) duke krijuar mekanizma të tilla si kolateralin, fondet e garancisë dhe normat komerciale të subvencionuara të interesit, për të inkurajuar bankat që të përfshihen më shumë në kredi rurale dhe investime në zonat rurale. Mundësia tjetër është krijimi i një institucioni financiar zyrtar për mbështetjen e zhvillimit rural.

Roli i kapaciteteve analitike dhe të kërkimit nuk është shumë i njohur dhe i prezantuar nga politikëbërësit si hap i nevojshëm për analizën që bazohet në rezultatet aktuale (Ex post) dhe në parashikime (Ex ante) për masat e politikës. Në këtë kontekst, është shumë me rëndësi që të forcohen lidhjet ndërmjet plitikëbërësve dhe komunitetit të hulumtuesve, specifikisht në analizën e politikave bujqësore. Në vend të analizimit herë pas here përpara përgatitjes së disa dokumenteve strategjike dhe programeve afatshkurtra, kryerja e vlerësimit të vazhdueshëm të ndikimit në bazë të një metodologjie të mirë-krijuar mund të sjellë rregullime të bazuara në dëshmi apo fakte. Një qasje e tillë do të përmirësonte po ashtu kapacitetetet analitike të institucioneve politikëbërëse.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, është se vendimmarrësit e politikave duhet të krijojnë korniza më të qëndrueshme dhe të parashikueshme të politikave the të zbatojnë atë që kanë miratuar. Ata duhet të shmangin ndryshimet e shpeshta në dokumentat strategjike dhe shumëvjeçare dhe, mbi të gjitha, në implementimin vjetor të programeve. Kjo është me rëndësi për procesin e zbatimit të programeve, por edhe për matjen e ndikimit real të tyre.

6. Mali i Zi: përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore

Aleksandra Martinovic[1], Darko Konjevic[2]

[11]Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Sigurisë Ushqimore dhe Ekologjisë, Universiteti i Donja Goricës, Podgoricë, Mali i Zi

[2]Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Zhvillimit Rural, Podgoricë, Mali i Zi

6.1 Zhvillimi ekonomik

Kur Mali i Zi shpalli zyrtarisht pavarësinë e tij në vitin 2006, ai ishte ende nën një gjendje të tranzicionit ekonomik. Pasi Këshilli Evropian i dha statusin e vendit kandidat, Mali i Zi ka hyrë në procesin e negociatave për t'iu bashkuar Bashkimit Evropian në qershor të vitit 2012. Karakteristika kryesore e zhvillimit të Malit të Zi që prej pavarësisë së tij ka qenë ndikimi i fluksit të lartë të IHD-ve, duke rezultuar në rritjen e konsumit të brendshëm. Qeveria, rrjedhimisht, ka ndërmarrë disa masa për të liberalizuar regjimin tregtar të Malit të Zi.

Tabela 6.1. Mali i Zi: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014

	2005	2014
PBB (milion euro)	1,815	3,425
Popullsia (milion)	0.623	0.622
Sipërfaqja e tokës (km^2)	13,812	13,812
Dendësia e popullsisë (banorë/km^2)	45	45
PBB / frymë, PFB (Euro)	7,483	12,710
Tregtia e jashtme si % e PBB-së	77.8	62.7

Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Mali i Zi, 2015.
PFB, pariteti i fuqisë blerëse.

Ekonomia e Malit të Zi bazohet kryesisht në shërbime. Shumica e mallrave të konsumit importohen. Është regjistruar një deficit i madh në bilancin e tregtisë, me importet e mallrave që tejkalojnë 50% të PBB-së dhe eksportet rreth 15%.

Ka pasur luhatje të mëdha në zhvillimin e ekonomisë së vendit që nga viti 2006. Deri në vitin 2008, ka pasur një periudhë gjallërimi, me rritje të regjistruara të PBB-së prej 8.7%. Megjithatë, një rënie e regjistruar prej 5.7% në vitin 2009 ka reflektuar në një recesion të dyfishtë, dhe kriza e zonës euro (një rënie shtesë prej 2.5% në vitin 2012) bëri që ekonomia të mbetet në të njëjtën gjendje të vështirë.

6.2 Zhvillimi bujqësor

6.2.1 Roli i bujqësisë dhe burimeve

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm në Mal të Zi dhe është një burim i rëndësishëm i punësimit dhe i të ardhurave për disa nga segmentet më të rrezikuara të shoqërisë, veçanërisht në veri, në pjesën malore të vendit, ku mundësitë e tjera për punësim janë të pakta. Rreth 37% e popullsisë së Malit të Zi jetojnë në zonat rurale dhe supozohet se rreth 70% e të ardhurave të përgjithshme të kësaj popullsie janë nga

aktivitetet bujqësore (MONSTAT 2010). Bujqësia përbën rreth 10% të PBB-së në Mal të Zi, një përqindje relativisht të lartë.

Tabela 6.2. Mali i Zi: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014

	2005	2014
% e VSHB-së	10.5	9.8[a]
% e punësimit	:	:[b]
Eksportet e produkteve agroushqimore (% e eksporteve të përgjithshme)	18.7	24.4
Importet e produkteve agroushqimore (% e importevetë përgjithshme)	19.1	27.1

Burimi: Baza e Të dhënave Statistikore Bujqësore – Mali i Zi, 2015.
a 2013.
b Sipas Zyres Statistikore të Malit të Zi (MONSTAT) të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2015, gjithsej 6.9% e të punësuarve punonin në bujqësi.
:, Nuk është në dispozicion.

Prodhimi bujqësor në Mal të Zi është shumë i larmishëm. Ai ka një numër të madh të degëve të ndryshme të bujqësisë si rezultat i kushteve të ndryshme mjedisore në rajone të ndryshme. Kështu, në rajonin bregdetar mbizotëron kultivimi i ullinjve, agrumeve dhe frutave të tjera subtropikale, në pjesën qendrore kultivohen frutat dhe perimet, dhe mbetet i konsiderueshëm prodhimi i mishit, qumështit dhe vezëve. Zonat karstike përfaqësohen nga blegtoria, kryesisht të dhirtat, ndërsa në pjesën veriore prodhimi i patates dhehortikulturës dhe dominon mbarështimi ekstensiv i gjedhit dhe të leshtave.

Sipas regjistrimit të bujqësisë të vitit 2010, toka bujqësore në Mal të Zi përbën 22.3% të sipërfaqes së përgjithshme (309.241 ha; 0.5 ha për frymë). Në Mal të Zi, një total prej 48,870 fermash bujqësore janë të regjistruara, prej të cilave 48.824 janë ferma familjare. Pjesa më e madhe e tokës bujqësore të shfrytëzuar janë livadhe dhe kullota (94.1%). SBSH e fermave familjare përbën 68.8% (212.724 ha) të sipërfaqes totale të tokës në dispozicion, me një sipërfaqe mesatare prej 4.4 ha të tokës shfrytëzuar bujqësore për fermë familjare. Ferma mesatare ka 6.3 ha tokë bujqësore në dispozicion, duke e vënë Malin e Zi më lartë vendeve fqinje në lidhje me këtë tregues.

Tabela 6.3. Mali i Zi: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2014

	2005	2014
SBSH (000 ha)	222[a]	230
Toka e punueshme si% e SBSH-së	2.5[a]	3.1
Prodhimet bujqësore si% e prodhimit të përgjithshëm bujqësor	:	:
Rendimenti mesatar i grurit (t/ha)	2.4[a]	2.9
Rendimenti mesatar i qumështit (t/lopë mjelëse)	2.403	2.908
Norma e eksportit ndaj importit tëprodukteve agroushqimore (%)	34.6	19.0

Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Mali i Zi, 2015.
a 2007.
:,nuk është në dispozicion.

Janë një sërë faktorësh që ndikojnë në strukturën dhe vëllimin e prodhimit bujqësor. Problemet që e bëjnë bujqësinë e Malit të Zi relativisht jo konkurruese janë; fermat e fragmentuara, vëllime të ulëta të prodhimit bujqësor, sektori i pazhvilluar i përpunimit, mungesa e një force punëtore të kualifikuar, struktura e pafavorshme moshore e fermerëve, niveli i ulët i përdorimit të teknologjive moderne të prodhimit, infrastruktura e pazhvilluar rurale dhe e përgjithshme, kostoja relativisht e lartë e inputeve (duke përfshirë ushqimin, i cili importohet kryesisht), dhe mungesa e kapaciteteve blerëse dhe të magazinimit.

6.2.2 Ndryshimet në tregtinë dhe prodhimin e agro-ushqimeve

Mali i Zi u bë anëtari i 154 i OBT-së në prill të vitit 2012. Që kur u bë anëtar i OBT-së, Mali i Zi ka patur një regjim mjaft të liberalizuar të eksport-importit. Mali i Zi ka ratifikuar Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) në vitin 2007, dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë (MTL-të) me Shoqatën e Tregtisë së Lirë të vendeve Evropiane (AETL) në vitin 2012, Federatën Ruse në vitin 2000, Ukrainën në vitin 2011 dhe Turqinë në vitin 2008, si dhe MSA-në me BE-në në bazë të marrëveshjes së përkohshme për tregtinë dhe çështjet e lidhura me tregtinë në vitin 2008.

Mali i Zi është një importues neto i produkteve bujqësore dhe ushqimore, duke u ballafaquar me një deficit tregtar. Megjithëse deficiti ka rënë gjatë viteve të fundit, ekziston ende një shkallë relativisht e ulët e mbulimit të importeve me eksporte.

Figura 6.1. Mali i Zi: tregtia e produkteve agroushqimore (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Mali i Zi, 2015.

Në vitin 2014, prodhimet bujqësore përbënin 29.4% të eksporteve të përgjithshme dhe 27.1% të importeve të përgjithshme. Mbulimi i importeve të produkteve agroushqimore me eksporte arriti në 20.55%, 6.8 pikë përqindje më e lartë se në vitin 2013 (MBZHR 2015a).

Partnerët kryesorë tregtarë të Malit të Zi vazhduan të jenë vendet e CEFTA-s dhe BE. Serbia ende është partneri më i rëndësishëm në tregtinë e përgjithshme, me 42% (203.5 milioneuro) të importeve dhe 17% (16.9 milion euro) të eksporteve.

Për vite me rradhë tregtia e jashtme ka qenë e dominuar nga grupe të caktuara të produkteve. Pothuajse 50% e importeve të përgjithshme në vitin 2014 janë nga gjashtë grup produktesh. Me kalimin e viteve, mishi i freskët, i ftohtë dhe i ngrirë ka qenë përqindja më e lartë e importeve të përgjithshme. Në vitin 2014 ky grup arriti në 21.4% të totalit. Vlerat më të larta vihen re për mishin e derrit të freskët. Produktet e qumështit përbënin 8.2% të totalit të importeve të produkteve bujqësore në vitin 2014. Shumica e tyre ishin djathrat (36.4%) dhe qumështi (31.6 %) jo i koncentruar (i trajtuar në ultra-ngrohje). Drithërat dhe produktet e industrisë së blojës, si miellrat, niseshte dhe nënprodukte të tjera drithërash, përbëjnë grupin e tretë më të madh të produkteve të importuara, me një vlerë të përgjithshme prej 31.6 milion euro në vitin 2014, duke formuar 6.5% të importeve të përgjithshme.

Në mënyrë të ngjashme, disa produkte dominojnë në eksportet e përgjithshme. Këto janë kryesisht vera, produktet e mishit dhe birra. Zhvillimi i industrisë së verës dhe

industrisë së mishit ka ndikuar në rritjen e eksporteve të verës dhe produkteve të mishit. Përveç kësaj, birra dhe produktet e duhanit kanë një vend të rëndësishëm në eksporte.

Të dhënat në lidhje me strukturën e tokës së punueshme në Mal të Zi theksojnë përdorimin e pamjaftueshëm të burimeve ekzistuese dhe kufizimeve të tilla si struktura e tokës dhe fragmentimi që e bëjnë të pamundur që të zhvillohet më shpejtë prodhimi bimor. Në të njëjtën kohë, përveç këtyre kufizimeve, ka një problem në lidhje me praktikat jo adekuate bujqësore dhe varietetet e kulturave bimore, natyrën sezonale të prodhimit, etj, të cilat kombinohen për të ndikuar drejtpërdrejt në produktivitetin dhe qëndrushmërinë e ofertës.

Tabela 6.4. Mali i Zi: zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore mes viteve 2007 dhe 2014

	Tradicionalisht, vendi është	Që nga viti 2007, prodhimi	Ndryshime domethënëse
Fruta dhe perime	Importues neto	Është rritur	
Verë	Eksportues neto	Ka rënë	
Patate	Importues neto	Është rritur	
Duhani	Eksportues neto	Nuk ka trend të ndjeshëm	
Mish lope dhe viçi	Importues neto	Nuk ka trend të ndjeshëm	Vlera e mishit të importuar të lopës në vitin 2014 ishte 12.1 milion euro. Mishi i lopës importohet nga Holanda, Austria dhe Serbia. Numri i gjethit ka rënë me 25 % ndërmjet vitit 2007 dhe 2012 dhe është rritur me 10 % në vitin 2014 në krahasim më vitin 2012
Mish derri	Importues neto	Është rritur	Në përputhje me marrëveshjet e tregtisë së lirë që Mali i Zi ka me BE-në dhe Serbinë, norma tarifore në importet e mishit të derrit të freskët është 0%. Zëvendësimi i importit për mish derri ka kuptim ekonomik duke qenë se çmimi për kilogram të mishit të derrit të freskët në Mal të Zi është nën 2,30 euro
Mish dele dhe dhie	I vetëmjaftueshëm	Nuk ka trend të ndjeshëm	Numri i deleve ka rënë me 8% ndërmjet vitit 2007 dhe 2014. Numri i dhive është rritur me 28% në të njëjtën periudhë
Mish shpendësh	Importues neto	Është rritur	Mishi i freskët i shpendëve është importuar kryesisht nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Gjermania dhe Brazili
Qumështi dhe produktet e qumështit	Importues neto	Është rritur	

6.3 Zhvillimi i politikave bujqësore

6.3.1 Korniza e politikave bujqësore

Ndryshimet fillestare në politikat bujqësore kanë filluar në fillim të këtij shekulli, duke liberalizuar përpunimin e produkteve agroushqimore nga kontrollet e çmimeve. Pas miratimit të strategjisë së bujqësisë dhe zhvillimit rural (Strategjia për Zhvillimin e Prodhimtarisë së Ushqimit dhe Zonave Rurale) në korrik të vitit 2006, Mali i Zi ka filluar një proces të futjes graduale të masave të politikave të ngjashme me ato qe aplikohen në BE. Është miratuar një program kombëtar për prodhimin e produkteve ushqimore dhe zonat rurale për 2009-2013 për zbatimin e strategjisë. Masat e qeverisë për zhvillimin dhe zbatimin e politikave bujqësore zbatohen nëpërmjet buxhetit vjetor të bujqësisë. Në qershor të vitit 2015, në kuadër të objektivit e zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale si pjesë e prioriteteve të përgjithshme të Malit të Zi për të ndjekur një politikë të anëtarësimit në BE, hyri në fuqi Strategjia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zonave Rurale 2015-2020 .

Mbështetje direkte jepet për prodhimin e kulturave bimore, qumështit dhe prodhimit blegtoral. Këto pagesa nuk janë në përputhje me rregullat e BE-së. Gjatë procesit të anëtarësimit, reformat që përqendrohen te ndarja e pagesave nga kriteret e prodhimit (decoupling) do të futen gradualisht dhe do të bazohen në të drejtat për hektar tokë të ligjshme)[18].

Politika e zhvillimit rural të Malit të Zi ishte strukturuar në përputhje me politikën e BE-së në vitet 2007-2013. Masat për forcimin e aftësisë konkurruese të prodhuesve formojnë grupin më të madh të masave (11 nga 17). Mbështetja për investime në fermat bujqësore u vendos me synim për të zbatuar programe për grante në përputhje me kërkesat e IPARD, me qëllim modernizimin e prodhimit, arritjes së standarteve në fushën e mbrojtjes së mjedisit, shëndetit të kafshëve dhe të mirëqenies, rritjes së cilësisë, higjienës dhe sigurisë ushqimore, dhe lidhjen e sektorëve të bujqësisë me atë të turizmit. Masat për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore kanë të bëjnë me ruajtjen e resurseve gjenetike në bujqësi, prodhimin organik dhe përdorimin e qëndrueshëm të kullotave malore. Ka gjithashtu masa për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale dhe për restaurimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të fshatrave dhe ndërtimin e infrastrukturës.

Mbështetja për shërbime të përgjithshme për bujqësinë është e veçuar për shërbimet me interes publik të tilla si arsimi, kërkimi, zhvillimi dhe analiza, përmirësimi i programeve të blegtorisë, programi i shërbimeve profesionale dhe këshilluese në prodhimin blegtoral, si dhe programi i masave për kontrollin e cilësisë së produkteve. Këto arrijnë në 5% të buxhetit të përgjithshëm bujqësor për vitin 2014.

Në zonat rurale të Malit të Zi, politikat specifike sociale kanë parandaluar shumë fermerë të angazhuar në bujqësi që të ushtrojnë të drejtën e tyre për pension. Prandaj, për mbajtësit e ekonomive familjare bujqësore që nuk kanë burime të tjera të të ardhurave, u është siguruar një mbështetje e veçantë përmes transfertave sociale për popullsinë rurale. Kjo lloj mbështetjeje synon të arrijë tek ekonomitë familjare rurale më në nevojë dhe në këtë mënyrë kontribuon në uljen e varfërisë në zonat rurale.

6.3.2 Transfertat buxhetore për bujqësi

Përqindja e buxhetit të përgjithshëm të Malit të Zi të ndarë për bujqësinë ka rënë nga 3% në vitin 2001 në më pak se 2% të totalit në vitin 2005 e në vazhdim. Afro 22% e buxhetit lidhet me masat e drejtpërdrejta mbështetëse (Tabela 6.5) për blegtori dhe prodhim bimor. Që nga viti 2011 masat, në kuadër të komponentit të zhvillimit rural, kanë caktuar rreth 7 milionë euro për përmirësimin e aftësisë konkurruese të prodhimit bujqësor dhe të përpunimit, si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale.

Shpërndarja e buxhetit bujqësor sipas shtyllave specifike të politikës bujqësore dhe sipas qëllimit të secilës prej shtyllave është paraqitur në figurat 6.2-6.5, duke përdorur qasjen e MPB-ve.

[18] Një përshkrim i detajuar i gjendjes aktuale dhe planit për harmonizimin me legjislacionin e BE-së është dhënë në kuadër të Planit të Veprimit për Kapitullin 11 të lëshuar nga Qeveria e Malit të Zi.

Tabela 6.5. Mali i Zi: Përbërja buxhetore për bujqësi sipas grupeve të masave (EUR 000), 2008–2015

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Masat e politikave të çmimit të tregut	**3,709**	**5,304**	**5,082**	**5,710**	**6,520**	**6,183**	**5,448**	**6,130**
Skemat e pagesave direkte	2,734	4,309	4,312	4,688	5,553	5,333	4,951	5,630
Mbështetja për bletari	40	235	230	182	182	200	147	148
Masat e stabilizimit të tregut	935	760	540	840	785	650	350	350
Masat e politikave të zhvillimit rural	**6,053**	**5,946**	**4,743**	**6,615**	**5,838**	**5,615**	**6,581**	**8,013**
Boshti 1: forcimi i aftësisë konkurruese të bujqësisë	4,222	4,241	3,210	4,070	4,090	4,815	5,631	6,980
Boshti 2: mbështetja për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore	432	625	853	929	800	340	378	440
Boshti 3: përmirësimi i cilësisë së jetës dhe diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale	1,399	1,080	680	1,616	948	460	572	593
Shërbimet e përgjithshme dhe transfertat sociale në bujqësi	**4,684**	**6,002**	**7,722**	**6,951**	**6,708**	**6,760**	**6,728**	**7,143**
Peshkimi	**18**	**315**	**1,124**	**171**	**171**	**214**	**250**	**300**
Programi veterinar dhe fitosanitar	**221**	**2,150**	**1,720**	**1,670**	**1,337**	**1,540**	**1,422**	**1,390**
GJITHSEJ	**14,685**	**19,717**	**20,391**	**21,117**	**20,574**	**20,312**	**20,429**	**22,976**

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Bazar në analizën e mbështetjes buxhetore, vihet re rritja e lehtë në financim, pak a shumë në mënyrë të barabartë e shpërndarë ndërmjet masave për mbështetjen e drejtpërdrejtë të prodhuesve dhe tregut, masave për mbështetjen e shërbimeve të përgjithshme dhe masave të zhvillimit rural (Figura 6.2), me përqindje mesatarisht më të lartë të alokuar për mbështetje drejt tregut dhe prodhuesve direkt.

Figura 6.2. Mali i Zi: përbërja e mbështetjes buxhetore për bujqësinë, 2011–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB-ve - Mali i Zi, 2015.

Pagesat direkte (Figura 6.3) lidhen kryesisht me pagesat per krerë, sipas sipërfaqes ose në bazë të sasisë së produktit, që nuk është në përputhje me masat aktuale të zbatuara nga modeli PPB. Prodhuesit nuk janë të detyruar të përmbushin kushtet e ndër-pajtueshmërisë. Gjithashtu,për menaxhimin dhe auditimin e pagesave të drejtpërdrejta, nuk vihen në zbatim sistemet e SIAK/SIPT . Pagesat për krerë kufizohen për ekonomitë

familjare me më shumë se katër lopë ose mëshqerra, më shumë se 40 dele ose më shumë se 30 dhi. Nga ana tjetër, numri mesatar i lopëve për fermë në Mal të Zi është 3.5. Kjo masë duhet të rishqyrtohet dhe pragu duhet të ulet për të dhënë një nxitje edhe për fermerët e vegjël.

Mbështetja në bazë të sasisë së produktit synon sektorin e prodhimit të qumështit, domethënë prodhuesit që shpërndajnë qumështin e tyre në baxho të regjistruara. Shumica dërrmuese e fermerëve nuk janë në gjendje të dorëzojnë qumështin që ata prodhojnë në baxho, për arsye të shumta, dhe nuk janë të pranueshëm (legjitim) për këtë mbështetje.

Figura 6.3. Mali i Zi: përbërja e pagesave direkte për prodhuesit,2011–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB-ve - Mali i Zi, 2015.

Figura 6.4 tregon shpërndarjen e fondeve strukturore dhe të zhvillimit rural. Investimet në ferma (aftësia konkurruese) mbizotërojnë dhe mbështeten kryesisht përmes projektit Zhvillimi Institucional dhe Forcimi i Bujqësisëtë Malit të Zi (ZhIFBMZ).

Figura 6.4. Mali i Zi: përbërja e masave për zhvillimin strukturore dhe rurale, 2011–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB-ve - Mali i Zi, 2015.

Masat mbështetëse të shërbimeve të përgjithshme (Figura 6.5) tregojnë përqindje në rënie të buxhetit total por transfertat sociale (15 % e buxhetit total), mbështetja operative për shërbimet veterinare dhe fitosanitare (8 %) dhe shërbimet e përgjithshme për bujqësinë (7 %) janë ende pjesë të konsiderueshme të strukturës së përgjithshme e buxhetit.

Figura 6.5. Mali i Zi: përbërja e masave mbështetëse të shërbimeve të përgjithshme, 2011–2014



Burimi: Baza e të dhënave MPB-ve - Mali i Zi, 2015.

6.4 Çështjet e fermave

Regjistrimi i bujqësisë i vitit 2010 ka evidentuar 48,870 ekonomi bujqësore, prej të cilave 46 janë biznese që kryejnë aktivitet bujqësor. Të gjithë njësitë ekonomike bujqësore së bashku zënë një sipërfaqe totale 221,298 ha të tokës bujqësore të shfrytëzuar apo mesatarisht 4.5 ha per fermë. Sipas regjistrimit, forca punëtore në bujqësi ishte 47,043 njësi pune vjetore (NjPV, që i përgjigjet punës së kryer nga një person që punon në një ekonomi bujqësore me orar të plotë për një vit). Nga totali prej 48,824 fermave familjare, 28,987 prej tyre (59.4 %) kanë më pak se 1 NjPV. 56 % e fermave familjare me PS deri në 4,000 euro kanë gjithashtu pak se 1 NjPV.

Tabela 6.6. Mali i Zi: treguesit kryesor të strukturës së fermave, 2010

	2010
SBSH per fermë (ha)	4.5
Fermat me SBSH < 1 ha (% e totalit)	55.2
NjSB për fermë me NjSB	3.6
Fermat me < 5 NJSB (% e total)	82.9
PS për fermë (Euro)	2,575
Fermat me PS < 2,000 Euro (% e totalit)	64.6

Burimi: Baza e të dhënave e Statistikave Bujqësore – Mali i Zi, 2015.

Mbarështimi i blegtorisë është një aktivitet shumë i rëndësishëm bujqësor në Malin e Zi. Regjistrimi i bujqësisë në vitin 2010 ka nxjerrë në pah 32,675 ferma bujqësore që merren me blegtori, dhe ato përbëjnë 66.9 % të numrit të përgjithshëm të fermave bujqësore në Malin e Zi. 75.4 % merren me gjedh dhe kanë mesatarisht 3.3 krerë gjedh.

6.5 Procesi i integrimit në BE

Në dhjetor të vitit 2013, Qeveria e Malit të Zi ka miratuar programin për anëtarësimin e Malit të Zi në BE, që mbulon periudhën 2014–2018. Programi i anëtarësimit përkufizon dinamikën e miratimit të *aktit komunitar* në përputhje me Bashkimin Evropian, dinamikën e forcimit të kapaciteteve administrative dhe të zhvillimit institucional. Strategjia e re për Zhvillimin e Bujqësisë dhe të Zonave Rurale 2015–2020 ka hyrë në fuqi në qershor 2015. Strategjia, së bashku me planin e veprimit për zbatimin e saj, janë parakusht për hapjen e Kapitullit 11 (bujqësia dhe zhvillimi rural) në procesin e anëtarësimit.

Strategjia e re është baza kryesore për harmonizimin e politikave kombëtare me PPB në kontekstin e procesit të integrimit në BE. Harmonizimi me standartet e BE-së do të vazhdojë paralelisht me përafrimin e kuadrit ligjor, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe aftësive të sektorit privat që të përputhen me kërkesat. Objektivat strategjike për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale për periudhën 2015-2020 janë përcaktuar si më poshtë (MBZHR 2015b):

- Zhvillimi i një sektori efektiv, inovativ dhe të qëndrueshëm agroushqimor që ofron produkte ushqimore të shëndetshme, të cilësisë së lartë, dhe të specializuara bazuar në vlerën e shtuar të burimeve natyrore dhe të metodave tradicionale të prodhimit, i cili është në gjendje të përmbush kërkesat dhe t'i rezistojë presionit konkurues në tregun e BE-së.
- Zhvillimi i aktivitetit ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës në zonat rurale me theks të veçantë në zhvillimin e ofertës së turizmit me cilësi të lartë dhe të një zinxhiri të shkurtër të furnizimit në prodhimin e produkteve të cilësisë së lartë dhe shërbimeve, e në të njëjtën kohë duke respektuar trashëgiminë kulturore dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.
- Nxitja e zhvillimit rural dhe shërbimeve sociale për të përmirësuar cilësinë e jetës në zonat rurale, për të reduktuar migrimin e popullsisë rurale në ato urbane.

Për të arritur qëllimet e caktuara, politikat do të zbatohen dhe politikat kombëtare do të harmonizohen me PPB në kontekstin e procesit të integrimit në BE.

Në kuadër të PPB, tregu për produktet bujqësore është rregulluar në mënyrë të tillë që të jenë të përcaktuara qartë standartet e cilësisë minimale, dhe rregullat për importin dhe eksportin e produkteve dhe të ndërhyrjeve të tregut, këto të fundit të përcaktuar në bazë të organizimit të tregut të përbashkët të BE-së. Qëndrimi zyrtar është se, në këtë fushë, Mali i Zi nuk mund të harmonizohet plotësisht me *aktin komunitar të* BE-së para anëtarësimit. Ligji për organizimet e tregut është planifikuar për vitin 2016. Në këtë kontekst, do të miratohet ligji i ri për verërat. Po ashtu është e nevojshme që të miratohet ligji i ri për pijet alkoolike dhe ligji për themelimin e agjensisë së pagesave, pasi të dy këto ligje e kane kaluar fazën e hartimit. Në përputhje me amendimet e *aktit komunitar të BE-së për* bujqësinë organike dhe politikën e cilësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) do të miratojë ndryshimet në rregulloret kombëtare që rregullojnë këtë fushë.

Mali i Zi aktualisht nuk ka SIAK siç përcaktohet nga *akti komunitar*. Kontrollet kryhen përmes sistemit të kompjuterizuar: regjistri i gjësë së gjallë, bazat e të dhënave lidhur me prodhimin bimor (kulturat bimore, duhani, perimet dhe serrat), regjistri i prodhuesve të rrushit dhe verës, regjistri i ullirit dhe regjistri i mbajtësve të politikave të sigurimit bujqësor. Megjithatë, këto bazat të të dhënave nuk janë të integruara. Kontrollet në vendin e ngjarjes kryhen për pagesat e blegtorisë dhe pagesat lidhur me kulturat bimore. Një nga objektivat e projektit ZhIFBMZ të Bankës Botërore është për të ngritur sisteme përkatëse të informacionit.

Aktualisht nuk ka një sistem SIPT. Rregullorja që lejon krijimin e sistemit të identifikimit të fermave dhe të parcelave të tokës është aprovuar, kështu që prezantimi i plotë i pagesave direkte (pavarësisht nga prodhimi) do të bëhet gradualisht deri në datën e anëtarësimit.

Mali i Zi nuk disponon Rrjetin e të Dhënave të Kontabilitetit në Ferma (FADN). Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural përcakton themelimin e sistemit të të dhënave të kontabilitetit në ekonomitë bujqësore të përzgjedhura bazuar në këto kritere: lloji i prodhimit, madhësia dhe shpërndarja rajonale. Regjistrimi bujqësor i vitit 2010 ofron bazat e mira për themelimin e sistemit të FADN-së.

Investimet duhet të drejtohen në përmirësimin e kapaciteteve dhe standarteve të higjenës, trajtimit të mbetjeve nga thertoret dhe nga industritë, si dhe në fushën e specializimit në kahun e ofertës.

Agjencia e Pagesës do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve të Fondit Evropian për Garantimin Bujqësor (EAGF) dhe të Fondit Bujqësor Evropian për Zhvillim Rural (EAFRD). Aktualisht, Drejtoria për Pagesën e IPARD-it është përgjegjëse për zbatimin e masave të zhvillimit rual, veçanarisht për alokimin e granteve, që është duke u financuar nga Projekti ZhIFBMZ.

Duke marrë parasysh rezultatet e arritura deri më tani, mund të shihet se në aspektin e harmonizimit të legjislacionit është arritur një përmirësim i konsiderueshëm. Megjithatë, kapacitetet administrative për zbatimin e suksesshëm të ligjeve dhe rregulloreve ende nuk janë të mjaftueshme dhe duhet të forcohen në masë të konsiderueshme.

Për zbatimin e plotë të standarteve të BE-së, është e nevojshme që të krijohen strukturat administrative në MBZHR, për të forcuar shërbimet e ekstensionit dhe për të trajnuar dhe informuar prodhuesit bujqësor rreth standarteve të BE-së, procesit të aplikimit dhe kritereve të pranueshmërisë që kanë të bëjnë me skema të ndryshme mbështetëse.

6.6 Fuqitë dhe dobësitë e bujqësisë

Ashtu siç mund të shihet nga analiza SWOT(PDMK) (Tabela 6.7), masat e ardhshme të politikave të zhvillimit rural janë të nevojshme për të përmirësuar strukturën dhe situatën ekonomike në sektorin bujqësor duke mbështetur zhvillimin e prodhimit ekonomikisht të qëndrueshëm të fermës.

Duke marrë parasysh strukturën e bujqësisë në Malin e Zi, shumica e fermave të vogla përballen me vështirësi sa i përket qëndrueshmërisë ekonomike në afatin e gjatë. Prandaj, duhet të krijohen masa për të lejuar grumbullimin e këtyre fermave në shoqata ose grupe të prodhuesve me qëllim të forcimit të pozitës së tyre në treg dhe për të ndikuar në diversifikimin e aktiviteteve në ferma.

Siç trajtohet edhe në seksionet e mëparshme, së bashku me faktin se bujqësia është një sektor shumë i rëndësishëm për ekonominë e Malit të Zi, është e qartë se bujqësia e Malit të Zi ka nevojë për investime të mëtejshme. Këto kanë të bëjnë me forcimin e kapaciteteve administrative apo të tjera me qëllim për të rritur sasinë, si dhe cilësinë e prodhimit bujqësor.

Së fundi, është e rëndësishme të theksojmë disa nga drejtimet kryesore për zhvillimin e ardhshëm të sektorit të integruar të prodhimit agroushqimor në Mal të Zi. Përveç të gjitha këtyre ndryshimeve të lartpërmendura strukturore dhe ligjore, është e nevojshme të theksohet komponenti inovativ, i cili përfshin nxitjen e sektorit të kërkimit dhe zhvillimit dhe përmirësimin e kapaciteteve të inovacionit në vend. Një tjetër komponent i rëndësishëm, duke marrë parasysh konkurrencën relativisht të ulët të produkteve agroushqimore të Malit të Zi, është të stimulohet bashkëpunimi më i fortë mes organizatave të prodhuesve, veçanërisht në standartizimin e cilësisë së produktit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë bujqësisë organike dhe treguesve gjeografikë.

Së fundi, promovimi i Malit të Zi si një shtet miqësor me mjedisin do të mund stimulonte prodhimin e qëndrueshëm dhe lidhjet më të forta mes bujqësisë dhe turizmit duke u përqëndruar në ushqimin tradicional vendas. Në këtë mënyrë, oferta turistike do të rritet nga furnizimi i i produkteve ushqimore tradicionale të një standarti sigurie dhe cilësie të lartë.

Tabela 6.7. Mali i Zi: Analiza SWOT e sektorit bujqësor

Përparësitë (S)	Dobësitë (W)
- Pririje të rritjes së zhvillimit dhe turizmit - Klima e përshtatshme për prodhimin e larmishëm - Cilësia e mirë e tokës - Niveli i ulët i ndotjes së tokës - Pasuri në diversitet - Tradita e prodhimit bujqësor - Kushte të përshtatshme për prodhimin organik - Fuqia punëtore relativisht e lirë - Potenciali në rritje i tregjeve vendore dhe rajonale - Zhvillimi i NVM-ve - Zgjerimi i tregut pa barriera tregtare	- Shkalla e lartë e importit - Madhësia e vogël e fermave bujqësore - Prodhimi sezonal - Zbatimi i pamjaftueshëm i teknologjive moderne dhe inovacioneve - Makineri e pajisje të vjetra - Mungesa e cilësisë së produktit të standartizuar - Struktura e papërshtatshme e moshës së fermerëve - Niveli i ulët i bashkëpunimit mes shoqatave të prodhuesve - Kapacitetet e pazhvilluara institucionale për mbështetjen e projekteve - Menaxhimi i dobët i ujit dhe ujërave të zeza - Niveli i ulët i ekspertizës dhe njohurive - Mungesa e njohurive për standartet e BE-së - Lidhja e vogël midis fermerëve dhe industrisë përpunuese
Mundësitë (O)	**Kërcënimet (T)**
- Kërkesa në rritje në tregun e brendshëm - Tendencat e reja në kërkesën turistike - Rritja në treg për produktet organike - Disponueshmëria e ndihmës kombëtare dhe e BE-së - Trendet pozitive të tregut ndërkombëtar - Trashëgimi kulturore dhe historike - Zbatimi i standarteve të cilësisë dhe sigurisë	- Varësia e lartë nga importi - Tregu informal - Konkurrenca e dobët për shkak të kostove të larta të inputeve - Rritja e vazhdueshme e kostove të prodhimit dhe tendenca rënëse e çmimeve për produktet bujqësore - Kostot e larta për rindërtimin dhe modernizimin - Mungesa e trajnimit në sigurinë e ushqimit dhe cilësinë - Mungesa e pajtueshmërisë me standartet e BE-së - Preferenca e pazhvilluar e konsumatorëve për produktet vendore - Aksesi i komplikuar në fondet për fermerët (kredi)

7. Serbia: përshkrimi i shkurtër i politikave bujqësore

Natalija Bogdanov

Fakulteti i Bujqësisë, Universiteti i Beogradit

7.1 Hyrje

Ky raport analizon karakteristikat më të rëndësishme të bujqësisë së Serbisë nga perspektiva e rëndësisë së sektorit për ekonominë kombëtare, tendencat e fundit, prodhimin e sektorit dhe të tregtisë së jashtme, zhvillimet kryesore në nënsektorët kyç dhe karakteristikat themelore të strukturës së fermës. Vëmendje e veçantë i është kushtuar politikës bujqësore në aspektin e kuadrit të politikave, strukturës së mbështetjes buxhetore dhe progresit drejt integrimit në BE.

Kjo analizë mbulon periudhën 2005–2014, duke u fokusuar në vitet e fundit. Analiza e sektorit bujqësor bazohet në të dhënat statistikore kombëtare të ofruara nga Zyra e Statistikave e Republikës së Serbisë (SORS). Të dhënat për transfertat e ekzekutuara buxhetore janë mbledhur nga Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Raporti është i organizuar si më poshtë: seksioni 7.2 jep një pasqyrë të mjedisit makroekonomik. Seksioni 7.3 ka të bëjë me kontributin e bujqësisë në ekonominë e vendit, karakteristikat e prodhimit dhe tendencat e tregjeve kryesore, duke përfshirë tregtinë ndërkombëtare. Seksioni 7.4 fillon me një përshkrim të koncepteve dhe të kornizave të politikave bujqësore të Serbisë, dhe më pas analizon fushëveprimin dhe strukturën e mbështetjes buxhetore sipas shtyllave dhe grupit të masave. Elementët bazë të strukturës së fermës janë analizuar në seksionin 7.5, duke përfshirë edhe çështjet e politikave lidhur me ristrukturimin e fermave. Raporti përfundon me diskutim dhe përfundime, së bashku me mendimin e autorit për aspektet kryesore të drejtimeve të politikës në periudhën e ardhshme.

7.2 Zhvillimi ekonomik

Gjatë periudhës së shqyrtuar, 2005–2014, ekonomia e Serbisë ka patur zhvillime ciklike. Prirjet pozitive ekonomike nisën të dobësohen në gjysmën e dytë të vitit 2008 me përhapjen e efekteve negative të krizës ekonomike globale.

Pas një rikuperimi modest nga recesioni global dhe rritjes së dobët të PBB-së në vitin 2011, Serbia ka hyrë në recesionin e dytë në vitin 2012. Ka pasur disa zhvillime pozitive në vitin 2013 (të cilat u kthyen në rimëkëmbje nga rënia ekonomike në vitin 2012), por në vitin 2014 trendet negative të treguesve kryesor makroekonomikë kanë vazhduar.

Tabela 7.1. Serbia: konteksti ekonomik, 2005 dhe 2014

	2005	2014
PBB (Milion euro)	21,103	33,059
Popullsia (milion)	7.456	7.147
Sipërfaqja e tokës (km^2)	88,361	88,499
Dendësia e popullsisë (banorë/km^2)	:	:
PBB/frymë, PFB (Euro)	7,400	9,800[a]
Tregtia e jashtme si përqindje e PBB-së (%)	57.1	80.6

Burimi: Baza e të Dhënave të Statistikave Bujqësore – Serbia, 2015.
a 2013.
PFB, barazia e fuqisë blerëse.

Aktiviteti ekonomik ka përjetuar një recesion të lidhur me përmbytjet në pjesën më të madhe të vitit 2014. Pasojat e përmbytjeve janë përqendruar shumë në sektorët kryesorë prodhues (d.m.th. bujqësi, industri, tregti dhe miniera), duke rezultuar në një rënie të dukshme reale në PBB me 1.8%. Përveç reduktimit të PBB-së, rënia është vënë re edhe në tregues të tjerë makroekonomikë. Këto përfshijnë rritjen e borxhit publik, stanjacionin e deficitit buxhetor dhe treguesit e tregtisë së jashtme.

Pas dy viteve të stabilitetit, në vitin 2014 monedha kombëtare u rrit kundrejt euros (3.7%). Inflacioni është mbajtur në një nivel më të ulët (2.9%) sesa në vitin e kaluar, ashtu siç ishte shkalla e papunësisë, e cila ka arritur nivelin më të ulët që nga fillimi i krizës (18.9 %).

7.3 Zhvillimi bujqësor

Kontributi i bujqësisë në ekonominë e Serbisë është i konsiderueshëm sa i përket përqindjes së sektorit në PBB, punësimit dhe bilancit tregtar. Përqindja e bujqësisë në treguesit përkatës makroekonomikë në vitin 2014 ka mbetur kryesisht në nivel të vitit të paraprak. Në vitin 2014 bujqësia ka kontribuar në VSHB me 9.7%, e cila ishte 0.3 pikë përqindjeje më e lartë se në vitin e kaluar, por ndjeshëm më e ulët se në fillim të periudhës së vëzhguar.

Rëndësia e sektorit të tregtisë së jashtme të Serbisë pasqyrohet në faktin se bujqësia është sektori i vetëm në ekonominë e Serbisë me një bilanc pozitiv tregtar. Tregtia e jashtme për produktet bujqësore dhe ushqimore në vitin 2014 përbënte 13.6% të tregtisë totale të jashtme, e cila është 1.2 pikë përqindjeje më shumë se vitin e kaluar. Kjo rritje është shkaktuar kryesisht nga një rritje 10.5% në eksporte.

Tabela 7.2. Serbia: bujqësia në ekonomi, 2005 dhe 2014

	2005	2014
% e VSHB-së	12.0	9.7
% e punësimit	23.3	21.9
Eksportet e produkteve agroushqimore (% eksporteve të përgjithshme)	20.3	20.6
Importet e produkteve agroushqimore (% e importeve të përgjithshme)	7.4	7.8

Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Serbia, 2015.

Punësimi në sektorin e bujqësisë ka rënë deri në vitin 2013, si për nga numri i të punësuarve (nga 636,000 në vitin 2005 në 492,000 në vitin 2013) ashtu edhe për nga përqindja e bujqësisë në punësimin e përgjithshëm (nga 23.3% në 21.3% për të njëjtat vite). Në vitin 2014 ka pasur një rritje të lehtë të numrit të të punësuarve në bujqësi: ai u rrit me 3.7%, duke arritur në 21.9% të punësimit total.

Tabela 7.3. Serbia: karakteristikat e sektorit bujqësor, 2005 dhe 2014

	2005	2014
SB (000 ha)	3,608	3,507
% e tokës së punueshme në SP	73.5	74.3
% e kulturave bimore në prodhimin e përgjithshëm bujqësor	62.3[a]	66.9
Rendimenti mesatar i grurit (t/ha)	4.0	3.9
Rendimenti mesatar i qumështit (t/lopë mjelëse)	2.6[a]	3.4
Të ardhurat faktor për NJVP (Euro)	:	:
Norma e eksprotit ndaj importit të produkteve agroushqimore (%)	117.6	189.0

Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Serbia, 2015.
a 2006.
:, nuk është në dispozicion; SB, sipërfaqja bujqësore.

Serbia është e pajisur me burime të konsiderueshme të tokës bujqësore, si përsa i përket madhësisë së saj ashtu edhe të cilësisë së tokave. Regjistrimi i bujqësisë i vitit 2012 ka regjistruar 3.861 milionë ha tokë bujqësore, nga të cilat 3.437 milion ha (89%) është SBSh. Ndryshimet vjetore në shumën e SBSh-së mund të luhaten lehtë, me rreth ±1 %.

Prodhimi bujqësor mbizotërohet nga prodhimi bimor (66.9%) dhe në periudhën 2005-2014 u karakterizua nga një trend me luhatje e shkaktuar nga ndryshimet e mëdha në rendimentet e kulturave bimore. Pavarësisht përmbytjeve të pranverës në vitin 2014, rendimentet e shumicës së kulturave bimore (misri, farërat vajore dhe panxhar sheqeri) kanë shënuar nivele të larta rekord, duke rezultuar në rritje të prodhimin të kulturave me 5.6%, dhe PBB me 3.8%. Rritja më e lartë e prodhimit në vitin 2014 është regjistruar për misrin dhe prodhimin e sojës, ndërsa një rënie në prodhim ndodhi për pataten, frutat, perimet dhe rrushin.

Prodhimi blegtoral është mbajtur në nivelin e viteve të mëparshme. Pas një rritje të lehtë në prodhimin blegtoral në vitin 2013 (rreth 2% më shumë se në vitin 2012), përgjatë vitit 2014 prodhimi është mbajtur në të njëjtin nivel , si në vitin paraprak (+0.4 %).

Figura 7.1. Serbia: treguesit e prodhimit bujqësor, 2005–2014 (2010 = 100)



Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Serbia, 2015.

Indekset e çmimeve reale të produkteve bujqësore gjatë 2005-2014 tregojnë luhatje dhe rënie në dy vitet e fundit. Në vitin 2014 çmimet e produkteve bujqësore kanë rënë në krahasim me vitin e mëparshëm, por niveli i tyre, në terma realë, ka mbetur mbi atë të vitit 2010. Krahasuar me vitin 2013, çmimet e produkteve bujqësore kanë qenë nominalisht më të ulëta, në nivelet 2.7%, dhe 5.6% në terma realë.

Çmimet e produkteve bimore kanë rënë si në terma realë (4.8%) dhe nominale (7.7%), ndërsa çmimet e prodhimeve blegtorale kanë qënë më të qëndrueshme (0.4 % lartë në terma nominalë, 2.5% poshtë në terma realë).

Në prodhimin bimor, rritjet më të mëdha reale të çmimeve janë regjistruar për perimet (25-30% në krahasim me vitin 2013) dhe disa fruta (mollë 5%, dardha dhe kumbulla 35%, rrushi i tavolinës 51%), të cilat kryesisht i atribuohen ndikimit të përmbytjeve në reduktimin e ofertës. Nga ana tjetër, çmimet e farërave vajore (përveç luledielli), drithërave dhe panxhar sheqerit ishin më të ulëta se në vitin paraprak (2–25 %).

Çmimet e produkteve blegtorale kanë mbetur të qëndrueshëm në krahasim me vitin paraprak. Një rritje e lehtë prej 7% është regjistruar në çmimet e mishit të viçit dhe mishit të qingjit, ndërsa çmimi i qumështit të papërpunuar të dhisë ka rënë në mënyrë të konsiderueshme, me 14 %.

Figura 7.2. Serbia: treguesit real të çmimeve të prodhimit bujqësor, 2005–2014 (2010 = 100)



Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Serbia, 2015.

Tregtia e jashtme në produktet bujqësore dhe ushqimore në vitin 2014 arriti në 3,509 miliard euro dhe ishte 7.2% më e lartë se në vitin 2013. Në vitin 2014, eksportet e produkteve bujqësore dhe ushqimore vazhduan të rriten, duke rezultuar në tepricat tregtare maksimale prej 1,081 miliard euro në vitin 2014 (22.6% më të larta se në vitin 2013). Raporti i mbulimit të importit të produkteve agroushqimore në vitin 2014 arriti në 1.89.

Figura 7.3. Serbia: tregtia e produkteve agroushqimore (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Serbia, 2015.

Destinacionet kryesore të eksportit të produkteve bujqësore dhe ushqimore janë vendet e BE-së (49.1% e eksporteve të përgjithshme në vitin 2014), të ndjekur nga vendet e CEFTA-s (33.3% e eksporteve) dhe vende të tjera (17.6% e eksporteve të përgjithshme).

Përbërja e importeve sipas origjinës, në vitin 2014 ishte si vijon: Vendet e BE-së 63%, tregjet e tjera 25% dhe vendet e CEFTA-s 12%. Për sa i përket partnerëve kryesor tregtarë, shumat më të mëdha të eksporteve shkuan drejt Bosnjes dhe Herzegovinës (16.5%), Rumanisë (12.2%) dhe Federatës Ruse (10.2 %).

Për shkak të sanksioneve të tregtisë ndërkombëtare që Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara kanë zbatuar ndaj Federatës Ruse në fillim të vitit 2014, tregu Rus po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për eksportet e Serbisë. Volumet e importit kanë origjinën nga Kroacia (8.9%), Gjermania (6.6%) dhe Italia (6.6 %).

Figura 7.4. Serbia: eksportet dhe importet e produkteve agroushqimore sipas tregjeve kryesore (mln EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të Dhënave Statistikore Bujqësore – Serbia, 2015.

Grupet kryesore të produkteve bujqësore në eksporte në vitin 2014 ishin drithërat (19.8%), perimet (17.9%), pijet joalkoolike (7.2%), duhani dhe produktet e duhanit (5.7%), yndyrnat bimore dhe shtazore (5.2%), dhe produktet ushqimore (5.0%). Importet në vitin 2014 u përbënë kryesisht nga frutat (10.8%), produktet e ndryshme ushqimore (7.9%), duhani dhe produktet e duhanit (6.9%), foragjeret (5.7%) dhe çokollata e kakaoja (5.9 %).

Tabela 7.4. Serbia: zhvillimet kryesore në tregjet bujqësore mes viteve 2005 dhe 2014

	Tradicionalisht, vendi është	Që nga viti 2005, prodhimi	Ndryshime të rëndësishme
Drithera	Eksportues neto	Nuk ka trend të rëndësishëm	Zona mesatare e kultivuar me drithëra në Serbi është 1.78 milion ha, me prodhim 9 milion ton. Misri dominon strukturën e drithërave, që përbën mesatarisht 56% të sipërfaqes së përgjithshme dhe 66% të prodhimit të përgjithshëm të drithërave. Rëniet në prodhim janë regjistruar në vitin 2007 dhe 2012, të shkaktuar nga kushtet e këqija të motit, duke rezultuar si në rendimente më të ulëta ashtu edhe në cilësi më të dobët (sidomos në vitin 2012). Rendimentet mesatare në 2005-2014 ishin 6 t/ha, me një nivel të lartë rekord prej 7.52 t/ha në vitin 2014. Eksportet e produkteve agroushqimore të Serbisë dominohen nga drithëra, rreth 17% mesatarisht. Vlera e eksporteve ka pasur një trend rritës deri në vitin 2012, kur ajo arriti kulmin (519 milion euro). Në vitin 2013 u ul për shkak të cilësisë së dobët të misrit. Megjithatë, eksportet e grurit kanë zvogëluar efektet e rënies së eksporteve të misrit, pasi ato janë rritur trefish, duke e bërë grurin si produktin me nivelin më të lartë të eskporteve për vitin 2013. Prodhimi rekord i misrit në vitin 2014 çoi në rikthimin e rritjes në eksportet e drithërave, duke arritur në 459 milion euro , d.m.th. 20% e totalit të eksporteve të produkteve agroushqimore.

	Tradicionalisht, vendi është	Që nga viti 2005, prodhimi	Ndryshime të rëndësishme
Sheqeri	Eksportues neto	Nuk ka trend të rëndësishëm	Në 2010-2014, zona e kultivuar me panxhar sheqeri ka qenë ndërmjet 60.000 dhe 71.000 ha. Përmbytjet në pranverën e vitit 2014 nuk kanë pasur ndikim në këtë prodhim. Në vitin 2014, rendimentet arritën kulmin prej 54.7 t/ha dhe si rrjedhojë prodhimi ka arritur një nivel rekord, pavarësisht nga rënia e lehtë në zonat e korrura. Tregu i panxhar sheqerit është i paqëndrueshëm, me luhatje në sasi të blera, çmime dhe ndërmjetës të tregut të përfshirë. Prodhimi rekord në vitin 2014 solli shumë probleme. Çmimet e panxhar sheqerit në vitin 2014 ka rënë në krahasim me vitin 2013 (nga 40 euro në 30 euro/t), por çmimet e kontraktuara ndërmjet rafinerive të sheqerit, blerësve dhe prodhuesve ishin ende të larta në krahasim me çmimin e sheqerit në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare. Për të minimizuar humbjet, rafineritë e sheqerit dhe blerësit shmangën detyrimet kontraktuale, gjë që çoi në paqëndrueshmërinë e tregut gjatë sezonit të korrjes. Përveç kësaj, përpunimi u shty nga kushtet e këqija të motit, të cilat shkaktuan cilësi më të dobët dhe kontribuan në rritjen e humbjeve në prodhim. Serbia është një eksportues neto i sheqerit (rreth 200.000 t në vit). Vlera mesatare e eksportit është 130 milionë euro, me një tendencë të lehtë rritëse gjatë 2010-2013. Një rënie të ndjeshme në vlerën e eksporteve pati në vitin 2014, si rezultat i rënies së çmimeve ndërkombëtare të sheqerit të kombinuar me rezervat të cilat arrinin në nivele rekord

Farëra vajore,vajra dhe yndyrna	Eksportues neto	Është rritur	Zona e kultivuar me bimët vajore në Serbi shkon ndërmjet 320,000 dhe 360,000 ha, me prodhim mesatar prej mbi 900,000 t. Prodhimi i farërave vajore ka një prirje të theksuar pozitive, duke arritur një maksimum prej 1.1 milion t në vitin 2014. Bima më e rëndësishme është luledielli, duke zënë 45% të sipërfaqes së përgjithshme të farërave vajore. Prodhimi i luledielit në vitin 2013 dhe 2014 ka arritur një sasi rekord prej rreth 510,000 t. Kjo rritje është rezultat i rritjes në rendiment, i cili në vitin 2014 arriti kulmin me vlerëprej 3.2 t/ ha. Sipërfaqja e mbjellur me soje është rreth 5,000 ha, dhe që nga viti 2009 ka qenë në rënie. Përkundër rënies në sipërfaqet e korrura, rendimentet e arritura rekord në vitin 2014 (3.5 t/ha) çuan në prodhimin më të lartë. Prodhimi farës së panxharit në 2010-2014 luhatej nga 20.000 t deri 44,000 t, pa një trend të theksuar. Rënia e çmimeve të farërave vajore në vitin 2013 vazhdoi në vitin 2014, në përputhje me zhvillimet në tregun global. Një rritje e lehtë prej 4% është regjistruar vetëm për çmimet e luledielit. Tregtia e jashtme në sektorin e farërave vajore, vajrave dhe yndyrnave është shumë e paqëndrueshme, me tendencat e rritjes së theksuar si në eksporte ashtu edhe në importe. Një bilanc pozitiv i tregtisë u arrit në vitin 2011, 2013 dhe 2014. Në vitin 2014, tregtia e jashtme shënoi eksporte rekord të luledielit dhe importet rekord për sojën. Tregtia e jashtme në sektor është e ndikuar shumë nga çmimet blerëse të brendshme dhe çmimet në tregjet përkatëse ndërkombëtare, kryesisht Hungareze
Fruta dhe perime	Eksportues neto	Nuk ka trend të rëndësishëm	Drufrutorët në Serbi zënë 167,000 ha (4.7% të tokës bujqësore) me një prodhim mesatar prej 1.2 milion tonë fruta. Sasitë më të mëdha janë kumbulla, mjedra dhe molla. Në 2010-2014 prodhimi i frutave paraqiste luhatje të larta, nga 930.000 t deri 1,541,000 t. Një trend i dukshëm i nivelit të prodhimit vihet re vetëm për disa fruta: prodhimi i pjeshkëve, qershive dhe manaferrave është në rritje, ndërkohë që prodhimi i mjedrave ka rënë në vazhdimisht që nga niveli i lartë rekord i arritur në vitin 2011 (32% më pak në vitin 2014). Duke filluar nga viti 2012, çmimet e pjsës më të madhe të frutave janë në rënie. Sipërfaqja e mbjellë me perime është vazhdimisht në rënie (nga 80,000 ha në 2005 në 66,000 ha në 2014). Prodhimi mesatar i perimeve është rreth 1 milion t, me rënie në vitet e prekura nga kushtet e ashpra të motit (2007, 2012 dhe 2014). Çmimet e shumicës së perimeve janë rritur në vitin 2014 dhe kjo rritje i atribuohet ndikimit të përmbytjeve të pranverës. Eksportet e frutave dhe perimeve në vitin 2014 arritën vlerën rekord prej 290 milionë euro, e cila është 85% më e lartë se mesatarja për periudhën 2005-2014. Duke pasur parasysh prirjen rënëse në prodhimin e perimeve dhe prodhimin e qëndrueshëm të frutave, rritja e eksporteve është supozuar të jetë rezultat i një rënieje në konsumin e brendshëm për shkak të një rënieje të standartit të jetesës
Verë	Eksportues neto	Ka rënë	Sipërfaqja e vreshtave dhe prodhimi i rrushit kanë qenë në rënie që nga viti 2010, dhe arritën një minimum prej 21.000 ha dhe 122,000 t në 2014. Tregtia e jashtme ka një bilanc negativ, përsa i përket vlerës dhe sasisë së verës. Deficiti tregtar i verës është 12 milionë euro. Importi i verës “bulk” apo verës “ekonomike” nga IRJ e Maqedonisë është në rritje, pasi që disa kantinat të mëdha të verërave nga Serbia kanë investuar ose kanë blerë disa kantina të mëdha të verës me vreshta në IRJ të Maqedonisë. Këto vreshta dhe kantina të verës përdoren kryesisht si një bazë materiale të papërpunuara, sepse verërat e importuara përpunohen dhe ambalazhohen në Serbi
	Tradicionalisht, vendi është	Që nga viti 2005, prodhimi	Ndryshime të rëndësishme

Patate	Importues neto	Ka rënë	Sipërfaqja e patates, rendimentet dhe prodhimi janë në rënie. Prodhimi ka arritur minimumin e tij, 578,000 t, në thatësirat e vitit 2012 dhe, pas rimëkëmbjes në vitin 2013, ka rënë me 23% në vitin 2014. Duke filluar nga viti 2007, Serbia ka pasur një deficit tregtar në rritje të vazhdueshme
Duhani	Importues neto	Nuk ka trend të rëndësisshëm	Duhani është rritur në 5.000 ha. Prodhimi ka arritur një maksimum prej 10.500 t në vitin 2014. Pas kësaj, ka pasur një rënie në sipërfaqen me duhan, me luhatje në prodhim. Bilanci tregtar ishte pozitiv për herë të parë në vitin 2014 (45.3 milion euro)
Mish lope dhe viçi	Eksportues neto	Ka rënë	Numri i gjedhit ka rënë ndjeshëm gjatë 2005-2014 (17%), duke arritur minimumin në 913,000 krerë në vitin 2013. Në vitin 2014 numri i gjedhit është rritur pak, me 1%. Përqindja e lopëve daj totalit të gjedhit po ashtu u reduktua nga 56% në 2006 në 50% në vitin 2014. Prodhimi i mishit të lopës dhe mishit të viçit po bie në përputhje me rënien e numrit të gjedhit. Në 2005-2014, prodhimi i mishit shkonte nga 70,000 t në 100,000 t, me nivelin më të lartë në vitin 2009 dhe më të ulët në vitin 2013. Bilanci tregtar i jashtëm është pozitiv, por me një prirje të theksuar në rënie që nga viti 2007. Eksportet maksimale, 27.3 milionë euro, janë arritur në vitin 2007, ndërsa në vitin 2014 ato ishin vetëm 6,6 milion euro. Importet e mishit të lopës së pari kanë tejkaluar 0.5 milion euro në vitin 2013, dhe në vitin 2014 arritën në 2.3 milionë euro
Mish derri	Importues neto	Ka rënë	Numri i përgjithshëm i derrave priret të ulet në vitet e fundit. Në vitin 2014, numri i përgjithshëm i derrave ishte 3.2 milionë euro, që paraqet një rënie prej 3% nga mesatarja në 2009-2013. Numri i dosave ka rënë në mënyrë të vazhdueshme, duke arritur minimumin prej 346,000 në vitin 2014 (11% e numrit total të derrave). Pas çmimeve rekorde të larta në vitin 2013, në vitin 2014 çmimet ranë, kryesisht për shkak të rritjes së madhe të importeve. Prodhimi i mishit të derrit luhatet, me një prirje të dukshme negative. Në vitin 2014, prodhimi i mishit të derrit ishte 258,000 t, pak më shumë se në dy vitet e mëparshme. Eksportet Serbe të mishit të derrit janë të ulëta, për shkak të kufizimeve mbi eksporte në tregun e BE-së. Vlera e eksporteve ka ndryshuar nga 0.05 milionë euro në vitin 2005 në 5.9 milionë euro në vitin 2012. Në vitin 2014 eksportet u rritën ndjeshëm në 44,000 t. Importet kanë një tendencë të vazhdueshme rritjeje, duke arritur kulmin në vitin 2014 me një vlerë prej 36 milionë euro. Në vitin 2010-2014 vlera e importeve u rrit katërfish.
Mish dele dhe dhie	I vetëmjaftueshëm	Është rritur	Pas një rënieje të lehtë të numrit të kafshëve në periudhën 2009-2011, mbarështimi i të leshtave është rimëkëmbur në vitet e fundit dhe po vazhdon rritjen që është parë në fillim të periudhës së studimit. Në vitin 2014 numri i deleve ishte 1.7 milion që është 8% më i lartë se në vitin paraprak. Ndërsa numri i dhive është vazhdimisht në rënie, duke arritur një minimum në 219,000 krerë në vitin 2014. Prodhimi vjetor i mishit të deles është në rritje në përputhje me rritjen e madhësisë së tufës. Prodhimi i mishit të deles është rritur nga 20.000 t në vitin 2006 në 30.000 t në vitin 2013. Bilanci tregtar është kryesisht pozitiv, me një trend rritës që nga viti 2012. Tregtia e jashtme e mishit të deles është e paqëndrueshme. Vlera maksimale e eksporteve ishte 0.5 milionë euro, e regjistruar në vitin 2008 dhe 2014. Teprica tregtare prej 0.2 milion euro në vitin 2014 ka qenë ndër më të lartat e regjistruar në të gjithë periudhën

Mish i shpendëve	I vetëmjaftueshëm	Është rritur	Numri i shpendëve arriti kulmin prej 22,800 në vitin 2009. Në vijim numri i shpendëve u ul në 17,200 në vitin 2014, në afërsi të nivelit në fillim të periudhës të mbuluar nga studimi. Prodhimi vjetor i mishit të shpendëve është rreth 94,000 t dhe ka një prirje rritëse. Përveç mishit të deles, mishi i shpendëve është i vetmi produkt blegtoral me rritje të vazhdueshme gjatë periudhës së vëzhguar. Eksporti i mishit të shpendëve është vazhdimisht në rritje. Vlera maksimale e eksportit, 9.2 milion euro, u arrit në vitin 2014. Vlera e importeve ishte më e ulët se 0.5 milionë euro deri në vitin 2011. Në vitet 2011-2013 vlera e importeve ka tejkaluar vlerën e eksporteve për herë të parë, duke shkaktuar një bilanc tregtar negativ. Bilanci tregtar në vitin 2014 ishte pak më pozitiv (0.3 milion euro)
Qumështi dhe nënproduktet e qumështit	Eksportuesi neto	Ka rënë	Numri i lopëve mjelëse ra me 28% në mes të 2006 dhe 2014. Madhësia minimale e kopesë në vitin 2013 ishte (429,000), dhe ka mbetur pothuajse e njëjtë në vitin 2014 (437,000). Rënia në prodhimin e qumështit është gjithashtu e vazhdueshme. Në 2006-2013, prodhimi ra me 10%, por ai është rritur lehtë në 2014 (në 1,5 milion t ose me 2.9%). Vlera rekord e eksporteve, 62.6 milion euro ishte në vitin 2014 (nga 7.5 milionë euro në vitin 2005). Importet u luhatën nga 6,9 milion euro në vitin 2006 në 41.8 milionë euro në vitin 2012. Bilanci tregtar ka qenë pozitiv që nga viti 2006, me një vlerë maksimale prej 26.7 milionë euro në vitin 2014

7.4 Zhvillimi i politikave bujqësore

7.4.1 Koncepti dhe korniza e politikave bujqësore

Gjatë disa dekadave të fundit, politika bujqësore në Serbi i'u është nënshtruar presioneve heterogjene dhe të ndërlikuara, të tilla si destabilitetit politik dhe ekonomik, nevoja për të pakësuar efektet negative anësore të kushteve të motit dhe çrregullimet e tregut global të gjashtëmujorit të dytë të viteve 2000. Në një mjedis të tillë, prioritetet dhe mekanizmat e politikës bujqësore janë përzgjedhur në mënyrë kryesisht pragmatike më tepër sesa në pajtueshmëri me dokumentet strategjike. Në përgjithësi, politika bujqësore ka qenë e drejtuar gjerësisht nga nevoja për të përshpejtuar rritjen e produktivitetit, ndërsa interesat më të gjera publike dhe sigurimi i mallrave publike kanë mbetur i një rëndësie dytësore (Bogdanov 2014).

Në vitet e fundit ka pasur pak progres në përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve ligjore dhe strategjike që përcaktojnë drejtimin e politikës bujqësore të Serbisë për periudhën në vijim. Politika aktuale bujqësore bazohet në disa dokumente që rregullojnë zbatimin e mbështetjes së bujqësisë dhe zhvillimit rural:

Ligji për Subvencionet e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor (LARDS) (Fletorja Zyrtare, nr. 10/2013) përcakton llojet e subvencioneve të bujqësisë dhe zhvillimit rural (pagesat direkte, masat e zhvillimit rural dhe grantet e veçanta), kërkesat e pranueshmërisë dhe shumat minimale për subvencion.

Strategjia e Zhvillimit Rural dhe Bujqësor për 2014-2024 (ARDS) (Fletorja Zyrtare, nr. 85/2014) përcakton drejtimin e zhvillimit bujqësor dhe rural të Serbisë gjatë periudhës së ardhshme 10-vjeçare, duke patur parasysh procesin e integrimit në BE. Qëllimet zhvillimore janë përcaktuar si më poshtë:

i) rritja e stabilitetit të prodhimit dhe të ardhurave të prodhuesve;
ii) rritja e konkurueshmërisë dhe përshtatjeve me kërkesat e tregjeve vendore dhe ndërkombëtare;
iii) sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mjedisit;
iv) përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale dhe zbutja e varfërisë; dhe
v) përmirësimi i menaxhimit të politikave publike dhe përmirësimi i kuadrit institucional për zhvillimin bujqësor dhe rural.

Në janar të vitit 2015, Komisioni Evropian miratoi IPARD-in për Serbinë, i cili hap rrugën për BE-në për të mbështetur zhvillimin rural të Serbisë gjatë gjashtë viteve të ardhshme. Duke marrë në konsideratë masat e ndryshme mbështetëse të ofruara për vendet e para-anëtarësimit nga BE-ja në kuadër të IPARD-it, programi është ndërtuar mbi gjashtë masa, të cilat janë: (i) investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore - grante për fermerët që prodhojnë qumësht, mish, fruta dhe perime (43 % e alokimit të IPARD-it për 2014-2020); (Ii) investimet në asetet fizike për përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe të peshkimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme që përpunojnë qumësht, mish, fruta dhe perime (36%); (Iii) masat agro-mjedisore - për fermat organike dhe kultivuesit e kulturave organik (5%); (Iv) zbatimin e strategjive zhvillimore lokale (3%); (V) zhvillimin e objekteve private të turizmit rural (10%); dhe (vi) asistencën teknike (3 %).

Edhe pse objektivat e politikave dhe prioritetet kryesore të ARDS dhe IPARD-it janë në përputhje me kuadrin e modelit PPB dhe pasqyrojnë prioritetet kombëtare, realizimi i tyre mbetet problematik. Faktorët kryesorë që kontribuojnë në zbatimin e prioriteteve dhe objektivave janë dinamikat e ndryshme në përshtatjet e kuadrit ligjor dhe politikave si dhe mungesa e koordinimit horizontal mes mekanizmave të ndryshme të politikave bujqësore[19].

7.4.2 Mbështetja buxhetore për bujqësinë

Gjatë periudhës së shqyrtuar, 2005-2014, mbështetja buxhetore për bujqësinë e Serbisë varionte si në vlerën totale ashtu edhe në strukturën e saj. Ndërmjet 2005 dhe 2008, buxheti i bujqësisë është rritur nga 150 milionë euro në 279 milionë euro. Kjo u pasua nga një rënie e ndjeshme në vitin 2009, por nga viti 2012 buxheti filloi të rritet dhe ka arritur kulmin prej 316,4 milionë euro në vitin 2014.

Të dhënat për 2005-2010 përfshijnë financimin nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, Gjuetisë dhe Peshkimit, Fondet për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Drejtoria për Pagesat Agrare. Që nga viti 2011, të dhënat për buxhetin e realizuar bujqësor përfshijnë fondet e dedikuara për subvencione (kreu 451 i buxhetit, Subvencionet për Ndërmarrjet Publike Jofinanciare dhe Organizatat) që zbatohen nga të gjitha drejtoritë e Ministrisë së Bujqësisë (duke përfshirë Drejtorinë e Veterinarisë, Drejtorinë e Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Pyjeve, Fondin Buxhetor për Pylltari, Fondin Buxhetor për Gjueti dhe Drejtorinë e Tokës Bujqësore), në mënyrë për të patur informacion të plotë për paratë publike të shpenzuara për sektorin e bujqësisë. Prandaj, shifrat janë plotësisht të krahasueshme për periudhën 2011-2014.

Megjithatë, luhatshmëria e lartë e transferimeve buxhetore është kryesisht pasojë e paqëndrueshmërisë së buxhetit të përgjithshëm, të shkaktuar nga ndryshimet e shpeshta në strukturat qeverisëse që çuan në mungesën e stabilitetit të politikave dhe mungesën e parashikueshmërisë. Përveç ndryshimeve të shpeshta në nivelin e mbështetjes, ka pasur edhe ndryshime të shpeshta në skemat dhe programet e financimit. Në përgjithësi, në vitet kur prodhimi u godit nga kushtet e pafavorshme të motit dhe/ose luhatjet e shpeshta të tregut, shumica e financimit është rishpërndarë drejt subvencioneve për inpute apo pagesave direkte për hektar. Kjo qasje është zbatuar për shkak se masat për të mbështetur stabilitetin e tregut nuk janë parashikuar nga ligjet për stimuj në bujqësi dhe zhvillim rural.

Në përputhje me Ligjin për Buxhetin e Serbisë për vitin 2014 (Fletorja Zyrtare, nr. 142/2014) fondet e përgjithshme të dedikuara për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit ishin 335 milion euro (3.5% e buxhetit të përgjithshëm të RS). Kjo

[19] Për shembull, sipas LSBZHR, Programi kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duhet të përcaktojë rrjedhën e zhvillimeve të politikave afatmesme, por ky dokument është ende duke u përgatitur; dhe SZHBR përcakton mekanizmat themelore të ndërhyrjes në rrjetin e sigurisë , por LSBZHR nuk përcakton këtë.

shumë paraqet një rënie prej 15% krahasuar me vitin 2013. Fondet e përcaktuara për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit kanë përfaqësuar 12% të VSHB-së të sektorit të bujqësisë, pylltarisë, gjuetisë dhe peshkimit, që është e pranueshme për një vend me të ardhura mesatare dhe sugjeron se nuk ka vend për rritje të konsiderueshme në financim.

Figura 7.5. Serbia: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për bujqësinë (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave e MPB-ve – Serbia, 2015.

Pavarësisht reduktimit të buxhetit të përgjithshëm të ministrisë, fondet për të mbështetur prodhuesit janë rritur me 18%, duke arritur në një maksimum prej 316,4 milion euro. Kjo rritje është shkaktuar nga një rritje prej 21.8% në fondet për masat e tregut dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të prodhuesve. Brenda këtij grupi të masave, subvencionet e ndryshme të inputeve janë rritur me më shumë se 100%. Për t'i ndihmuar fermerët e Serbisë për të përmbushur nevojat e rëndësishme, të ripërtërijnë plantacionet, kulturat bimore, objektet dhe infrastrukturën, si dhe të përgjigjen më mirë ndaj fatkeqësive natyrore, janë futur pagesat direkte në formë të subvencioneve të inputeve variabël për blerjen e farërave, fidaneve dhe plehrave minerale.

Masat e drejtpërdrejta mbështetëse për prodhuesit kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme nga viti në vit. Në shumicën e rasteve kjo ka qenë për shkak të dështimeve të tregut që rrjedhin nga kushtet e pafavorshme të motit dhe luhatjeve të çmimeve, por edhe për shkak të mungesës së udhëzimeve të duhura strategjike dhe të mungesës së kuadrit të të prioriteteve dhe politikave të përcaktuara qartë. Fondet për këtë shtyllë të politikave përbënin mesatarisht rreth 77% të buxhetit të përgjithshëm në periudhën 2005-2014 dhe janë rritur në mbi 86% mesatarisht për periudhën 2012-2014.

Figura 7.6. Serbia: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për masat direkte mbështetëse të prodhuesve (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave e MPB-ve – Serbia, 2015.

Figura 7.7. Serbia: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për pagesa direkte për prodhuesit (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave e MPB-ve – Serbia, 2015.

Shuma dhe struktura e mbështetjes së drejtpërdrejtë është shumë heterogjene, sidomos kur bëhet fjalë për subvencionet e inputeve variabël. Këto ndryshime të shpeshta dhe tërësore sugjerojnë se ky instrument është përdorur gjerësisht për të zgjidhur nevojat urgjente dhe për t'u përballur me sfidat që paraqiten nga kuadri i politikave dhe të metat e sistemit.

Figura 7.8. Serbia: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për subvencionimin e inputeve variabël (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave e MPB-ve – Serbia, 2015.

Mbështetja për zhvillimin rural ka qenë dukshëm më e lartë në fillim të periudhës dhe masat dhe programet përmes të cilave është zbatuar ishin shumë më të larmishme. Megjithatë, rëndësia e masave të zhvillimit rural është mpakur gradualisht, duke arritur më pak se 1.4% të buxhetit të përgjithshëm në vitin 2014. Mbështetja buxhetore për zhvillimin rural në Serbi ka për qëllim kryesisht mbështetjen e investimeve në fermë, të zbatuara përmes granteve për rindërtimin e objekteve, mekanizimin e fermave dhe blerjen e pajisjeve, rimbjelljen dhe zgjerimin e drufrutorëve dhe vreshtave, dhe normat e subvencionuara të interesit.

Figura 7.9. Serbia: zhvillimi i mbështetjes buxhetore për zhvillimin rural (milion EUR), 2005–2014



Burimi: Baza e të dhënave e MPB-ve – Serbia, 2015.

Tabela 7.5. Serbia: masat dhe instrumentat kryesorë të politikave bujqësore; 2005 dhe 2014

	Të zbatuara	Që nga viti 2005, mbështetja	Ndryshime të rëndësishme
Masat mbështetëse të tregut	Po, herë pas here	Ka rënë	Gjatë viteve 2005–2011 në Serbi janë zbatuar masa të ndryshme për mbështetjen e tregut (rimbursimet e eksportit, ndërhyrje me blerje, financimi i shpenzimeve operative të rezervave publike dhe bashkëfinancimi i magazinimit). Stimujt e eksportit ishin masa e vetme që janë aplikuar në mënyrë të përhershme deri në vitin 2011, ndërsa magazinimi privat dhe blerjet emergjente janë financuar herë pas here (gjatë viteve kur kushtet e papërshtatshme të motit kanë shkaktuar shqetësime në tregje). Pas vitit 2011, masat e mbështetjes së tregut janë tërhequr dhe janë zëvendësuar me pagesat direkte
Subvencionet për inputet variabël	Po, rregullisht	Është rritur	Subvencionet e inputeve përfshinin masa të ndryshme, përqindja e të cilave ka ndryshuar me kalimin e kohës. Që nga viti 2007, subvencionet e inputeve janë bërë një skemë mbizotëruese e mbështetjes buxhetore për bujqësinë, duke lëvizur nga 18% (2013) në 72% (2010) të buxhetit të përgjithshëm bujqësor. Tendenca e përgjithshme në vitet e fundit ka qenë përqendrimi i mbështetjes tek karburantet dhe plehrat minerale. Ky trend ka vazhduar në vitin 2014: këto subvencione janë rritur në 84 milionë euro nga 42 milionë euro në vitin 2013. Përveç subvencioneve për karburante dhe plehra minerale, janë aplikuar gjithashtu në mënyrë të përhershme edhe subvencionet për mbarështimin e blegtorisë (2,5 milion euro në vitin 2014), si dhe për sigurim (5.4 milion euro në vitin 2014). Ka pasur ndryshime të shpeshta në atë se si janë zbatuar masat e politikave bujqësore deri në vitin 2013. Me miratimin e LSBZHR në fillim të vitit 2013, janë përcaktuar për një periudhë të gjatë kohore kriteret e pranueshmërisë. Sipas ligjit, çdo person juridik, sipërmarrës apo personi fizik i cili është mbajtës i një fermë familjare është i pranueshëm për subvencionet e inputeve të variabël
Pagesat direkte në bazë të prodhimit	Po, rregullisht	Ka rënë	Pagesat direkte në bazë të prodhimit (mbështetjes së çmimeve) janë zbatuar rregullisht, me luhatje të konsiderueshme në fondet e shpenzuara në këtë lloj të masave. Masa kryesore është subvencioni i qumështit, i cila është zbatuar vazhdimisht gjatë disa dekadave të fundit. Në vitin 2014 shuma e shpenzuar për premium në cmimi e qumështit ishte 40.6 milionë euro (me një rritje prej 10% nga viti 2013). Që nga viti 2012 masat e tjera nga ky grup janë hequr. Që nga viti 2009 është paguar një normë e sheshtë për litër qumësht, në vend të normave më të larta për qumështin e prodhuar në rajonet kodrinore dhe malore që aplikoheshin më parë. Në vitin 2013 dhe 2014 subvencionet e qumështit janë llogaritur për litër të qumështit të dorëzuar në tremujorin paraprak (RSD 7 për litër)dhe paguar çdo tre muaj për qumështin e lopëve, deleve dhe dhive,. Për t'u kualifikuar për përfitimin e subvencionit të qumështit, përfituesi duhet të dorëzojë minimalisht 3000 litra qumësht lope për tremujor. Në rajonet me kushte të vështira bujqësore kjo kërkesë është ulur në 1,500 litra

Pagesat direkte bazuar në sipërfaqe/nr krerësh	Po, rregullisht	Është rritur	Gjatë periudhës së studimit fondet për pagesat direkte për sipërfaqe/numër krerësh janë ulur gradualisht derisa në vitet 2010-2011 u hoqën nga mbështetja buxhetore. Në vitin 2012 pagesat direkte në sipërfaqe/numër krerësh janë rifutur, duke përbërë 44% të mbështetjes së përgjithshme buxhetore në formën e pagesave të sheshta (fikse) për hektar të tokës së punueshme dhe subvencione për blegtori me cilësi të mirë. Në vitin 2014, 49% e buxhetit bujqësor është shpenzuar për pagesat direkte për sipërfaqe/numër krerësh. Përveç mbështetjes për hektar të tokës bujqësore, pagesat direkte që nga viti 2013 përfshijnë gjithashtu mbështetje për mbarështimin e bagëtive të ndryshme, për lopët që ushqejnë me qumësht, dema/mëshqerra, rritjen në peshë të qengjave dhe derrave, bletarisë dhe kultivimin e peshkut
Pagesat direkte të ndara nga prodhimi	Nuk janë zbatuar		

	Të zbatuara	**Që nga viti 2005, mbështetja**	**Ndryshimet e rëndësishme**
Mbështetja e investimeve në fermë	Po, rregullisht	Ka rënë	Fondet e destinuara për mbështetjen e zhvillimit rural në përgjithësi, dhe ato për mbështetjen e investimeve në fermë, kanë rënë. Shuma mesatare e fondeve në 2011-2014 ishte rreth 75% më e ulët se në 2005-2008. Në vitin 2014 fondet për mbështetjen e investimeve në fermë ishin 9.5 milion Euro , d.th. 3.5% e buxhetit të përgjithshëm bujqësor. Masat mbështetëse dhe kriteret e pranueshmërisë kanë ndryshuar shpesh deri në 2013. Që nga viti 2013 parimi bazë i paraqitur nga LSBZHR është se fermat në zonat e largëta kodrinore dhe malore dhe ato në pronësi të personave më pak se 50 vjeç duhet t'i jepen subvencionet më të favorshme. Subvencionet janë 30% të vlerës së investimit, dhe 45% e vlerës së investimit në zonat me kushte të vështira bujqësore
Mbështetja e industrisë ushqimore	Po, rregullisht	Nuk ka trend të rëndësishëm	Mbështetja për përpunimin dhe marketingun e prodhimeve bujqësore përfshin grante për investime në përmirësimin e cilësisë së verës dhe pijeve alkoolike. Përveç investimeve në përmirësimin e cilësisë, disa aktivitete të tjera gjithashtu mbeshteten, të tilla si aktivitetet e shoqatave të prodhuesve të verës/pijeve alkoolike në krijimin e një treguesi gjeografik të produkteve, stimujve për marketing dhe aktivitetet e promovimit , etj Aktivitete të tilla në sektorët tjerë (fruta dhe perime) janë mbështetur nëpërmjet projekteve të ndihmës së huaj dhe nga pushtetet vendore
Pagesat lidhur me mjedisin	Po, rregullisht	Nuk ka trend të rëndësishëm	Stimujt që lidhen me agro-mjedisin në Serbi përfshijnë pagesat për mirëmbajtjen e burimeve gjenetike bujqësore (për hektar/krerë) dhe fermat e angazhuar në bujqësinë organike. Masa që synojnë përmirësimin e mjedisit dhe fshatit zbatohen rrallë. Ky grup i masave ka rreth 0.2% të mbështetjes së përgjithshme buxhetore. Në 2014, financimi është rritur nga periudha paraprake: ai arriti në 1 milion euro, apo 0.5% të buxhetit bujqësor

Mbështetja e zonës rurale	Jo në masë të konsiderueshme	Nuk ka trend të rëndësishëm	Përmirësimi i zhvillimit të ekonomisë rurale, duke mbështetur diversifikimin e të ardhurave nga fermat dhe përmirësimet në infrastrukturë kanë një përqindje të vogël të buxhetit të përgjithshëm. Shuma të konsiderueshme janë shpenzuar për përmirësimet e infrastrukturës rurale vetëm në vitin 2007 (nga buxheti për planin e investimit kombëtar). Mbështetja për përmirësimin e zhvillimit të ekonomisë rurale është zbatuar përmes stimujve për artizanate tradicionale, rinovimin e objekteve dhe infrastrukturës për turizmin rural, etj. Disa nga aktivitetet që lidhen me zhvillimin e turizmit rural dhe infrastrukturës gjithashtu janë financuar nga fondet e tjera (buxhetit të Ministrisë së Ekonomisë, projekteve të ndihmës së huaj dhe qeverive lokale)
Masat e mbështetjes së përgjithshme	Po, rregullisht	Nuk ka trend të rëndësishëm	Pjesa më e madhe e mjeteve financiare është shpenzuar për kontrollet dhe masat fitosanitare. Nuk ka pasur luhatje të mëdha në shumën dhe strukturën e mbështetjes financiare, pasi si fondet ashtu dhe aktivitetet janë përcaktuar në programet afatgjata, të cilat mund të ndryshohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Mbështetja financiare për masat e mbështetjes së përgjithshme luhatej midis 21 milion euro në vitin 2012 dhe 22.7 milionë euro në vitin 2011. Ndarjet buxhetore për shërbimet e ekspertëve dhe këshillimin ishin mesatarisht 3.5 milion euro dhe për sigurinë e ushqimit 19.2 milionë euro

Transfertat për shërbime të përgjithshme në bujqësi në 2011-2014 arritën në 22.5 milionë euro mesatarisht. Në kuadër tëpolitikës së masave të përgjithshme dhe shërbimeve që lidhen me bujqësinë, janë zbatuar programe të rregullta të ministrisë për shërbimet e ekstensionit, shërbimet e ekspertëve dhe të kontrollit të sigurisë së ushqimit. Duke qenë se ato janë zbatuar në baza shumëvjecare, fondet janë më të qëndrueshme se sa për grupet e tjera të masave. Në dy vitet e fundit ka pasur një tendencë të rritjes së lehtë, por përqindja e tyre në transfertat e përgjithshme buxhetore ka rënë (nga 11.5% në 2011 në 7.5% në vitin 2014).

Transfertat e tjera për bujqësinë përfshijnë mbështetjen e aktiviteteve të financuara nga nënllogaritë e drejtorive të ndryshme (Drejtoria e Pyjeve, Fondi Buxhetor për Pylltari, Fondi Buxhetor për Gjueti, Drejtoria e Tokës Bujqësore). Disa prej masave dhe programeve që ata kanë zbatuar në vitet e fundit mund të klasifikohen si mbështetje e zhvillimit rural (konsolidimi i tokës, zgjerimi i fermave, rrugët pyjore), por nuk ka të dhëna të qëndrueshme për paratë e shpenzuara për këto qëllime. Megjithatë, mund të supozohet se në vitin 2014 shtesa prej 2 million euro deri 3 milion euro, nga buxheti i Drejtorisë për Tokat, mund t'i atribuohet mbështetjes së zhvillimit rural.

7.5 Çështjet e fermave

7.5.1 Prirjet dhe strukturat e fermave

Regjistrimi i bujqësisë i vitit 2012 ka identifikuar 628,552 ferma familjare dhe 3,000 ndërmarrje bujqësore (prej të cilave 386 janë kooperativa). Sektori bujqësor karakterizohet nga nje strukturë e fortë e dyfishtë e fermave me ndryshime të konsiderueshme rajonale në madhësinë e fermës dhe llojin e veprimtarive bujqësore.

SBSh mesatare është 5.4 ha pë fermë, me dallime të mëdha në nivel rajonal, që shkojnë nga 3.6 ha në Rajonin Jugor dhe Lindor të Serbisë deri 10.9 ha në Rajonin e Vojvodinës. 48% e fermave kultivojnë më pak se 2 ha, ndërsa fermat më të vogla se 5 ha formojnë 78% të numrit total të fermave. Vetëm 3.1% e fermave kanë 20 ha ose më shumë dhe ato përfaqësojnë 44% të totalit të SBSh-së.

Sipas të dhënave të regjistrimit, Serbia ka 2.02 milion NjSB. 77.5 % të pronave të fermave kishin pak blegtori. Shifrat mesatare të NjSB për fermë (4.1) dhe për hektar të

SBSH-së (0.59) sugjerojnë mbizotërimin e tufave të vogla. Pothuajse një e treta e fermave kanë më pak se 1 NjSB, duke treguar se prodhimi blegtoral bazohet në nevojat e vetë-mjaftueshmërisë.

Sektori bujqësor i Serbisë punëson 1.4 milion njerëz. Numri i përgjithshëm i NJVP-ve në vitin 2012 ishte 646,283, d.m.th. 1.02 për fermë. Në terma rajonalë, dendësia e popullsisë (raporti person–tokë) është më i favorshëm në Vojvodinë (11.7 ha të SBSh-ve për NjVP) se në Serbinë jugore (3.6 ha të SBSH për NjVP). Mosha mesatare e mbajtësit të fermës është 59 vjeç, me 35 % të fermerëve që janë mbi 65 vjeç dhe 65 % mbi moshën 55 vjeçare. Vetëm 4.6 % e drejtuesve të fermave janë nën moshën 35 vjeçare, dhe 10.5 % janë 35–45 vjeçarë.

PS mesatar për fermë është 5,900 euro. 45.9 % të fermave kanë PS më pak se 2,000 euro për fermë. Dallimet rajonale në PS dhe NjVp për fermë janë shumë të larta, që tregon se të dy treguesit janë më të favorshëm në Vojvodinë se në të gjitha rajonet tjera (duke përfshirë edhe Beogradin).

Tabela 7.6. Serbia: treguesit kryesor të strukturës së fermave, 2012

	2012
SBSh për fermë (ha)	5.4
% e fermave me SBSh< 1 ha	28.2
NjSB për fermë me NjSB	4.1
% e fermave me NjSB< 1	28.4
PS për fermë (Euro)	5,918
% e fermave me PS< 2,000 Euro	45.9

Burimi: Baza e të Dhënave e Statistikave Bujqësore – Serbia, 2015.

Në përgjithësi, nga perspektiva rajonale, ekonomitë e fermave të vogla dhe gjysëm-ekzistenciale janë të përqëndruara në pjesën jugore të vendit, ndërkaq të ndara sipas sektorit ato kryesisht janë të përfshira në kultivimin e frutave dhe perimeve dhe në drithëra, dhe më pak në bimë foragjere. Rreth 80 % e të punësuarve në bujqësi (shprehur në NjVP) janë në njësitë ekzistenciale: fermat me PS më pak se 2,000 euro. Në anën tjetër, në rajonin verior (Vojvodinë), më shumë se 75 % të punësuarve në fermave punojnë në ferma që marrin PS më shumë se 250,000 euro (Bogdanov dhe Babović 2014).

Vetëm 12 % të ekonomive të fermave janë të përfshirë në diversifikimin e të ardhurave në fermë. Karakteristika e këtyre fermave janë se 65 % drejtohen nga menaxherët e fermave që janë mbi moshën 55 vjeçare, ato kryesisht gjënden në pjesën jugore të vendit (mbi 85 %), ato kanë PS më pak se 4,000 euro dhe për nga specializimi kanë blegtori apo sistemet e përziera të prodhimit (kulturat bimore dhe perime, blegtori të përzier, kryesisht për prodhimin e qumështit). Shifrat më lartë sugjerojnë se fermat familjare të vogla dhe të mesme janë shumë aktive, duke kërkuar të ardhura plotësuese dhe mekanizma për përballimin e vështirësive në bujqësi (Bogdanov dhe Babović 2014).

7.5.2 Politikat e lidhura me çështjet e fermave

Procesi i ristrukturimit të fermave në Serbi është bërë në mënyrë spontane dhe të ngadalshme. Qeveria i'u dha fermerëve dhe investitorëve një mesazh jo të qartë dhe të papërshtatshëm rreth drejtimit të dëshiruar për zhvillimin e fermave.

Politika bujqësore nuk është i përgjigjur në mënyrën e duhur nevojës për të përshpejtuar ndryshimet strukturore. Masat e mbështetjes për përshpejtimin e ndryshimeve strukturore janë përzgjedhur në mënyrë jo të përshtatshme dhe janë zbatuar vetëm herë

pas here (stimuj me norma fikse për fermerët "pasivë" me qëllim të aktivizimit të tregut të tokës me qera, normat e subvencionuara të interesit për kreditë afatgjata, etj.). Fakti që fermat e Serbisë janë mjaft të shumëllojshme në madhësi fizike dhe ekonomike, llojin e bujqësisë që kryejnë dhe gjenerimin e të ardhurave nënkupton se nevojiten masa mbështetëse më të larmishme dhe më të mirë shënjestruara, në vend të mbështetjes me "një masë për të gjithë".

Sfidat kryesore për politikat bujqësore në lidhje me ristrukturimin e fermave janë:

- Theksi aktual për mbështetjen për njësi sipërfaqe dhe për numër krerësh të kafshëve (mbi 90% e transfertave për prodhuesit) mundëson përfitime më të mëdha për fermerët e mëdhenj, ndërsa fermat e vogla dhe të mesme mbeten të kufizuara në përpjekjet e tyre për të reformuar, modernizuar dhe për të rritur madhësinë e fermës. Përveç kësaj, fondet për mbështetjen e investimeve në fermë janë jashtëzakonisht të ulëta dhe kushtet për shfrytëzimin e tyre janë shumë të ndërlikuara për shumicën e fermave të vogla dhe të mesme.
- Përveç të metave konceptuale dhe mungesës së financimit, ekzistojnë pengesa të konsiderueshme për të patur ndryshime më dinamike strukturore, në vecanti mangësitë në funksionimin e mbështetjes buxhetore. Një nga problemet më të mëdha është përfaqësimi i ulët i fermave dhe sipërfaqes bujqësore në regjistrin e fermave. Numri i përfituesve të mbështetjes buxhetore (treguar nga fermerët aktiv të regjistruar në regjistrin e fermave) është i vogël (310,000-320,000, d.m.th. rreth 50%), ashtu siç është edhe sipërfaqja që ata kultivojnë (rreth 1.2 milion ha).
- Larmishmëria e thellë rajonale në strukturën e fermës nuk është trajtuar në mënyrën e duhur nga mbështetja buxhetore; mbështetja dominohet nga subvencionet e inputeve variabël për kulturat bimore, që rezulton në përfitime të disbalancuara midis rajoneve. Kjo strukturë e buxhetit është më e favorshme për përfituesit në Vojvodinë, për shkak se ata kanë qenë në masë të madhe të mbuluar nga regjistri i fermës dhe fermat në këtë rajon janë më të mëdha.
- Edhe pse ka pasur ndihma të larta kompensuese për fermat në ZMPF-të, lista e masave mbështetëse nuk është përshtatur për llojet e prodhimit që mbizotërojnë në zona të tilla dhe për nevojat e tyre specifike.

Duke pasur parasysh profilin demografik të popullsisë rurale të Serbisë, dhe zhvillimet në tregun e punës, për ristrukturimin e fermave nuk duhet të kontribuojë vetëm politika bujqësore . Për të përmirësuar konkurrencën, sektori i fermave ka nevojë për mundësitë e punësimit për tepricën e fuqisë punëtore në fermat familjare. Dinamika e ngadaltë e ristrukturimit dhe zhvillimet në pjesë të tjera të ekonomisë së Serbisë që nga vitet 1990 nuk e favorizojnë tregun rural të punës. Prandaj, koordinimi horizontal dhe një përzierje e programeve të ndryshme të zhvillimit rural dhe social janë të nevojshme për të përshpejtuar procesin e transferimit të aseteve (të pakta)të fermës në brezat e ardhshëm.

7.6 Procesi i integrimit në BE

Këshilli Evropian ka miratuar vendimin për t'i dhënë Serbisë statusin e kandidatit për anëtarësim në BE më 1 mars 2012, dhe më 28 qershor 2013 ka vendosur të hapë negociatat e anëtarësimit me Republikën e Serbisë. Negociatat për anëtarësim në BE kanë filluar zyrtarisht më 21 janar 2014. Procesi i shqyrtimit (ekzaminimit) për Serbinë në fushën e bujqësisë filloi në shtator 2013 dhe përfundoi në fund të marsit 2015.

Harmonizimi i kuadrit të politikave është vendosur si prioritet për politikëbërësit, dhe ka patur arritje në këtë drejtim. Serbia është tashmë duke aplikuar disa instrumente të politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural të ngjashme me PPB-në, por masat mbështetëse nuk janë në përputhje me *aktin komunitar*. Në përgjithësi, përafrimi me

aktin komunitar mbetet në një fazë të hershme dhe është duke ecur me hapa të ngadalshëm.

Deri vonë, progresi drejt zbatimit aktual të IPARD-it është penguar me vonesat në krijimin e strukturave të nevojshme operacionale. Viti 2015 ka sjellë progres të konsiderueshëm në shumicën e çështjeve të mbetura pezull: në shkurt të vitit 2015 është rivendosur Drejtoria për Pagesat Agrare (Agjencia e Pagesave) , janë duke vazhduar aktivitetet për përkufizimin e standarteve minimale kombëtare dhe ka nisur rekrutimi i personelit.

Bazuar në përvojat e anëtarësimeve paraprake, krijimi i mjedisit për absorbimin (thithjen) e mirë të fondeve është faktor kryesor për efektshmërine e IPARD-it. Aktualisht, sfidat kryesore për Serbinë janë (i) vazhdimi i angazhimit për të punuar në strukturat e IPARD-it, (ii) rekrutimi dhe trajnimi dhe (iii) përgatitja e publikut të gjerë, veçanërisht përfituesit dhe institucionet rurale të financave, për thithjen e fondeve të IPARD-it, gjë që mbetet si çështje vendimtare. Megjithatë, viti 2016 mbetet viti i synuar, por në këtë fazë është ende herët për të thënë se zbatimi i IPARD mund të arrihet në kohën e caktuar.

7.7 Përfundimet dhe rekomandimet

7.7.1 Objektivat dhe sfidat kryesore të politikave

Gjatë 10 viteve të fundit bujqësia e Serbisë eshte karakterizuar nga stanjacioni (ose rritja e ngadalësuar), rritje të ndjeshme të eksporteve dhe një përqindje relativisht e lartë e shpenzimeve të përgjithshme të ekonomive familjare që shkojnë për ushqim. Ky paradoks tregon zhbalancime strukturore dhe kufizimet brënda zinxhirit të vlerave, si dhe shumë hapësirë për përmirësim të mëtejshëm.

Analiza e ndryshimit të PBBQ-së sipas sektorëve tregon se madhësia e tufave dhe prodhimi blegtoral janë duke rënë (ashtu si edhe PBBQ-ja), ndërsa PBBQ-ja e kulturave bujqësore ndryshon në madhësi dhe përbërje. Si produkti ashtu edhe rritja e eksportit të sektorit në 10 vitet e fundit bazohen në disa grupe të mallrave: drithëra, bimët industriale, dhe frutat e perimet. Ky kontekst tregon se burimet e mëdha dhe të larmishme bujqësore të Serbisë përdoren dobët.

Liberalizimi i tregtisë, si hap drejt anëtarësimit në BE, dhe marrëveshjet e reja tregtare me vendet që nuk janë në BE kanë kontribuar në ndryshimin e rregullave tregtare ndërkombëtare të Serbisë. Këto ndryshime e kanë ekspozuar sektorin bujqësor në një nivel të lartë të konkurrencës, duke ngritur çështjen e aftësisë së tij për të konkurruar në tregjet vendore dhe ndërkombëtare. Të dhënat e fundit tregojnë se sektori bujqësor ka mangësi mbi industritë tjera në aftësinë konkurruese të eksportit, pasi që është i vetmi sektor me një bilanc pozitiv tregtar. Megjithatë, ndërsa konkurrenca e shumë mallrave bujqësore është e lartë, që nuk është rasti i industrisë ushqimore: struktura e eksporteve është e dominuar nga produktet primare bujqësore (rreth 79%), ndërkohë që tek importet kjo prezencë është më pak e theksuar(65%). Nga ana tjetër, produktet e përpunuara bujqësore arrijnë në vetëm rreth 20% të eksporteve (28% e importit).

Mbizoterimi i fermave të vogla është pengesë kryesore për rritje më dinamike. Ndërsa Vojvodina ka përjetuar ndryshime më dinamike strukturore dhe ka një strukturë të favorshme të fermave (përqindje më e lartë e fermave më të mëdha), pjesët jugore të Serbisë janë të kufizuara nga toka më pak e favorshme, struktura të pavolitshme të fermave dhe burime të pashfrytëzuara bujqësore. Politika bujqësore nuk adreson siç duhet dallime të tilla të gjera rajonale në madhësinë e fermës dhe llojin e punimeve bujqësore.

Korniza aktuale e politikave ka një theks të fortë në mbështetjen e drejtpërdrejtë për sipërfaqe dhe numër krerësh për kafshë, dhe ajo financon masat e zhvillimit rural vetëm në mënyrë modeste. Kjo ka penguar ristrukturimin më dinamik të fermave të vogla dhe

të mesme. Mbi 90% e buxhetit bujqësor është ndarë për pagesat e drejtpërdrejta dhe është përdorur kryesisht nga fermerët më të mëdhenj; kjo ka bllokuar reformat strukturore në një numër të madh të fermave të vogla dhe të mesme.

Mbështetja e disbalancuar gjithashtu nënkuptonte që fermerët në pjesën veriore të vendit (Vojvodinë) kanë marrë pjesën më të madhe të fondeve, duke përkeqësuar pabarazitë rajonale (tashmë të thella). Deri tani, fermerët në zonat e marxhinalizuara rurale nuk kanë përfituar shumë nga politikat bujqësore. Edhe pse ka pasur ndihma më të larta kompensuese për fermat në ZMPF-të, lista e masave mbështetëse të zhvillimit rural nuk është përshtatur për llojet e prodhimit që mbizotërojnë në zona të tilla dhe nevojat e tyre specifike.

Koncepti dhe kuadri i politikave bujqësore janë dalluar shumë nga zhvillimet e përgjithshme politike dhe ekonomike. Shuma, struktura dhe mekanizmat e zbatimit të mbështetjes buxhetore janë të gjitha të paqëndrueshme, duke reflektuar mungesën e drejtimit strategjik dhe të porosive të qarta për përdoruesit. Një qasje e tillë nuk është as efektive e as në gjendje të adresojë siç duhet kufizimet mbi zhvillimin e sektorit.

Përshtatjet e politikave vendore bujqësore me PPB deri më tani kanë qenë josistematike, të pjesshme dhe jo mjaftueshëm të koordinuara. Në rrethana të tilla, pa bashkëveprimin e reformave të politikave, buxheti është shfrytëzuar keq, pavarësisht nga përmasat e tij. Për më tepër, disa ndryshime të reformave janë bërë me nxitim dhe kanë provokuar pasoja të forta (direkte dhe indirekte) në dinamikën e reformave strukturore dhe klimën e investimeve (liberalizimi i parakohshëm i tregut, duke lejuar tokën bujqësore që t'u shitet të huajve, etj.).

7.7.2 Rekomandimet e politikave

Të zgjerohet baza për rritjen e sektorit, duke përfshirë më shumë ferma, më shumë tokë dhe më shumë nënsektorë me potencial për rritje.

Më shumë ferma dhe sipërfaqe bujqësore duhet të mbështeten. Struktura e fermës dominohet nga ferma të vogla dhe të mesme me të ardhura të përziera. Shumica e fermave janë shumë të vogla dhe joefikase për të qenë konkurruese, si për eksport ashtu edhe në tregun e liberalizuar të brendshëm (qumësht, mish derri dhe viçi).

- Një sfidë e veçantë për vendimmarrësit e politikave është që të nxisin rritjen e produktivitetit në numër të madh të fermave të vogla dhe të mesme (5-20 ha). Shumë prej këtyre fermave kanë të ardhura të përziera dhe janë dyfish të kufizuara, si nga mungesa e mundësive për punësim jashtë bujqësisë edhe nga procesi i ngadalshëm i konsolidimit të fermës. Politika bujqësore duhet t'i japë përparësi veçanërisht atyre fermave që kanë fuqinë aktive të punës dhe kanë treguar interesim për modernizimin dhe rritjen e madhësisë së fermës.
- Rritja e qasjes së fermerëve në mbështetjet buxhetore si për tokën në pronësi ashtu edhe për tokën e dhënë me qera është instrumenti kryesor për të zgjeruar madhësinë e fermës. Duke pasur parasysh se dhënia me qera e tokës kontribuon në zgjerimin e fermave dhe konsolidimin e tokës, nga perspektiva e përdorimit të saj në mënyrë racionale është e papranueshme që kjo sipërfaqe të përjashtohet nga mbështetja. Kërkesat e pranueshmërisë për përfituesit janë ndryshuar disa herë (dhe ende shkaktojnë probleme). Që nga viti 2015 e drejta për pagesa direkte ka qenë e kufizuar në 20 ha për fermë, në një përpjekje për të kufizuar financimin e prodhuesve të mëdhenj. Nga ana tjetër, kriteret për atë se cila klasë dhe kategori e tokës mbështetet, nuk janë përcaktuar dhe harmonizuar me kadastrën e tokës, duke treguar pengesat sistematike për një shfrytëzim më racional të fondeve.
- Menaxhimi i tokës shtetërore dhe të drejtave të pronës mbi tokën që ishte në pronësi të kooperativës i'u nënshtrohet diskutimeve dhe ende nuk është zgjidhur. Debatet publike janë duke u zhvilluar në një atmosferë frike në lidhje me rrezikun

se një elitë është duke kapur ngastra të mëdha të tokës. Për të përshpejtuar konsolidimin e tokës dhe ristrukturimin e fermës duhet të sigurohen aksesi i barabartë në tokë (eliminimi i kufizimeve në tregjet e tokës) dhe mbrojtja e të drejtave të pronës .

Mallrat e reja dhe nënsektorët duhet të vihen në shënjestër nga programe të udhëhequra më mirë për mbështetjen thelbësore.

- Mbarështimi i blegtorisë është një nga sektorët më premtues. Pavarësisht nga një rënie në fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe rënie të theksuar të madhësisë së kopesë në 10 vitet e fundit, mbarështimi i blegtorisë ka një traditë të gjatë të prodhimit të cilësisë së lartë dhe mundësi që të bëhet një industri konkurruese në rritje dhe me kualitet të lartë. Mungesa e mundësive për të eksportuar mish të freskët e ka parandaluar zhvillimin e industrisë së mishit. Rimëkëmbja e kësaj industrie (me kontrollin dhe çrrënjosjen e etheve klasike të derrave) duhet të kontribuojë në çmime dhe prodhim më të qëndrueshëm, dhe rritjen e mëtejshme të eksporteve.
- Pjesa veriore e Serbisë qendrore ka kushte të favorshme për kulturë bimore të përzier dhe bujqësinë blegtorale, bujqësinë organike dhe prodhimin e frutave. Përshpejtimi i ristrukturimit të fermës në këtë rajon nuk është një çështje vetëm e madhësisë relative të pagesave direkte dhe përkrahjes për zhvillimin rural. Kjo kërkon koordinimin e një game të gjerë të aktiviteteve dhe përfshirjen e aktorëve të ndryshëm (skemat e daljes në pension më herët, mbështetja me një normë të sheshtë për fermat e vogla, skemat agro-mjedisore, forcimi i zinxhirëve të vlerës).
- Shumë produkte bujqësore janë tepër konkurrues në tregun ndërkombëtar, por industria e përpunimit për shumë mallra është nën nivelin e pritshëm. Konkurrueshmëria e disa nënsektorëve është ndërtuar mbi ekzistencën e një tregu të madh dhe shumë të mbrojtur të brendshëm (mishi, produktet e qumështit, disa perime), ndërsa të tjerët mbështeten në suksesin e një numri të vogël të drejtuesve të mëdhenj (sheqeri, vajra vegjetalë). Me liberalizimin e tregut, këto industri do jenë të ekspozuar ndaj konkurrencës së fortë. Kjo tregon se reformat strukturore përgjatë tërë zinxhirit të vlerës janë të nevojshme, më tepër se mbështetja direkte e prodhuesit.

Përzgjedhja më e mirë dhe shënjestrimi i duhur i masave të zhvillimit rural është e nevojshme për të adresuar pabarazitë rajonale dhe reformat urgjente strukturore.

- Pabarazitë e thella dhe në rritje rajonale në burime natyrore, asetet e fermës dhe llojin e punimeve të fermës, duhet të merren parasysh për të siguruar trajtimin e të gjithë përfituesve të politikave në mënyrë të barabartë dhe balancimin e nevojave të tyre. Për të arritur këtë qëllim, vendimmarrësit e politikave duhet të jenë më të ndjeshëm për faktin se investimi në bujqësi nuk është vetëm për të përmbushur objektivat e saj ekonomike, por edhe për krijimin e strukturave më të favorshme sociale dhe të mirave publike. Prandaj, është thelbësore që të rishpërndahen fondet buxhetore në mes të pagesave direkte për sipërfaqe/ numër krerësh për krerë dhe zhvillimit rural dhe masave strukturore.
- Me të drejtë, ekziston frika se mbështetja e investimeve të fermës (e cila dominon në shtyllën e dytë) dhe përmirësimi i objekteve të përpunimit të ushqimit do të merren në masë të madhe nga ferma më të mëdha nga rajonet më të zhvilluara. Për këtë arsye, është e rëndësishme të krijohen masat që do të sigurojnë përfitime për fermerët e vegjël dhe ata në zonat margjinale, për të rritur integrimin e tyre në zinxhirin e tregut dhe për të zvogëluar rrezikun e të ardhurave. Masat që mbështesin diversifikimin e të ardhurave të fermës dhe aksesi në shërbime sociale dhe financiare, si dhe sigurimi i rrjetave të sigurisë, duhet të merren parasysh me qëllim për të rritur aftësinë ripërtëritëse të bujqësisë në ferma të vogla.

- Produktiviteti i lartë i punës është çelësi për përmirësimin e aftësisë konkurruese të numrit të madh të fermave (gjysmë) ekzistenciale. Ky objektiv kërkon lehtësimin e ndryshimeve në strukturën e fermës me kapitalizmin dhe modernizimin e burimeve të fermës, si dhe duke ulur papunësinë e fshehur. Duhet të futen skema mbështetëse për fermerët e rinj dhe të inkurajohet transferimi i aseteve mes brezave. Duke marrë parasysh zhvillimet demografike, një grup i instrumenteve (që përfshijnë politikat e ndryshme), duhet të zbatohen për të ndihmuar fermerët e rinj që t'i kapërcejnë barrierat për hyrje në bujqësi. Masa të tilla do të kontribuojnë në aktivizimin e tregut të tokës dhe në reformat strukturore më dinamike (përveç ndikimeve pozitive sociale).

Një ndryshim i politikave është i nevojshëm për të siguruar një përdorim më efektiv të kuadrit të politikave aktuale, me të cilat mund të mësohen si prodhuesit ashtu edhe administratorët.

- Mbështetja e buxhetit për bujqësi në periudhën e studimit kryesisht është luhatur brenda një intervali prej 4-5% të shpenzimeve të përgjithshme publike, por ka rënë në 3.5% në vitet e fundit. Krahasimet me vendet e tjera tregojnë se madhësia relative e mbështetjes buxhetore (për hektar ose për fermë) në Serbi është shumë më e ulët (Volk et al. 2014). Nga ana tjetër, duket se shuma e buxhetit bujqësor në shifra të tilla pra 12% të VSHB-së së sektorit, është e pranueshme për pozitën aktuale të ekonomisë së Serbisë. Megjithatë, efektet e debatueshme të së kaluarës dhe zhvillimet më të fundit në mbështetje të politikave arsyetojnë krijimin e një sistemi që do të maksimizojë efektivitetin dhe efikasitetin e shpenzimeve publike për bujqësinë.
- Është e nevojshme që dokumentet e programimit të përafrohen me njëri-tjetrin dhe të vihen në praktikë, si edhe të qartësohet lidhja me atë se çfarë duhet të arrihet nga mbështetja e buxhetit. Rritja e mbështetjes buxhetore, pa objektiva dhe tregues të përcaktuar qartë për monitorimin e zbatimit të tyre, nuk ka kuptim.
- Luhatshmëria në shpenzimet buxhetore, përsa i përket vlerës vjetore dhe masave mbështetëse, pasqyron të kuptuarit e dobët konceptual të lidhjeve brenda sektorit agroushqimor. Disa nga masat e politikave dhe skemat mbështetëse duhet të rivlerësohen për sa i përket aftësisë së tyre për të kontribuar në arritjen e objektivave të planifikuara (p.sh. subvencionimi i qumështit kanë rezultuar në çmime relativisht të larta të prodhuesve, por gjithësesi nuk arriti të parandalojë rënien e numrit të lopëve mjelëse dhe prodhimin e qumështit).

Aktivitetet në lidhje me integrimin në BE duhet të koordinohen më mirë dhe të udhëhiqen nga objektivat më të qarta që u japin prioritet interesave kombëtare.

- Ndryshimet e fundit dinamike në politikat bujqësore, sa i përket legjislacionit, kuadrit konceptual dhe futjes së llojeve të reja të mbështetjes, janë të shtyrë të gjitha nga progresi drejt integrimit në BE. Disa nga këto zgjidhje janë pranuar pa kushte, pa marrë parasysh prioritetet kombëtare, specifikat dhe kapacitetet. Duke qënë se Serbia ka statusin e vendit kandidat (që është vetëm një fazë paraprake në procesin e anëtarësimit në BE), dhe nuk është e detyruar të përafrojë politikën bujqësore me PPB para anëtarësimit në BE, vendimmarrësit e politikave duhet të adresojnë në mënyrë proaktive disbalancat e brendshme e të paqëndrueshme strukturore me efekte të dëmshme mbi performancat e sektorit agroushqimor dhe jetesën rurale, në mënyrë që ata të mund të përafrojnë gradualisht politikën kombëtare me PPB.
- Masat mbështetëse të përdorura në periudhën e para-anëtarësimit duhet të jenë ato që do të rrisnin aftësinë konkurruese në mënyrë që Serbia të mund të përballet me tregun e gjerë të BE-së në mënyrë efikase. Prandaj, duhen bërë më shumë përpjekje për harmonizimin e politikave të ndryshme dhe instrumentave të politikave që lehtësojnë reformën strukturore të fermave, inkurajojnë investimet, forcojnë zinxhirët e vlerave dhe ruajnë strukturat sociale rurale. Theksi aktual mbi

pagesat për sipërfaqe dhe për numër krerësh për blegtorinë, subvencionimi i produkteve (qumështit) dhe subvencionimi i inputeve (si karburantit) ruan strukturën aktuale të fermave dhe redukton fondet buxhetore në dispozicion për investime.

- Ndërtimi i ambientit institucional të nevojshëm nga BE-ja për ofrimin e programit IPARD është nevojë urgjente. Krijimi i ambientit për absorbimin e mirë të fondeve është një faktor kyç për efektshmërinë e IPARD-it. Deri tani këto përpjekje kanë qenë të përqendruar në ndërtimin e institucioneve për mbikëqyrjen dhe zbatimin e programeve. Detyrave administrative lidhur me procesin e ndërlikuar të aplikimit, instrumentave financiare dhe promovimit të programit u është dhënë vëmendje e kufizuar.

Referencat

Baza e të dhënave e Statistikave Bujqësore (2015). Baza e të dhënave e statistikave bujqësore e përpiluar për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën*, IRJ të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë në kuadër të projektit të SWG IPTS: "Analiza e politikave bujqësore dhe zhvillimit rural të vendeve të Ballkanit Perëndimor". E aksesueshme në: http://app.seerural.org/agricultural-statistics/.

Baza e të dhënave e MPB-ve. (2015). Baza e të dhënave e Masave të Politikave Bujqësore e përpiluar për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën*, IRJ të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë në kuadër të projektit të SWG IPTS: "Analiza e politikave bujqësore dhe zhvillimit rural të vendeve të Ballkanit Perëndimor" (të dhëna të pabotuara).

Bajramoviç, S., Nikoliç, A., Butkoviç, J. (2014). Bujqësia dhe Politikat Bujqësore në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në: Volk, T., Erjavec, E., Mortensen, K. (redaktorë): Politika bujqësore dhe Integrimi Evropian në Evropën Juglindore, FAO, Budapest.

Bogdanov, N. (2014). Zhvillimi i mbështetjes për zonat më pak të favorizuara dhe rajonet jo të privilegjuara: Sfida e politikës bujqësore në Serbi. Kongresi i EAAE-së: Agro-Ushqimi dhe Inovacionet Rurale për Shoqëritë më të Shëndetshme, gusht Lubjanë (Slloveni).

Bogdanov, N., Baboviç M. (2014). Fuqia punëtore dhe aktivitetet e ekonomive bujqësore – Regjistrimi i bujqësisë në Serbi 2012. Zyra Statistikore e Republikës së Serbisë, Beograd (Serbi).

Bogdanov, N., Rodiç, V. (2014). Bujqësia dhe Politikat Bujqësore në Serbi. Në: Volk, T., Erjavec, E., Mortensen, K. (redaktorë): Politikat Bujqësore dhe Integrimi Evropian në Evropën Juglindore, FAO, Budapest, f.153–169.

Drejtoria për planifikimin ekonomik (2015). Trendet ekonomike të Bosnjës dhe Herzegovinës. Raporti vjetor për vitin 2014, Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Sarajevë.

KE (2014a). Raporti i Progresit për Shqipërinë për vitin 2014. Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2014-2015. Dokumentet e Punës së Stafit të Komisionit. Bruksel.

Erjavec, E. (2007). Politika e përbashkët bujqësore e BE-së, detyrat dhe procesi i integrimit të Ballkanit Perëndimor. Në: Shevarljiç, M., Tomiç, D. (redaktorë): Zhvillimi i zonave bujqësore dhe rurale në Evropën Qendrore dhe Lindore: punimet e dokumenteve dhe abstrakteve plenare, Shoqata e Ekonomistëve Bujqësore të Serbisë, Zemun, f. 39–43.

Erjavec, E., Mortensen, K., Volk, T., Rednak, M., Eberlin, R., Ludvig, K. (2014). Analiza e Mangësive dhe Rekomandimet. Në: Volk, T., Erjavec, E., Mortensen, K. (redaktorë): Politika Bujqësore dhe Integrimi Evropian në Evropën Juglindore, FAO, Budapest.

Erjavec, E., Rednak, M., Bajramoviç, S. (2010). Politika e Përbashkët Bujqësore e BE-së dhe Sfidat që e presin Bosnjën dhe Hercegovinën. Punimet e Fakultetit të Bujqësisë dhe Shkencave të Ushqimit të Universitetit të Sarajevës, Vëllimi LV, Nr 60/1, Sarajevë.

Eurostat (2015). Baza e të dhënave e statistikave Evropiane. E aksesueshme në: http://ec.europa.eu/eurostat/web/agriculture/data.

Kotevska, A., Martinovska Stojceska, A. (redaktorë) (2015). Ndikimi i strukturës socio-ekonomike të popullsisë rurale në suksesin e politikave të zhvillimit rural. Shoqata e Ekonomistëve Bujqësor të Republikës së Maqedonisë, Shkup.

Kotevska, A., Martinovska Stojcheska, A., Tuna, E., Simonovska, A. (2015). A ndikojnë rrjetet në qëllimin e fermerëve për të aplikuar për programin e zhvillimit rural?

Material i prezantuar në Konferencën e Përbashkët Shkencore Ndërkombëtare: Perspektivat Agrare XXIV dhe Konferenca e 25-të Vjetore e Shoqërisë Austriake të Ekonomisë Bujqësore, Pragë (Republika Çeke).

MBPZHR (2012). Raporti i Vlerësimit Afatmesëm i PZHBR-së 2007-2013. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë.

MBPZHR (2013a). Programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014–2020. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë.

MBPZHR (2013b). Raporti i Gjelbër, Kosovë* 2013. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë.

MBPEU (2014). Strategjia Kombëtare Bujqësore dhe e Zhvillimit Rural (SKBZhR) 2014–2020. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave e Maqedonisë, Shkup.

MBPEU (2015). Raporti Vjetor Bujqësor 2015. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave e Maqedonisë, Shkup.

MBZHR (2015a). Informacione mbi tregtinë e jashtme të produkteve bujqësore në Malin e Zi në vitin 2014. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Podgoricë, Mars 2015.

MBZHR (2015b). Strategjia për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale 2015–2020. Drafti, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Podgoricë.

MBZHRAU (2013). Vjetari statistikor. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Tiranë.

MBZHRAU (2014). Strategjia Ndër-sektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (SNBZHR 2014-2020). Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Tiranë.

MONSTAT (2010). Regjistrimi Bujqësor në Malin e Zi, Zyra Statistikore e Malit të Zi. E aksesueshme në: http://www.monstat.org/eng/.

Nikoliç, A., Uçar, K., Uzunoviç, M. (2014). Ndikimi i politikave publike në aftësinë konkurruese të bujqësisë në BeH. Punimet e Konferencës së 24-të Shkencore të Ekspertëve në Bujqësi dhe Industrinë Ushqimore, Sarajevë.

OECD (2008). Vlerësimi i OECD-së për Mbështejen e Prodhuesve dhe treguesit e ngjashëm të mbështetjes bujqësore: Konceptet, llogaritjet, interpretimi dhe përdorimi (manuali i PSE-së), Drejtoria e OECD-së për Tregti dhe Bujqësi, Paris.

Pejanoviç, M. (2013). Pluralizmi politik dhe demokracia parlamentare në Bosnjë dhe Hercegovinë. Konferenca Ndërkombëtare: Zhvillimi i demokracisë, Instituti i Studimeve Humaniste Nova Revija, Lubjanë, Slloveni. E aksesueshme në: http://institut-nr.si/wp-content/uploads/2014/06/mirko-pejanovi%C4%87.pdf

Pringle, R., Burlini, E. Schiessl, M. (2014). Vlerësimi për programin IPARD dhe ndihmës për sektorin bujqësor dhe Zhvillimin Rural në Republikën e Maqedonisë.

Qineti, A., Rajcaniova, M., Braha, K., Ciaian, P, Demaj, J. (2015). "Paragjykimi i gjendjes ekzistuese të strukturave agrare të tokës në Shqipërinë rurale." 27(4): 517–536.

Rednak, M., Volk, T., Erjavec, E. (2013). Një mjeti për klasifikimin uniform dhe analizat e mbështetjes buxhetore për bujqësinë për vendet e anëtarësimit në BE. Shqyrtimi i Ekonomisë Bujqësore, 2013, vëll. 14, nr. 1, 76–96.

Sadikoviç, E. (2015). Reforma e administratës publike në kontekstin e riorganizimit territorial të Bosnjës dhe Hercegovinës. Konferenca Ndërkombëtare: Zhvillimi i demokracisë, Instituti i Studimeve Humaniste Nova Revija, Zagreb, Kroaci. E aksesueshme në: http://institut-nr.si/wp-content/uploads/2015/05/Sadikovi%C4%87-Elimir-Razvoj-demokracije-28.-4.-29.-4.-2015-Zagreb.pdf.

Terry, D. (2013). Ekonomia Politike e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Mundësitë për Reformë. Pikëpamja e Botës së Globalizuar. E aksesueshme në: http://thegwpost.com/tag/reforms/

UNDP (2013). Raporti i Zhvillimit Njerëzor i Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 2013: Zhvillimi Rural në Bosnje dhe Hercegovinë: Miti dhe Realiteti, Sarajevë.

Volk, T., Erjavec, E., Mortensen, K. (redaktorë) (2014). Politika Bujqësore dhe Integrimi Evropian në Evropën Juglindore. Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO-UN). Budapest. E aksesueshme në: http://seerural.org/wp-content/uploads/2009/05/FAO-SWG-Book-12-11-2014_Final.pdf.

Volk T., Rednak M., Erjavec, E. (2014). Analiza midis Vendeve të Ndryshme e Bujqësisë dhe Politikave Bujqësore të Vendeve të Evropës Juglindore në krahasim me Bashkimin Evropian. Në: Volk, T., Erjavec, E., Mortensen, K. (redaktorë): Politikat Bujqësore dhe Integrimi Evropian në Evropën Juglindore, FAO, Budapest.

Volk, T. (ed.) (2010). Bujqësia në vendet e Ballkanit Perëndimor. Studime mbi sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit në Evropën Qendrore dhe Lindore, vëll. 57. Instituti i Leibniz-it për Zhvillimin Bujqësor në Evropën Qendrore dhe Lindore (IAMO), Halle (Saale). E aksesueshme në: http://www.iamo.de/dok//sr_vol57.pdf.

Europe Direct është një shërbim për t'ju ndihmuar ju të gjeni përgjigje për pyetjet tuaja rreth Bashkimit Evropian
Numër telefoni pa pagesë (*): 00 800 6 7 8 9 10 11
(*) Operatorë të ndryshëm të telefonisë celulare nuk lejojnë aksesin në numrat 00 800 ose këto telefonata mund të faturohen.

Një pjesë e madhe e informaciove shtesë mbi Bashkimin Evropian është në dispozicion në internet.
Këto informacione mund të arrihen përmes serverit Europa http://europa.eu

Si të sigurohen publikimet e BE-së

Publikimet tona janë të disponueshme në Librarinë e BE-së (http://bookshop.europa.eu),
ku ju mund të bëni një porosi me agjentët e shitjeve sipas zgjedhjes tuaj.

Zyra e Botimeve ka një rrjet ndërkombëtar të agjentëve të shitjeve.
Ju mund të siguroni detajet e tyre të kontakteve duke dërguar një faks në (352) 29 29-42758.